



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**

**PUNIM DOKTORATURE**

**ÇËSHTJE TË VARIACIONIT  
GJUHËSOR NË MJEDISIN  
UNIVERSITAR TË QYTETIT TË  
VLORËS**

**Punoi**

**Ma. Doriana KLOSI**

**Udhëhoqi**

**Prof. dr. Valter MEMISHA**

**Tiranë, 2014**

---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**

**Tezë në kërkim të gradës shkencore**

**“DOKTOR”**

**Fusha: Gjuhësi**

**Specialiteti: Sociolinguistikë**

**Tema: ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR NË  
MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS**

**Autor**

**Ma. Dorjana KLOSI**

**Drejtues shkencor**

**Prof. dr. Valter MEMISHA**

**JURIA**

- 1) \_\_\_\_\_ **Kryetar**
- 2) \_\_\_\_\_ **Oponent**
- 3) \_\_\_\_\_ **Oponent**
- 4) \_\_\_\_\_ **Anëtar**
- 5) \_\_\_\_\_ **Anëtar**

**Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2014**

Gjuha shqipe është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar.

Holger Pedersen

*Darius-it,  
Për çdo buzëqeshje të dhuruar!*

*Falenderime*

*Çdo punë shkencore e rëndësishme, nuk mund të realizohet pa kontributin shkencor dhe emocional të shumë njerëzve. Të gjithë ata meritojnë falenderime të veçanta.*

*Dëshiroj të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen time për udhëheqësin shkencor, Prof. dr. Valter Memisha, për kujdesjen e dashamirësinë e tij, për mendimet e sugjerimet që më ka dhënë me përvojën e vet të vyer.*

*Veçanërisht falenderoj të gjithë studentët e Universitetit "Ismail Qemali" që morën pjesë në realizimin e anketave dhe bisedave nëpërmjet të cilave u mbledhën e gjithë lëndat gjuhësore e shfrytëzuar në këtë punim.*

*Falenderim i veçantë për familjarët e mi, sidomos dy prindërit e mi të mrekullueshëm që nuk kanë ngurruar të më mbështesin e përkrahur në çdo hap të studimit tim të gjatë dhe të vështirë.*

PASQYRA E LËNDËS

ÇËSHTJE TË VARIACIONIT GJUHËSOR  
NË MJEDISIN UNIVERSITAR TË QYTETIT TË VLORËS

|   |           |
|---|-----------|
| I. Hyrje.....   | 9         |
| a. Metodologjia .....   | 13        |
| b. Përqasja e përgjithshme metodologjike.....   | 14        |
| 1. Përzgjedhja e pjesëmarrësve.....   | 14        |
| 2. Moshë dhe statusi social i pjesëmarrësve.....  | 14        |
| 3. Shoqëria.....  | 15        |
| 4. Përmasa e grupit.....  | 15        |
| 5. Vendi i realizimit të bisedës.....   | 15        |
| 6. Tematika e bashkëveprimit.....   | 16        |
| c. Subjektet .....  | 16        |
| d. Mekanizmat/mjetet e punës kërkimore. Anketimi, vëzhgimi.....   | 16        |
| <b>II. Kreu i parë: Komunikimi gjuhësor në shqipen standarde dhe marrëdhëniet e ndërsjella të standardit me njësitë dialektore.....</b> | <b>19</b> |
| a. Komunikimi në shqipen standarde.....   | 19        |
| Rast studimi 1.....   | 23        |
| b. Ndikimi i standardit dhe marrëdhëniet gjuhë e njësuar / nëndialekt / idiolekt.....   | 28        |
| c. Përfundime.....  | 35        |
| <b>III. Kreu i dytë: Universiteti dhe komunikimi gjuhësor.....</b>  | <b>38</b> |
| a. Ligjërimi studentor: gjuha dhe kultura rinore.....   | 38        |
| b. Sjellja gjuhësore dhe ligjërimi si pjesë e saj: diferencat e sjelljes gjuhësore në mjedisin universitar.....                         | 40        |
| c. Përfundime.....  | 46        |
| <b>IV. Kreu i tretë: Diferencat gjuhësore sipas ndryshorëve sociolinguistikë</b>  |           |
| a. Diferencat sipas ndryshorit <i>gjini</i> .....   | 48        |
| 3. a. Analizë teorike e ndryshorit gjini.....   | 49        |
| 3.a.1 Perspektivat e fundit teorike.....  | 49        |
| 3.a.1.1 Modeli i defiçitit .....  | 50        |
| 3.a.1.2 Modeli i dominancës.....  | 50        |
| 3.a.1. 3 Modeli i diferencës .....  | 50        |
| 3.a. 1.4 Modeli i ligjërimit ose sjelljes gjuhësore.....  | 51        |
| 3.a. 2 “Legjendat” mbi gjuhën dhe gjininë.....  | 52        |
| 3.a. 3 Stereotipet.....   | 53        |

---

|   |     |
|---|-----|
| 3. a. 4 Analizë praktike e perspektivave teorike.....                                 | 54  |
| 3.a. 4.1 Format dhe funksionet e ligjërimit bisedor-ndërgjinor.....                   | 56  |
| 3.a. 4.2 Karakteristika të ligjërimit gjinor.....                                     | 59  |
| Rast studimi 2.....   | 60  |
| 3. a. 4. 3 Tematikat që trajtohen nga gjini të ndryshme.....                          | 67  |
| 3. a. 4. 4 Vështirësitë e studimit të ligjërimit gjinor.....                          | 71  |
| b. Diferencat sipas ndryshorit mjedis familjar dhe klasë ekonomike.....               | 72  |
| 3. b.1 Çfarë është ligjërimi familjar?.....   | 72  |
| 3. b.2 Tematika e përdorimit të dialekteve në familje.....                            | 73  |
| Rast studimi 3.....   | 74  |
| c . Diferencat sipas ndryshorit mjedis administrativ.....                             | 77  |
| Rast studimi 4.....   | 79  |
| d. Përfundime.....  | 85  |
| <b>V. Kreu i katërt: Taktikat e ligjërimit studentor</b> .....                        | 87  |
| <b>a.Zbunimet dhe përkëdhelitë.....</b>   | 87  |
| 4. a. 1 Zbunimet .....  | 88  |
| 4. a. 2 “Të folurit fëmijor” / Baby talk.....   | 92  |
| 4. a. 3 Nofkat.....   | 93  |
| 4.a. 3.1 Roli dhe vendi i nofkave e fjalëve përkëdhelëse në ligjërimin gjinor.....    | 94  |
| b. Sharjet dashamirëse.....   | 96  |
| Përfundime .....  | 99  |
| c. Zhargoni studentor vlonjat.....  |     |
| 102   |     |
| 3.c. 1 Tipare leksikore të zhargonit studentor në Universitetin “Ismail Qemali” ..... | 103 |
| d. Përfundime .....   | 119 |
| <b>VI. Kreu i pestë: Sociolekti i të rinjve në mjediset universitare të Vlorës</b>    |     |
| a. Të folurit “Peer Groups” kundrejt përdorimit vetjak të gjuhës.....                 | 124 |
| 5.a.1 Përkufizime të ndryshme të Sociolektit.....                                     | 124 |
| 5.a.2 Tipare të sociolektit. ....   | 124 |
| 5.a. 3 Gjuha e fshehtë e bashkësive gjuhësore studentore.....                         | 129 |
| 5.a.4 Përdorimi vetjak i gjuhës në marrëdhënie me gjuhën e grupit..                   | 132 |
| b. Ligjërimi i shkujdesur, pjesë e sociolektit studentor Vlonjat.....                 | 136 |
| 5.b.1 Përkufizime të ndryshme të Ligjërimit të shkujdesur.....                        | 137 |
| 5.b.2 Vendi dhe roli i ligjërimit të shkujdesur në gjuhën shqipe....                  | 138 |
| 5.b.3 Funksionet e ligjërimit të shkujdesur.....                                      | 140 |
| 5.b.4 Përdorimet e ligjërimit të shkujdesur.....                                      | 141 |

---

---

|   |     |
|---|-----|
| Rast studimi 5.....   | 144 |
| Njohja e termit dhe frekuenca e përdorimit të tij për:<br>etiketimin e njerëzve, sipas ndarjes gjinore dhe ndarjes Jug / Veri;..... | 145 |
| b. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi dhe përdorimi i<br>shprehjeve sinonimike të ligjërimit të shkujdesur.....             | 154 |
| b.1. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi .....   | 154 |
| b. 2. Përdorimi i shprehjeve sinonimike të ligjërimit të shkujdesur .....   | 158 |
| Rast studimi 6.....   | 162 |
| a. Etiketime në bazë të degës së studimit. ....   | 162 |
| b. Etiketime për njerëzit.....  | 162 |
| c. Etiketime për studentët sipas performancës akademike.....  | 163 |
| d. Etiketime për aktivitetet shkollore.....   | 165 |
| e. Etiketime për aktivitetet jashtëshkollore.....   | 166 |
| Rast studimi 7.....   | 173 |
| 5. c .5 Vendi dhe roli i huazimeve në ligjërimit të shkujdesur.....   | 175 |
| c. Gjuha e internetit dhe mesazheve elektronike.....  | 176 |
| Përfundime .....  | 178 |

|   |            |
|---|------------|
| <b>VII. Kreu i gjashtë: Kundrime leksiko-semantike te ligjërimit studentor në Universitetin e Vlorës.....</b> | <b>184</b> |
| a. Karakteristikat e bisedave dhe tiparet ligjërimore jashtë auditorit.....                                   | 184        |
| b. Shkelje të normës standarte në ligjërimit të folur dhe të shkruar brenda dhe jashtë auditorit.....         | 186        |
| 6.b.1 Elementi fonetikor.....   | 187        |
| 6.b.1.1 Gabimet leksiko-fonetikore .....  | 187        |
| 6.b.1.2 E foljma tradicionale vendore.....  | 190        |
| 6.b.2. Leksiku bisedor.....   | 192        |
| 6.b.2.1 Tipare leksikore të gjuhës së folur jashtë auditorit.....   | 192        |
| 6.b.2.2 Tipare leksikore të ligjërimit të shkujdesur.....   | 195        |
| c. Prurjet e reja leksikore.....  | 201        |
| d. Përfundime.....  | 204        |

|  |            |
|--|------------|
| <b>VIII. Kreu i shtatë: Kundrime gramatikore te ligjërimit akademik studentor.....</b> | <b>208</b> |
| a. Kundrime të përgjithshme.....   | 209        |
| 7.a.1 Dukuri sintaksore.....   | 209        |
| 7.a.2 Tipare gjuhësore të ligjërimit akademik studentor.....                           | 210        |
| b. Tipare gjuhësore të ligjërimit bisedor .....  | 214        |
| 7.b.2 Gabimet drejtshqiptimore .....   | 215        |
| c. Kundrime morfologjike.....  | 224        |
| 7.c.1 Elemente drejtshqiptimore.....   | 220        |

|   |            |
|---|------------|
| d. Proceset fjalëformuese në fjalët shqipe dhe fjalët e huazuara të përdorura në ligjërimin bisedor dhe atë të shkujdesur ..... | 226        |
| 7.d.1 Shmangiet drejtshqiptimore.....   | 229        |
| 7.d.2 Elemente drejtshkrimore.....  | 230        |
| 7.d.3 Gabime drejtshkrimore .....   | 230        |
| e. Çështje të normës sintaksore.....  | 232        |
| f. Kundrime gramatikore të studentëve sipas ndryshorit<br><i>mjedis administrativ</i> .....                                     | 233        |
| 7. f.1 Shkelje të normës gramatikore.....   | 234        |
| g. Përfundime.....  | 236        |
| <b>VIII. Përfundime dhe rekomandime .....</b>   | <b>241</b> |
| <b>IX. Tabela, figura, modele anketimesh.....</b>   | <b>252</b> |
| <b>X. Bibliografia.....</b>   | <b>274</b> |

## **HYRJE**

Qyteti i Vlorës ka një universitet që këtë vit feston 20-vjetorin e çeljes. Në këtë universitet, me disa fakultete e me dhjetëra degë, ndjekin studimet mijëra studentë, që jo vetëm dallohen nga profili i studimeve, por edhe nga tipare e veçori gjuhësore që së shumti lidhen edhe nga mjedisi familjar, shoqëror dhe gjeografik nga vijnë.

Duke qenë afër ligjërimit të studentëve dhe duke u bazuar në përvojën dhjetëvjeçare në arsim, më lindi ideja për ta trajtuar shkencërisht ligjërimit studentor në një punim teze doktorate, gjë që mori edhe miratimin institucional. Kisha filluar herët të evidentoja veçoritë e këtij ligjërimit. Por tani fillova të punoja me synim të caktuar dhe me një platformë e metodologji të caktuar. Kundrimi nga afër i këtij ligjërimit, duke gjetur e paraqitur të dhëna sa më të plota dhe të vlefshme, na shpuri në identifikimin e jo pak tipareve ligjërimore me interes për sociolinguistikën.

Të gjitha këto kanë zënë vend në punimin ***Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës***, i cili në formën e tanishme ka synuar të analizojë dhe të interpretojë në mënyrë sa më të gjerë dhe sa më përfshirëse ***variacionin gjuhësor*** që lidhet me këtë mjedis universitar, duke u ndalur në dukuri shumë komplekse, të tilla, *si ligjërimit dhe sjellja gjuhësore te studentët, diferencat e sjelljes gjuhësore, të kushtëzuara nga ndryshorët sociolinguistikë e më konkretisht nga ndryshorët të tillë si, përkatësia e klasës ekonomike dhe niveli arsimor i familjeve të studentëve, përkatësia gjinore, përkatësia e degës së studimit (variacioni gjuhësor te studentët e gjuhëve të huaja dhe të gjuhës e letërsisë shqipe, te studentët e shkencave të edukimit, shkencave inxhinerike, ekonomike etj.).*

Është fakt se në vështrim *diastatik* të folurit studentor gati - gati formon *një ligjërimit të veçantë*, i cili në mënyrë të pashmangshme ndërthet edhe tipare diatopike (sepse studentët vijnë pak a shumë nga zona jugperëndimore e Shqipërisë), por edhe tipare që lidhen me rrafshin kohor (këtu nuk po flasim për ndryshime diakronike, por për ato që dallojnë studentët e viteve të para nga ato të fundit, që lidhen me jetën 4-5 vjeçare në universitet). Studentët përdorin fjalë e sidomos terma të shumtë e të larmishëm në të folurin e përditshëm, gjatë orëve të mësimit në auditor, por edhe jashtë tij. Kjo larmishmëri shërben për të shprehur mendime të ndryshme apo për të përshkruar e interpretuar ngjarje e situata në të cilat ata marrin pjesë. Pikërisht në këto situata, që klasifikohen në këtë punim, studentët e degëve të ndryshme përdorin leksik dhe stil të ngjashëm të të shprehurit dhe të komunikuarit, përta u përket:

- *termave dhe ngjyrimet e tyre në biseda rreth mësimt,*
- *mënyrën e të komunikuarit gjatë orës së mësimt e jashtë saj*
- *përshkrimin e eksperiencave të përditshme.*

Ky punim bën një përpjekje për të trajtuar në mënyrë të ndarë, por edhe të ndërthurur, veçoritë e të folurit studentor, që markohet për studentë e grupe studentësh me terminologjinë përkatëse që ata përdorin, ndalet në ndërtimin strukturor të fjalive,

pa lënë mënjanë morfologjinë e eptimit, dhe atë të fjalëformimit, duke kaluar në dukuri që lidhen me etnografinë e të folurit (fjala vjen përkëdhelitë, sharjet dashamirëse etj.), si dhe sjell vëzhgime mbi njohuritë gjuhësore të studentëve në universitetin e Vlorës.

### **Paraqitje e shkurtër e materialit**

**Kapitulli i parë** përshkruan komunikimin që realizohet në shqipen standarde si dhe marrëdhëniet midis gjuhës standarde dhe nënndarjeve të saj. Ndonëse, Universiteti “*Ismail Qemali*” shtrihet gjeografikisht në jug-perëndim të Shqipërisë, studentët që vijojnë studimet aty i përkasin mjediseve administrative të ndryshme, duke krijuar kështu një shoqëri heterogjene nga pikëpamja gjuhësore. Prandaj, për të kuptuar më mirë shfaqet gjuhësore të studentëve të Universitetit të Vlorës është me vlerë diskutimi i elementeve të dy dialekteve dhe pasqyrimi i tyre në ligjërimin letrar.

Sot, në auditorët universitarë, dialektet vihen në pozita nënshtimi ndaj gjuhës letrare kombëtare, ato pësojnë përditë ndikimin e saj për t’u afruar me të, përgjithësisht duke marrë tiparet e përbashkëta letrare e duke humbur tipare të veçanta dialektore. Ligjërimi i përdorur prej pedagogëve dhe studentëve është ligjërim standard, pra është nën ndikimin e normës letrare; megjithatë në këtë rast norma zbatohet në mënyrë të rregullt, por jo të rreptë për sa i përket përdorimit të njësive të stilemave. Duhet pranuar fakti se vështrimi në praktikën shkollore dhe jashtë saj të bën të mendosh se duhen ende përpjekje të mëdha për të rritur kulturën gjuhësore të studentëve dhe gjuhëpërdoruesve.

**Kapitulli i dytë** paraqet një tablo të përgjithshme të ligjërimin studentor brenda dhe jashtë auditorit, duke u bazuar në përdorimin e gjuhës në funksion të pasqyrimin të kulturës rinore dhe analizimin e diferencave të sjelljes gjuhësore në mjedisin universitar. Gjuha është mjeti kryesor në komunikimin social. Ligjërimet ndërretjake të realizuara në kontekste të ndryshme, përveç mesazheve, përcjellin edhe kulturën e bashkëbiseduesve, pra, kulturën rinore. Gjuha dhe kultura ndërliqhen me njëra – tjetrën në mënyra të shumta dhe komplekse.

Kultura rinore është nën një proces ndryshimi të vazhdueshëm dhe gjuha siguron të gjitha mjetet e duhura linguistike dhe stilistikore për të pasqyruar këto ndryshime.

**Kapitulli i tretë** përqendrohet në *ndryshorët* sociolinguistikë si gjinia, mjedisi familjar dhe klasa ekonomike, mjedisi administrativ. Këto *ndryshorë* kanë ndikim të madh në zgjedhjet gjuhësore të individëve dhe në ligjërimin e bashkësive shoqërore.

Spektri i trajtimit të kësaj çështjeje është i gjerë dhe kërkon shqyrtime analitike në shumë rrafsh gjuhësore, më së shumti në leksik dhe në frazeologji, sidomos në kalimet kuptimore të fjalëve. Mendojmë se analizimi i këtyre çështjeve është realizuar i plotë, ndonëse kërkohen studime të mëtejshme në këto drejtime në gjuhën shqipe.

**Kapitulli i katërt** përqendrohet në analizimin e plotë të taktikave të ligjërimin studentor. Dukuritë gjuhësore, si: zbulimet dhe përkëdhelitë, *baby talk*, nofkat, sharjet dashamirëse etj., janë hetuar për të përcaktuar rolin, vendin dhe realizimin e tyre në ligjërimin studentor.

Zhargoni i studentëve është pjesë e rëndësishme e ligjërimit studentor. Kjo vlen edhe për ligjërimin e studentëve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Në praktikën perëndimore, zhargonet, duke përfshirë këtu edhe ligjërimin e shkujdesur, termat dhe shprehjet tabu etj., zënë vend të rëndësishëm në gjuhën standarde. Por, në gjuhën shqipe, fjalët dhe shprehjet zhargonore nuk e kanë këtë status, prandaj, ato nuk paraqiten në asnjë fjalor të gjuhës standarde. Arsyeja e analizimit të detajuar të zhargonit studentor është rëndësia e tij dhe roli që zë ky ligjërim në përditshmërinë tonë gjuhësore. Mendojmë se studimi i mëtejshëm i kësaj nënçështjeje është me rëndësi pasi vlen të përcaktohet roli dhe vendi i tij në rrjedhën gjuhësore.

**Kapitulli i katërt** përqendrohet në sociolektin studentor, në dy drejtime kryesore: marrëdhëniet gjuhësore midis “peer groups” dhe idiolektit, dhe ligjërimi i shkujdesur. Bashkësia shoqërore studentore dhe nëngrupet që e përbëjnë atë, kanë krijuar gjuhën e tyre, sociolektin, i cili njëkohësisht formëson dhe përforcon lidhjet shoqërore të grupit.

Nga studimi mbi element të ndryshëm të ligjërimit studentor vërehet se zhargoni i përgjithshëm studentor, sociolekti, idiolekti, karakteristikat e ligjërimit sipas gjinisë e mjedisit administrativ, zbulimi, përkëdhelitet dhe “sharjet dashamirëse” zënë vend të veçantë në ligjërimin verbal të studentëve, duke i dhënë karakter bisedor dhe të shkujdesur komunikimit jashtë auditorit. Këto tre elemente janë dukuri me karakter gjuhësor e shoqëror dhe zbatoheshin në rrethana që buronin nga strategjia e ligjërimit.

Të gjitha shtresat e leksikut, shembuj të fjalorit të grupit, gjuha e komunikimit të përditshëm dhe e folmja e fshehtë dhe analizimi i detajuar i ligjërimit të shkujdesur, si pjesë e rëndësishme e sociolektit studentor janë shqyrtuar dhe pasqyruar në punim.

**Kapitulli i gjashtë** përqendrohet në analizimin e kundërimeve leksiko-semantike të ligjërimit studentor. Karakteristikat e bisedave dhe tiparet ligjërimore jashtë auditorit, shkeljet e normës standarde në të folur dhe shkruar brenda e jashtë auditorit, tiparet dhe shkeljet fonetike janë disa prej çështjeve që trajtohen në pjesën e parë të këtij kapitulli.

Një pjesë e këtij kreu përshkruan në mënyrë të gjerë dhe praktike leksikun, shtresat e tij, shoqëruar nga një analizë gjuhësore tipareve leksikore të gjuhës së folur jashtë auditorit dhe tipareve leksikore të ligjërimit të shkujdesur. Vëmendje i kushtohet, gjithashtu, prurjeve të reja leksikore që u vërejtën në gjuhën e folur të studentëve.

**Kapitulli i shtatë** paraqet një pasqyrë të plotë të kundërimeve gramatikore, morfologjike e sintaksore, që u vërejtën në ligjërimin e studentëve brenda dhe jashtë auditorit. Pra, përpos, risive leksikore, në sistemin e gjuhës së folur mund të vërehen edhe risi sintaksore: ndryshime në ndërtimin e fjalive, në lidhjet mes fjalive të thjeshta e të përbëra, në lidhjet mes fjalive pyetëse dhe çuditëse; janë paraqitur tipa të rinj të rendit të fjalëve; janë bërë ndryshime në raportet mes ligjërimit të drejtpërdrejtë dhe

ligjërimin të ndërmjetuar; janë vënë në raporte kohët e ndryshme gramatikore; janë bërë copëzime të dialogëve, ndarje të tekstit, lojë fjalësh etj.

Ligjërimi akademik në ambiente të brendshme të universiteteve dhe veçanërisht në auditore karakterizohet nga një sërë tipare, shkelje e shmangie drejtshkrimore e drejtshqiptimore të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë kapitull.

### **Metodologjia – mbledhja e të dhënave**

Në këtë seksion paraqitet një shpjegim i plotë i çështjeve të ndryshme metodologjike të përdorura në mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave në studim.

Seksioni është organizuar në pesë pjesë, secila përfaqëson elemente të ndryshme të procesit të mbledhjes së të dhënave:

a. Përqasja e përgjithshme metodologjike: qëndrimi i përgjithshëm metodologjik që ndikoi në mënyrën e mbledhjes së të dhënave

b. Organizimi i ndërveprimeve: masat e ndryshme të përdorura në formimin e grupeve të pjesëmarrësve dhe ndërtimi i bisedave.

c. Anketimi, vëzhgimi: hartimi i pyetësorëve në lidhje me çështje specifike; vëzhgimi i bisedave spontane dhe të kontrolluara të studentëve

#### **a. Përqasja e përgjithshme metodologjike**

Element kryesor në realizimin e studimeve mbi bashkëveprimet ndërpersonale është përqasja metodologjike për mbledhjen e të dhënave. Gjuhëtarët, si Roger dhe Bull (1988), kanë identifikuar dy përqasje të ndryshme nga njëra-tjetra për mbledhjen e të dhënave gjatë bashkëveprimit verbal: metoda “eksperimentale” dhe “natyrore”.

Duke u bazuar në karakteristikat e secilës, gjatë përdorimit të tyre praktik, u pa e arsyeshme që dy metodat të përdreshin jo vetëm të veçuara nga njëra-tjetra, por edhe së bashku. Kombinimi i elementeve të ndryshme të secilës metodë krijoi avantazh në mbledhjen e të dhënave, sepse shfrytëzoi më të mirën e secilës prej tyre dhe shmangu të metat.

Shkurtimisht, metoda eksperimentale bazohet në ushtrimin e kontrollit të vazhdueshëm mbi ndërveprimet gjuhësore të studentëve. Ky kontroll përfshin manipulimin e variableve kryesore për të evidentuar efektin, që ka pasur në të dhënat e mbledhura ligjërimore. Ndërsa, metoda natyrore bazohet në mbledhjen e të dhënave duke mos ushtruar asnjë lloj kontrolli mbi bisedën apo interlokutorët. Në këtë mënyrë, përfitohen ndërveprime spontane, autentike dhe të pakushtëzuara nga faktorë të jashtëm. Megjithatë, u hasën disa vështirësi në analizimin e të dhënave të mbledhura me këtë metodë, sepse mungonte objektivi kryesor i analizës dhe ekzistonte mundësia që të dhënat mund të interpretoheshin në mënyra të ndryshme.

Ndërsa, kombinimi i elementeve të ndryshme të secilës metodë, bëri që procesi i mbledhjes së të dhënave të ishte më fleksibël, duke shmangur efektin tërësisht natyral apo tërësisht eksperimental. Duke pasur parasysh rezultatet e bisedave të analizuara sipas kësaj përqaasjeje, shprehim bindjen se bashkimi i dy metodave duke përcaktuar disa kritere, është përqaasje e duhur për të realizuar qëllimet e veçanta kërkimore në këtë studim.

Kontrolli i ushtruar mbi variable të rëndësishme si gjini, mjedis familjar, mjedis administrativ etj., ishte thelbësor dhe ndihmoi në arritjen e konkluzioneve të ndryshme ku krahasimet e bëra midis grupeve ishin të lidhura me variable të parapërcaktuara. Gjithashtu, sigurimi i të dhënave në mënyrë natyrore e të pakushtëzuar ishte shumë i rëndësishëm në lidhje me vlefshmërinë e përgjithshme të rezultateve.

Materiali i mbledhur u analizua dhe shqyrtua përmes metodës induktive dhe asaj deduktive. Të dhënat janë klasifikuar, tipizuar dhe përgjithësuar sipas tematikave përkatëse.

## **b. Përqaasje e përgjithshme metodologjike**

### **1. Përzgjedhja e pjesëmarrësve**

Procedura eksperimentale e selektimit të kandidatëve në bazë të variableve të ndryshme e specifike, u përdor për të kontrolluar vlefshmërinë gjatë procesit kërkimor. Me qëllim që të izoloheshin variable të caktuara, si për shembull variabli gjinor, si burim i vetëm midis grupeve, që po studioheshin u mënjanuan variablet e tjera, që mund të ndikonin bashkëveprimin ndërmjet interlokutorëve. Për këtë qëllim, pjesëmarrësit u përzgjedhën në bazë të disa kritereve: moshë, gjinia, statusi social, familjariteti me njëri tjetrin.

### **2. Moshë dhe statusi social i pjesëmarrësve**

Duke u bazuar në rezultatet e Labov<sup>1</sup> (1972) dhe Helfrich<sup>2</sup> (1997) se moshë dhe statusi social ndikojnë në përdorimin e gjuhës në bashkëveprim, u përzgjedhën pjesëmarrës me moshë apo status social të njëjtë. Arsyeja e këtij vendimi ishte se në bisedat e para të realizuara, kriteri i moshës dhe statusit social të studentëve nuk u mor parasysh dhe pjesëmarrësit me moshë apo status social më të lartë ishin më të lirshëm dhe dominuan bisedën në një përqindje të konsiderueshme, ndërsa më të rinjtë a me status social më të ulët u shfaqën më të tërhequr në bisedë (kishte raste kur studentë me status social të ulët dhanë kontribut më të madh në bisedat e përziera, sesa bashkëmoshatarët e tyre).

---

<sup>1</sup> Rosen, L., *An Interview with William Labov*. United States, 1979, f. 16-19.

<sup>2</sup> Voorhoeve, P., *In memoriam o. L. Helfrich: (1860—1958)*, London, 1958, f. 249-253

Për realizimin e bisedave të “kontrolluara”, pjesëmarrësit u përzgjedhën paraprakisht studentë që të plotësonin kriterin e të njëjtës moshë dhe të njëjtit status social. Përzgjedhja e studentëve sipas viteve të studimit i përmbushi më së shumti të dyja kriteret.

### **3. Shoqëria**

Për realizimin dhe mbledhjen e materialit të duhur, përbënte avantazh që pjesëmarrësit në bisedë të kishin lidhje shoqërore me njëri-tjetrin, pasi familjariteti nxiti bashkëveprime spontane midis tyre. Gjithashtu, kur biseda zhvillohej midis miqsh, reagimet kufizuese që studentët mund të shfaqnin ndaj regjistruarit ishin më të pakta. Si rezultat, ulej ndjeshëm efekti i të qenit i vëzhguar apo i kontrolluar. Për më tepër, biseda që zhvillohet ndërmjet interlokutorëve që nuk njihen karakterizohet nga kufizimi i ndikuar prej “normave sociale” dhe si rezultat nuk reflektojnë sjellje bashkëvepruese të natyrshme<sup>3</sup>.

Duke u bazuar në këto vëzhgime, u krijua bindja se për arritjen e suksesshme të objektivave të përcaktuara, pjesëmarrësit duhet të ishin të familjarizuar me njëri-tjetrin.

### **4. Përmasa e grupit**

Përmasa e pjesëmarrësve në grup ishte një tjetër variabël që duhej të mbahej konstant. Që biseda të ndiqte rrjedhën e duhur, sipas kriterëve të përcaktuara, u vendos që numri maksimal i studentëve –bashkëbisedues të ishin pesë deri në shtatë persona. Përzgjedhim përbënin rastet kur bashkëveprimi zhvillohej në orën e mësimet.

### **5. Vendi i realizimit të bisedës**

Zgjedhja e vendit ku do të realizoheshin bashkëveprimet e regjistruara, ishte shumë e rëndësishme sepse siguronte mbledhjen e informacionit sa më spontan gjatë bisedës që rridhte natyrshëm. Duke u bazuar në këtë premisë, u përcaktuan tre vende kryesore ku do të realizohej mbledhja e informacionit: I- auditori, II- jashtë auditorit, (por brenda mjedisit universitar) III-jashtë mjedisit universitar (shtëpi, lokal, konvikt, etj).

Ndonëse prania e një pale të tretë “vëzhguese” në bisedë ndikon më shumë sesa vendodhja në rrjedhën e natyrshme të komunikimit midis interlokutorëve, shprehim bindjen se vendi ku realizohet biseda, kontribuon drejt spontanitetit të rrjedhës ligjërimore, por nuk kushtëzon totalisht natyrshmërinë e bisedës.

---

<sup>3</sup> Rosen, L., *An Interview with William Labov*, United States, 1979, f. 16-19.

## **6. Tematika e bashkëveprimit**

Shkolla, familja, shoqëria, përcaktimet gjinore, zbulimet e përkëdhelitet, sharjet dashamirëse, janë disa nga tematikat mbi të cilat janë zhvilluar bisedat, vëzhgimet dhe anketimet.

### **c. Subjektet**

Subjekti kryesor i vëzhgimeve, bisedave dhe anketimeve janë studentët e viteve të para, të dyta dhe të treta të Universitetit të Vlorës. Të gjitha rezultatet e përfuara janë realizuar brenda auditorit, në mjediset universitare dhe jashtë tij.

### **d. Mekanizmat - mjetet e punës kërkimore**

Duke ndjekur me kujdes shfaqjet gjuhësore të studenteve të Universitetit të Vlorës, u kryen vëzhgime dhe biseda të ndryshme me studentë në këtë institucione dhe u mblodh pjesa më e madhe e materialit ilustrues. Ky material (anketimi me pyetësor apo vëzhgimet e bisedave spontane / të kontrolluara), i gërshtuar me literaturën përkatëse, shërbeu për të vënë në dukje disa veçori të të folurit të të rinjve studentë, si përshebull, shfaqjet interesante në lidhje me tiparet leksikore dhe strukturat e veçanta gramatikore.

Mjetet e punës janë fletët e anketimit në lidhje me fjalorin e përgjithshëm akademik / bisedor dhe të shkujdesur, që përdoret në mjediset universitare në bazë të ndarjes gjinore apo të degës së studimit etj.

### **Baza teorike e punimit dhe literatura e shfrytëzuar**

Studimet sociolinguistike, në botë, por edhe në Shqipëri, sot janë pikun e tyre, sidomos ato që lidhen edhe me dialektologjinë urbane. Në studimet gjuhësore shqiptare këta 20 -25 vjetët e fundit kanë ardhur punime të shumta si studime të mirëfillta monografike, si tekste universitare, si punime doktoraturash, si artikuj shkencorë apo si kumtesa në veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Madje nuk ka asnjë veprimtari të tillë, në të cilën të mos kumtohet për problemet që lidhen me sociolinguistikën. Shqipëria ka njohur një zhvillim të jashtëzakonshëm pas viteve '90 të shekullit XX, pas rrëzimit të diktaturës komuniste dhe pas hapjes ndaj vendeve, popujve e kulturave të tyre, sidomos atyre perëndimorë. Por një zhvillim cilësor pëson shoqëria shqiptare pas rënies së kufijve ndarës me Kosovën, me Maqedoninë e Malin e Zi. Kjo solli që kontaktet ndërmjet vetë shqiptarëve të rritet në mënyrë shumë të shpejtë dhe të panjohur më parë. Kjo u shoqërua me dukuri interesante gjuhësore që lidhen së shumti me objektin e sociolinguistikës. Një dukuri tjetër e këtyre dy dhjetëvjetëshave të fundit është lëvizja mekanike e popullsisë dhe vendosja e saj në metropolet kryesore, Tiranë dhe Prishtinë, por edhe në qytetet e tjera të mëdha, veçanërisht në ato bregdetare, si Durrësi, Vlora, por edhe në qytete të tjera si Elbasani, Shkodra, Korça, Prizreni etj. Dhe kjo solli dukuri shumë interesante gjuhësore që lidhen së shumti me dialektologjinë rurale, me etnolinguistikën e

sociolinguistikën. Dhe dukuria tjetër, që lidhet drejtpërdrejt me temën tonë, është ngritja e një rrjeti shumë të gjerë të institucioneve të arsimit të lartë. Vetëm në Shqipëri politike (pa përfshirë Republikën e Kosovës dhe Maqedoninë), sot (në vitin 2014) i kanë dyert të hapura 59 universitete dhe shkolla të larta, në auditorët e të cilave janë ulur rreth 163.000 studentë. Ky është një numër shumë domethënës, dhe vetë dukuria e arsimit të një mase kaq të madhe shoqërohet me dukuri shumë interesante gjuhësore, më tipikja se kjo masë shumë e madhe jo vetëm është zotëruese shqipes standarde, por edhe rrezatuese e tij.

I gjithë ky spektër dukurish është studiuar dhe po studiohet nga ana sociolinguistike, duke na vënë në dorë një literaturë shumë të vlefshme, në të cilën jemi mbështetur edhe ne. Mbështetje ka qenë literatura në shqipe, por sidomos ajo në anglishte. Më gjerë kjo referohet në literaturën që shoqëron punimin si dhe në citimet e shumta në faqet e tij. Po përmendim vetëm dy tre autorë që kanë peshë në studimet për këtë fushë: G. R. Cardona, *Introduzione al' etnolinguistica*, Societa editrice il Mulino, Milano, 1976; Hudson R. A. *Sociolinguistics*. Cambridge: CPU, 1996; Humbolt Wv. *Linguistic variability and intellectual development*. University Miami Press 1971; Labov W. *Sociolinguistic Patterns*. Philadelphia University Press 1972; Labov, T., *Language barriers among adolescents*. American Speech, Vol. 67, No. 4, 1992; Labov, T., *Social and language boundaries among adolescents*. American speech. Vol. 2, No. 4, 1992; Labov, W, *Sociolinguistics patterns*, Philadelphia. 1989; Shkurtaç Gj. *Sociolinguistika e gjuhës shqipe*, Botimet Toena, Tiranë 2012; Shkurtaç Gj. (2013) *Nga dialektologjia tradicionale deri tek etnografia e të folurit: mbërritje dhe hapësira të reja për hulumtime sociolinguistike*, Studime sociolinguistike, KOTTI, Korçë; Shkurtaç Gj. *dialektologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2013; Shkurtaç Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003; Shkurtaç Gj., *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006; Shkurtaç Gj., *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006; Shkurtaç Gj., *Nga gjeografia gjuhësore te dialektologjia urbane*, në "S. albanologjike", I, Tiranë, 1996; Shkurtaç Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001; Shkurtaç Gj., *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009; Shkurtaç Gj., *Prirje dhe prurje si fryte të ndeshjes së normave me thyerjet e saj në shqipen e sotme*, në "Seminari Ndërkombëtar për gjuhën...", 27/1, Prishtinë, 2008 etj., etj.

### **Adresimi i punimit**

Punimi ynë ndalet në një vështrim gjithëpërfshirës të ligjërit studentor në mjedisin universitar të Vlorës. Ky këndvështrim, me origjinalitetin e vet, me analizat e hollësishme dhe me përgjithësimet e bëra, sjell një gur në mozaikun shumëngjyrësh të studimeve shqiptare për të folmet shoqërore në gjuhën shqipe. Ndaj, si i tillë ai synon të shfrytëzohet dhe të japë sadopak ndihmesë për studentët, pedagogët e gjuhës shqipe, por edhe për studiuesit, sociolinguistë, etnolinguistë, dialektologë, leksikologë e leksikografë, morfologë e fonologë, sintaksologë e studiues të stilistikë së shqipes. Ai u drejtohet edhe dashamirësve të fjalës shqipe sidomos atyre që e grumbullojnë atë

në terren apo e vjelin nga burime të ndryshme sidomos nga gjuha e shkruar, synon të shfrytëzohet dhe të japë sadopak ndihmesë për mësuesit e gjuhës shqipe edhe në sistemin parauniversitar, për gazetarëve, politikanët etj.

## KAPITULLI I PARË.

### **Komunikimi gjuhësor në shqipen standarde dhe marrëdhëniet e ndërsjella të standardit me njësitë dialektore të gjuhës shqipe**

---

- a. Komunikimi në shqipen standarde**
  - b. Ndikimi i standardit dhe marrëdhëniet gjuhë e njësuar / nëndialekt / idiolekt**
- 

#### **a. Komunikimi në shqipen standarde**

Komunikimi në një gjuhë të përbashkët ka shumë përparësi: ne komunikojnë më mirë dhe kjo lehtëson marrëdhëniet shoqërore duke shmangur keqkuptimet gjuhësore e kulturore dhe ndihmon në unifikimin e sistemit arsimor. Gjuha standarde jo vetëm që na jep një identitet të fortë kombëtar, por edhe na jep një pozicion të fortë në kuadrin botëror. Gjuha standarde është gjithashtu e nevojshme për shkak se është dokumenton një pasuri që do të trashëgojnë brezat e ardhshëm.

Standardi gjuhësor është një variant i veçantë i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ka status më të lartë sesa variantet e tjera. Gjuha standarde mishëron zbatimin e rreptë e tërësinë e normave, si dhe rregullat fonetike, leksikore, gramatikore të gjuhës shqipe, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë folësit, pavarësisht nga mjedisi: qarqet akademike, politike, media dhe gjetkë.<sup>4</sup> Norma standarde ka luajtur rol udhëheqës, në procesin e zhvillimit gjuhësor, megjithatë është e parakohshme të mendohet se mjafton arsimit i detyrueshëm apo i mesëm që standardi të zotërohet nga populli<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> D, Chrystal-D., *Davy, Investigating English Style*, London, 1969, f. 64.

<sup>5</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2001. f.150.

**Gjuha standarde** krahas shumë tipareve, sidomos gjuhësore, të përbashkëta me format e tjera të gjuhës, **karakterizohet nga disa tipare**, të cilat e bëjnë të funksionojë si një sistem më vete dhe si një formë e veçantë e gjuhës<sup>6</sup>. Ajo mbështetet në normën leksikore, gramatikore, drejtshkrimore, por edhe në normën drejtshqiptimore. Shqiptimin standard e studion drejtshqiptimi<sup>7</sup>.

Norma letrare e shqiptimit ka dy aspekte:<sup>8</sup>

Së pari, ajo ka të bëjë me përbërjen fonemore të fjalëve, d.m.th përcakton përbërjen fonemore që është normative, duke konsideruar të gabuar një përbërje tjetër fonemore.

Aspekti i dytë i normës letrare të shqiptimit lidhet me realizimin e fonemave në pozicione të ndryshme dhe me vendin e theksit në fjalë. Këto dy aspekte të normës, megjithëse janë të ndryshme, lidhen ngushtë me njëri-tjetrin. Gjuha letrare duhet të jetë e njësuar në të shkruar, por edhe në të folur. Drejtshqiptimi është pjesë e kulturës së të folurit dhe pjesë e pandashme e normës së gjuhës letrare.<sup>9</sup> Rregullat e drejtshqiptimit kanë vlerë praktike shoqërore. Rëndësia e shqiptimit të njëjtë në shoqëri rritet krahas me rritjen e rëndësisë dhe përhapjes së fjalës publike, domethënë të shkollës, radios, mbledhjeve, konferencave, teatrit, etj. Të gjitha këto forma, kërkojnë që fjalët të shqiptohen sipas rregullave të gjuhës standarde që të kuptohen me lehtësi nga dëgjuesit, pavarësisht nga niveli i kulturës së tyre gjuhësore<sup>10</sup>.

Gjithashtu, faktorët jashtëgjuhësorë përbëjnë një aspekt të rëndësishëm për funksionimin dhe zhvillimin e gjuhës letrare. Këta faktorë ndikojnë jo vetëm në drejtimin leksikor dhe gramatikor, por edhe në atë fonetikor<sup>11</sup>.

Profesor A. Dodi shpreh mendimin e tij për këtë çështje: *“Shkenca jonë gjuhësore, u ka kushtuar vëmendje të veçantë faktorëve brendagjuhësorë për shpjegimin e dukurive të ndryshme gjuhësore. Por absolutizimi i tyre, nënvlerësimi dhe mohimi i rolit të faktorëve jashtëgjuhësorë është i gabuar dhe nuk jep mundësinë për të shpjeguar shumë dukuri gjuhësore”*.<sup>12</sup>

Aspektet socio-psikologjike të pranimit të standardit duhet trajtuar veçmas për të folurit formal dhe për të folurit joformal. Sidomos, në të folurin formal folësit ndodhen nën presion, përzgjedhja leksikore e fjalëve dhe e leksemave është e

<sup>6</sup> Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 28

<sup>7</sup> *Me fjalën drejtshqiptim ose fonetikë normative kuptojmë normat e gjuhës së folur që sigurojnë shqiptimin e njëjtë në gjuhën letrare.* Dodi A, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, 2004, f. 28

<sup>8</sup> Çerkezi, E., & Billa, E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*, Korçë, 2013, f. 310.

<sup>9</sup> Gjinari, J. *Përfaqja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik*, Tiranë, 1984, f. 2.

<sup>10</sup> Çerkezi, E., & Billa, E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*, Korçë, 2013, f. 310-3011.

<sup>11</sup> Shih po aty, f. 311.

<sup>12</sup> Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 128

rëndësishme, njëkohësisht koha dhe tensioni i bisedës janë në kundërshtim me komoditetin që zakonisht kërkon të folurit formal.<sup>13</sup>

Në shkencën e gjuhës së folur, ka vend për të hulumtuar edhe etnografinë e të folurit në të cilën trajtohen: variantet e përdorimit të gjuhës, situata e të folurit, ndikimi i faktorëve jogjuhësorë në gjuhë si p.sh.: faktorët arsimorë, kulturorë, kultura e komunikimit, kontaktet gjuhësore, edukimi gjuhësor në shkollë, etj.<sup>14</sup> Pra, përpjekja për të shpjeguar gjithë dukuritë gjuhësore vetëm me ligjet e brendshme të gjuhës, pa marrë parasysh edhe faktorët shoqëror, ku ajo jeton dhe zhvillohet, është e gabuar.

Profesorët J. Gjinari e Gj. Shkurtaç pohojnë se zhvillimi i gjuhës standarde është një ilustrim i qartë ku duket ndikimi i mjaft i madh i faktorëve shoqërorë mbi faktorët e normës letrare. Gjuha standarde ka funksion realizimin e komunikimit ndërjet përdoruesve të saj, dhe ushtron ndikimin e saj me mjete të shumta gjuhësore në mjedise dhe shtresa sociale të ndryshme. Studiues Shkurtaç shprehet se: “*Me lindjen dhe formimin e gjuhës letrare kombëtare, dialektet paraqiten brenda gjuhës së përbashkët si mbeturina të fazave të mëparshme parakombëtare të gjuhës, kurse gjuha letrare paraqitet si mbikrahinore dhe si shkalla më e lartë e zhvillimit*”.<sup>15</sup>

Struktura fonetike e normës letrare huazon në mënyrë të vazhdueshme elemente gjuhësore prej të dy dialekteve, megjithëse në strukturën e saj spikasin disa tipare të shqiptimit bazuar në ligjërimin jugor, siç janë për shembull: ë-ja e theksuar, së cilës gegërishtja i përgjigjet me *a* hundore (*za-zë; baj-bëj; nana-nënë, etj.*<sup>16</sup>), rotacizmi i *n*-së ndërzanore në një kategori fjalësh të vjetra (*vena-vera, hyna-hyra, bani-bëri*), mungesa e hundorësisë dhe e gjatësisë së zanoreve, togu i zanoreve (*ua*), ruajtja e grupeve *mb, nd, ng, ngj*, të paasimiluara; tregojnë për një lidhje të ngushtë të normës letrare me bazën jugore. Por pasurimi i normës letrare me fjalë të të dyja dialekteve ka sjellë në gjuhë elemente të reja fonetike.

Vështrimi në praktikën shkollore dhe jashtë saj të bën të mendosh se duhen ende përpjekje të mëdha për të rritur kulturën gjuhësore të studentëve dhe gjuhëpërdoruesve.

Risitë e zhvillimit bashkëkohor arrihen përmes lidhjes trekëndësh: tekst – mësues -student<sup>17</sup>.

--*Libri është hartuar në gjuhën e zgjedhur të standardit, kalon nga ligjërimi i folur dhe i shkruar.*<sup>18</sup>

---

<sup>13</sup> Paçarizi, Rr., *Rruga e zhvillimit të shqipes standard në raport me nevojat e komunikimit*, Tiranë, 2011, f. 6.

<sup>14</sup> Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 245.

<sup>15</sup> Shih po ai, po aty, f. 245.

<sup>16</sup> *Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1980, f. 65.

<sup>17</sup> Kotrri, P., & Topalli, T., *Gjuha dhe ligjërimi në shkollë në kuadrin e shqipes standard*, Tiranë 2003, f. 407.

--*Mësuesi (dhe pedagogu)* është specialisti që jep lëndën dhe përcjell tekstin te studentët<sup>19</sup>, dhe në këtë mënyrë, mësuesit, duke përdorur që nga normat e drejtshkrimin e deri tek kultura e gjuhës në përgjithësi, bëhet modeli gjuhësor përpara klasës. Studentët janë nën ndikim të vazhdueshëm të këtij modeli gjuhësor.<sup>20</sup>

--*Auditori*: universitetet tashmë janë kultura dinamike, që përbëhen nga shumësi kulturash sa të ngjashme, aq edhe të ndryshme midis tyre. Klasa është një shoqëri e vogël me gjuhën e saj, e cila përbëhet nga një grup individësh që përfaqësojnë stile të ndryshme komunikimi. Sot, ***në auditorët universitarë, dialektet vihen në pozita nënshtrimi ndaj gjuhës letrare kombëtare***, ato pësojnë përditë ndikimin e saj për t'u afruar me të, përgjithësisht duke marrë tiparet e përbashkëta e duke humbur tipare të veçanta dialektore. Ligjërimi i përdorur prej pedagogëve dhe studentëve është ligjërim standard, pra nën ndikimin e normës letrare; megjithatë në këtë rast norma zbatohet në mënyrë të rregullt, por jo të rreptë për sa i përket përdorimit të stilemave<sup>21</sup>.

Edhe pse në gjendjen e sotme të gjuhës letrare normat e shqiptimit letrar përgjithësisht janë kristalizuar, në hallka të veçanta të tij, vihen re ende disa lëkundje. Kjo pasqyrohet mjaft mirë në komunikimet joformale të biseduesve nga mjedise të ndryshme administrative. Si rezultat i ndikimit të këtij ndryshori sociolinguistik, në të shprehurin *standard*, sidomos në strukturën fonetike të gjuhës, zënë vend elemente të strukturës së dialektit jugor e verior.

Universiteti *Ismail Qemali* shtrihet gjeografikisht në jug-perëndim të Shqipërisë, studentët që vijojnë studimet aty i përkasin mjedisve administrative të ndryshme, duke krijuar kështu një shoqëri heterogjene nga pikëpamja gjuhësore. Janë të shumtë shembujt gjuhësore të studentëve nga qyteti i Vlorës, Tepelenës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Tiranës, Pukës, Kukësit, Shkodrës e Hasit, të cilët paraqesin tipare dialektore/krahinore në mjedisin universitar. Prandaj, për të kuptuar më mirë shfaqjet gjuhësore të studentëve të Universitetit të Vlorës është me vlerë diskutimi i elementeve të dy dialekteve dhe pasqyrimi i tyre në ligjërimin letrar.

Studiuesi Shkurtaj (2003:232) pohon se ndikimi i gjuhës letrare ndihet edhe në lëmin e të folurit të përditshëm, i cili pëson ndryshime të vazhdueshme, duke u afruar me gjuhën letrare. Në shkolla dhe mjedise akademike është e rëndësishme për studentët dhe profesorët të flasin gjuhën standarde, sepse jo të gjithë prej tyre vijnë

<sup>18</sup> Studiuesi Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe*, dallon dy lloj librash: teorike dhe praktik (sidomos librat e gramatikës, ku mbizotëron gjuha e saktë e përdorur sipas normës gramatikore, por e zhveshur nga emocioni), dhe librat letraro-artistike, (të cilët karakterizohen nga përdorimi elastik i normës, si dhe përcjellin emocion me intensitet të lartë). Këta lloj librash janë ndërtuar sipas parimit: kush flet, me kë, përse dhe në çfarë varianti gjuhësor.

<sup>19</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2001. f.150. Pedagogët kanë përgjegjësi që ta bëjnë sa më të kuptueshëm dhe efektiv të folurin e tyre. Sa më shpesh të përdoren stile të njëjta ligjërimi, aq më i suksesshëm është komunikimi.

<sup>20</sup> Po aty, f.150.

<sup>21</sup> Po aty, f.174.

nga i njëjti mjedis administrativ, gjithashtu i përkasin kushteve të ndryshme shoqërore, ku funksionon dhe zhvillohet gjuha<sup>22</sup>.

Ky pohim gjen zbatim në auditorët e universitetit, gjatë komunikimit formal midis pedagogëve dhe studentëve. Stilet e komunikimit të pedagogëve dhe studentëve janë secili të kuptueshëm në vetvete, por ata mbartin ndryshime të cilat mund të krijojnë keqkuptime gjatë bashkëbisedimit. Nëse stili i komunikimit të pedagogut ndryshon nga stili i studentëve të tij, atëherë ata nuk komunikojnë me efektivitetin e duhur. Kjo është si rezultat edhe i faktit se nuk mund të pretendohet se të gjithë studentët t'i përshtaten një stili të vetëm, atij të pedagogut. Por, edhe pedagogu duhet të ketë parasysh llojet e ndryshme të të folurit të studentëve, në mënyrë që t'i përshtatet atyre.<sup>23</sup>

Duke shkuar më tej, në ligjërimin e përditshëm të studentëve si përdorues të standardit, në situatat joformale, vërehen shmangie dhe lëkundje të normës letrare, ndonëse tematika e bisedës është rreth mësimëve.

Gjithashtu, për arsye të ndikimit të gjuhës letrare, si dhe bashkëveprimit ndër-dialektor, numri i folësve që kalojnë në të folurin letrar shtohet, por dialekti nuk zhduket pa lënë gjurmë.<sup>24</sup> Tiparet dialektore shfaqen si ngjyresë krahinore të gjuhës letrare, pra në formën e një nënshtrëse origjinale dialektore. Timbret krahinore që shfaqen në shqiptim nuk konsiderohen thyerje të normës letrare.<sup>25</sup>

### **Rast studimi 1**

Për të parë shkallën e përvetësimit të gjuhës së njësuar letrare shqipe, të drejtshqiptimit e drejtshkrimit të saj nga 100 studentë në degë e vite të ndryshme studimi u prezantuan me disa pyetje në lidhje me përdorimin e gjuhës standarde në auditor dhe jashtë tij. Në këtë rast është zbatuar metoda empirike. Rezultatet e studimit paraqiten më poshtë sipas pyetjeve përkatëse:

#### **(1) Sipas jush, mendoni se keni njohuri të mjaftueshme për gjuhën letrare?**

Pjesa më e madhe e studentëve, rreth 70% , u shprehën se kanë njohuri të mjaftueshme rreth standardit dhe situatave ligjërimore kur duhet përdorur, ndërsa 30 % dhanë përgjigje jo të drejtpërdrejta në lidhje me këtë çështje, jo të drejtpërdrejta në lidhje me këtë çështje, duke lënë të nënkuptojnë se njohuritë e tyre për gjuhën letrare ishin të pakta.


---

<sup>22</sup> Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 37-40

<sup>23</sup> Keranen, N., & Bayyurt, Y., *Bridging the Gap Between Teaching Styles and Learning Styles: A Cross-Cultural Perspective*, United States. 2006, f. 1.


<sup>24</sup> Shkurtaj, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2003. f.233-234

<sup>25</sup> Shih, po aty. f. 234



Figurë 1. 1 Përqindja e njohurive për normën standarde.


Ndërkohë, nga bisedat e ndryshme u evidentua se realisht vetëm 50% e studentëve të anketuar zotërojnë shumë mirë rregullat drejtshqiptimore të normës, 20% i përkasin nivelit mesatar dhe 30% e tyre nuk i zotërojnë mirë rregullat gjuhësore të njësuara, por ligjërimi i tyre manifeston forma të varianteve dialektore dhe shkelje të normës standarde.



Figurë 1. 2 Përqindja e njohurive për normën gjuhësore.

**(2) Në bisedat me miqtë dhe shokët, shoqet e klasës, flisni më tepër në gjuhën standard apo në atë bisedore ose të lirë?**

Përgjigjet e të anketuarve dhe konkluzionet e arritura nga vëzhgimi nxorën në pah se, 80% përdor ligjërimin bisedor dhe deri diku të shkujdesur në situata joformale; ndërsa 20% përdorin gjuhën standarde. U vu re se, edhe kjo kategori që “pretendon” që përdor standardin në biseda të lira, ligjërimi i tyre karakterizohet nga tipare bisedore ku mbizotëron ana subjektive dhe emocionale e ligjëruesve.



Figurë 1. 3 Përqindja e mbizotërimit të gjuhës së thjeshtë dhe standardit në bisedat e lira.

Në këtë rast gjen shprehje edhe koncepti gjuhësor kode dhe forma “*quasi-standard*” –thujse standarde (Daniel Long, 1996:118-135). Në rastin tonë, folësit studentë kanë perceptimin që në ligjërimin e tyre verbal ata përdorin normat standarde të gjuhës, edhe pse diskursi i tyre gjuhësor paraqet format jostandarde të cilat nuk konsiderohen letrare. Si rrjedhim, gjatë kalimit të kodeve nga ligjërimi bisedor në atë standard, dukuri e njohur në gjuhësi si code-switching, interlokutorët me pavetëdije përdorin tipare ligjërimore të të dyja kodeve: forma standarde dhe jostandarde. Përdorimi i këtyre kodeve kushtëzohet nga faktorë socio-psikologjik dhe shpjegohet nga kompetenca gjuhësore e individit.<sup>26</sup> Të para në kuadër më të përgjithshëm të Sociolinguistikës, format gjuhësore që perceptohen si standarde hedhin dritë mbi rolin e tyre në përdorimin e gjuhës, përhapjen e dialekteve dhe në procesin e vazhdueshëm të ndryshimit të gjuhës.

Studiuesi Gj. Shkurtaç, gjithashtu, është shprehur se shumë njerëz, edhe në stilin e shqiptimit libror, bien në shmangie nga norma letrare<sup>27</sup>. Kjo ndodh sepse shumë njerëz nuk janë shkëputur ende nga veçoritë e dialektit a të folmes së vendlindjes, si p.sh. fjalët me *e* të theksuar, të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore (**m, n, nj**) duhet të shqiptohen me *e* (dhe jo disa me *e* dhe disa më *ë*): *dhemb* jo *dhëmb*, *fëmër* jo *fëmër*, *vënd* jo *vënd*, *mëndje* jo *mëndje*, etj. Pra, në trajtën e folur të ligjërimin të studentëve ruhen ende mjaft gjurmë dialektore e nëndialektore. Kjo lidhet në radhë të parë, me arsye që shprehitë nyjëtimore folësi i merr që në moshë të vogël dhe ato nguliten fort e bëhen relativisht të qëndrueshme.

Si rezultat i relativizmit gjeografik, Universiteti i Vlorës, karakterizohet nga raste ku mbizotëron shumëllojshmëria e nëndialekteve. Ky tipar është më i dukshëm tek studentët e vitit të parë të studimit të cilët i kanë ende të forta lidhjen me vendlindjen dhe si pasojë edhe më stilin ligjërimor që flitet aty. Por kontakti i përhershëm i tyre me stafin pedagogjik, komunikimi i drejtpërdrejtë dhe numri i madh i pjesëmarrësve në të, siç është ora e leksionit apo seminarit, ndikon ligjërimin e studentëve duke forcuar më tepër prirjen drejt normës së përgjithshme dhe komunikimi merr natyrë librore.<sup>28</sup>

### **(3) Në cilin prej dialekteve (geg / tosk) bazohet gjuha standarde?**


Ata dhanë këto përgjigje: vetëm 82 % e tyre kishin njohuri se toskërishtja është në bazë të gjuhës sonë standarde, ndërsa 15 % mendojnë se norma letrare mbështetet në shkrirjen e dy dialekteve dhe vetëm 3 % u shprehën se standardi bazohet në gegërishte. Përemri pronor në shprehjen *klasa tënde*, u konsiderua gramatikisht i saktë

<sup>26</sup> Long, D., *Quasi-Standard as a linguistic concept*, United States, 1996, f. 118-120.

<sup>27</sup> Shkurtaç, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 1001.

<sup>28</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 16-163.

nga 40% e studentëve të anketuar, ndërsa pjesa tjetër quajten të saktë dy variantet e tjera *klasa jonë* dhe *klasës suaj*.




**Figurë 1. 4** Njohuritë e studentëve për normën gjuhësore të paraqitura në përqindje

**(4) Gjuha standarde përdoret në:**

- (a) Mjediset publike**
- (b) Në shkolla**
- (c) Në gazeta e televizione**
- (d) Në dokumentet zyrtare**
- (e) Të gjitha alternativat.**

Pothuajse të gjithë studentët e anketuar pohuan se përdorimi gjuhës standarde realizohet në institucione apo shkrime zyrtare. Ndonëse, një pakicë e pakonsiderueshme zgjodhën pikën (e) *të gjithë alternativat*, duke përfshirë përdorimin e gjuhës standarde edhe në mjediset publike.




**Figurë 1. 5** Përqindja për kontekstin e përdorimit të normës gjuhësore.

**(5) Varianti i saktë është:**

- (a) standard**
- (b) standarti**
- (c) standart**
- (d) standardizimi**

Në këtë rast, në të folur në variantin b / c ndodh shurdhimi i bashkëtingëllores –d në pozicion fundor. 48 % e studentëve përzgjedhën variantin (a), 24 % e tyre

zgjodhën alternativën (b), 18 % përzgjedhën variantin (c) dhe 10 % alternativën e fundit (d).



**Figurë 1.6** Përqindja e përzgjedhjes së alternativave për shqiptimin e fjalës *Standard*.

### **(6) Çfarë stili ligjërimit përdorni gjatë komunikimit me pedagogët?**

Gjithashtu, 90% e studentëve u përgjigjën se në komunikimet me pedagogë, t përdorin normën letrare; ndërsa 10% e të anketuarve përdorin një të folur më të thjeshtë i karakterizuar nga fjalë apo struktura gramatikore të thjeshta:

**Student 1.** Mund të m'a shpjegoni dhe njëherë ju lutem, se nuk e kam shumë të qartë.

**Student 2.** Presore të lutem, mund të më bëni një përmbledhje për këtë çështje se nuk e kuptova?

**Student 3.** Ju lutem mund të m'a shpjegosh edhe një herë pjesën e fundit të mësimit sepse nuk e kam kuptuar dhe kam nevojë për një sqarim të dytë?

**Student 4.** Ka mundësi t'a shpjegoni edhe një herë?

**Student 5.** Presore, të lutem mund t'a shpjegosh përsëri? Nuk e kam shumë të qartë.

**Student 6.** Presore, të lutem mund t'a shpjegosh përsëri këtë pjesë, po nuk e patët bezdi?

**Student 7.** Këtë pjesë e kisha shumë të vështirë për t'a kuptuar, mund t'a shpjegoni edhe një herë?

Në këto shembuj bie në sy shkelja e normës letrare në mënyrë të pavetëdijshme, ndoshta prej mosnjohjes së mirë të rregullave normative. Ndërkohë, që parimi i Daniel Long, forma dhe kode pothuajse standarde, zbatohet në të gjitha rastet. Në këtë mënyrë ai shndërrohet në rregullë përgjithësuese për ligjërimitin akademik të Universitetit "Ismail Qemali".

Sikurse vihet re, norma standarde e përdorur në universitet, ka huazuar disa tipare fonetike, gramatikore e leksikore nga ligjërimiti bisedor. Gjithmonë e më shpesh përdoren format e shkurtuara të foljeve, fjalët me kuptim të përgjithshëm, përshëndetjet e zakonshme, etj. Kjo prirje nuk e pengon aspak komunikimin midis dy niveleve të ndryshme akademike, pedagogë-studentë, përkundrazi, është një ndihmesë për të lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit.

Ndërkohë, që në shqyrtimin e normës drejtshkrimore u realizuan ese në tema të lira për të parë gabimet karakteristike drejtshkrimore të studentëve. Objektiva e kësaj pune hulumtuese ishte evidentimi i gabimeve të studentëve në fushën e morfologjisë.

Në bazë të rezultateve të nxjerra nga kontrolli i ese-ve të studentëve mund të nxirret përfundimi se shkalla e përvetësimit të gjuhës letrare shqipe nga studentët nuk është në nivel të duhur. Gabimet në këtë fushë, paraqiten më të detajuara në kapitullin “*Kundërime gramatikore*”.

V. Lebovi<sup>29</sup> ka vënë re se cilësia e arsimit të një vendi, ndikon në minimizimin e dallimeve midis variantit të gjuhës standarde dhe variantit të folur joformal. Nga ky pohim, shprehet qartë roli i padiskutueshëm që ka edukimi gjuhësor gjatë viteve të shkollimit dhe kultivimi i tij i mëtejshëm në rritjen e kompetencës gjuhësore për normën standarde.

Gjatë këtij procesi gjuha letrare dhe dialektet derisa të gjallojnë do të jenë në lidhje dhe në marrëdhënie dialektike të caktuara në zhvillim<sup>30</sup>. Një konceptim i tillë i raporteve midis gjuhës standarde dhe ligjërimeve dialektore lejon që për shkollën apo universitetin të ndërtohet një strategji gjuhësore më elastike dhe më reale. Në thelbin e kësaj politike gjuhësore do të qëndronte konceptimi i varianteve gjuhësore të shqipes si segmente të një kontinumi, në të cilin për qëllime studimi nga pikëpamja funksionale mund të dallohen: “(1) *gjuha standarde librore*; (2) *gjuha standarde e folur*; (3) *ligjërimi i zakonshëm bisedor*; (4) *ligjërimi i shkujdesur*, tipare gjuhësore të të cilit përputhen më shpesh me dialektin”. (Shkurtaj-Memushaj 1998:60)

Gjithsesi shtrohet pyetja, a mund të jemi të kënaqur nga niveli i përvetësimit të gjuhës letrare dhe kulturës gjuhësore të nxënësit apo studentët? Dhe ku duhet t'i shohim shkaqet për një ngecje të tillë? Këto pyetje meritojnë studime të mëtejshme e të thelluara.

#### **b. Ndikimi i standardit dhe marrëdhëniet gjuhë e njësuar / nëndialekt / idiolekt**

Gjuha standarde shqipe ka në bazë tipare të dialektit jugor në sistemin leksikor, në sistemin morfologjik e në sistemin fonetik. Ndërsa nga dialekti verior ka marrë disa elemente të veçanta me qëllim plotësimin e disa funksione të caktuara dhe që nuk

---

<sup>29</sup> Agnihotri, R. K., *Labov's Concept of the Vernacular Speech: The Site of Language Structure, Acquisition and Change*, United States, 2013, f. 101.

<sup>30</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 387.

shkaktojnë përzierje brenda tij<sup>31</sup>. “Gjuha letrare kombëtare ngrihet dhe formohet mbi bazën e dialekteve e merr lëndët gjuhësore prej tyre dhe formon një sistem mbidialektor me normë të njëjtë për të gjithë. Zakonisht mbi bazën e saj qëndron një dialekt. Nga pikëpamja gjuhësore çdo dialekt ka mundësi dhe është i aftë të t’u ngritur në nivelin e një gjuhe letrare e cila ka në bazën e vet një dialekt, por nuk përputhet krejtësisht me të”<sup>32</sup>.

Norma letrare, krijoi shtresat e saj nëpërmjet lidhjeve me strukturat e ndryshme gjuhësore të të dy dialekteve. Gjatë procesit të huazimit dhe përzgjedhjeve gjuhësore, norma standarde ka mënjanuar shumë elemente të rrafshit tingullor e leksikor me karakter mbeturinor. Për ilustrim mund të përmendim se në toskërisht sot bashkëjetojnë format me rotacizëm dhe format pa rotacizëm p.sh., (*vera-vena*), por (*hëna-hana*), etj. Rotacizmi i *n*-së ndërzanore në strukturën e gjuhës letrare mund të konsiderohet një tipar i shqiptimit jugor (*khs: vera-vera, hini-hiri, bani-bëri*)<sup>33</sup>. Fjalë të tilla ndjekin rregullat e normës letrare të drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit me *-r*. Por, rotacizmi është një ndërrim historik që nuk vepron më në gjuhën shqipe.

Gjuha letrare ka huazuar edhe mjaft elemente të leksikut nga dialekti geg. Gjatë këtij procesi huazimi janë përfutur edhe forma pa rotacizëm (formime të tilla në shqiptimin jugor duhet të kishin rotacizëm). Si rezultat, në gjuhën letrare gjenden fjalë që kanë burimin nga gegërishtja dhe që s’kanë rotacizëm, si: *zana, rini*, të cilat janë integruar plotësisht në strukturën e gjuhës letrare.

Në këto kushte, mund të shprehemi se norma letrare është në marrdhënie të vazhdueshme e të pandërprera me të dyja dialektet. Por, shembujt e mësipërm, nxjerrin përfundimin se gjuha standarde bazohet më tepër në dialektin tosk, duke pasqyruar tipare dhe elemente gjuhësore më afër veçorive të shqiptimit jugor.

Gjuha si dukuri shoqërore e veçantë, ka një ndërthurje e ndërtim mjaft kompleks. Duke e parë gjuhën si dukuri shoqërore që ndryshon pandërprerë në rrjedhë të kohës në lëmin e shqipes, vërehen ndryshime gjuhësore të rrafshit leksikor, fonetik, morfologjik, sintaksor. Ato bëhen objekt studimi e interpretimi, duke e pasuruar gjuhën shqipe me prurje produktive.<sup>34</sup> Kjo gjuhë e normuar me rregullat e standardit i shërben një komuniteti të caktuar, jo thjesht për komunikim, por edhe si arritje e përparim të zhvillimit të përgjithshëm kulturor gjuhësor të çdo individi të shoqërisë.

Gjithashtu, gjuha e folur ka një sistem më të ndërlikuar, me shumë nënsisteme e mjete gjuhësore të stileve të ndryshme, që funksionojnë në sferën shkencore-tekniqe,

<sup>31</sup> Çerkezi, E., & Billa, E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*, Korçë, 2013, f. 312.

<sup>32</sup> Gjinari, J., *Rotacizmi në dialekte dhe në gjuhën letrare në “Gjuha jonë”*, Tiranë, 1978 f. 46-47.  
Cituat në: Çerkezi E., & Billa E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*, Korçë, 2013, f. 311.

<sup>33</sup> *Fjalori i sotëm i gjuhës shqip*, Tiranë, 1980, f. 98.

<sup>34</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territorial që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 380.

në sferën shtetërore-administrative, letrare-artistike, politike-shoqërore, etj., kurse gjuha e stileve ka një sistem më të thjeshtë për shkak të numrit të kufizuar të stileve të saj<sup>35</sup>.

Dallimi i tyre vjen edhe ngaqë në kodifikimin e normës së gjuhës së shkruar, në parimin fonetik<sup>36</sup> që është parimi themelor i gjuhës sonë letrare, ndërthuren edhe parimi gramatikor, i cili kërkon të ruhen në shkrim njësia tingullore e fjalëve e të morfemave dhe parimi historik me parimin tradicional, që e largojnë normën e gjuhës së shkruar nga norma e shqiptimit të sotëm.

Të shumta janë trajtimet teorike për gjuhën si fenomen socio-kulturor, për gjuhën standarde dhe marrëdhënien e saj me dialektet. Sipas A. Marashit (2011:11) shqipja i ka mjaft të gjalla dhe tepër aktive dialektet e saj. Prurjet dialektore dhe e folura bisedore janë rryma të natyrshme, që mund ta ushqejnë e ta vitalizojnë normën letrare.<sup>37</sup>

Një paraqitje sado e shkurtër mbi studimet në këto fusha gjuhësore do të merrte shumë hapësirë. Prej studimeve të deritanishme mund të thuhet se nga të dy format e gjuhës standarde më e zbuluar dhe më e ndjeshme ndaj trysnive së dialekteve është forma e folur, sidomos ligjërimi bisedor. Ndryshe nga sferat e fonetikës dhe të morfologjisë që kanë inventar dhe sistem të përcaktuar e të fiksuar, sferat e leksikut e të sintaksës mbeten gjithmonë më të hapura ndaj veprimit të dialekteve edhe në normën e shkruar sepse këto dy sfera kanë më shumë shtresëzime stilistike, që kanë nevojë për variante funksionale, dhe ka ndërtime dhe fjalë sinonime që duhen pasuruar kohë pas kohe.<sup>38</sup>

Gjithsesi, situata e sotme gjuhësore sillet mjaft problematike në lidhje me fushën e zbatimit të kulturës gjuhësore. Jo në çdo aspekt të përdorimit të vet gjuha njihet saktësinë dhe normativitetin standard. Kështu, shumëllojshmëria e mjeteve të shprehjes, e gjuhëve të shumta të lëvruara brenda një komuniteti, e përdoruesve të tyre kanë rënë në një shkujdesje dhe deformim të standardit.

Në fazën e tanishme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare sferat e leksikut e të sintaksës janë më tepër në lëvizje dhe pësojnë më shumë ndryshime se sistemi fonetik dhe morfologjik. Për arsye të ndryshme kjo është më e theksuar sidomos për sistemin leksikor. Për kristalizimin e mëtejshëm të sistemit leksikor dhe sistemit sintaksor, gjuha letrare u drejtohet më shpesh dialekteve. Në këto dy sfera sot ndihet më shumë veprimi i dialekteve mbi gjuhën tonë standarde.<sup>39</sup>

---

<sup>35</sup> Çerkez, E., & Billa, E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*. Korçë, 2013, f. 313.

<sup>36</sup> Gjinari, J., *Përfaqja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik*, Tiranë, 1984, f. 68.

<sup>37</sup> Marashi, A., *Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve*, Tiranë, 2011, f. 12.

<sup>38</sup> Hudson, R., *Sociolinguistika*, Tiranë. 2002, f. 25

<sup>39</sup> Çabej, E., *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1975, f. 213.

Aspekti i parë që trajtojmë është përfshirja në gjuhën letrare të fjalëve dialektore të cilat shërbejnë për pasurimin, pastrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. Gjuha letrare funksionon në formën e shkruar dhe në formën e folur, midis këtyre dy varianteve ka edhe dallime. Prurjet e shumta të popullatave në qendrat urbane kanë sjellë edhe një përthyerje të ndjeshme të normës letrare, sikurse në qendrat rurale duket një përforsim i dialekteve. “*Ndikimet më të shumta të dialekteve pasqyrohen në sferën e leksikut. Sferat e fonetikës e të morfologjisë i ndjejnë shumë pak dhe shumë ngadalë ndryshimet që vijnë nga shumë dialekte. Përgjithësisht dukuritë dialektore që janë ose që arrijnë të bëhen pas një kohe në fillim gjejnë përdorim të gjerë në variantin e folur të gjuhës letrare dhe pastaj mund të zënë vend edhe në formën e shkruar duke pësuar kështu forma ndryshimi të mëtejshme, në mënyrë të pjesshme ose duke u ndërruar krejt.*”<sup>40</sup>

Kështu, në gjuhën letrare nuk do të hynin nga dialektet pa funksione të veçanta fjalë të tilla, si<sup>41</sup>: *katërdhetë, nadje, edh, tlynë, rënkoj* “ngushëlloj”, *cini* “kanë uji”, etj. Ajo ka pranuar variante dialektore me funksione stilistike ose si sinonime: *gocëvashë* krahas *vajzë*, *lirishtë* krahas *rage*, *epem* krahas *përkulem*.

Ndodh që studentë të ardhur nga qytetet veriore të përdorin me shoqërinë e tyre leksik, ndërtime fjalësh apo shqiptime krahinore. Kjo ndodh më tepër kur ata janë me vajza e djem nga mjedisi i tyre administrativ; ndërsa janë më të pakta rastet e shprehjeve gjuhësore krahinore kur ndodhen në shoqëri heterogjene<sup>42</sup>.

Dijetarë si Bali, Guberina, etj., kanë vënë re se njeriu gjendet në të folur, jo në gjuhë. Ata kanë ndjekur edhe intonacionin nga aspekti i veprimtarisë gjuhësore, të cilin e konsideronin si tërësi vlerash të gjuhës së folur, të realizimit folës. Bali me të drejtë dalloi nyjëtimin nga intonacioni. I pari shenjon folësin, i dyti përmbajtjen e të folurit; ai nënkupton mënyrën e artikulimit të tingujve p.sh.: dallimin midis palataleve e afrikateve dhe të njëjësive të tjera gjuhësore, dallimet e shqiptimit standard-jostandard, kurse intonacioni mund të ndryshojë përmbajtjen e realizimit të të folurit, pra, ai është bartës i përmbajtjes afektive.<sup>43</sup> Folësit dallohen nga pikëpamja stilistike, gjithashtu edhe nga ana fonetike.<sup>44</sup>

Ndër gabimet më të shpeshta në fushën e fonetikës e të fonologjisë në ligjërimin e shqipes janë: përdorimi i varianteve territoriale të fonemave zanore e bashkëtingëllore, përngjashmimi e rënie tingujsh të papranueshme për shqiptimin letrar; zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/, humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /r/, mospërdorimi i glotales [h], shqiptimi më i përparmë e ndonjëherë edhe afrikatizimi i mesgjuhoreve /q, gj/ në /ç,

<sup>40</sup> Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 246.

<sup>41</sup> *Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe*, 1980.

<sup>42</sup> Diferencat gjuhësore sipas mjedisit administrativ paraqiten më të zgjeruara në kapitullin e tretë.

<sup>43</sup> Mujaj, H., *Edukimi gjuhësor dhe indeksikaliteti në gjuhën standarde*, Korçë, 2013, f. 46.

<sup>44</sup> Ducrot, O.; Porter, C.; Rabbitt K., & Waugh L., *Charles Bally and Pragmatics*, United States, 1991, f. 2-19.

xh/; këmbimi i /h/-së me /f/-në, ndërrimi i /nj/-së në /j/, monoftongimi i grupeve të zanoreve /ie/ dhe /ue/ në zanore të rëndomta të gjata, etj.<sup>45</sup>

Gjuha e folur është edhe nën ndikimin e dialekteve dhe gjysmëdialekteve. Parimi fonetik mbetet parimi themelor i cili luan një rol të rëndësishëm në shprehjet gjuhësore të folësit.<sup>46</sup> Norma e gjuhës së folur shqipe pasqyrohet në shprehjet gjuhësore të folësit dhe tregues i zbatimit të saj të drejtë është fakti se si reagon ky folës ndaj varianteve të ndryshme të shqiptimit. P.sh.: shqiptimet, *qën*, *e ënjte*, *shtrënjt*, ngjallin reagim të dëgjuesit dhe vlerësohen si tipare të qarta dialektore të jugut<sup>47</sup>.

Po kështu, edhe lidhur me përdorimin e (ë)-së së theksuar përpara bashkëtingëlloreve hundore, norma e gjuhës së folur e shkruar është njësuar mbi bazën e formave me (e).<sup>48</sup> Lëkundje të normës dhe format me (ë) dëgjohen jo vetëm nga njerëzit e thjeshtë, apo situata joformale, por edhe njerëzit me kulturë gjuhësore, si folësit në tv, etj. Vihet re përdorimi i *e-ë*: *vënd*, *mënd*, *brënda*, *trëmb*, *më dhëmb*, etj.<sup>49</sup>

Shmangie nga norma kemi dhe në përdorimin e *r-rr*: *pavarrësisht*, *orre*, *zotërri*.

Përdorimet e tipit *çertifikat* për certifikatë, *uversitet* për universitet, *fugon* për furgon, *vin* për vjen, *filëm* për film, *pastaja* për pastaj, *naturisht* për natyrisht, *e bëjëm* për e bëme, etj., janë jashtë normës.

Trysnia e dialekteve në raste shumë të pakta shihet edhe në tiparet që lidhen në inventarin e strukturave dhe të formave morfologjike e sintaksore, d.m.th. edhe në raste kur dallimet e dialekteve janë të karakterit strukturor, pra shumë të rëndësishme.<sup>50</sup>

Krahas tipareve të lartpërmendura, shkelje të normës gramatikore janë edhe tipare të tilla si: gabime në përdorimin e nyjës; përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore, në vend të përemrave vetorë; mosdallimi i gjinisë së përemrave vetorë *ata* dhe *ato*; përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën *të*; përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë, që e formojnë shumësin me *-e* dhe *-ra*; dëgjohen shpesh pjesoret e foljeve pa mbaresa: (kam) *lexu*, *shku*, *shkru*; e pakryera veprorë e foljeve ndonjëherë dëgjohet e shkruhet në formën (punojsha) në vend të formës (punoja); *ne*, *ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve*, *juve*; etj.

<sup>45</sup> Beci, B., *Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore*, Tiranë, 1995, f. 53.

<sup>46</sup> Shkurtaç, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f.104.

<sup>47</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 382.

<sup>48</sup> Shkurtaç, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f.124.

<sup>49</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 380.

<sup>50</sup> Omari, A., *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, Tiranë, 2011, f. 175.

Të shpeshta janë edhe gabimet në përdorimin e formës standarde të lidhore, sepse në vend të /ë/-së ose përdoret /e/-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës së tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh.: (thuhet) *të shkojë* ose *të shkon*, *të punoje* ose *të punon*, *të mësoje* ose *të mëson* ( < *duhet të shkojë*, *të punojë*, *të mësojë*) etj<sup>51</sup>.

Duke qenë se gjuha jonë letrare tashmë është e formuar dhe është e ngulitur, në vështrim e parë do të dukej sikur këtu ka një kontradiktë. Por, në të vërtetë nuk ka kontradiktë sepse, së pari në tërësinë e gjuhës letrare të formuar sistemi dhe norma leksikore janë më të hapura. Së dyti, sidomos në sferën e leksikut janë shumë të pakta dallimet e mirëfillta dialektore<sup>52</sup>. Fjalët që do të hynin nga dialektet nuk do t'i binin ndesh normës letrare. Përgjithësisht, këto fjalë të këtilla janë pasuri e gjuhës shqipe. Për ilustrim po japim disa nga këto fjalë: *boranë*, *batak*, *gjithnajë*, *kopanis*, *tejtu* etj<sup>53</sup>.

Sociologët dhe gjuhëtarët shprehen se shumë pak dihet për strategjitë e të folurit dhe të komunikimit, me të cilat të rinjtë duan të afirmohen në grupin e tyre shoqëror, të krijojnë realitete alternative (subkultura) ose të garojnë për prestigj. Mirëpo, ***në komunikimet e ndërmyjetme*** për të rinjtë është me rëndësi ta shprehin Vetën. Të jesh anëtar i një grupi kërkon një nivel të caktuar të ndërveprimit shoqëror. Njëpërmjet shoqërisë, të rinjtë mësohen ta përcaktojnë identitetin e tyre. Brenda shoqërisë, rrallë, krijohet një lloj identiteti i përkohshëm personal, siç e quan Brown (1990). Komunikimet brenda grupeve të tilla ofrojnë rast për t'i zbatuar aftësitë shoqërore dhe zhvillojnë strategji efektive për komunikim me shokët dhe me të tjerët. Në këtë situatë sociale, gjuha luan një rol të rëndësishëm gjatë përcaktimit të identitetit shoqëror të të riut. Si rezultat, krijimi dhe loja me gjuhën nuk është e pazakonshme në shoqëritë e tilla.

Secili prej nesh i përket grupeve të ndryshme sociale dhe gjithsecili përdor shumëllojshmëri stileshe gjuhësore, me elemente paksa të ndryshme nga stilet gjuhësore të përdoruesve të tjerë të gjuhës.

Po ashtu, studimet sociolinguistike kanë parashtruar mendime për *identitetin statutor të folësit*, të ashtuquajtur ndryshe idiolekt. Në këto studime shtrohet edhe teza se “gjatë ndërkëmbimeve individuale forma e mesazhit reflekton identitetin e adresës dhe referentin përkatës”<sup>54</sup>. Duke kundruar gjetjet gjuhësore të studentëve, tashmë jo në tërësi por si individë të veçantë, vërejmë se si ato pasqyrojnë identitetin individual e social: moshë, seks, krahinë, karakteristikat fizike të zërit, pozicioni, dhe prezantimi i parë i tyre paraqitet njëpërmjet emërtimeve nga të tjetër e për të tjerët. Kështu, përdorimi i zbulimeve: *Lushka*, *Niti*, *Genushe* etj; shfaqja e antroponimeve konotative *Altin Tralalaja*, *Genta Sherrxhesha* dhe i emrave të përgjithshëm: *shoku*,

---

<sup>51</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 383.

<sup>52</sup> Gjinari, J., *Përfaqja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik*, Tiranë, 1984, f. 2.

<sup>53</sup> *Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe*, 1980.


<sup>54</sup> Morau, M., “*Sociolinguistique*”, Paris, 1997, f. 163.

*shoqe*, të cilat shërbejnë si forma të adresimit për të shfaqur orientimin e tyre psikosocial në raport me adresën<sup>55</sup>, si edhe ndjenjën për të vendosur raportet e distancës ose të afërsisë me të tjerët.

Në lëmin e studimeve gjuhësore mbi idiolektin, shumë debate e etiketojnë gjuhën si më tepër vetjake sesa sociale, duke krijuar edhe “*konfliktin*”: Idiolekt kundrejt Sociolekt. Gjuha e përdorur nga individit është përkufizuar si dialekt individual—mënyra origjinale e përdorimi të gjuhës gjatë aktit ilokucionar.<sup>56</sup>

Gjatë përdorimit individual të gjuhës, folësi ndikohet nga një sërë faktorësh, si p.sh.:

**Tabela 1. 1 Faktorët që ndikojnë në ligjërimin individual**



Ndryshimet më të shumta në nivel individual, janë hasur në *fjalorin* e përdorur sipas interesave dhe aktiviteteve dhe *shqiptimin* e fjalëve e shprehjeve të ndryshme, i cili ndikohet nga mjedisi administrativ, që i përket secili student, si dhe nga situata sociale. Në rast të ndryshimit të situatave, folësi ndryshon regjistrin gjuhësor duke e përshtatur ligjërimin në varësi të situatës. Dukuria e ndryshimit të regjistrit (në sociolinguistikë njihet si register switching) ndikon në fonologji, sintaksë, leksik dhe elementet paragjuhësore të individit<sup>57</sup>. Elementet e lartpërmendura ndryshonin dhe përshtateshin sipas interlokutorit me të cilin zhvillohej biseda.

Tipar tjetër i dallueshëm i idiolektit është tipari fonetikor, i cili fiton përdorim edhe në bashkësinë socio-gjuhësore në të cilën folësi individual është anëtar.<sup>58</sup> Nëse tipari fonetikor fiton popullaritet, ai gjen përdorim edhe më të gjerë në kulturat e tjera gjuhësore. Janë jo të pakta rastet kur dëgjohej rëndom të përdoren variante të tilla të fjalëve: *shtëpia-shpia; shpërlaj-shplaj; rrugë-rug; mundësi-munci; internet-net; një çikë-çikë; duhen-duen; hajd-hajt; çfarë-ça; rrihet-riet; vijnë-vin; rëndësishme-rëndsisishme; përdorues-përdorus; kraharor-kraror*.

<sup>55</sup> Shih po ai, po aty, f. 164

<sup>56</sup> Louwrence M., *Investigating the relation between idiolect and sociolect*, Netherlands, 2004, f. 6.

<sup>57</sup> Rentel V. M., & DeStefano J. S., *Language variation: Perspectives for teachers*, United States, 2004, f. 333.

<sup>58</sup> Briscoe R. E., *Individualism, Externalism and Idiolectal Meaning*, United States, 2006, f. 98.

Si përfundim: Duhet pasur parasysh se gjuha e folur e çdo njeriu, varësisht nga vendlindja, vendbanimi, arsimit, profesioni, etj., pasqyron gjurmët e përvojës dhe të përjetimeve të tij.<sup>59</sup>

Dialektet dhe idiolektet do të jenë gjithnjë një burim i pashtershëm për gjuhën letrare e cila do të marr atje fjalë për t'u dhënë kuptimet e një termi dhe do të marr forma e shëmbëlltura formimi fjalësh për të krijuar terma të rinj, ndërtime sintaksore dhe modele origjinale. Gjithë lënda që merr gjuha nga dialektet i nënshtrohet normës së saj sidomos normës fonetike e gramatikore.<sup>60</sup>

Ky proces ka një rëndësi të madhe në zhvillimin e gjuhës sonë të përbashkët sepse me këtë rrugë gjuha letrare duke u rritur nga pikëpamja sasiore shtresën e përbashkët të saj, pëson edhe ndryshime cilësore, afrohet më shumë me dialektet. Kjo rrugë së bashku me procesin e ndikimit të gjuhës letrare mbi dialektet të çon në bashkërendimin e dialekteve me gjuhën letrare.

Normat e dialektet bashkëjetojnë e bashkëveprojnë në mënyrë të pandalshme duke e pasuruar njëra-tjetrën, por deri në atë kufi që nuk do të prekë vlerat e gjuhës së përbashkët standarde shqipe dhe funksionet e saj.

## **PËRFUNDIME**

Gjuha është në proces të vazhdueshëm ndryshimi e zhvillim. Burimi kryesor për këto lëvizje në gjuhën letrare do të jenë përherë dialektet. Gjuha standarde kombëtare është, por duhet të jetë më e hapur ndaj dialekteve, të pranojë prej tyre çdo gjë që nuk bie ndesh me sistemin e saj, çdo gjë që integrohet në mënyrë të natyrshme dhe që pasuron atë. Gjatë këtij procesi gjuha letrare dhe dialektet do të jenë në marrëdhënie të dyanshme gjersa të jetojnë dialektet<sup>61</sup>. Përdorimi i variantit letrar të dialektit nuk e rrezikon gjuhën letrare kombëtare të njësuar. Asnjëri nga dialektet nuk i ka shteruar mundësitë e tij shprehëse, nuk ka vënë në qarkullim të gjithë pasurinë leksikore, frazeologjike dhe ndërtimet sintaksore. Përdorimi i dialekteve në sfera dhe funksione të caktuara do ta pasuronte gjuhën standarde në drejtim të leksikut dhe sintaksës<sup>62</sup>.

Gjithashtu, studiues Kryeziu (2011:94) shprehet se standardi i shqipes nuk duhet t'i përjashtojë apo mohojë dialektet dhe prurjet e reja, as të ngurtësohet, por as të

---

<sup>59</sup> Po aty, f. 234.

<sup>60</sup> Shkurtaj, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2003, f. 234.

<sup>61</sup> Gjinari, J., *Marrëdhëniet e sotme të dialektikave me gjuhën letrare*, Tiranë, 2011, f. 456.

<sup>62</sup> Mansaku, S., *Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standard-dallime terminologjike dhe përmbajtësore*, Tiranë, 2011, f. 60-61.

copëtohet apo rrënohet. Gjuha standarde duhet të jetë një mjet njësimi për kombin e kulturën tonë.<sup>63</sup>

Gj. Shkurtaj (2013:5) pohon se “*në çdo komb a gjuhë kombëtare të caktuar, ka aq variante e idiolekte sa janë realisht folësit e një gjuhë të marrë në studim, shumëzuar për aq lloje e nënloje variantesh sa janë rastet e ligjërimeve që ndjekin parimin tashmë të njohur të sociologut Joshua Fishman: kush flet, me kë, kur, ku, për çfarë*”<sup>64</sup>.

Sinonimia sintaksore, mjetet e ndërtimit e reja sintaksore, fjalët e reja dhe zhvillimet semantike e bëjnë më të zhdërvjelltë dhe më të larmishme gjuhën standarde, ato krijojnë brenda saj variacione social-kulturore dhe stilistike<sup>65</sup>.

Gjithashtu, Shkurtaj shprehet se çdo varietet i gjuhës duhet të shihet në lidhje të ngushtë me faktorët jashtëgjuhësorë që e shoqërojnë atë. Kundrimi gjuhësor duhet bërë në lidhje të ngushtë me anën shoqërore, të kulturës shpirtërore dhe asaj materiale, duke i parë ato si anë të ndryshme, por të lidhura ngushtë në kuadrin e një bashkësie gjuhësore të dhënë.

Duke qenë se në nënsisteme të ndryshme të shqipes letrare, kanë hynë dukuri fonetike e gramatikore dhe elemente të tjerë gjuhësore të dialekteve (sikundër u përmendën më sipër), është pritur që të krijohen vështirësi në zotërimin si duhet të këtyre veçorive. Megjithatë, për aq sa kemi pasur mundësinë t’i ndjekim këto shkrimet e studentëve të të gjitha viteve, është për t’u vënë në dukje se gabimet që janë ndeshur janë më të pakta për sa i përket pikërisht këtyre tipareve dalluese midis gjuhës letrare dhe dialekteve të shqipes. Gabimet më të shumta bëhen në të folurin informal e deri diku formal dhe në fusha të tjera, sidomos në zbatimin e rregullave gramatikore dhe për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme dhe mosinteresimit për zotërimin e zbatimin e normës letrare<sup>66</sup>.

V. Lebovi, në studimet sociolinguistike, ka vënë re se sa më cilësor të jetë arsimimi i një vendi, aq më i vogël do të jetë dallimi midis variantit të gjuhës standarde dhe varianit të folur joformal. Nga ky konstatim, del roli i edukimit gjuhësor që në ciklet e fillores dhe kultivimi i tij në të gjitha stadet e studimit.

Ndërsa në komunikim me pedagogët, studentët ndryshojnë regjistër duke kaluar nga informaliteti në gjuhë në një shkallë më të lartë të mirësjelljes dhe ligjërimit normativ.

Marrëdhëniet e ndërsjella me variantet e tjera jostandarde të gjuhës kanë qenë dhe janë një nga rrugët kryesore për pasurimin dhe zhvillimin e gjuhës standarde në fushën e leksikut dhe të sintaksës<sup>67</sup>. Dialektet ushtrojnë trysni mbi gjuhën letrare,

---

<sup>63</sup> Kryeziu, B., *Shqipja mes globalizimit dhe variantizimit*, Tiranë, 2011, f. 94.

<sup>64</sup> Fishman, J., *Who speaks what language to whom and when?* Paris, 1965, f. 49.

<sup>65</sup> Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë. 2003, f. 110.

<sup>66</sup> Bajnica, I., *Çështje të shqipes së sotme letrare*, Tiranë, 1992, f. 102-103.

<sup>67</sup> Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë, 2003, f. 114.

veçanërisht në fushën e leksikut, struktura e të cilit është gjithnjë më e hapur se strukturat e tjera (fonetike e gramatikore)<sup>68</sup>. Gjithashtu, sipas studiues M. Samara, ndikimi i dialekteve në këtë drejtim ka bërë të mundur krijimin e atij që është quajtur “ndërdialekt”, i cili vihet re sidomos në aspektin e folur ose në stilin e “bisedave të përditshme”<sup>69</sup>. Integrimi i leksikut dialektor në gjuhën standarde krijon mundësi për zhvillimin e përsosjen e normës leksikore duke e pastruar atë nga elementet e huaja nëpërmjet zëvendësimit me fjalë dialektore ose krahinore të huazimeve prej gjuhëve të tjera fqinje ose jofqinje.

---

<sup>68</sup> Samara, M., *Roli i dialekteve të shqipes për zhvillimin e normës letrare në fushën e leksikut*, Tiranë, 1992, f. 333.

<sup>69</sup> Shih po aty, f. 334.

## KAPITULLI I DYTË

### Universiteti dhe komunikimi gjuhësor brenda dhe jashtë tij

---

- a. **Ligjërimi studentor: gjuha dhe kultura rinore.**
  - b. **Sjellja gjuhësore dhe ligjërimi si pjesë e saj: diferencat e sjelljes gjuhësore në mjedisin universitar**
- 

#### a. **Ligjërimi studentor: gjuha dhe kultura rinore.**

Shqipja në mijëvjeçarin e ri është nën ndikimin mjaft të madh të kulturës rinore, e pasur me elemente stilistikore të larmishme që ndryshojnë shpejt dhe pasqyrojnë identitetin e adoleshentëve e të rinjve<sup>70</sup>. Në këtë kontekst, gjuha përbën jo vetëm burimin e mjeteve leksiko-semantike dhe gramatikore, por është edhe një mjet i rëndësishëm i stileve kulturore të rinjtë. Ndonëse stilet dhe situatat sociale ndryshojnë vazhdimisht, përdorimi simbolik i gjuhës për të shfaqur identitetin vetjak ose atë në grup, do të zgjatë në kohë sa vetë gjuha<sup>71</sup>.

Dekadat e fundit në Shqipëri janë shoqëruar jo vetëm me ndryshime politike dhe ekonomike, por ndryshimi më i madh ka ndodhur në stilin e jetës. Shumë të rinj, por jo vetëm, të ndihmuar nga mediet, shfaqën identitetet e tyre në veshje, flokë, muzikë, kërcim dhe gjuhë. Zhvillimi i teknologjisë, sidomos i medias digjitale interaktive (internet), favorizoi krijimin e stileve inovative të kulturës rinore. Në gjuhën shqipe janë përfutur forma dhe përdorime të reja gjuhësore<sup>72</sup>. Përdoruesit më ekspert dhe krijues të kësaj media janë të rinjtë. Ata përdorin edhe këtë formë komunikimi për të përhapur kulturën e tyre. Gjuha shqipe formëson stilet rinore të komunikimit nëpërmjet internetit, duke kaluar kufijtë gjeografik të Shqipërisë dhe bashkon të rinjtë

---

<sup>70</sup> Bucholtz, M., *Globalization: language and youth culture*, United States, 2000, f. 281.

<sup>71</sup> Bently, H., *Slang today and yesterday; dictionary of American slang; Slang, phrases and idiom in colloquial english and their use*, United States, 1935, 63.

<sup>72</sup> Vehbiu, A., *Leksiki i shqipes së sotme - Sfida të pasurimit*, Tiranë, 2011, f. 444.

shqiptarë anembanë botës. Në kontekstin e përdorimit të medias digjitale interaktive, huazimet dhe shkëmbimet kulturore e gjuhësore janë të njëkohshme<sup>73</sup>.

Fenomeni gjuhësor më i dukshëm dhe dominues i kulturës rinore është ligjërimi i lirë. Ligjërimi i shkujdesur, si pjesë e zhargonit studentor shqiptar është pak i studiuar dhe mungojnë të dhëna të plota në këtë drejtim. Ndërsa, studiues të huaj kanë dokumentuar përdorimin dhe funksionimin e këtij ligjërimi, si tipar dallues i grupeve të ngushta shoqërore<sup>74</sup>.

Dy çështje janë të diskutueshme: përdorimi i ligjërimin të lirë për të dalluar identitetet rinore nga njëri-tjetri dhe procesi i transmetimit e transferimit leksiko-semantic të këtij ligjërimi nga një grup tek tjetri.

Studimi dhe rezultatet tregojnë se kultura rinore nuk është e bashkuar gjuhësisht [d.m.th. kulturat rinore shqiptare (studentët përfaqësojnë mjedise të ndryshme administrative) paraqesin dallime e ngjashmëri gjuhësore midis tyre]; konteksti luan ende rol të rëndësishëm në këtë komunikim. Folësit e përdorin gjuhën me qëllim që të arrijnë synimet e tyre dhe gjatë procesit të dhënies e marrjes së informacionit, gjuha e kultura ridimensionohen për t'iu përshtatur identiteteve e qëllimit të komunikimit. Është i domosdoshëm studimi i praktikave gjuhësore të kulturës rinore jo thjesht si shfaqje gjuhësore e veçuar nga dukuritë e tjera të gjuhës, por si një burim stilistikor që krijon një mori identitetesh sipas grupmoshave.

Gjithashtu, në studim vërtetohet se një përqindje e të rinjve studentë nuk përfshihen tërësisht në “trendin” e kulturës rinore ku ata bëjnë pjesë. Kjo rezistencë ndaj rrymës së kulturës rinore, në përgjithësi shoqërohet edhe me rezistencë ndaj ndryshimeve gjuhësore që karakterizon këtë shtresë shoqërore. Ata refuzojnë të përdorin në mënyrë të tepruar terma dhe fraza zbuluese, sharje dashamirëse, fjalë të huaja apo të etiketojnë të tjerët me qëllim talljeje, ironie apo humori. Qëllimi i kësaj zgjedhjeje gjuhësore qëndron në ruajtjen dhe shfaqjen e individualitetit dhe personifikimin e tyre tashmë si individ dhe përdorues gjuhë të ndërgjegjshëm.

Ndryshueshmëria që shfaqet në identitetet sociale të të rinjve është tregues i mungesës së unitetit në kulturën rinore dhe i rolit të kontekstit në ligjërim. Pavarësisht nga kompetenca gjuhësore, folësit përdorin burimet linguistike të shqipes për të qenë krijues në kontekste të ndryshme, gjatë këtij procesi gjuha e kultura riformohen për t'iu përshtatur identiteteve të reja kuptimore<sup>75</sup>.

Studimi i praktikave rinore është i rëndësishëm për analizimin e ligjërimin rinor, jo thjesht si njësi e vetme gjuhësore, por si tërësi burimesh stilistike që së bashku krijojnë një mori identitetesh sociale sipas ndryshorit *moshë*<sup>76</sup>. Ura që lidh ngushtë variantin e folur me standardin përfaqëson një aspekt themelor të shkencave

---

<sup>73</sup> Vehbiu, A., *Leksiki i shqipes së sotme - Sfida të pasurimit*, Tiranë, 2011, f. 446.

<sup>74</sup> Bucholtz, M., *Globalization: language and youth culture*, United States. 2000, f. 283.

<sup>75</sup> Shih, po ai, po aty, f. 282.

<sup>76</sup> Labov, T., *Social and language boundaries among adolescents*, United States. 1992, f. 340.

didaktiko-psikologjike, pra gjuhën standarde me të gjitha rregullat e saj ta kthejë në aftësi të çdo individi<sup>77</sup>.

Si konkluzion, gjuha është mjeti kryesor në komunikimin social. Ligjërimet ndërpersonale të realizuara në kontekste të ndryshme, përveç mesazheve, përcjellin edhe kulturën e bashkëbiseduesve<sup>78</sup>, në rastin tonë, kulturën rinore. Gjuha dhe kultura ndërliidhen me njëra – tjetrën në mënyra të shumta dhe komplekse.

Ngjarjet, eksperiencat, mendimet, emocionet, qëndrimet, vlerat dhe besimet shprehen nëpërmjet mjeteve gjuhësore. Si rrjedhojë, gjuha shpreh realitetin kulturor të interlokutorëve. Lënda e mbledhur gjatë hulumtimit shkencor nxjerr në pah se grupet sociale, sikundër janë bashkësitë e ndryshme shoqërore të studentëve shpeshherë shprehen nëpërmjet të njëjtit kod gjuhësor.

Pra, folësit identifikojnë veten dhe të tjerët, duke përdorur të njëjtat mjete gjuhësore, të cilat i konsiderojnë si simbole të identitetit të tyre social. Fjalët, frazat dhe kuptimet e veçanta që asociohen me shprehje të caktuara, iu imponohen anëtarëve të grupit shoqëror. Në rast refuzimi, për të përdorur gjuhën tipike të një grupi të caktuar shoqëror, konsiderohet si refuzim ndaj bashkësisë sociale dhe kulturës së tyre. Si rezultat, mund të shprehemi se gjuha simbolizon realitetin kulturor.

### **b. Sjellja gjuhësore dhe ligjërimi si pjesë e saj: diferencat e sjelljes gjuhësore në mjedisin universitar**

Gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet, duke përdorur një sistem mjjetesh ( tinguj, morfema, fjalë, trajta) dhe rregullash për vargëzimin e tyre (për ndërtimin e fjalëve, togfjalëshave e fjalive)<sup>79</sup>. Ndërthurja e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, me vijueshmërinë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit, rezulton në një bashkëbisedim të suksesshëm.

Pavarësisht nga qëllimi i komunikimit (si shprehja e ndjenjave dhe e botës së brendshme, ndikimit mbi të tjerët, veprimi në shoqëri, etj.), gjuha nuk i nënshtrohet një ndryshimi rrënjësor, por i shfrytëzon më tej mundësitë e brendshme të sistemit, duke përfutuar kështu komunikim më të pasur, më të efektshëm që është i hapur edhe për modelet vetjake. Kjo lejon që të shprehet individualiteti i ligjëruesit dhe origjinaliteti i tij. (Lloshi, 2001:8). Pra, ndodh gërshetimi i modelit dhe veçantisë. Në këtë kontekst, koncepti i stilit ose idiolektit, si kulturë gjuhësore individuale apo veçanti e shijes gjuhësore të autorit në zgjedhjen midis mënyrave sinonimike edhe atëherë kur situatat e qëllimet e komunikimit mund të jenë të njëjtat, vepron fuqishëm

---

<sup>77</sup> Long, D., *Quasi –standard as a linguistic concept*, United States, 1996, f. 118.

<sup>78</sup> Kramsch, C., *Language and culture*, Oxford, 1998, f. 3.

<sup>79</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 7.

në ligjërimin ndërpersonal. Sikurse është shprehur G. L. Byfoni “*Stili është vetë njeriu*”.<sup>80</sup>

Sot, të rinjtë studentë përdorin terma dhe tema të thjeshta nëpërmjet të cilave realizojnë të plotë shprehjen emocionale e subjektive, sponate e joformale. Sa më shumë të mbështeten tek faktorët jashtëgjuhësorë, mimika, intonacioni, etj, aq më shumë mbizotëron natyra bisedore në ligjërim.<sup>81</sup>

Si rezultat, përpjekja për të zgjedhur me kujdes fjalët dhe stilin e ligjërimit dobësohet shumë dhe komunikimi është i drejtpërdrejtë. Por, për folësin ka rëndësi që ky bashkëveprim të jetë i përshtatshëm për qëllimet e tij dhe nuk përqendrohet tek çështja se sa “korrekt” është të folurit e tij; prandaj, biseda del si e rastësishme.

Tabela e mëposhtme paraqet disa mënyra se si studentët interpretojnë ose krijojnë shprehjet e tyre sinonimike për thënie të veçanta. Numri i studentëve të anketuar për këtë qëllim është 50. Ata i përkasin degëve të ndryshme të studimit dhe përfaqësojnë mjedise të ndryshme administrative. Për këtë arsye disa interpretime personale të shprehjeve paraqiten në dialekt:

**Tabela 2. 1 Interpretime personale të studentëve për fjalë ose shprehje të përdorura në marrëdhëniet informale me njëri-tjetrin, në ambientin universitar (jashtë auditorit).**

| <b>Fjalët dhe shprehet si duhen thënë</b>     | <b>Fjalët dhe shprehjet si thuhet apo interpretohen nga studentët</b> |
|---|---|
| Më shkatërrove!                               | Më destruktove fare!  |
| Edhe për sa minuta përfundon ora e mësimimit? | <i>Edhe sa min..Mbaron Ora?</i>                                       |
| Ti nuk kupton.                                | Je out fare!  |
| Të dua!                                       | Te amo kulish im.   |
| Nuk e nxjerr sekretin.                        | E ka gojën si arka e plakës.  |
| Si të duash ti.                               | Si të dush. Si “urdhëron” zotrote                                     |
| Nuk e kupton çfarë po të them.                | Hajde nesër. Po flas kot! Kujt i flas!                                |
| Ndrysho temën e bisedës.                      | Ndërroje diskun.  |
| U keqkuptove!                                 | I merr fjalët me cepa!  |
| Dakord!                                       | Ok, ok!; U morëm vesh tani!   |
| Kalofsh mirë!                                 | Klm...  |
| Faleminderit!                                 | Rrofsh!   |
| Nuk mërzitem për atë gjë!                     | Smë mërzitet aslher!  |
| Mirëmëngjesi!                                 | Gjesi! Mëngjesi!  |
| Mirupafshim!                                  | Paçim! Pao!   |

<sup>80</sup> Lloshi Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 9.

<sup>81</sup> Labov T., *Social and language boundaries among adolescents*, United States, 1992, f. 345.

Të shumtë janë edhe shembujt e përdorimit vetjak të gjuhës. Një grup vajza dhe djem, 45 studentë, shprehen kështu për të njëjtat pyetje:

**(1) Si reagoni kur shikoni diçka të bukur?**

Studente vjaza:

**Studente 1:** Ua, sa e bukur!; Sa gjë e veçantë!

**Studente 2:** Kull fare! (<ang. Cool, <alb. fantastike); këto t'a bëjnë me sy...! (për një veshje të bukur);

**Studente 3:** Sa e bukur!; Shumë të bukura kto!

Student djem:

**Student 1:** Super!; Hallall!

**Student 2:** Grand fare!

Rreth 90% e të vajzave të intervistuarë për këtë nënçështje përdorin pasthirrat, mbiemrat, sinonimet, fjalët e huaja për të shprehur habi, vlerësim dhe emocion. Ndërsa djemtë shprehin mendimet pozitive nëpërmjet një të foluri më të lirë apo të shkujdesur.

**(2) Si reagoni kur dëgjon një lajm të keq?**

Studente vjaza:

**Studente 1:** Ua, çfarë ishte ajo? Mos, sa keq! Po s'i ndodhi kështu?

**Studente 2:** Bobo, sa keq...! O Zot, çfarë tmerri!

**Studente 3:** Ua, sa gjynah....!

Edhe në përgjigjet e kësaj pyetjeje mbizotërojnë pasthirrat, shprehjet emotive në ligjërimin e vajzave; ndërsa në ligjërimin mashkullor vërehet një përdorim i gjerë i mbiemrave, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Duhet theksuar se në lidhje me dy pyetjet e mësipërme, shprehjet gjuhësore shoqërohen së tepërmi nga elementet jashtëgjuhësore, si mimika, gjestikulacioni, lëvizje të veçanta të duarve apo të trupit etj. Këto tipare shfaqen më së shumti në ligjërimin femëror.

**(3) Keni një fjalë ose shprehje që e përdorni gjithmonë?**

**Studente 1:** O Zot, o Zot!; Qyqja!; Qesh mirë kush qesh i fundit! Hë, se bota e rumbullakët është, rrotullohet nga rrotullohet dhe prapë në një vend vete!

**Studente 2:** Jalla o gra, s'e burra s'ka!; Hallal!; Jam të më fali Zoti (jam shumë e mirë)!; Jam e çmendur për gallata!; Ja kjo i bashkoi tufat (vetullat).

**Studente 3:** Jalla, jalla, n'a je bërë si burri i babait! (kur dikush bëhet tepër i bezdisur); Duaj të të duan.;

**Studente 4:** Mos e prish terezinë.; Vallahi, Nuk durohet.; Më shkule (shkrive) së qeshuri.; Ç' të të llafos!

**Studente 5:** Bëfshi qejf!; Shkëlqyer fare.; Po, pra, po!; Është kryevepër!; S'kam hiç qejf!

**Studente 6:** Vdeksha tre herë rresht, po është kujtuar ajo!; Ma hoqe trurin!; Unë ty love shumë!; Do na japësh nga një domate, me lalë?

**Studente 7:** Më e mira do bëhet, më keq s'ka ku të vejë.; Hallall, e meriton!; Pfff, n'a mbaruan lekët.

**Studente 8:** Hi! Bye! See you soon! Ci vediamo! Etj.

**Studente 9:** Pikë e zezë me këta njerëz të bardhë.; Të marrtë lumi, me të lartë, se me të poshtë i merr të gjithë!; Eh, ç'na gjeti!; Pleqëri n'a kape shpejt!

**Studente 10:** Të lutem.; Zemra. Motra.

**Studente 11:** Të keqen. Të vdes unë për ty! Të puth fort. Je tip fare. Kape një çik ktë foton. Grand fare! Ua, po ku qenka tap fare nga mendja! E ke bërë siguracionin për jetën?

Tipare karakterizuese të ligjërit të studentëve në lidhje me fjalët dhe shprehjet e tyre tipike janë shpejtësia e të folurit, pasaktësia gramatikore e semantike, duke krijuar edhe pështjellim në mendim sepse studentët përqëndrohen më shumë në transmetimin e mesazhit, emocionit apo mendimit sesa në mënyrën e ndërtimit të thënieve, apo qartësinë e tyre kuptimore, si p.sh.: *u qyqja, hallal, jam të më fali Zoti!, tufat (vetullat), je bërë si burri i babait, je tap fare nga mendja etj.*

#### (4) Si i flet një shoqe/shoku për një mësim të gjatë e të vështirë?

**Studente 1: Anglisht, Delvinë:** Nuk mundem, vdiqa. Vetëm kur e shoh librin më lodh. Nuk m'a bën zemra t'a lexoj.

**Studente 2: Anglisht, Vlorë:** Më duket sikur kam për të mësuar "Lahutën e Malësisë".

**Studente 3: Inxh. Mekanik, Skrapar:** Mos sa acarues ky leksioni! Si do e mësojmë? Po sa të vështirë që i bëjnë edhe këta? (pedagogët)

**Studente 4: Italisht, Vlorë:** Pfff! Sa shumë n'a dha për të mësuar kjo sot. Nuk mundem më.

**Studente 5: Biznes, Fier:** Ma shpjegon dot më shkurt mësimin? Çfarë kuptimi ka kjo shprehja?

**Studente 6: Cikël i ulët, Tepelenë:** Nuk kam nerva. Gjithë ky mësim i gjatë më plasi koka.

**Studente 7: Informatikë, Vlorë:** O Zot, po dhe kjo sa na dha për të lexuar. Nuk e frenoi pak lexionin.

**Studente 8: Informatikë, Vlorë:** O Zot i madh! S'kam më nerva që të mësoj këtë mësimin.

Në shembujt e mësipërm vërehet përdorimi i shprehjeve figurative, si: *vdiqa, nuk ma bën zemra, nuk kam nerva, më plasi koka, nuk e frenoi lexionin etj*; shkeljeve të normës gjuhësore sidomos në përdorimin e fjalive, që nuk ndjekin rregullën kryesore të normës gjuhësore në formimin e fjalisë: kryefjalë + kallëzues + kundrinor<sup>82</sup>. Shembujt si: *s'kam më nerva që të ....; nuk kam nerva...; nuk mundem më...; nuk mundem...etj.*, paraqesin fjali që u mungon kryefjala.

Ndërsa në komunikim me pedagogët, studentët ndryshojnë regjistër duke kaluar nga informaliteti në gjuhë në një shkallë më të lartë të mirësjelljes dhe ligjërimit normativ.

### (1) Çfarë e bën të veçantë stilin tuaj të të folurit?

**Studente 1:** Përdorimi i ligjërimit të folur të qytetit tim, Beratit.

**Studente 2:** Dialekti i krahinës, Vlorës; të folurit pak i vrazhdë;

**Studente 3:** Zëri i lartë, fjalët e huaja, fjalët krahinore, të cilat unë i përdor pa vetëdije dhe të tjerët m'i vënë në dukje.

Tiparet e lartpërmendura pasqyrojnë ligjërimin e nwnkulturws (subkulturës) rinore studentore. Të rinjtë jashtë kontekstit formal janë më pak të saktë e të vëmendshëm në përdorimin e standardit. Në këtë rast, nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e madhe shqiptimit, i cili, megjithëse nuk barazohet me shqiptimin dialektor, ka elemente që nuk përputhen me normën letrare. Shpeshherë, të folurit e shpejtë, të pakujdesshëm, edhe shqiptimi i paqartë dhe i paplotë janë tipare të këtij ligjërimi<sup>83</sup>. Ata paraqesin stile të ndryshme të komunikimit në varësi e në përshtatje me rrethanat e ligjërimit. Kështu, në bisedat me njëri-tjetrin, studentët përdorin ligjërimin bisedor, dhe në raste të veçanta edhe ligjërimin e shkujdesur, ndërsa në bisedat e realizuara në mjediset akademike me pedagogë e student apo student-

---

<sup>82</sup> Çeliku, M.; Karapinjalli M., & Stringa R., *Gramatika praktike e gjuhë shqipe*, Tiranë, 1998, f. 125.

<sup>83</sup> Shkurtaç, GJ., *Kahe dhe dukuri të kulturës shqipe*, Tiranë, 2003, f.99.

student, ligjërimi i tyre paraqet tipare të ligjërimi libror. Megjithatë, të folurit në gjuhën letrare kombëtare është sot shenjë e tregues kulture.<sup>84</sup>

Ndërkohë, lëshimet që bëjnë mësuesit dhe pedagogët në moszbatimin e normës gjuhësore, krijojnë probleme edhe në mospërvetësimin e materies mësimore<sup>85</sup>. Duke qënë se Universiteti i Vlorës shtrihet në jug të Shqipërisë dhe numri më i madh i studentëve e pedagogëve është nga kjo zonë gjeografike, edhe pedagogët shfaqin tolerancë më të madhe ndaj ndryshimeve fonetike në ligjërimin studentor.

Folësit e toskërishtes shqiptimin e *y-së* e realizojnë me *i-në*, i rrafshojnë dridhëset: *r* dhe *rr*, në disa raste *ë-në* e shqiptojnë për *e-në*: *fëmër, mënt, vënt*, etj., në pozicionin fundor i shurdhojnë bashkëtingëlloret e zëshme, si p.sh.: *zok i math, mënt*, etj.<sup>86</sup>.

Ligjërimi i përdorur në klasë, përpara se të fillojë mësimi bart shumë nënkuptime, dhe figura letrare, sikurse shembulli më poshtë pasqyron bisedën e zhvilluar midis disa studentëve:

- A. *Kush i ka bërë detyrat?* \_  
B. *Pse s'ke bërë ti?*  
A. *Jo, i kam bërë por dua t'i kontrolloj pak.* \_  
B. *Dhe unë i kam bërë, po s'jam i sigurt!* \_  
C. *Ja shikoji si i kam bërë unë, ishin shumë të thjeshta.*  
D. *Unë s'ja kam idenë fare, se di ç'a do bëj?*

Sikundër vihet re biseda paraqet tipare bisedore dhe informaliteti. Krahas gjuhës së folur, këto tipare hasen edhe në gjuhën e shkruar, ku mund të përfshihen shënimet e simbolet e ndryshme, që studentët mbajnë gjatë leksioneve apo seminare, si p.sh.  $\leq$  *më e vogël se...l*,  $\geq$  *më e madhe se...*,  $\neq$  *ndryshe ose në ndryshim nga*, & me kuptimin *dhe*, ~ nënkupton *e njëjtë*,  $\uparrow$  do të thotë *si më sipër*, etj.; shkurtimet e fjalëve, si *x* me kuptim *e për, dmth për domethënë* etj.; gabimet në të shkruar, shkruajtja e fjalëve pa *ë-në* fundore ose zëvendësimi i *ll-së* me *dh-në*, si kan për *kanë*, moster për *mostër*, sje dh për *sjell*, etj...

Ndërsa në detyrat që studentët u dorëzojnë pedagogëve u kushtojnë rëndësi tipareve gramatikore e leksikore. Më poshtë paraqitet një tekst i përkthyer nga një student i anglishtes: *Kompjuterat dhe interneti janë bërë tashmë mjete jetese për çdo gjë, që nga komunikimet me njeri-tjetrin, kërkimet e ndryshme, e deri tek puna në zyrë. Jo çuditërisht, fjalë të reja të lidhura me këto teknologji, po bëhen tashmë pjesë ne gjuhën e përditshme. Shërbimet e internetit mund të jenë të mërziqshme, kjo për shkak të numrit të madh të fjalëve teknike që vazhdojnë të shfaqen në internet, vetëm*

<sup>84</sup> Shih po aty, po ai, f.233.

<sup>85</sup> Badallaj, M., *Sa dhe si realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet*, Tiranë, 2011, f. 556.

<sup>86</sup> Shih po aty, f. 557.

*për tu bërë të përdorshme dhe familjare. Ndaj po bëhet e vështirë ta imagjinosh gjuhën e përditshme pa këto terma. Një nga termat e parë kompjuterik, kishte të bënte me procesimin e fjalës, duke e huazuar kështu këtë fjalë nga bota tradicionale e Zyrave.*

Në paragrafin e mësipërm mbizotërojnë tiparet e një gjuhe formale duke ndjekur normat standarde të drejtshkrimit, duke respektuar rregullat gramatikore, shenjat e pikësimit dhe shkrimin e saktë të një sërë fjalësh, si: e *mërzitshme*, *zyrë*, *janë bërë tashmë*, *çuditërisht*...

## **PËRFUNDIME**

Studentët dhe kultura e tyre gjuhësore janë burim krijimi i varianteve të ndryshme gjuhësore. Këto variante duhen vështruar si dukuri sociolinguistike.

Çdo përgjithësim për përdorimin e gjuhës nga të rinjtë lidhet drejtpërdrejt me ngjashmëritë e situatave në të cilat të rinjtë përdorin gjuhën e tyre<sup>87</sup>.

Si rezultat, stilet dhe situatat ligjërimore ndryshojnë vazhdimisht. Gjuha merr forma dhe përdorime të reja, duke qenë se përdoruesit më krijues e entuziastë janë të rinjtë, ka të ngjarë që identitetet kulturore të kenë lidhje me këtë grupmoshë.<sup>88</sup> Ndonëse, ligjërimi akademik është një ndër tiparet kryesore në institucionet universitare, gjuha e studentëve jashtë auditorit nuk mund t'i shmanget aspektit bisedor dhe deri diku të shkujdesur, aspekt ky i cili po shtrihet gjerësisht në mjediset jashtë auditoreve.

Shumë gjuhëtarëve u tërheq vëmendjen ndikimi i faktorëve të ndryshëm në përdorimin e gjuhës. Në varësi nga funksioni që luan gjuha në shoqëri dhe kulturë, tema që kumton, kush e flet dhe e shkruan, me kë, ku, kur dhe për çfarë shkakut e qëllimi etj, janë krijuar shtresime të caktuara të gjuhës, si ato stilistike, dialektore, zhargonike, idiolektore, etj<sup>89</sup>.

Kultura rinore është nën një proces ndryshimi të vazhdueshëm dhe gjuha siguron të gjitha mjetet e duhura linguistike dhe stilistike për të pasqyruar këto ndryshime.

Pra, gjuha nuk është një burim statik. Në përdorim dhe përshtatim atë sipas qëllimeve tona –përpunojmë material, theksojmë, krijojmë gjëra të reja<sup>90</sup>. Anëtarët e komuniteteve gjuhësore sjellin risi në drejtime të ndryshme: bëjnë gjëra të reja dhe

---

<sup>87</sup> Eckert, P., *Adolescent language*, New York, 2003 f. 52003.

<sup>88</sup> Labov, W., *Sociolinguistics patterns*, Philadelphia. 1989

<sup>89</sup> Ibrahim, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike.*, Tiranë, 2011, f. 502.

<sup>90</sup> Eckert, P., *Adolescent language*, New York, 2003, f. 32003.

krijojnë mënyra të reja të të folurit për këto risi. Fati, pra jetëgjatësia, e prurjeve të reja varet nga statusi i krijuesit të tyre në shoqëri.

Në dekadën e fundit janë krijuar shumë identitete rinore, të cilat janë të dallueshme nga njëri – tjetri në stilin e veshjes, muzikës, në gjuhën e përdorur etj. Në fillimet e shekullit XXI, të gjithë jemi dëshmitarë të zhvillimit teknologjik dhe ndikimin, që ka pasur në jetën tonë dhe sidomos të të rinjve të cilët i janë përshtatur inovacioneve teknologjike dhe njëkohësisht kanë krijuar stile të reja të kulturës rinore. Pra, gjuha ka fituar forma dhe përdorime të reja, të cilat shënjojnë realitetet dhe kontekstet socio- kulturore<sup>91</sup>.

---

<sup>91</sup> Bucholts M., *Globalization: language and youth culture*. North Carolina, 2000, f. 281.

## **KAPITULLI I TRETË**

### **Diferencat gjuhësore sipas ndryshorëve sociolinguistikë**

Në përgjithësi heterogjeniteti apo diversiteti gjuhësor bashkekziston me heterogjenitetin dhe diverstitetin shoqëror. Nuk ekziston ndonjë rast në të cilin bashkësia shoqërore dhe etnokulturore të jenë homogjene nga ana gjuhësore, sikurse nuk njihet asnjë situatë ku një bashkësi shoqërore dhe etnokulturore të ketë homogjenitet shoqëror. Nga studimet e derisotme rezulton se ekzistojnë pesë faktorë të diferencimit të sjelljes gjuhësore të individëve të një bashkësie shoqërore. Ato janë: moshë, gjinia, grupi etnik, klasa ekonomiko-shoqëror dhe niveli arsimit. Tre faktorët e parë kanë karakter natyror, dhe dy të tjerët kanë karakter shoqëror.

Megjithatë, duke pasur parasysh se studimi në fjalë realizohet në mjedisin universitar të Vlorës, atëherë faktorët e diversitetit të sjelljes gjuhësore do të jenë si më poshtë:

---

**a. Diferencat sipas ndryshorit *gjini***

**b. Diferencat sipas ndryshorit *mjedis familjar dhe klasë ekonomike***

**c. Diferencat sipas ndryshorit *mjedis administrativ***

---

Le të shqyrtojmë në mënyrë të veçantë secilin prej tyre.

### **a. Diferencat sipas ndryshorit *gjini***

Fusha e interesit që ngjall kjo temë është e shumanshme pasi në përpjekjet për të zbuluar konceptet, që lidhen ngushtë me gjuhën dhe gjininë, hidhet dritë edhe mbi faktorët e shumtë jashtëgjuhësorë (socialë, kulturorë etj), që rezultojnë në përdorime të ndryshme të të njëjtit mjet të komunikimit, ligjëritimit njerëzor. Spektri i trajtimit të kësaj çështjeje është i gjerë dhe kërkon shqyrtime analitike në shumë rrafshë

gjuhësore, më së shumti në leksik dhe në frazeologji, sidomos në kalimet kuptimore të fjalëve.

### **3. a Analizë teorike e ndryshorit gjini**

Në kuadër të edukimit të përgjithshëm, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe mësimi i të folurit. Ndarja e njerëzve në gjini nuk ka lidhje vetëm me gjininë natyrore, por ka pasojat e saj edhe në aspektin sociolinguistik, pra në një shtresim a degëzim të ligjërit sipas seksit. Duke qenë se shoqëria ka bërë ndarjen gjinore të punës, burrat merren më shumë me punë që kërkon më tepër forcë fizike, ndërsa gratë, kudo e kurdoherë, janë marrë më shumë me punët e shtëpisë, kjo rezulton edhe në një ndarje të përdorimit të gjuhës në fushën e leksikut e frazeologjisë e gramatikën<sup>92</sup>.

Femrat e meshkujt edhe nëse nga pikëpamja dialektore janë njësoj (pra, i përkasin të njëjtës familje) ata paraqesin dallime në të folur sipas seksit. Ndarja tradicionale e punës ka qenë njëkohësisht edhe një ndarje shoqërore e të folurit, e mënyrave të shprehjes, e zotërimit të një sferë terminologjike ndaj një tjetre edhe sipas seksit<sup>93</sup>.

Dallimi i njerëzve sipas seksit është një nga ndryshorët e rëndësishëm në sociolinguistikë. Nga kërkimet e derisotme, por edhe nga studimet e realizuara për këtë punim, del se gratë, vajzat flasin në mënyrë të ndryshme nga burrat, djemtë. Duket se ato kanë edhe një leksematikë të tyre, në përgjithësi në të folurin e përditshëm, në veçanti për dukuri e pjesë intime të jetës femërore; ndërsa meshkujt, përveç tipareve në mënyrën e të shprehurit në lidhje me femrat, kanë fjalë e shprehje të tyre, që i thonë vetëm ata dhe konsiderohen të “ndaluar” për gjininë tjetër<sup>94</sup>.

#### **3.a.1 Perspektivat e fundit teorike**

Për të pasqyruar më saktë lidhjet midis gjuhës dhe gjinisë, janë përmendur disa nga perspektivat e fundit teorike mbi këtë tematikë. Teoritë e mëparshme (Johnson 1997) të përdorimit të gjuhës dhe gjinisë bazoheshin në dikotominë gjinore, ku mashkulli dhe femra ishin në pozita të kundërta me njëra-tjetrën<sup>95</sup>. Por kjo teori, linte mënjanë faktin se të dyja gjinitë përdorin të njëjtat burime gjuhësore dhe shfrytëzojnë të njëjtin sistem komunikimi. Kështu që, gjatë përdorimit të gjuhës në bisedë midis gjinive, disa elemente mbivendosen me njëri-tjetrin dhe si rezultat, ligjërimi femëror dhe mashkullor, përveç ndryshimeve të shumta, shfaq edhe disa elemente të

---

<sup>92</sup> Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*, Tiranë, 2006, f. 10.

<sup>93</sup> Shkurtaç, GJ., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 232.

<sup>94</sup> Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*, Tiranë, 2006, f. 6.

<sup>95</sup> Johnson, S., & Meinhof, U. H., *Language and masculinity*, Oxford, 1999, f. 310.

ngjashëm<sup>96</sup>. Vëmendje e madhe i është kushtuar identifikimit dhe përshkrimit të këtyre elementeve.

### **3.a.1. 1 Modeli i deficitit**

I pari nga të katërt modelet kryesore të paraqitura në punim për studimin e gjuhës dhe gjinisë është modeli i *deficitit*. Sipas kësaj qasjeje, femrat trajtoheshin si përdoruese të gjuhës në pozita jo të barabarta në lidhje me meshkujt, prej të cilëve rrjedh norma në gjuhë. Protagonistja kryesore e këtij modeli ishte Robin Lakoff. Sipas një interpretimi të përgjithshëm që mund t'i bëhet studimeve të Lakoff del se: “Ligjërimi femëror është në përgjithësi më inferior kundrejt ligjëritit mashkullor dhe ky ligjërim reflekton inferioritetin personal dhe shoqëror të femrave”<sup>97</sup>. Lakoff përshkroi se mënyra e të shprehurit të femrave paraqet tipare si: “mungesa e besimit, pasiguri, dhe mirësjellje apo respekt të tepruar”. Këto karakteristika pasqyroheshin në ligjërimet femërore nëpërmjet pyetjeve konfirmuese, intonacionit të lartë në fund të fjalive dëftore etj.

### **3.a.1. 2 Modeli i mbizotërueses (dominancës)**

Ky model nënkupton se në bisedat ndër-gjinore, ka të ngjarë që meshkujt të ndërpresin bisedën më shumë se femrat dhe sipas modelit të mbizotërueses / dominancës gjuha konsiderohet si “manifestim patriakal i rendit social”<sup>98</sup>. Si konkluzion, meshkujt përpiqen të dominojnë bisedën. Por lindin pyetjet, “Ndërprerjet e bisedës nga interlokutorët e gjinisë mashkullore janë shprehje të mbizotërueses / dominancës? Ekziston ndonjë arsye ose faktor tjetër përveç mbizotërueses / dominancës që ndikon në rrjedhën normale të bisedës? Janë interesimi dhe përfshirja në bisedë arsye që çojnë në ndërprerjen e bisedës?”

Talbot<sup>99</sup> e ka kritikuar këtë model dhe ka arritur në përfundimin se kjo qasje mund të trajtohet së bashku me modelin e diferencës, diskutuar më poshtë dhe që të dy përfaqësojnë një model të hershëm për analizën e gjuhës dhe gjinisë në shkencat sociale ”.

### **3.a.1. 3 Modeli i diferencës**

Qasja e tretë shqyrtuar në studim është *diferenca* ose *dallimi*<sup>100</sup>. Qëllimi i këtij modeli është të shqyrtojë mënyrën se si femrat dhe meshkujt rriten në nënkultura të

---

<sup>96</sup> Hendrix, E. H., *Genderly Speaking*, Georgia, USA, 2001, f. 2.

<sup>97</sup> Lakoff, R., *Language and Woman's Place*, Cambridge, 1973, f. 62.

<sup>98</sup> Shih po aty, f. 40.

<sup>99</sup> Tablot, M., *Language and Gender - An introduction*, USA, 2010, f. 114.

<sup>100</sup> Lakoff, R., *Language and Woman's Place*, Cambridge, 1973, f. 63

ndryshme që pasqyrojnë organizime sociale të ndryshme. Në këtë qasje, Talbot pretendon se, "sjelljet të perceptuara, më përpara, si përpjekje të meshkujve për të dominuar femrat janë ri-interpretuar si një "fenomen ndër-kulturor"<sup>101</sup>.

Sipas Kraford (1995:1), "burrat dhe gratë janë të destinuar ... të keqkuptojnë njëri-tjetrin, nëse ata i nuk njohin plotësisht dallimet e tyre sociale". Gjthashtu, Kraford<sup>102</sup> përshkruan se si "dallimet thelbësore ndërmjet femrave dhe meshkujve formësojnë mënyrën se si ata flasin." Këto dallime "i përkasin individit dhe reflektohen në tipare të personalitetit, qëndrimet, besimet, apo qëllimet e individit ". Për të vërtetuar ose hedhur poshtë tiparet e këtij modeli, janë shqyrtuar koncepte e pyetësorë me studentë të të dyja gjinive<sup>103</sup>.

Ndërsa, Xhohnson and Meinhof<sup>104</sup> paraqesin kritika ndaj modelit të diferencës, sepse kjo qasje "nuk arrin të sqarojë pse dy gjinitë i përkasin nënkulturave të ndryshme".

#### **a. 1. 4 Modeli i ligjëritimit ose sjelljes gjuhësore**

Modelet e mësipërme paraqesin ngjashmëri më njëri-tjetrin, edhe pse secili prej tyre tashmë ka marrë vlerësime pozitive dhe kritika negative<sup>105</sup>, ato kanë shërbyer si nxitës për studimet e hershme feministe. Gjuhëtarët tani preferojnë një qasje të diskursit për të studiuar gjuhën dhe gjininë, duke theksuar në veçanti mënyrën në të cilën diskursi ndihmon për të ndërtuar identitetet gjinore<sup>106</sup>.

Ndërsa sociolinguistika, tradicionalisht, ka supozuar se njerëzit flasin në mënyrën që reflekton personalitetin, dhe tipare të tjera individuale<sup>107</sup>. Ky model i ri përqendrohet më tepër tek meshkujt dhe krijon mundësi studimi ndërdisiplinore më të mëdha, në një sërë fushash studimi, duke përfshirë: sociologjinë, psikologjinë dhe studimet kulturore.

---

<sup>101</sup> Tablot, M., *Language and Gender - An introduction*. . USA, 2010, f. 115.

<sup>102</sup> Holmes, J., *Review of: Talking Difference - on gender and language* . Cambridge, 1997, f. 430-433.

<sup>103</sup> Reflektimet mbi teoritë dhe qasjet gjinore të studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" paraqiten të shtjelluara më poshtë në nënçështjen: *Rast studimi*.

<sup>104</sup> Johnson, S., & Meinhof, U. H., *Language and masculinity*. Oxford, 1999, f. 310

<sup>105</sup> Scott, A., *Review of: Language and Woman's Place by Robin Lakoff*, United States, 1976, f. 74-75 .

<sup>106</sup> Cameron, D., *Gender and Language Ideologies' In Holmes and Meyerhoff 'Handbook of Language and Gender*, Oxford, 2003, f. 159.

<sup>107</sup> Thorne, B., *Review of: Language and Woman's Place by Robin Lakoff*, Chicago, 1976 , f. 744-746.

### 3.a. 2 Legjendat mbi gjuhën dhe gjininë

Bazuar në teoritë apo modelet e ndryshme mbi lidhjen gjuhë-gjini, por edhe në praktikën shoqërore të kulturës shqiptare, krijohet ideja se shumë prej pikëpamjeve tona rreth sjelljes gjuhësore - ndërgjinore bazohen në stereotipe, të cilat janë të mësuara, ndoshta që në vogëli.

Gjuha është e gjinizuar, dhe të gjitha dallimet gjinore që reflektohen në gjuhë janë të krijuara nga shoqëria<sup>108</sup>. Ajo është e tejmbushur me stereotipe, humor, proverba e thënie që i tregojnë femrat inferiore ndaj meshkujve. Ka të ngjarë që stereotipi më i përhapur për të folurin femëror është: vajzat dhe gratë flasin shumë.... Megjithatë, nuk është realizuar ende një studim për të mbështetur këtë mendim, ndërkohë që studime të tjera kanë vërtetuar të kundërtën<sup>109</sup>.

Sipas një vështrimi të përgjithshëm historik për çështjet gjinore, njerëz që kanë pasur ndikim të madh në periudha të ndryshme të zhvillimit të njerëzimit, kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje me pozitën gjinore në shoqëri<sup>110</sup>:

**Aristoteli:** *“Kurajoja e një burri tregohet kur komandon, ajo e një gruaje kur bindet”.*

**Zigmund Frojd:** *“Anatomia është fati i tyre. Femra është një qenie njerëzore deviante”.*

**Charles Darwin:** *“Gruaja ndryshon nga burri në tiparet e saj mendore. Forca intuitive ose perceptimi i shpejt tek gratë është më e theksuar sesa tek burrat, por këto aftësi janë karakterisikë e një race më të ulët dhe si rrjedhim e një faze të kaluar dhe më të ulët të evolucionit”.*

Gjithashtu, edhe gjuha shqipe mund të konsiderohet si patriarkale, sepse pasqyron anshmëritë e pabarazitë e gjinive në kulturën tonë<sup>111</sup>. Sipas këtyre stereotipeve, vajzat e gratë portretizohen vazhdimisht si: llafazane, merren me thashetheme...Të gjitha këto përgjithësime kulturore për ligjërimin gjinor nuk janë të dokumentuara ose vërtetuara shkencërisht.

Çdo shoqëri cakton norma të ndryshme për vajzat e djemtë, gratë dhe burrat<sup>112</sup>. Këto norma përcaktojnë çdo aspekt të jetëve të tyre dhe të ardhmes së tyre; gjithashtu, ato reflektohen edhe në sjelljen gjuhësore të të dy gjinive. Mënyra se si gratë e burrat “duhet” të flasin, kufizon përdorimin “vetjak” të gjuhës. Sipas E. Gordon<sup>113</sup> dhe

---

<sup>108</sup> Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*, Tiranë, 2006, f. 23.

<sup>109</sup> Swaminathan, N., & Gender, J., *Do Women Talk More than Men?* United States, 2007, f. 68.

<sup>110</sup> Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*. Tiranë, 2006, f. 14-15.

<sup>111</sup> Manual për të rinjtë dhe mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore*, Tiranë, 2005, f. 5.

<sup>112</sup> Shih, po aty, f. 11.

<sup>113</sup> Gordon, E., *Sex, Speech, and Stereotypes: Why Women Use Prestige Speech Forms More than Men*, Cambridge, 1997, f. 50.

Eman<sup>114</sup>, tiparet sociale për ndarjen gjinore të gjuhës ushtrojnë ndikim të madh mbi sjelljen e individit. Ndërsa, Johnson and Meinhof<sup>115</sup>, kanë shprehur mendimin se burrat e gratë i përkasin dy nënkulturave të ndryshme.

Në këtë studim është bërë përpjekje për të vërtetuar vlefshmërinë e këtyre konkluzioneve dhe për të zbuluar nëse përkatësia gjinore ekziston në komunitetin studentor të Universitetit “Ismail Qemali” dhe si ndikon ajo në ligjërim gjinor.

### **3. a. 3 Stereotipet**

Qëndrimet sociale për rolet dhe atributet gjinore hedhin dritë mbi stereotipet e bazuara mbi dallimet e tyre seksuale. Ato i kufizojnë njëzërit në atë që ata mund të bëjnë dhe shprehin nëpërmjet vetes së tyre. Nga pikëpamja gjuhësore, krijohet bindja se stereotipet ndikojnë në përdorimin “normal” gjuhësor të femrave e meshkujve.

Kramarae<sup>116</sup> dhe West<sup>117</sup> diskutojnë se “nuk është gjetur asnjë tipar përgjithësues ndërkulturor, verbal ose jo verbal, që të karakterizojë ligjërimin femëror”. Pra, në sistemin gjuhësor nuk gjendet asnjë tipar që të kushtëzojë këtë ndarje gjinore të gjuhës; ndërsa, gjenden plot elemente socio-kulturore të cilat “detyrojnë” burrat e gratë të përdorin gjuhën në një mënyrë të caktuar, në bazë të roleve të tyre gjinore. Profesor Shkurtaj shkruan se “Përkatësia gjinore ndikon në karakteristika, profesione e gjuhë. Disa fjalë ose shprehje gramatikore janë në qendër të bisedave të grave / vajzave dhe ato ndikojnë në ndryshimin e diskursit femëror”.<sup>118</sup>

Nga eksperiencia personale dhe shfletimi i literaturës, mund të thuhet se shoqëria i kategorizon disa fjalë më shumë me një gjini sesa me tjetrën, për shembull: “*pastrova shtëpinë, gatova, lava enët/rrobat, u kujdesa për motrën, shkova në pazar dhe bleva ushqimej.*” konsiderohen tipike të ligjërimin femëror.

Sipas Bhasin<sup>119</sup> dhe Gordon<sup>120</sup> ‘...gjinia, ndryshe nga seksi, është një variabël i ndryshueshëm, jo vetëm në kohë e hapësirë, në kultura e familje të ndryshme, por një njeri mund të jetë shumë ose pak “femëror” dhe shumë ose pak “mashkullor”.

Ndërsa, Key<sup>121</sup> përshkruan se “përdorimi i diferencuar i gjuhës nga meshkujt e femrat, pasqyrohet më tepër në shoqëri sesa në sistemin gjuhësor”. Terma të tilla si

---

<sup>114</sup> Berryman, C. L., & Eman, V. A., *Language and Gender Communication, Language and Sex*, United States, 1983, f.30-35.

<sup>115</sup> Johnson, S., & Meinhof, U. H., *Language and masculinity*, Oxford, April 1999, f. 312

<sup>116</sup> Kramarae, C., *The Voices and Words of Women and Men*, United States, 1983, f. 195.

<sup>117</sup> West, C., *Sexist Language: A Modern Philosophical Analysis*, United States, 1983, f.329 .

<sup>118</sup> Shkurtaj, GJ., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 233.

<sup>119</sup> Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*, Tiranë, 2006, f. 17.

<sup>120</sup> Gordon, E., *Sex, Speech, and Stereotypes: Why Women Use Prestige Speech Forms More than Men*, Cambridge, 1997, f. 50.

“shumë e bukur, e lezetshme, shpirti...” ndeshen më dendur në gjuhën e femrave; ndërsa, tolerimi i vazhdueshëm i sjelljeve të ashpra dhe fjalëve të shkujdesur i përkasin më tepër gjuhës së meshkujve, duke iu referuar pjesëve intime të trupit të njeriut, sidomos të femrës, intimitetit; foljet që emërtojnë veprime të lidhura me seksin dhe seksualitetin, etj. Por nuk duhet lënë pa përmendur se ligjërimi femëror dallohet për karakterin e theksuar eufemistik e për praninë e shumë fjalëve tabu. Sikundër ka vërejtur prof. Shkurtaj, gratë janë më gojështurura, kjo duket sidomos në sharjet dhe mallkimet<sup>122</sup>. Si rezultat i shkëputjes nga mjedisi familjar dhe administrativ, dhe vendosjes së tyre në mjedise fizike e kulturore të reja, në ligjërimin femëror vihet re një pakësim i eufemizmave të vendlindjes.

Në këtë nënçështje janë shqyrtuar stereotipet në lidhje me gjinitë e ndryshme. Janë shqyrtuar stereotipet që gjuhëtarët e lartpërmendur sugjerojnë se u përkasin ligjërimin ndërgjinor. Për të analizuar thellësisht këto tipare, në punim janë paraqitur citate e shprehje të shkruara në pyetësor për të konstatuar se çfarë mendojnë studentët në lidhje me stereotipet gjinore.

### **3. a. 4 Analizë e perspektivave teorike**

Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin se diferencat gjuhësore midis gjinive nuk nxiten nga elemente gjuhësore, por këto ndryshime janë produkt i proceseve dhe praktikave sociale. Të qënurit djalë apo vajzë *ndërtohet* nga shoqëria—një proces gjatë të cilit gjuha luan rol kyç<sup>123</sup>.

Duhet theksuar se elemente të tilla si, familja, shoqëria, kultura, shkollimi, raca, grupi etnik dhe zhvillimi ekonomik, janë faktorët që ndikojnë në ndryshimet e të folurit gjinor<sup>124</sup>. Shoqëria shqiptare, por edhe vetë mësuesit, në përgjithësi, i inkurajojnë vajzat të përdorin sjellje gjuhësore të mira, ndërsa tolerojnë djemtë të shprehin ligjërimet të pasjellshme apo disi të ashpra në zgjedhjen e fjalëve.

Gjinia<sup>125</sup> është një faktor që ndikon në ligjërim, pavarësisht nëse studimi bazohet në sjelljet verbale, shoqërore, mendore, emocionale apo fizike të studentëve. Kjo s’do të thotë që vajzat apo djemtë të komunikojnë në atë mënyrë që mund të komunikojnë anëtarët e gjinisë, që secili prej nesh i përket. Por rëndësi ka mënyra sesi bashkëveprojnë gjinitë e ndryshme me njëra-tjetrën për të rritur cilësinë e komunikimit.

---

<sup>121</sup> Bodine, A., *Review of: Male/Female Language*, Cambridge, 1977, f. 104-110

<sup>122</sup> Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2004, f. 233.

<sup>123</sup> Manual për të rinjtë e mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore: perspektiva gjinore*. Tiranë, 2005, f. 8.

<sup>124</sup> Shih, po aty, f. 12.

<sup>125</sup> Amsberry, D., *Talking the Talk: Library Classroom Communication and International Students*, United States, 2008, f. 255.

Duke u bazuar në materialin e mbledhur për këtë çështje dhe në analizimin e tij, mund të diskutojmë se marrëdhënia gjuhë-gjini duhet shqyrtuar në këto drejtime:

- I. Stilet e ligjërimit bisedor-ndërgjinor.
- II. Tematikat që trajtohen nga gjini të ndryshme. Tematikat që trajtohen nga gjinia mashkullore e femërore paraqesin dy gjëra të ndryshme:
  - a. Si gjuha zbulon, mishëron dhe mbështet qëndrime të gjinisë.
  - b. Si përdoruesit e gjuhës flasin në mënyra të ndryshme e të veçanta që pasqyrojnë gjininë e tyre.

Çështja e parë është pjesërisht historike dhe e lidhur me studimin e pozitës së burrave dhe grave në shoqëri. Në të përfshihen pretendime të tilla si gjuha përdoret për të kontrolluar, dominuar, ose marr në mbrojtje<sup>126</sup>. Kjo pikëpamje mund të jetë objektive nëse ilustron të dhënat ose se çfarë ndodh. Por ajo mund të paraqes karakter subjektiv nëse objekti i studimit përcaktohet nga ndjenjat e subjektit të supozuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Çështja e dytë e studimit rikujton shumë diskutime të ndikimit relativ të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit social. Në këtë prizëm mund të theksojmë dy elemente:

- kushtëzimi kulturor apo social mund të ndikojë në qëndrimet gjinore në të folur dhe në të shkruar, por
- ekzistojnë dallime objektive midis gjuhës të burrave dhe asaj të grave, dhe asnjë kusht social apo shoqëror mund t'i eliminojë tërësisht këto dallime.

Duhet theksuar se elemente<sup>127</sup> të tillë si, familja, shoqëria, kultura, shkollimi, raca, grupi etnik dhe zhvillimi ekonomik, janë faktorët që ndikojnë në ndryshimet e të folurit gjinor. Shoqëria shqiptare, por edhe vetë mësuesit, në përgjithësi, i inkurajojnë vajzat të përdorin sjellje gjuhësore të mira, ndërsa tolerojnë djemtë të shprehin ligjërimi të pasjellshme apo disi të ashpra në zgjedhjen e fjalëve.

Dallimet midis këtyre dy lloj komunikimesh varen nga motivet e komunikimit. Femrat dhe meshkujt jetojnë, punojnë dhe studiojnë së bashku, kështu që është e rëndësishme për të ditur ndryshimet gjinore në ligjërim, sepse kjo çon në rritjen e aftësisë për t'u lidhur dhe kuptuar më mirë të tjerët.

---

<sup>126</sup> Bodine, A., *Review of: Male/Female Language by Mary Ritchie Key*, Cambridge, 1977, f. 104-110

<sup>127</sup> Maxwell-Atkinson, J., & Heritage, J., *Structures of Social Action: Studies in Conversation Analysis*, Cambridge, 1984, f. 148.

### **3. a. 4. 1 Format dhe funksionet e të folurit**

Deborah Cameron<sup>128</sup>, në studimet e saj për ligjërimin gjinor shprehet se: çdo pretendim që shpërfill ekzistencën e ndryshimeve synon të thjeshtëzojë panoramën. Mund të thuhet se, me gjithë pikëpamjet e ndryshme që kanë studiuesit e ndryshëm, duket se ata bashkohen në një mendim të vetëm: *dallimet gjinore në gjuhë janë të lidhura pazgjidhshmërisht me faktorët socialë dhe etnolinguistikë*. Në studimin e gjuhës dhe gjinisë si variabël, duhet të zbatohet parimi i bashkëveprimit dhe format e mirësjelljes. Qëllimi është gjetja e përgjigjes për pyetjen: shfaqin djemtë dhe vajzat ndryshime thelbësore në mënyrën në mënyrën e tyre të komunikimit?

Shumë studime të huaja, si për shembull në *“Living Language”* (f. 222), George Keith dhe John Shuttleworth sugjerojnë se:

- vajzat- flasin më shumë se meshkujt, janë më të sjellshme, të pavendosura / në mëdyshje, ankohen më shumë, bëjnë shumë pyetje, dhe janë më bashkëpunuese, ndërsa,

- djemtë- betohen më shumë, nuk flasin për ndjenjat, flasim më shumë për sportin, vajzat dhe makinat në të njëjtën mënyrë, fyejnë shpesh njëri-tjetrin, janë konkurrues në bisedë, dominojnë bisedën, flasin me më shumë autoritet, japin më shumë komanda, ndërpresin më shumë në bisedë.

Gjithashtu, edhe sipas Lakoff<sup>129</sup>, gjatë procesit të të pyeturit gjinia femërore shpreh pasiguri dhe hezitim. Ndërsa, Weiher<sup>130</sup> e konsideron të pyeturin si element të rëndësishëm të bashkëveprimit: femrat pyesin më shumë si pasojë e forcës së personalitetit dhe jo të pasigurisë. Pretendohet se gjatë bashkëveprimeve ndërgjinore, meshkujt flasin dy herë më shumë se femrat.

Disa prej këtyre konkluzioneve janë përshkrime objektive, të cilat mund të vërtetohen, nëpërmjet pyetjeve, dhënies së komandave, ndërsa të tjerat paraqesin mendime tepër përgjithësuese, disa prej tyre të pabazuara edhe jo-gjuhësore, si për shembull, meshkujt flasin me më shumë autoritet.

Për të ilustruar këtë çështje u realizuan vëzhgime të shumta të diskutimeve të diktuarra dhe bisedave të lira midis studentëve të Universitetit të Vlorës. Analizimi i transkripteve të këtyre bisedave nxori në pah rreth 557 ndërprerje në biseda. Duke u bazuar në modelin e dominancës, rezultati është: vajzat dhe djemtë e ndërpresin bisedën pothuajse me të njëjtën frekuencë, përkatësisht: djemtë 34.1 % dhe vajzat

---

<sup>128</sup> Rudolf, P., *Review of: Language and Sexuality by Deborah Cameron; Don Kulick*, Cambridge, 2005, f. 277-282.

<sup>129</sup> Winson, D. A., *Review of: Talking Power: The Politics of Language by Robin Lakoff*. United States, 1991, f. 99-101.

<sup>130</sup> Weiher, C., *Sexism in Language and Sex Differences in Language Usage: Which Is More Important?* United States, 1976, f. 242.

33.8 %. Djemtë ndërpresin pak më shumë gjatë bisedave, por diferenca është e papërfillshme nga ana statistikore.

Rezultatet e studimit me studentët, meshkuj dhe femra, në Universitetin e Vlorës nxorën në pah katër çështje<sup>131</sup>, në kontrast me njëra-tjetrën<sup>132</sup>. Ato janë:

- Pavarësi *kundrejt* Intimitet
- Informacion *kundrejt* Ndjenja
- Urdhra *kundrejt* Propozime
- Konflikt *kundrejt* Kompromis

Në çdo rast, karakteristikat mashkullore (çfarë gjykohet të jetë më e zakonshme si mashkullore) janë të parat. Cilat janë këto dallime?

### **Pavarësia *kundrejt* intimitetit**

Vajzat tentojnë drejt ruajtjes së privatësisë, intimitetit dhe mbështetjes reciproke<sup>133</sup>. Djemtë kërkojnë të jenë më të pavarur, duke ruajtur kështu edhe statusin e tyre social<sup>134</sup>. Këto tipare bëjnë që djemtë të reagojnë ndryshe nga vajzat për të njëjtën situatë. Për shembull, shumë prej studenteve pranuan se për të ftuar një shoqe ose shok për kafe në shoqërinë e tyre, ato më parë duhet të merrnin aprovimin e shokëve të tyre, pjesëtarë të shoqërisë së ngushtë. Ndërsa, djemtë studentë ftojnë një shok ose shoqe pa qenë i nevojshëm miratimi i shoqërisë së tyre të ngushtë.

### **Informacione *kundrejt* ndjenjave**

Për të ilustruar këtë nën-çështje, studentët sollën shembuj nga jeta e tyre në familje. Një djalë i ri e bën një telefonatë të shkurtër telefon. Nëna e tij dëgjon bisedën. Më vonë ajo e pyet atë në lidhje me atë - ai do të shkojë të luajë futboll. Ndërsa, vajza e bën një telefonatë, e cila zgjat gjysmë ore ose më shumë. Nëna pyet në lidhje me atë – përgjigjja e dhënë është: "*ti e di*" "*për gjëra...*". Biseda ka qenë kryesisht përshkrimi dhe komenti rreth ndjenjave. Në shoqërinë shqiptare, shqetësimet dhe problemet e djemve janë parë si më të rëndësishme se ato të

---

<sup>131</sup> Goetting, A., *Review of: You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation* by Deborah Tannen *Journal*, United States, 2008, f. 99.

<sup>132</sup> Deborah Tannen është mbëtetsja më e madhe e modelit të Diferencës. Për këtë arsye, në artikullin e saj *You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation*, ajo ka kategorizuar gjashtë çështje që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Gjatë analizimit të lëndës së mbledhur për këtë qëllim, u arrit në përfundimin se vetëm katër prej tyre i përshtateshin situatës ligjërimore – gjinore në mjediset universitare të Vlorës.

<sup>133</sup> Drass, K. A., *The Effect of Gender Identity on Conversation Author*, United States, 1986, f.296.

<sup>134</sup> Goetting, A., *Review of: You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation* by Deborah Tannen *Journal*, United States, 1992, f. 99.

vajzave<sup>135</sup>, por sot kjo situatë mund të përmbysset në mënyrë që dhënia e informacionit dhe shprehja emocionale e vajzave të konsiderohet me të njëjtën vlerë sikurse komunikimet e djemve.

### Urdhra kundrejt propozimeve

Vajzat shpesh sugjerojnë se njerëzit bëjnë gjërat në mënyrë të tërthortë<sup>136</sup>, - "le të...", "pse nuk kemi.....?" Ose "nuk do të jetë mirë, nëse ne mund të përdorim ...?". ndërsa, djemtë mund të përdorin dhe të preferojnë të dëgjojnë urdhra ose komanda të drejtpërdrejta.

### Mashkullorja si normë

Një nga idetë më me ndikim që udhëheqin jetën sociale është ai i mashkullores si normë<sup>137</sup>. Terma të tilla si "burra", "njeri" dhe "njerëzit" e përcjellin shumë mirë këtë. Përdoren terma që i përkasin gjinisë mashkullore edhe kur i referohemi një grupi në përbërje të së cilit janë djem edhe vajza. Por në qoftë se, njerëzit besojnë se stilet e ligjërimit të dy gjinive janë të ndryshëm, duket se është më se e zakonshme se vajzat janë ato që ndryshojnë. Në se mohohen ndryshimet në ligjërimin gjinor, atëherë, rritet edhe më shumë konfuzioni, tashmë i përhapur mbi (ri)formimin e marrëdhënieve midis vajzave dhe djemve<sup>138</sup>.

Ka shumë elemente që e mbështesin këtë pohim. Si për shembull:

| <u>Vajzat</u>   | <u>Djemtë</u>   |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Flasin shumë</li><li>• Flasin në kontekste private</li><li>• Ndërtojnë lidhje</li><li>• Flasin njëkohësisht</li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>• Nuk flasin shumë</li><li>• Flasin në publik</li><li>• Negociojnë për statusin/shmangin dështimin në bisedë<sup>139</sup></li><li>• Flasin me rradhë</li></ul> |

Pra, standardi përdor mashkulloren si normë, por edhe nëse femrat do të ndryshojnë ligjërimin e tyre duhe huazuar element të ligjërimit mashkullor, atëherë

<sup>135</sup> Manual për të rinjtë e mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore: Perspektiva gjinore*. PSHPZH. Tiranë, 2005, f. 13.

<sup>136</sup> Zhang, Li-F., *Do age and gender make a difference in the relationship between intellectual styles and abilities?* China, 2010, f. 96.

<sup>137</sup> Manual për të rinjtë e mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore: Perspektiva gjinore*, Tiranë, 2005, f. 12.

<sup>138</sup> Kollock, P., Blumstein, & Schwartz, P., *Sex and Power in Interaction*, United States, 1985 f. 67.

<sup>139</sup> Drass, K. A., *The Effect of Gender Identity on Conversation Author*, United States, 1986, f.298.

ato rrezikojnë që shoqëria t'i gjykojë ndryshe dhe me ashpërsi<sup>140</sup>. Pra, gjuha është patriakale dhe për rrjedhojë ajo bart dhe pasqyron anshëmirtë dhe pabarazitë e gjinive. Në lidhje me këtë çështje, shumë studente, por edhe studentë u shprehen se një vajzë që flet si djalë duket si burrë, e ashpër, jo femërore.

### **3. a. 4. 2 Karakteristika të ligjërimit gjinor të studentëve në Universitetin e Vlorës**

Për realizimin e këtij studimit, u vëzhguan diferencat e sjelljet gjuhësore të studentëve të ndryshëm. Gjatë vëzhgimit dolën në pah karakteristika të ndryshme, të cilat mund të kategorizohen në e fjalëve të përdorura, elementet gramatikore dhe leksiku i përdorur ( p.sh., fjalët që përcjellin emocion), elementet paralinguistik, ndërprerjet në bisedë<sup>141</sup>.

*Qëllimi i parë* i nënçështjes ishte analizimi i përgjigjeve të pyetjes: Ka ndryshime në ligjërimitin e vajzave dhe të djemve? U mendua se ndryshimet më të mëdha do të shfaqeshin në fjalët e mirësjelljes nga të dyja gjinitë, sepse këto fjalë janë shënjes të mirë që tregojnë sesi individët lidhen me botën e jashtme<sup>142</sup>. Megjithatë, për të sqaruar më mirë këtë çështje, u shqyrtua edhe një gamë e gjërë fjalësh që përshkruajnë gjendjet psikologjike dhe proceset sociale, duke përfshirë referencat me miqtë, familjen, emocionet etj.

*Qëllimi tjetër* i studimit ishte përcaktimi i rolit të kontekstit social e kulturo në krijimin e ndryshimeve gjinore në të folur. Kërkimet e shumta për literaturë në gjuhën shqipe rreth kësaj çështjeje rezultuan se punime të mirëfillta për këtë tematikë janë shumë të pakta.

Klasa është një shoqëri e vogël dhe ka gjuhën e saj të veçantë, një gjuhë që ndikon në ato që ndodhin në klasë. Diskutimi dhe të pyeturit e studenteve është një pjesë e rëndësishme e repertorit të të nxënës<sup>143</sup>. Të kërkosh ndihmë në klasë është një strategji aktive që ndihmon dhe rrit të mësuarin studentor. Të nxënës efektiv kërkon një sërë aftësish si zgjuarsia, vullnet, përkushtim, por një vend të veçantë në këtë fushë zë edhe aftësia e të formuluarit mirë të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Por lind pyetja: Cila gjini është më e suksesshme në komunikim? Fakti është se, pavaresisht nga situata, djemtë dhe vajzat janë tepër efektiv në bisedë. Ky pohim, më shumë se kurrë, është i vërtetë në klasë. Vëzhgimet e kryera në universitetin: "I. Qemali" në Vlorë kanë treguar se ekzistojnë ndryshime në ligjërimitin e vajzave dhe djemve, megjithatë këto ndryshime nuk janë thelbësore .

---

<sup>140</sup> Ochs, E., *Transcription as Theory*, United States, 1999, f. 68.

<sup>141</sup> Ferguson, N., *Simultaneous Speech, Interruptions and Dominance*, England, 1977, f. 295-302.

<sup>142</sup> Drass, K. A., *The Effect of Gender Identity on Conversation Author*, United States, 1986, f. 234.

<sup>143</sup> Johnson, G., *Style and Stylistic*, London, 1992, f. 134.

## **Rast studimi 2**

Për të vërtetuar deklaratat e mësipërme, në shumë klasa me studentë të degëve të ndryshme u zhvilluan disa aktivitete dhe një pyetësor në lidhje me dallimet gjuhësore në të folurin gjinor.

**Aktivitet 1.** Studentët u njohën me thëniet e lartpërmendura dhe u nxitën të shprehnin mendimet rreth atyre deklaratave. Së pari, studentët e ndarë sipas gjinisë paraqitën mendimet për të folurin femëror ose mashkullor. Së dyti, ata shprehën nëse ishin ose jo dakort me deklaratat për gjininë e kundërt-studentet femra u shprehën për thëniet rreth gjinisë mashkullore dhe studentët meshkujt u shprehën për gjininë femërore.

**Aktivitet 2.** Studentëve iu kërkua të plotësonin tabelën 2 dhe 3.

Më poshtë paraqiten pyetjet e shoqëruara nga përgjigjet dhe interpretimet përkatëse:

- (1) ***Keqkuptimi ndërkulturor ndodh kur dy ose më shumë njerëz të kulturave të ndryshme nuk e kuptojnë plotësisht njëri-tjetrin për shkak të ndryshimeve kulturore.*** Kjo teori mund të përdoret edhe në komunikimin midis meshkujve dhe femrave. Jepni vlerësimin tuaj sipas listës numërore 1-5 (1-aspak dakort 5-shumë dakort) për thënien:

*“Femrat dhe meshkujt nuk përfaqësojnë dy kultura të ndryshme në lidhje me komunikimin!”*

| <b>1</b>            | <b>2</b>          | <b>3</b>       | <b>4</b>      | <b>5</b>            |
|---------------------|-------------------|----------------|---------------|---------------------|
| <b>Aspak dakort</b> | <b>pak dakort</b> | <b>neutral</b> | <b>dakort</b> | <b>shumë dakort</b> |


Shpjegoni me fjalë përgjigjen tuaj:

Për këtë nënçështje studentët shprehën mendime të ndryshme:

Pro: *“Duke qenë se jetojmë në një vend, në një shoqëri, kjo nuk nënkupton se midis dy gjinive duhet të ketë ndryshime thelbësore në stilin e jetës dhe të menduarit.*

Por të shumta ishin mendimet që shprehnin kundërshtim për thënien e lartpërmendur: *meshkujt dhe femrat nuk kanë asnjëherë botëkuptime të njëjta, ata janë dy qenie që mendojnë dhe veprojnë ndryshe. Ndarja sociale në bazë gjinie e vërteton se ata përfaqësojnë dy botëkuptime të ndryshme dhe paralele me njëri-tjetrin, si rezultat ata i përkasin dy kulturave të tyre.”*

E paraqitur në përqindje, do të kishim këto rezultate:



Figurë. 3.1 Keqkuptimi ndërkulturor midis gjinive.

Sikurse, paraqitet në grafik, është i barabartë numri i studentëve, rreth 21 % për secilën alternativ në total 42 %, nuk ishin aspak dakort me thënien, ndërsa gjysma tjetër ishin dakort. 45 % e studentëve të anketuar ishin shumë dakort se të dy gjinitë nuk përfaqësojnë dy kultura të ndryshme.

Rezultati i mësipërm mund të argumentohet me zhvillimin që kanë pësuar të dyja gjinitë në kohët e sotme. Duke u bazuar në aspekte të ndryshme të jetës, femrat dhe meshkujt janë konkurentë me njëri-tjetrin por edhe midis së njëjtës gjini. Megjithatë, studentët bazohen në komunikimin e lirë dhe të drejtpërdrejt që ata kanë midis tyre për të shprehur mendime të tilla si: femrat dhe meshkujt nuk i përkasin dy kulturave të ndryshme. Shpeshherë, në ligjërimin e lirë nuk dallohet kultura e një mashkulli nga e një femre, sepse në shumë raste të dyja gjinitë flasin njësoj, deri diku me të njëjtin fjalor, që shpeshherë është edhe vulgar.

Megjithatë, studimet e hollësishme mbi lëndën e mbledhur, vërtetuan se në përgjithësi i foluri i vajzave dhe djemve paraqet tipare ligjërimore relativisht të ndryshme, sidomos në drejtim të leksikut, fonetikës dhe strukturave gramatikore. Ndryshimi i vërejtur bazohet në përvojën jetësore, stilin e jetesës familjare, ndikimi i bashkësisë shoqërore e kulturore ku studentët janë rritur. Megjithatë, kur vajzat dhe djemtë realizojnë komunikimin në grupe heterogjene gjinore, ata paraqesin tipare të përafërta të menduarit dhe të shprehurit. Pra, ky botëkuptim i “ndryshëm”, nuk është aq i ndryshëm saqë të konkludojmë se të dy gjinitë përfaqësojnë dy kultura të ndryshme.

(2) Në tabelën e mëposhtme jepen pesë deklaratat rreth gjuhës dhe gjinisë.

Vendosni në krah të secilës deklaratë numrin 1-5 sipas mendimit tuaj.


Tabela. 3.1 Deklaratat në lidhje me përgjithësimet socio-kulturore.

|  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|--|---|---|---|---|---|
| Femrat bëjnë më shumë thashetheme se meshkujt. |   |   |   |   |   |
| Gjatë bisedave mes meshkujve dhe femrave,      |   |   |   |   |   |

|   |  |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|--|
| meshkujt ndërpresin më shumë bisedat.   |  |  |  |  |  |
| Femrat përdorin më tepër stil bindës apo shpjgues, shoqëruar nga termat e mirësjelljes sesa meshkujt (p.sh., ‘do të ishte e mundur sikur...’, ‘të vjen keq sikur...’) |  |  |  |  |  |
| Meshkujt kundërshtojnë ose ndërpresin më tepër njëri-tjetrin në bisedë.   |  |  |  |  |  |
| Femrat kanë tendencën të vazhdojnë bisedën rreth të njëjtës tematikë (p.sh të flasim për të njëjtën temë që mund të kenë folur më parë)                               |  |  |  |  |  |

Në vazhdimësi të pyetjes së mësipërme, studentët u shprehën për disa deklaratave të tjera rreth gjinisë. Sipas tyre, vajzave dhe djemve, janë femrat ato të cilat merren më tepër me thashetheme, si rezultat i kësaj, janë vajzat ato që përdorin më tepër stil bindës në bisedë, shoqëruar nga termat e mirësjelljes. Ndërsa meshkujt ndërpresin më tepër bashkëbiseduesin gjatë bisedave midis tyre por edhe në komunikimin ndërgjinnor.

E paraqitur në grafik do të kishim këto rezultate:



**Figurë 3. 2 Përqindja e rezultateve të deklaratave përgjithësuese për gjininë.**

Prej diskutimeve, bisedave dhe analizimit të pyetësorit, u konstatua se ligjërimi femëror është më i kujdesshëm në formulimin e frazave; ndonjëherë është hezitues dhe emocional. Mjafton të dëgjosh me vëmendje vajzat kur flasim gjatë orës së mësimit ose edhe jashtë auditorit, por në ato raste kur tema e bisedës është rreth mësimit, pikërisht në këto situata vërehet se ato:

1. Përdorimi i frazave shpjguese dhe modifikuese, duke përdorur fjalë si: *domethënë, kështu pra, ashtu, duket siku*, etj.

Përdorimi i shprehjeve të mirësjelljes, si: “e ke problem sikur.....”, “Do të më bëhej shumë qejfi sikur ...”.

2. Përdorimi i tepruar i mbiemrave zbukurues: *fantastike, i bukur, i madh fare*.

3. Përdorimi i deklaratave të drejtpërdrejta. Meshkujt i perifrazojnë mendimet në mënyrë më të tërthortë.

4. Përdorimi i leksikut të veçantë: femrat përdorin më shumë fjalë për gjëra të tilla si emocionet, ndërsa djemtë përdorin më shumë fjalë për sportet e ndryshme.

5. Përdorni i fjalës pyetëse "pse?" (të tilla si, "Pse nuk e hapni derën?"). Bëjnë më shumë pyetje sesa djemtë.

Përdorin shprehje tepër të zbukuruara, por edhe fjali ku shprehet mosbesim.

Mbi-përdorimi i tepruar i foljes: mendoj, *thashë unë*, p.sh: "Unë mendoj se ..."

6. Kërkojnë më shumë të falur: (për shembull, "Më vjen keq, por mendoj se...")

7. Përdorimi i ndërtimeve modale: (të tilla si mund të, do, duhet, duhet- "A duhet të dalim tani?")

8. Përdorimi i intensifikuesve *më veçanërisht kështu dhe shumë* (për shembull, "Jam shumë / aq e kënaqur që erdhët!")

9. Sasia e madhe e të folurit: vajzat flasin shumë, janë më të pakursyera në të folur duke bërë që kjo të kthehet në tipar dallues të tyre.

10. Psherëtimë e mallkojnë më shumë sesa djemtë: *të hëngërt mortjal!; u kanceri...!*

11. Përdorin më shumë shprehje zbuluese e përkëdhelëse me njëra-tjetrën dhe me djemtë.

Gjithashtu, ligjërimi femëror përdor më shumë përemra, folje dhe fjalë sociale, fjalë që përshkruajnë gjendje të ndryshme emocionale dhe psikologjike. Mohimi dhe fjalët referuese për shtëpinë, janë gjithashtu tipare të këtij ligjërimi.

Ndërsa, djemtë, në ligjërimin e tyre, i tejkalojnë vajzat në një sërë dimensionesh gjuhësore, si: gjatësia e fjalës, përdorimi i numrave, nyjeve e parafjalëve.

**(3) Sugjerimi se femrat dhe meshkujt mund të përdorin tipare ligjërimore të gjinisë tjetër, nënkupton se një mashkull që përdor stil të foluri femëror mund të konsiderohet si "i butë, delikat" dhe "femëror", dhe një femër që përdor stil të foluri mashkullor mund të konsiderohet si "agresive" dhe "mashkullore".**

Sipas mendimit tuaj cilat janë karakteristikat e ligjërimin (të folurit) femëror, që e bëjnë një mashkull të duket si "i butë"?

Studentët paraqitën një sërë tiparesh, të cilat ata i konsideronin të ligjërimit femëror por kur ato përdoren nga një mashkull, e bëjnë atë të duket ndryshe nga të tjerët. Të tilla janë: përdorimi i shpeshtë i shprehjeve të mirësjelljes: *të lutem, faleminderit*; përdorimi i fjalëve në formë të shkurtuar: *gjesi goca*; përdorimi i tipareve që konsiderohen si tipike femërore, si: mënyra e sjelljes me delikatesë apo e ecjes, toleranca e tepruar, butësia ndaj femrave, ndjeshmëria ndaj situatave apo ngjarjeve që përcjellin emocion, të folurit me edukatë, mallkimet, përdorimi i tepër i fjalëve përkëdhelëse, zëri i hollë dhe i butë dhe nuk përdor shpesh fjalë banale.

Ndonëse, studentët shprehën qëndrime jo shumë mbështetëse ndaj personave, të cilët mund të kenë në ligjërimin e tyre tiparet e lartpërmendura, u vu re se djemtë paraqitën qëndrime negative apo tallëse, ndërsa vajzat ishin më tolerante dhe të hapura ndaj qëndrimeve të tilla.

*Sipas mendimit tuaj cilat janë karakteristikat e ligjërimit (të folurit) mashkullor, që e bëjnë një femër të duket “agresive”?*

Ndërsa, për këtë pikë qëndrimet e shprehura nga të dyja gjinitë ishin pothuajse negative. Djemtë dhe vajzat studentë, nuk aprovonin që një vajzë të kishte sjellje me tipare mashkullore. Gjestet dhe shprehjet tipizuese për këtë kategori janë: gjestet dhe mënyra e ecjes, modeli i flokëve dhe veshja si djalë, agresiviteti në sjellje, mosbinjda, kokfortësia e tepruar, fjalori vulgar, të sharat dhe të bërtiturat, “hakmarrja”, kundërvënia e tepruar ndaj të tjerëve në raste konflikti, mungesa e tolerancës, impulsiviteti, ngritja e zërit, tendenca për t’u mburur, paragjykimi ndaj femrave etj. Shpesh studentët i etiketojnë vajza të tilla si: *adoleshente në krizë* apo *flasin si rrepiste*. Shprehjet më të përdorura nga vajzat që paraqesin në ligjërimin e tyre tipare të ligjërimit mashkullor janë: *ik ore idjot, u bëre ti moj, s’ke shans, ku je o njish, ta çaj ballin* etj.

- a. Pretendohet se meshkujt që përdorin tipare të ligjërimit bisedor femëror paragjykojnë më tepër se femrat që paraqesin tipare të ligjërimit mashkullor në të folur. Përcaktoni me numër mendimin tuaj rreth deklaratës së mësipërme:


|                     |                   |                |               |                     |
|---------------------|-------------------|----------------|---------------|---------------------|
| 1                   | 2                 | 3              | 4             | 5                   |
| <b>Aspak dakort</b> | <b>pak dakort</b> | <b>neutral</b> | <b>dakort</b> | <b>shumë dakort</b> |

Shpjegoni me fjalë përgjigjen tuaj.

Djemtë që përdorin tipare të ligjërimit femëror shpeshherë etiketohen si “femëruca” apo “fashkull”. E kundërta ndodh me vajzat që përdorin tipare ligjërimore të meshkujve. Ato paragjykojnë negativisht nga të tjerët, por nuk etiketohen me ndonjë term të caktuar.

Etiketimet negative në këtë rast lindin nga mendësia e bashkësisë shoqërore, e cila përcakton ndarjen gjinore në sfera të ndryshme, duke përfshirë edhe sjelljen. Pra, për meshkujt pritshmëritë janë më të mëdha sesa për femrat. Ata duhet të kenë të mishëruara tipare të cilat identifikohen me ligjërimin mashkullor, si: të jenë të fortë në veprime dhe sjellje, të imponohen etj. Shumë studente u shprehën se djemtë mund të paragjykojnë sepse mirësjellja apo tipare të tjera femërore mendohen të jenë jashtë natyrës së tyre.

Rezultatet e aprovimit apo kundërshtisë për deklaratat e mësipërme janë:



**Figurë 3.3** Përqindja e tolerancës së studentëve ndaj vajzave dhe djemve që paraqesin tipare ligjërimore të gjinisë së kundërt.

**(4) Në tabelën e mëposhtme përcaktoni nëse tiparet e mëposhtme janë femërore, mashkullore apo i përkasin të dyja gjinive.**

**Tabelë. 3.2** Përcaktimi i tipareve sociale sipas gjinisë.

|                 | Konkurues | Bashkëpunues | Agresiv | Përpiqen shumë | Llafazanë | Të ndjeshëm (emocionalë) | Praktikë | Përdorin shumë pyetje konfirmuese. |
|-----------------|-----------|--------------|---------|----------------|-----------|--------------------------|----------|------------------------------------|
| Meshkuj         | ↑         |              | ↑       |                |           |                          | ↑        |                                    |
| Femra           |           |              |         | ↑              | ↑         | ↑                        |          | ↑                                  |
| Të dyja gjinitë | ↑         | ↑            |         | ↑              |           |                          |          |                                    |

Bazuar në përgjigjet e studentëve të anketuar, mund të shprehem: 54 % e studentëve kanë bindjen se meshkujt janë më konkurrues, ndërsa 46 % mendojnë se të dyja gjinitë janë konkurrues në situatat e ndryshme jetësore;

Djemtë, në ligjërimin e tyre, paraqesin tipare më të ndryshme nga të vajzave.

1. Gjuha që ata përdorin është e prerë, koncize dhe karakterizohet nga ton deklarativ;


2. Ligjërimi i tyre është direkt, që shpreh fuqi dhe siguri.
3. Shprehjet e përdorura prej tyre janë më të shkruartra, ku ndonjëherë dëgjoen fjalë të ligjërimin të shkuajdesur duke i dhënë një farë vlere tiparizuese për të folurin e tyre.

Vajzat:

1. Përdorimi i pyetjeve konfirmuese “*po ti, do ikësh në mësim?*”
2. Theksimi i disa fjalëve nëpërmjet intonacionit –*kështu që, shumë, goxha bukur.*
3. Përdorimi i intonacionit pyetës në fjalitë pohore: femrat bëjnë deklarata në formën e pyetjeve duke e ngritur zërin e tyre në fund të fjalisë pohore, duke shprehur pasigurinë. Për shembull, “*Çfarë dege je? Juridik?*”

Në bisedat midis gjinisë dhe ndërgjinore, u vu re përdorimi i shpeshtë i fjalëve dhe shprehjeve të huaja, sidomos nga gjuha angleze dhe italiane, më pak nga gjuha greke etj. Në korpusin e leksikut të mbledhur për këtë qëllim përfshihen edhe terma të përdorur nga të dyja gjinitë në komunikimet virtuale, të cilat i përdorin edhe në komunikimin e përditshëm. P.sh.:


Ai më bëri *tag* në një foto. I bëra “share” një linku. Kjo foto ka marë shumë “*lajke*”.



Figurë 3. 4 Përqindja e përdorimit të fjalëve të huaja në komunikimin e përditshëm ndërgjinor

Fjala më e përdorur nga vajzat dhe djemtë student është fjalë angleze *OK*, e cila përdoret nga 95 % e studentëve. Përdorim të gjerë, rreth 82.5 % në komunikimin bisedor ka përsëritetja e gjuhës angleze *Hi*, por edhe përsëritetja e gjuhës italiane *Ciao*. Në grafik paraqitet qartë se fjalët e huaja kanë fituar përdorim të madh në ligjërimin e përditshëm studentor.

Disa nga arsyet e përdorimit të këtij leksiku janë: (1) tendenca e kohës (2) efikasiteti (3) ekonomizimi i fjalëve dhe shprehjeve (4) ndikimi nga shoqëria (5) nuk i përdorin.



**Figurë 3.5** Arsyet e përdorimit të leksikut të gjuhëve të huaja në ligjërim e përditshëm dhe virtual të studentëve të universitetit “Ismail Qemali”.

Sikurse vërehet nga të dhënat e grafikut, arsyeja kryesore pse studentët përdorin leksik të gjuhëve të huaja në komunikimin e tyre të përditshëm dhe atë virtual, është *tendanca e kohës*. Rreth 40 % e vajzave dhe 20 % e studentëve të anketuar pohuan se përdorimi i fjalëve e shprehjeve të huaja është prirje e të rinjve, e cila është shumë e përhapur në vitet e fundit. Ndërkohë, efikasiteti në gjuhë është arsyeja që është votuar më pak nga djemtë përdorin leksik të gjuhëve të huaja; ndërsa më pak se 3 % e vajzave të anketuar kanë vendosur të fundit faktin që nuk i përdorin fjalët e huaja. Në studimin e kësaj nënçështjeje u intervistuan rreth 400 studentë, nga të cilët 62.5 % ishin vajza dhe 27.5 % djem.

### **3. a. 4. 3 Tematikat e bisedës që trajtohen më shumë nga gjini të ndryshme.**

Tematika e bisedës është një tjetër stereotip për burrat e gratë. Sipas Koates<sup>144</sup>, temat kryesore-stereotipike të bisedave të meshkujve janë: makinat, teknologjia modern, pija, udhëtimi, femrat. Ndërsa tematika kryesore në bisedat e gjinisë femërore është: moda, stili i jetës, familja, puna etj.

Ndërkohë që, shqyrtimi i të dhënave me bazë gjinore (**Pyetësi 1, çështja 1**) nxorri në pah një sërë tematika dhe terma që vajzat dhe djemtë përdorin gjatë bisedave. Djemtë, gjithashtu, diskutojnë më shpesh çështje që janë shqetësuese për ata dhe betohen më shpesh. Vlen për t’u theksuar se frekuenca e përdorimit të këtyre fjalëve ka lidhje me temën e bisedës.

<sup>144</sup> Frazer, T. C., *Review of: America Women Talk by Jennifer Coates*, United States, 1998, f. 416.


Më poshtë gjendet një list me tema të ndryshme bisedash që mund të diskutohen në ambiente të ndryshme si lokal apo mjedis në shkollë, jashtë auditorit. Vendosi numra nga 1-9 sipas rëndësisë ( 1-sh. e rëndësishme, 9-aspak e rëndësishme) në kolonën e djathtë.

**Tabelë. 3. 3 Tematikat e bisedave sipas gjinisë.**


| Tematikat   | Renditja sipas rëndësisë (1-9) |                  |
|---|--------------------------------|------------------|
|   | Lokal                          | Jashtë auditorit |
| Makinat   |                                |                  |
| Veshjet   |                                |                  |
| Çështjet aktuale /Politike zë një pjesë shumë të madhe të kohës së njerëzve |                                |                  |
| Futbolli  |                                |                  |
| Shtëpia   |                                |                  |
| Thashetheme të ndryshme   |                                |                  |
| Seksi   |                                |                  |
| TV  |                                |                  |
| Puna  |                                |                  |

Djemtë flasin dhe përdorin më shumë terma për 90% paratë (puna), 87% femrat, 74% makinat, 66% futbolli, 53% thashetheme të ndryshme, 34% cigaret, 20% televizori, 17% çështjet aktuale, 10% shtëpia; ndërsa vajzat flasin më shumë për dhe rreth 85% rrobave, 73% paraqitjes së jashtme, 71% meshkujt, 68% thashetheme të ndryshme (për persona që nuk janë prezent gjatë bisedës), 54% shtëpia, 52% televizori, 28% puna, 16% çështjet aktuale, 5% futbolli.

E paraqitur në grafik, të dhënat e mësipërme janë:



**Figurë 3. 6 Tematika e bisedave të djemve student.**



Figurë 3.7 Tematika e bisedave të vajzave studente.

Përsa i përket numrit të fjalëve të përdorura, përdorimit të përemrit të vetës së parë numri shumë, dhe kategori të tjera, si: emocionet (inati, gëzimi), gjinia, koha dhe hapësira nuk u evidentua ndonjë dallim thelbësor midis ligjërimit të përdorur nga vajzat dhe djemtë studentë. Tabela 5 thekson faktin se djemtë dhe vajzat dallohen vetëm në kategoritë e fjalëve (p.sh., fjalët emotive kundrejt fjalëve konjitive), por ata përdorin nivele të ndryshme gjuhësore.

Ligjërimi femëror thekson gjendjet psikologjike e sociale<sup>145</sup>. Ligjërimi mashkullor thekson çështjet e përditshme që i shqetësojnë ata. Më poshtë paraqiten shembuj të ndryshëm, të shkurtër, që mbështesin këtë përfundim.

Studentet, të çliruara nga trysnia e vëzhgimit, ata përshkruan gjendje psikologjike (p.sh., *i çmendur, e vështirë, më janë ngritur nervat, etj*), proceset sociale (p.sh., *motra, shoqet*), foljet (p.sh., *po shikoj, po flas, mendova, thashë*) dhe mohimet (p.sh., *fare, aspak, jo*).

**Studente #1:** *Epo mirë. Po shikoja atë filmin, po s'është se po e shihja, se po bëja detyrën e kursit në kompjuter. Mezi shtyp në kompjuter, prandaj ka edhe disa gabime. Më bërtiti edhe mami. Më mërzi edhe ajo se po punoja unë.*

**Studente #2:** *S'jam hiç mirë, jam ujë në djersë. Koka po më dhemb shumë. Jam sëmure.*

**Studente #3:** *Jam në chat. Po flas me miqtë. Më ka marrë shumë malli për rata. Nuk kam qenë asnjëherë larg shtëpisë. Çdo ditë pas mësimit, dilnim gjithmonë të gjitha bashkë. Ndonjëherë linim edhe ndonjë orë.*

<sup>145</sup> Shkurta, Gj., *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 326.

*Student #4: Nesër është provimi i menaxhimit. Jam shumë në ankth. Detyrën e kursit e bëra mira, por për provim s'kam mësuar shumë.*

Shembuj nga ligjërimi mashkullor.

*Student #1: Pasi dorëzoi provimin studenti shprehet: Presore, më fal nëse kam bërë ndonjë gabim gramatikor sepse është e vështirë të përqëndroresh kur e di se ke edhe vetëm njëzet minuta kohë dhe pastaj mbaron provimi.*

*Student #2: Detyra kërkonte të përshkruanim se si e përjetojmë festat e fund vitit. Por unë në vend që të shkruaj për këto, mendoj për gjëra të tjera.*

*Student #3: Pse duhet të shkruaj për mendimet e mia? Si t'ia nis për të shkruajtur mendimet e mia?!*

*Student #4: Isha në bibliotekë për të mbaruar detyrën sepse në shtëpi nuk kisha sinjal. Nja dy studentë që kisha afër vetëm flisnin, mezi e mbarova detyrën.*

Ndërsa në ligjërime joformale të vajzave dhe djemve, biseda mbizotërohet nga ana subjektive e emocionale e folësve. P. sh.:

Bisedë vajzë-vajzë

(A) *Sa inat e kam letërsinë, o Zot!*

(B) *Pse moj mua më pëlq!*

i. *Hë moj shtrigë, tre orë për të ngritur telefonin?*

ii. *Avazh, se e çave telin nga të bërtiturat.*

Bisedë djalë-djalë:

i. *O naçu do ikim në pub ore?*

ii. *Po ju o legena, sot e gjetët që s'do vi unë?*

iii. *Hë ore, vendosët?*

**Si konkluzion**, djemtë dhe vajzat e përdorin gjuhën për qëllime të ndryshme<sup>146</sup>. Ndryshimet në të folurin gjinor rrjedhin nga koncepti që vajzat dhe djemtë kanë për komunikimit. Përse shërben komunikimi?- është pyetja që femrat dhe meshkujt i japin përgjigje të ndryshme.

Djemtë e konsiderojnë komunikimin si një mjet që shërben për të shkëmbyer informacion, domethënë, ata flasin kur kanë diçka për të thënë, kur duan të arrijnë një qëllim të caktuar, i kushtojnë më pak rëndësi anës afektive të të folurit dhe nuk japin shumë hollësira rreth çështjes.

---

<sup>146</sup> Kollock, P.; Blumstein, P., & Schwartz P., *Sex and Power in Interaction*, United States, 1985. f. 39.

Vajzat përdorin komunikimin për të krijuar lidhje me të tjerët, për të diskutuar rreth një çështjeje në të cilën mbizotëron aspekti emocionues dhe të treguarit e hollësishëm të çështjes.

Tiparet e ligjërimit femëror të shprehura më sipër nuk janë universale, sepse ato shfaqen në një pjesë të femrave, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre paraqesin siguri, besim, dhe forcë në ligjërimin e tyre. Ndryshimet në të folurin gjinor janë më pak të dukshme në shoqëritë e zhvilluara dhe më tepër të theksuara në shoqëritë të pazhvilluara ekonomikisht, ku femra nuk luan rol kryesor në shoqëri dhe familje<sup>147</sup>.

Pavarësisht nga kultura apo arsimimi që femrat mund të kenë, anketimet dhe vëzhgimet e kryera në institucionin<sup>148</sup> e lartpërmendur kanë treguar se: 78% e vajzave edhe kur kanë shfaqur siguri në ligjërimin e tyre, thënëit që ato kanë përdorur përfundonin me intonacion ngritës, tamam sikur të bënin pyetje. Ky tipar tregon përpjekjen e femrës për t'u barazuar nëpërmjet ligjërimit me pozitën e djemve, por tregon edhe mungesën e besimit në shfaqjen e mendimeve të tyre.

Nëpërmjet punimit, ne bëjmë të mundur të pohojmë se si tiparet e ligjërimit të vajzave kushtëzohen apo diktohen nga mjedisi social-kulturor ku ato jetojnë dhe arsimimi i tyre, prandaj është e nevojshme njohja e zakoneve, e traditave dhe botëkuptimit, sepse, vetëm kështu do të nxirren në pah tiparet ligjërimore, eufemizmat, tabutë, etj, të ligjërimit femëror.

### **3. a. 4. 4 Vështirësitë në studimin e ligjërimit gjinor**

Gjatë studimit lindi pyetja: A është e lehtë apo e vështirë studimi i gjuhës së përdorur nga të dy gjinitë? Në përfundim të studimit u konkludua se studimi i gjuhës dhe gjinisë është e lehtë dhe e vështirë në të njëjtën kohë.

Është e lehtë për shkak se shumë studentë e konsiderojnë interesante studimin e lidhjes së gjuhës me gjininë, dhe duan të gjejnë mbështetje për të shprehur pikëpamjet e tyre. Është shumë e lehtë të mbledhësh prova për të vërtetuar studimin e gjuhës në lidhje me çështjet gjinore. Gjithashtu, është e lehtë të zbatohen dhe verifikohen në praktikë pretendimet e bëra nga gjuhëtarë në studimet e mëparshme.

Studimi gjuhës në lidhje me gjininë është edhe i vështirë, për shkak se studentët mund të ndikohen nga emocionet dhe të jenë subjektiv në gjykimet e tyre.

---

<sup>147</sup> Manual për të rinjtë dhe mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore: Perspektiva gjinore*, Tiranë, 2005, f. 21.

<sup>148</sup> Krahas eksperiencës profesionale 10-vjeçare në Universitetin e Vlorës, mësimdhënia në vite të ndryshme të degës së gjuhës angleze, por edhe mësimdhënia e anglishtes si gjuhë e huaj në vitin e I dhe II në Fakultetet e ndryshme të UV-së, më krijoi mundësinë të studioja, anketoja, dhe verifikoja aspekte të ndryshme e të shumta të ligjërimit studentor dhe atij gjinor.

Titulli i librit të John Gray-it, “*Burrat janë nga Marsi, Gratë nga Venusi*”, është një metaforë, ne nuk vijmë me të vërtetë nga planetë të ndryshëm. Por, dallimet që gjuhëtarë të ndryshëm kanë vënë në dukje lindin vetëm për shkak se burrat dhe gratë ndajnë një hapësirë të përbashkët sociale.

### **b. - Diferencat sipas ndryshorit mjedis familjar dhe klasë ekonomike**

Gjuha e familjes është një faktor vendimtar për kulturën gjuhësore, sidomos në moshën parashkollore. Duke qenë se familja është bashkësia shoqërore dhe gjuhësore më e vogël e shoqërisë njerëzore, ka rëndësi mjedisi ku lind dhe rritet njeriu, sepse po të mos ishte një mjedis i tillë familjar, atëherë do të kishim individë që do të shfaqnin probleme shqetësuese në të folur<sup>149</sup>.

Në historinë e gjuhësisë shqiptare, pas viteve 1990 ky fenomen u paraqit në formë të reja diskutimi. E pashmangshme ka qenë *tematika e përdorimit të dialekteve dhe rivlerësimi i çështjes së gjuhës si “çështje e kulturës”*. Qysh prej asaj kohe e deri më sot kjo problematikë vazhdon të jetë shqetësuese në universitetet tona.

Këtë atmosferë shqetësuese e kanë pohuar edhe një pjesë e konsiderueshme e studentëve të edukuar në shkollë me frymën e zbatimit të rreptë të normës standarde. Individët, pavarësisht shkollimit të tyre vazhdojnë të ruajnë, në një përqindje të vogël, formë gjuhësore të hershme.

#### **3. b. 1 Çfarë është ligjërimi familjar?**

Ligjërimi familjar përfshin të gjitha fjalët, shprehjet që përdoren por edhe krijohen, dhe në përgjithësi kuptohen vetëm nga anëtarët e një familjeje<sup>150</sup>. Duke u bazuar në këto kushte të përdorimit dhe krijimit të tyre, një pjesë e leksikut (neologjizma) të krijuar nga familjarët, nuk gjenden në fjalorët shpjegues.

Sipas reformatores britanike, Helen Bosanquet<sup>151</sup>, shumë familje kanë “gjuhën” e tyre, e cila formësohet në gjirin familjar dhe shpeshherë është e pakuptueshme nga të gjithë ata që nuk i përkasin grupit të ngushtë familjar. Për të tjerët, leksiku i veçantë i familjes, pra neologjizmat, konsiderohen si të pakuptimta. Pikërisht, për këtë arsye, gjuha familjare mbahet e fshehur nga të tjerët.

---

<sup>149</sup> Simkins, B. J., & Wildman, B., *An Investigation into the Relationships between Gender and Language' Sex Roles*, United States, 1991, f. 361.

<sup>150</sup> Nordquist, R., *What is Family Slang?* United States, 2012, f. 1.

<sup>151</sup> Bosanquet, H. D., *The family*, Chicago, 1907, f. 399

Ndërsa studiues Pol Dikson<sup>152</sup> (Paul Dickson), në një prej studimeve të tij të fundit, *Family Words*, zbulon dhjetëra e qindra shprehje angleze të këtij ligjërimi. Fjalori i paraqitur i referohet çdo aspekti të jetës familjare, duke përfshirë marrëdhëniet familjare, situatat sociale, deri tek pajisjet dhe aparaturat shtëpiake. Të tilla janë: *Barrisland* shpreh kuptimin: vendi ku fshihesh kur ndihesh keq apo në siklet, p.sh. të fusësh kokën poshtë jastëkut apo të mbulosh fytyrën me duar; *Menutis* është fjala që nënkupton një shumëllojshmëri zgjedhjesh përpara se të merret një vendim etj.

Studentët shqiptarë, të Universitetit “Ismail Qemali”, pohuan se në familjet e tyre përdoren fjalë dhe shprehje që janë tipike të rrethit të ngushtë familjar, por këto fjalë dhe shprehje nuk mund të cilësohen si neologjizma. Janë shumë të pakta krijimet leksikore brenda familjes. Gjuha familjare, më shumti, përbëhet nga fjalë, shprehje, apo proverba që janë të njohura edhe për të tjerët, sikurse janë krahina apo qyteti në të cilin ata jetojnë. Ndryshimi midis familjeve amerikane, të cituara nga Pol Dikson në *Family words*, me ata shqiptare janë pikërisht fjalët. Në familjet amerikane përdoren shumë neologjizmat të cilat krijojnë një komunikim të fshehtë dhe të kuptueshëm vetëm nga anëtarët e familjes. Fjalori i këtij komunikimi mund të trashëgohet edhe brez pas brezi dhe gjatë kësaj periudhe ai pasurohet, përditësohet me neologjizma që i përshtaten edhe ndryshimeve kulturore, teknologjike etj. Porse, në ligjërimin familjar shqiptar neologjizmat janë të pakta, komunikimi realizohet nëpërmjet fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese. Shpeshësia e përdorimit të një leksiku të caktuar brenda familjes është tipari themelor i saj. Ndonëse, nuk mungojnë edhe rastet kur gjuha familjare i bashkangjit kuptime të tjera fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese. Pra, gjuha e përdorur në familje fiton deri diku tiparin e fshehtësisë.

### **3. b. 2 Tematika e përdorimit të dialekteve në familje**

Si e perceptojnë vetë studentët këtë realitet? Cili është mendimi i tyre a ekziston një prirje drejt standardizimit të shqiptimit dhe nëse po, cili është modeli i shqiptimit letrar?

Në anketën e zhvilluar me studentët e Universitetit të Vlorës, që u krye në dy etapa: diskutimi në auditor i çështjes së gjuhës letrare dhe plotësimi i pyetësorit, u anketuan 200 studentë, u arritën këto përfundime:

*Në familje në të shumtën e rasteve flitet në dialekt për arsye se vendet prej ku vijnë ata i përkasin një shtrirjeje gjeografike ku i gjithë rrethi flet në dialekt.*

*Edhe pse preferojnë të flasin në dialekt, studentët janë kundër mësimin apo favorizimit të dialektit në universitet.*

---

<sup>152</sup> Dickson, P., *Family words: a dictionary for people who don't know a frone frone from a brinkle*, Washington, 1998, f. 3.

*Zakonisht shumica e studentëve preferojnë që në familje ta ruajnë kulturën tradicionale duke përdorur në çdo situatë gjuhën e rrethit (dialektin).*

*Një pakicë e vogël e “studentëve e shohin gjuhën standarde si një mjet të domosdoshëm për t’u paraqitur sa më denjësisht në shoqëri”.*

Janë të shumta rastet kur studentët përdorin shprehje të mjedisit familjar edhe në situatat joformale e në kontekste sociale të një miqësie të ngushtë. Të tilla janë:

**Tabelë 3.4 Shembuj të ndryshëm nga ligjërimi familjar sipas qyteteve.**

|                | <b>Shprehje tipike të mjedisit familjar</b>  |
|----------------|--|
| <b>Vlorë</b>   | <i>...a të heqtë...; ik lipsu...; kombisht (pjepër i vogël); kur të vinë mend, s’ti hanë as qëntë; sporë (dreq);</i>                             |
| <b>Durrës</b>  | <i>Shëndet, jetë dhe harmoni i kërkoj Zotit!, Kështu u mbleshim përhera!, “Mizerje!” (me përkëdheli)</i>   |
| <b>Shkodër</b> | <i>Ka hup si Xhafferri simiten. (E ke humbur si Xhafferri simiten.); Si asht vendi bahet kuvendi. ( Si është vendi bëhet kuvendi.)</i>           |
| <b>Fier</b>    | <i>Kush kërkon ç’i teket, në fund merr ç’i mbetet; cirku për këndin e lojzrë; pasta për tortë; albitër, ai boti për dikë të panjohur;</i>        |
| <b>Korçë</b>   | <i>Shtri këmbët sa ke jorganin; se vë ujin në zjarr;</i>   |
| <b>Ballsh</b>  | <i>Me plakun tallu se do të bëhesh vet, por me të sëmurin jo se e ka kusur nga Zoti; bir Selmani i nënës; ...gur për kokën tënde do ti kesh;</i> |
| <b>Lushnja</b> | <i>qepe gojën se ta dhashë një suratit; ëmbëlsirat e mia, tërë lezet;</i>  |

### **Rast studimi 3**

Në anketën e zhvilluar me studentët e studimeve Bachelor, që u krye në dy etapa: diskutimi në auditor dhe plotësimi i pyetësorit, ku u anketuan 150 studentët, u arritën këto përfundime:

Në më të shumtën e rasteve, studentët përdorin të folmen vendore në komunikimet familjare, për arsye se e gjithë familja dhe farefisi flasin në dialekt.

Për arsyen e lartpërmendur, studentët preferojnë që në familje të ruajnë traditën gjuhësore – kulturore, duke përdorur të folmen krahinore / vendore në të gjitha situatat ligjërimore.

Ndonëse, në komunikimet joformale me njëri – tjetrin studentët preferojnë të flasin në dialekt, ata pohojnë se janë kundër përdorimit të së folmes vendore në auditor.

Një pjesë, rreth 39 % e studentëve e konsiderojnë përdorimin e normës letrare në situata jashtë universitetit, si një mjet të rëndësishëm që realizon komunikim të

drejtpërdrejt, duke shmangur keqkuptimet ndërkulturore dhe e konsiderojnë gjuhën si një mjet social për t'u paraqitur sa më mirë në shoqëri.

Sipas rezultateve sociolinguistike është vërtetuar që marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve në aspektin gjuhësor dobësohen shumë, ndërsa rritet ndikimi i grupeve dhe moshatarëve. Kjo prirje të rinjtë fillon gjatë viteve të studimeve universitare. Konteksti i ligjërimit së bashku me element të tjerë, është vendimtar në përcaktimin e regjistrit gjuhësor që do të përdoret në komunikim.<sup>153</sup>

Pra, dallimet individuale të përdorimit të gjuhës ndikohen nga mjedisi familjar dhe më pas ai shoqëror. Dallimi më i madh social është ai midis gjuhës së individit në varësi të klasës apo shtresës sociale të familjes. Ndryshimet e dukshme vërehen në tonin, vrazhdësinë apo leksikun e përdorur, në ndërtimin e fjalisë dhe në përdorimin e elementeve morfologjike dhe sintaksore<sup>154</sup>.

Pavarësisht ndikimit në rritje të shoqërisë në përzgjedhjen e regjistrave gjuhësorë, duhet pohuar se familja është faktor i rëndësishëm në stilin ligjërimit. Niveli arsimimit të prindërve apo anëtarëve të tjerë të familjes, ndikon në ligjërimitin e pjesëtarëve të tjerë. Sa më i lartë të jetë niveli i shkollimit, aq më e përpunuar e më e stërholluar është ligjërimiti<sup>155</sup>. Prindër që kanë shkollim të lartë përpunon më mirë flasin me fëmijët edhe në shtëpi në varietetin standard. Pavarësisht nga niveli i kulturës gjuhësor të prindërve në gjuhën standarde, formësimi i saktë dhe i plotë i normës prej nxënësve realizohet në shkollë dhe universitet.

Variacioni në gjuhë shfaqet më tepër në fushën e fonologjisë, leksikut, pra në përzgjedhjen e fjalëve, apo edhe në ndërtimet gramatikore të veçanta, sidomos ato nën ndikimin e gjuhëve të huaja. Problem i vërtetë janë pakujdesia e theksuar ndaj gjuhës, gabimet pa fund, vërshimi i fjalëve të huaja, përdorimi i paskajores, pasqyrimi i gjatësisë dhe shkurtësisë së zanoreve ose dukuri të tjera. (Ymeri 2002:54)

Elementet gjuhësore të lartpërmendur reflektojnë pozitën socio-ekonomike, intelektuale e arsimore të familjeve të këtyre individëve. Shpeshherë ndodh që mjedisi familjar, shoqëruar nga të gjithë elementet gjuhësore, sjell ndryshime në të folurën e anëtarëve të saj. Studiuese A. Piluri, shprehet se, janë të dukshme dallimet në aftësitë gjuhësore e komunikative të njerëzve me nivele të ndryshme arsimore, ose të fëmijëve që vijnë nga shtresa të mesme e të larta, nga ata të shtresave të ulëta etj<sup>156</sup>.

Basil Bershtajn është shprehur se dallimet gjuhësore vëzhgohen në mjediset sociale dhe statusi i një grupi të caktuar shoqëror, siç është familja, dallohet nga format gjuhësore të përdorura<sup>157</sup>. Dallimet janë më të dukshme në rast se ka ndryshime të mëdha socio-ekonomike midis familjeve. Pra, vërehen dy klasa sociale mjaft të

---

<sup>153</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë 2005, f. 158.

<sup>154</sup> Piluri A., & Dardha, D., *Ndikimii mjedisit social në gjuhën e fëmijëve*, Korçë, 2013, f. 140.

<sup>155</sup> Shkurtaç, Gj. *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 159.

<sup>156</sup> Piluri, A., & Dardha, D., *Ndikimii mjedisit social në gjuhën e fëmijëve*, Korçë, 2013, f. 140.

<sup>157</sup> Bernstein, B., *Language and Social Class*, England, 1960, f. 271-276

ndryshme nga njëra-tjetra: klasa e mesme dhe klasa e ulët punëtore. Diferencat gjuhësore midis këtyre dy shtresave sociale, rrjedhin nga modelet ligjërimore krejtësisht të ndryshme që ato përdorin.

Bershtajn, gjithashtu, sugjeron se format ligjërimore të klasës së mesme janë dominante kundrejt atyre të klasës së ulët, e cila përdor një kod gjuhësor të ngushtë e të kufizuar në përzgjedhjet gjuhësore.

Profesor Shkurtaj në botimin e tij *Sociolinguistika*, shprehet se: *sjellja gjuhësore dhe kompetenca komunikative e njerëzve duhet të jetë e lidhur me të ardhurat dhe me pozicionin e tyre shoqëror të tyre në klasat dhe në hierarkinë shoqërore*. Gjithashtu, Shkurtaj pohon se: *si rregull, sa më i lartë të jetë niveli arsimor dhe edukativ, aq më i dukshëm do të jetë edhe dallimi i sjelljes gjuhësore të individit nga ta që kanë një shkallë më të ulët*<sup>158</sup>.

Në vëzhgimet e bëra për këtë qëllim, dallimet më të zakonshme që vërehen janë:

Ata studentët që vijnë nga familje të shtresës së mesme apo nga prindër intelektualë, kanë një fjalor më të pasur, përdorin leksik më të përzgjedhur, janë më të qetë kur flasin, përdorin në mënyrë të përshtatshme strukturat dhe tiparet gramatikore, përdorin shprehje më të mirë-strukturuara etj.

Ndërsa studentët që vijnë nga familje të shtresës punëtore, paraqesin shkujdesje në përdorimin e gjuhës së folur, kanë një fjalor më të kufizuar, përdorin fjalë dhe shprehje të thjeshta, të cilat ndodh që të jenë të pastrukturuara etj.

Mendohet se të këto tipare gjuhësore krijojnë një inferioritet lingvistik<sup>159</sup>. Por është për t'u theksuar edhe një fakt, i cili u evidentua gjatë analizimit të lëndës gjuhësore. Shumë prej studentëve të anketuar, që vijnë nga familje të shtresës punëtore ose nga prindër të paarsimuar, mundohen ta përshtatin të folurin e tyre sipas situatës ligjërimore. Si rezultat, ata bëjnë përpjekje serioze për t'u shprehur në gjuhën letrare dhe i foluri i tyre nuk ndihmoi për të dalluar shtresën shoqërore ose intelektuale të tyre. Kjo kategori studentësh, si folës me ndërgjegje, synojnë të dalin nga sjellja gjuhësore e tyre, dhe përpiqen të zotërojnë një sjelljeje tjetër. Sikundër, u hasën raste të studentëve që vijnë nga familje intelektuale apo shtresë shoqërore e mesme ose lartë, të cilët përdorin një kod gjuhësor që nuk i përket origjinës së tyre.

Për të ilustruar këtë pikë, po paraqesim disa shembuj nga ligjërimi i folur që studentët përdorin në familje:

**Student 1.** *Posi nuk të beson njeri që janë plumb mësimet! Kam dy provime në një ditë. Po do mundohem të dal sa më mirë, po se di. Avazet filluan. S'di ç'a të mësoj më parë, nuk është e drejtë. Ku do ikim këtë verë? Po mendoja të filloja ndonjë punë po nuk ja dal dot? Relaks. Kam dalë pak keq në këtë provim, po do e rregulloj.*

---

<sup>158</sup> Shkurtaj, GJ., *Sociolinguistik*, Tiranë, 2005, f. 158/9.

<sup>159</sup> Piluri, A., & Dardha, D., *Ndikimii mjedisit social në gjuhën e fëmijëve*, Korçë, 2013, f. 141.

**Student 2.** *O familja, e dini që kam provimet, pak respekt, se pastaj thoni pse ngele...mos ngele. Unë i bëra të gjitha, por ajo nuk ma dha. Lashë vetëm dy pyetje. Më në fund, shyqyr se vdiqëm motra. Ç'a do bëjmë se u plakëm në shtëpi? E pi kafën kur do. I merr dot të gjitha provimet? U plakëm këtu.*

**Student 3.** *I bëra të gjitha ushtrimet. I mora të gjitha. Ika unë, të djelën vi. Ngrihet robi kur i do qejfi. Ku do vemi për pushime sivjet? I bëjnë bomb fare, të ngatëruara. Nuk kam për t'ju zhgënjyer. Mezi po pres të vij në prapë pushimet, se jam lodhur me ngarkesën mësimore. E mora! E ndrita!*

**Student 4.** *Kam provim, kam mësuar ca. Ishalla dal mirë. Janë ca të vështira. Kur do shkojmë andej? (për pushime) E bëra provimen, pres përgjigjen. Mirë dola. Çfarë planesh ke? Nuk dola mirë po hajt s'ka gjë.*

Sikundër vihet re, shembujt nuk janë të ndarë sipas shtresave sociale, sepse frazat dhe leksiku i përdorur paraqet tipare të normës standarde, të ligjëritimit bisedor dhe ligjëritimit të shkujdesur. Të tilla janë: *plumb mësimet, ajo nuk ma dha, shyqyr se vdiqëm motra, u plakëm në shtëpi, robi, shoqëruar nga struktura gramatikore të cinguar dhe të paplota, pjesa më e madhe e informacionit është e nënkuptuar brenda kontekstit social dhe gjuhësor që ato përdoren etj.*

Në fakt, nëpërmjet shqyrtimit të sjelljes gjuhësore të studentëve që i përkasin shtresave të ndryshme shoqërore e intelektuale, mund të përcaktohen më mirë edhe aspekte të sjelljes sociale dhe të personalitetit të individit.

### **c. Diferencat sipas ndryshorit mjedis administrativ**

Mjedisi shoqëror, vendlindja dhe kontakti i vazhdueshëm i këtyre elementeve, ndikon dukshëm në të folurin individual. Nga gjendja faktike dhe reale që mbretëron në shkollat, fakultetet tona nuk mund të jemi të kënaqur dhe lëshimet duhet t'i kërkojmë si në sistemin tonë arsimor, ashtu edhe në kujdesin tonë ndaj gjuhës letrare<sup>160</sup>. Prandaj në shkollat tona paraqitet edhe një tjetër problem: shpjegimi i raporteve midis gjuhës standarde dhe dialekteve. Gjuha që përvetësohet në shkollë, nuk është e njëjtë me gjuhën që e përdoret në familje ose në rrethin më të ngushtë. Për nxënësin apo studentin gjuha e rrethit është parësore, gjuha letrare vjen pas asaj popullore. E folmja është gjuha e tij amtare. Me ndihmën e tij, ai më pastër dhe më lehtë e mëson botën dhe i shpjegon emocionet dhe dëshirat e tij. Me hyrjen në shkollë, bota zgjerohet, plotësohet dhe komplikohet<sup>161</sup>. Dituritë e reja kërkojnë komunikim më

---

<sup>160</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 381.

<sup>161</sup> Shih po aty, f. 384.

të pasur dhe më të ndërlikuar gjuhësor, ku gramatika e të folmes së tij nuk i ndihmon më.

Këtë më së miri e shpjegon D. Korson<sup>162</sup>, i cili vëren se gjatë kalimit të fëmijëve nga familja në shkollë ata i shmangen fuqishëm ndikimit të familjes dhe të rrethit shoqëror, ku përdoret një variant ligjërimitor i ndryshëm nga varianti standard që kërkohet në shkollë, gjë që bën që te një pjesë e tyre të hasen anomali në përshtatjen me mjedisin e ri ligjërimitor dhe, përgjithësisht, mossuksese në përvetësimin e disiplinave mësimore.

Përveç kësaj, nxënësi apo studenti mund të përjetojnë edhe ndryshimet fizike e emocionale të moshës, që paralelisht e tërheq atë në pasiguri gjuhësore<sup>163</sup>. Këtë pasiguri mund ta ilustrojmë me dy raste: në të parin një student i vitit të parë, gjuhëletërsi, i shpjegon shokut të tij se: *“Ka frikë mos ta qosh të flas në gjuhën letrare, andaj hesht”*. Rasti i dytë kur një student i sapo shpërngulur nga viset rurale në qytet, nga dita e parë e mësimin kthehet i zhgënjyer në shtëpi sepse nuk mund t’i kuptonte plotësisht pedagogët kur flisnin.

Arsyet e këtij mossuksesi qëndrojnë, ndër të tjera, edhe në vështirësinë e këtyre individëve për të përvetësuar normat e gjuhës standarde, apo siç thuhet ndryshe në literaturën sociolinguistike, në *“inkompetencë gjuhësore”*<sup>164</sup>.

Megjithatë, të rinjtë, tashmë, e zotërojnë mirë kompetencën e tyre gjuhësore, dhe kur përballen me folës të qyteteve të ndryshme e kanë të lehtë të përcaktojnë origjinën dhe kulturën gjuhësore të interlokutorëve.

Kjo situatë gjuhësore paraqitet edhe në Universitetin e Vlorës. Shumë prej studentëve, vendas ose të qyteteve të tjera, bëjnë përpjekje për të folur në gjuhën standarde. Megjithë përpjekjet për të komunikuar sipas rregullave të standardit, janë jo të pakta situatat, tematikat në të cilat ata përdorin tipare ligjërimitore të mjedisit administrativ e familjar të tyre.

Sa për ilustrim të shohim disa shembuj të kategorive të ndryshme të cilët paraqesin variante në gjuhën standarde shqipe<sup>165</sup>.

**(Leksik):** *medikamente/ ilaçe; Gjela të detit/ biban/ quran; film i animuar/ film i vizatuar; pema e Vitit të Ri/ bredhi i Vitit të Ri; Plaku i Vitit të Ri/ Babadim ri etj.*

**(Fologji):** *tanks/ tank; kaubojs/ kauboj; fans/ fan; skorpion/ skorpions; afrojt/ ofroj; simulan/ simultant; sesion/ seksion/ sezon; alo/ allo etj.*

**(Morfologji):** *e shpifur/ e nevertishme/ e gërditshme; habitejt/ çuditejt; ulje/ skonto; regjion/ rajon etj.*

---

<sup>162</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 386.

<sup>163</sup> Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 127.

<sup>164</sup> Shih po aty, f. 125.

<sup>165</sup> Shkurtaj, Gj., *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 65.

(**Sintaks**): *kalon rrugën/ kalon nëpër rrugë; hipi në tren/ i hipi trenit/ marr trenin; nuk figuronte në listë/ nuk ishte në listë; paraqes kërkesë/ kërkoj etj.*

Pavarësisht nga ajo se çfarë funksioni luan gjuha në shoqëri dhe kulturë, për çfarë teme kumton, kush flet dhe shkruan me të, me kë, ku, kur dhe për çfarë shkakut përdoret, etj., janë krijuar shtresime, përkatësisht ndryshime të caktuara të gjuhës, si ato: stilistike, dialektore, sociolektore, zhargonike, idiolektore, etj., faktorë që ndikojnë kulturën e përgjithshme gjuhësore të folësit<sup>166</sup>.

Të gjitha këto dukuri gjuhësore, të manifestuara në formë variantesh kanë rëndësinë e tyre dhe karakter relativ dhe thjesht pa marrë parasysh se cilit variant i takojnë, është e pamundur t'i shkyçësh nga përdorimi gjuhësor i çdo individit – si folës dhe përfaqësues të gjuhës standarde shqipe, randaj sipas kësaj pikëpamjeje toleranca gjuhësore paraqitet si qëndrim i arsyeshëm dhe udhëzim i evetëm për sjellje gjuhësore dhe shoqërore<sup>167</sup>.

Ndikim të madh në këtë aspekt kanë edhe mediat, të cilat janë pasqyrë e jetës kulturore, artistike, gjuhësore etj. Në median e shkruar dhe të folur duhet të mbizotërojë përdorimi i gjuhës letrare dhe si të tilla luajnë një rol të madh në disa drejtime, si: në emancipimin e masave të lexuesve, të dëgjuesve e teleshikuesve, gjithashtu ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare, duke filluar nga lexuesit e gjer te punonjësit e arsimit e kulturës.

#### **Rast studimi 4**

Nisur nga vëzhgimet e bisedave midis studentëve nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë u vu re se përdorimi i të folmes dialektore ishte në një masë të dukshme. Të dhënat bazë për këtë rast studimi janë marrë nëpërmjet pyetësore të realizuar me pedagogë dhe studentë në lidhje me ligjërimin e studentëve në mjedisin akademik<sup>168</sup>.

##### **a. Për pedagogë**

##### **1. A evidentohet e folmja dialektore në universitet?**

Po \_\_\_70%\_\_\_

Jo \_\_\_7%\_\_\_


Ndonjëherë \_\_\_23%\_\_\_

<sup>166</sup> Ibrahim, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike*, Tiranë, 2011, f.512.

<sup>167</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 385.

<sup>168</sup> Për realizimin e kësaj ankete disa nga pyetjet janë huazuar nga Balla M., *Marrëdhëniet e sotme gjuhë standard-dialekt në shkolla*, Tiranë, 2011, f 268-271.

Ma. Dorian Klossi




**Figurë 3. 8 Përqindja e përdorimit të të folmes dialektore të studentëve sipas pedagogëve.**

Kështu, tek studentët e Shqipërisë së Veriut vihen re shmangie në shqiptimin<sup>169</sup> e fjalëve që kanë në përbërje të tyre grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng**, të cilat dëgjohen në trajtën e tyre dialektore gege d.m.th. me asimilimin e tyre në **m, n, ñ**: *maj, mush, knoj*. Po kështu fjalët në togun e zanoreve **ua** (duar, mua, shkruar), si dhe me **ue** (mësues, i gëzueshëm), gjithashtu në trajtat dialektore gege, shprehen me togjet të monoftonguara përkatësisht në **u** (<**ue**): *dur, gru, mu, shkru*, etj. Ndërsa studentët të Shqipërisë së Jugut shqiptojnë me **ë** mistore në vënd të **sh**, fjalë si *çfaqje, çkarkoj, çkul, i çkujdesur*, ose nuk shqiptojnë fonemën shumëdridhëse **rr**, duke e shqiptuar atë si **r**: *ara, ruga, rush* etj., në vënd të *arra, rruga, rrush*. Pra, në një farë mënyre, kemi një “labërizim” më të dukshëm të kësaj të folmeje, ndoshta sepse Universiteti i Vlorës ndodhet në jug të Shqipërisë.

**2. Motivet kryesore të këtij ndikimi janë:**

- II. Studentë që vijnë nga zonat rurale 46%
- III. Studentë që vijnë nga rrethet e tjera 48%
- IV. Tek të gjithë studentët 6%




**Figurë 3. 9 Motivet e ndikimit të të folmes dialektore.**

**3. A pasqyrohet forma dialektore në punët me shkrim të studentëve?**

Po 15%      Jo 85%


<sup>169</sup> Shkurtaç, GJ., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 101.



**Figurë 3. 10** Pasqyrimi i formës dialektore në punët me shkrim.

**4. A ndërhyhet nga ana juaj tek këto studentë apo jehohet të flasim lirshëm?**

Po 87% Jo 13%




**Figurë 3. 11** Përqindja e korrigjimit të të folmes dialektore në orën akademike.

**b. Për studentët**

**2. Nga jeni me origjinë?**

Qytet 55% Fshat 45%




**Figurë 3. 13** Përqindja e origjinës së studentëve të anketuar.

3. A ndryshon e folmja juaj në shtëpi me atë në universitet?

Shumë 86%

Pak 11%

Aspak 3%



Figurë 3. 14 Përqindja e ndryshimit të të folmes në shtëpi me atë në universitet, të studentëve të anketuar.

4. Cilat janë disa nga shprehjet e vendlindjes dhe të familjes tuaj që vazhdoni t'i përdorni edhe në mjedisin e jashtëm të Universitetit?

Shtresimi territorial paraqitet në formë dialekti dhe në formë variantesh të gjuhës së normuar standarde<sup>170</sup>. Të shumtë janë shembujt (fjalët, togfjalëshat, fjalitë) që pasqyrojnë ndikimin e gjuhës së mjedisit të tyre administrativ e familjar në ligjërimi bisedore të studentëve.

Tabela 3. 5 Fjalët dhe shprehjet që studentë nga qytete të ndryshme përdorin në situata të caktuara, deri diku me humor, dhe më shoqërinë e tyre të ngushtë.

| Qyteti | Shprehje tipike të vendlindjes   |
|--------|--|
| Vlorë  | <i>Vehi (vendi), krypë (kripë), fëmër, burazer, dackë, Evlat, Simite. Rrospi (rrugaçe), Kallogre (fëmër me fatkeqsi në jetë), Hë vëlla, E'ore ça bën? Ore, Noku, E humba toruan, O vëlla, O motra, Ça bëre mirë? U bëfsha dru, Çer, Laro, Të theva në mes, Shkrepe të shkretën, Botile (nga ita. &lt; bogtilia, alb. &lt; shishe), Rrofsh vëlla, Nona fare Laro dreqit, Do vish moj ti, Na ben si legene kjo, Ça idioti ky? Lum ajo per mendjen që ka, Xinxërfîle nga mëndja, Mosha lart dhe mendja poshtë, Goxha djalë, Femër e zgjuar, Djalë për kokë të djalit, Lumsi ata prindër që kanë atë vajzë, Ajo mjaltë nxjerr nga goja. Ça bëre mirë? Fiks o ça! Si të kam? Rrofsh! Të paça!</i> |
| Durrës | <i>O me ça bone? Do ikim për qokë. Kemi luft meç! Mananej....! Je tu u ngrof n'diell! Jamallnume...!(më ka marrë malli)</i>  |

<sup>170</sup> Ibrahim, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike*, Tiranë, 2011, f. 501.

|   |   |
|---|---|
| <b>Lushnjë/<br/>Elbasan /<br/>Berat</b> | <i>Qysh? (si?), imën (tani), akshëm (mbasdite)<br/>Ku je o lali, Ça ban? Imen, Laknor, Qelbsina, Kokudha. Qyqja re<br/>dreq, pika që s'të bie! Ça thotë qy? Si ma ke shnetin?</i>   |
| <b>Skapar</b>                           | <i>Trangull (kastravec), qefpi (petulla me kos),</i>  |
| <b>Delvinë</b>                          | <i>Karpur (shalqi), vuloma (zhytje), brushul (pispilit), hurmë (kaki)</i>   |
| <b>Shkodër</b>                          | <i>Mir se na ke ardh. Ta hangsha zemrën. Mir se ju gjeta tanve.</i>   |
| <b>Fier</b>                             | <i>Do hidhemi matanë, Kështu flasim ne nga fiery, Po më dhembin<br/>kembët mau me, Ti je dele fare me, He re ça do? Çfar dreqin ke? Ke<br/>lajthitur gjë? Mos më çaj kokën ti ere. Si s'u fryve njer (gjithmon ha<br/>shumë), Opo ti e ke të bluar (e ke çdo gjë në rregull), E ke në tav çdo gjë,<br/>Buli im, Hë me dhe ti si bën! Burrë i dheut!</i> |
| <b>Kuçovë</b>                           | <i>Ere, Noku, Noce, Eme, Llaçkë, Shtrembaluqe, Ngela si presh,<br/>O zogju mbaje veten se nuk ta ka fajin njeri.</i>  |
| <b>Dibër</b>                            | <i>Mshele derën (mbylle derën), A je kon mirë (a ke qen mirë), Ça je ka<br/>bo? Le nom. Ça me than. S'jam tu rrejt! (nuk po gënjej).</i>  |

Në tabelën.7 paraqiten disa nga fjalët e shprehjet që studentët nuk i përdorin ose mundohen t'i shmangën përdorimin e tyre në mjediset universitare ose me studentë që nuk i përkasin rrethit të tyre të ngushtë shoqëror dhe në këtë mënyrë shmangin keqkuptimet e ndryshme kulturore, gjuhësore dhe etiketimet që janë rezultat i përdorimit të gjuhës së vendlindjes.

**Tabela 3. 6 Fjalët dhe shprehjet që studentë nga qytete të ndryshme nuk i përdorin në ambientet e brendshme universitare apo me studentë të tjerë që nuk janë në shoqërinë e tyre të ngushtë.**

| <b>Qyteti</b> | <b>Shprehje tipike të vendlindjes</b>   |
|---------------|---|
| <b>Vlorë</b>  | <i>aderbardhë (të kesh “derën-fatim” e bardhë), sabah (mëngjes), xhade<br/>(rrugë), avlli, derman, t'u bëfsha, hë të kegen, hiç pa bili. Burazer (vëlla),<br/>Dackë (shpull, pëllëmbë), Sterrë (vend i thellë në greminë), Kucumble<br/>(përkëdhelje për fëmijë), Çudive (mirmëngjes),<br/><br/>Musender (dollap i madh), Linj (këmish), Strom (qylim), Derman<br/>(xhan), Është që ta vrasësh me bukë në gojë. E moj të rëntë bomba!<br/>Derbardhë. I uruar dhe ti. Ku e ke kaplloqen? O vëlla, ik se na trashe.</i> |
| <b>Durrës</b> | <i>O me ça bone? Do ikim për qokë. Kemi lujt menç! Mananej....! Je tu<br/>u ngrof n'diell! Jamallnume...!(më ka marrë malli)</i>  |
| <b>Berat</b>  | <i>Hëmë, hëime, e re (hë ore)</i>   |

|                           |   |
|---------------------------|---|
| <b>Lushnjë / Çorovodë</b> | <i>E zeza bir! Të hangërt mortja! Qysh? (si?), imën (tani), Qy (Ky), Çyryke, qerrata, babaxhan. Qyrtk.</i>  |
| <b>Shkodër</b>            | <i>Mir se na ke ardh. (Mirë se erdhe.); Si ka njëf. a njëf mirë? (E një mirë?); Tu fjet si kihe. (Duke fjetur si qengj.); A je çu herrët? (Je zgjuar shpejt?) Ta hangsha zemrën. Mir se ju gjeta tanve. (Mirë se ju gjeta të gjithëve.), Mu ban mukajet. (Mu bënë ndihmë.),</i> |
| <b>Korçë</b>              | <i>Byrazer (vëlla), Çupkë, E bre lalkë si je? Mollë pe korçë, Çkemi o byrazer? Kërnačka, Lakror.</i>  |
| <b>Fier</b>               | <i>Ere (Ore), Vlla (Vëlla), Fijuar (fejuar), Daje (dajë), Mos më bëj si xhixherkë mua (mos më bëj llafazanen), Je thes i grisur (nuk mban asnjë sekret), Ke gjunjë ti ( ke para, ta mban të më japësh ca), Të këndon dhe zverku (nuk rri rehat flet shumë),</i>                 |
| <b>Kukës</b>              | <i>Ja ke nxjerr fundin që tash, Kujt i paske ga për faqe t'zes, I ki ndreq sendet ti? Viii ky bre, Të rantë kaqinoja dhe shaplamoste.</i>   |
| <b>Dibër</b>              | <i>Cuc (vajzë), Voc (djalë), Cull (fëmijë), Tahaj (tani)<br/>Voe (vezë), Paish (pishë), Dor (borë), Capa (kafshat buke), Si i ke pasë gjintë? (njerzit e shtëpisë),</i>   |

Gjithashtu, shumë studentë pohuan se gjatë komunikimit ndërkulturor, me studentë të kulturave dhe mjedisve të tjera gjeografike, kanë ndodhur edhe keqkuptime. Diferencat gjuhësore me bazë fonetikën dhe leksikun janë shkaku kryesor i keqkuptimeve ndërkulturore. Shprehja të tilla si: *të martofsha plakën* (Vlorë) apo *ta bëra gropën* (Fier), *je baba Zot* (Ballsh), *të qafsha moj Shegë* (Elbasan), *ku je moj ta marsha* (Shkodër), shpesh herë kanë krijuar keqkuptime midis interlokutorve. Pjesë në ngatërresat e krijuara, gjatë bisedave me studentë nga vise të ndryshme, kanë edhe fjalët dialektore, si: *xhen* (Tropojë) për *qen* (Vlorë), *androj* për ëndërroj është folja e cila është kuptuar si *androj rroba, rujta* (Elbasan) për *pashë, shoshenka* (Elbasan) për *shapka, ime* (Elbasan) për *tani, qyqe* (Leskovik) me kuptimin kur dikush ndihet keq por në qytete të tjera si Vlora, Fieri etj., ka kuptimin kur dikush ka humbur ndonjë pjesëtar të familjes.

Grafikët me përqindje, përgjigjet e pyetësorit theksojnë edhe një herë faktin se në Universitetin e Vlorës u gjetën elemente të ndikimit dialektor tek studentët. Në studimet e saj për gjuhën e të rinjve, gjuhëtarja Penelop Ekert<sup>171</sup> shprehet se ligjërimi i të gjithë folësve bazohet në dialekt, në varësi të origjinës ose mjedisit administrativ dhe me kë janë shoqëruar më parë. Në të folmen ndikon shumë qeliza bazë “familja”, origjina e tyre, shoqëria dhe niveli i shkollimit<sup>172</sup>. Por, nëqoftëse individët shpërngulen atëherë gjatë procesit të bashkëbisedimit, folësit mund ta ndryshojnë të

<sup>171</sup> Holmes, J., *Review of: AmericaLanguage and Gender by Penelope Eckert*, United States, 2004, f. 846-849.

<sup>172</sup> Balla, M., *Marrëdhëniet e sotme gjuhë standard-dialekt në shkolla*, Tiranë, 2011, f. 272.

folmen e tyre. Krahas tipareve dialektore të origjinës, ata mund të shfaqin edhe tipare shqiptimore të rajoneve, të vendeve në kontakt. Ky parim gjen zbatim edhe në sociolektin studentor vlonjat. Sikurse është përmendur edhe më lartë, heterogjeniteti gjuhësor i studentëve krijon larmishmëri në gjuhën e përbashkët studentore. Por vihet re se një pjesë e konsiderueshme e studentëve të ardhur nga mjedise të tjera administrative krahas tipareve dialektore të vendlindjes huazojnë edhe disa tipare të së folmes së qytetit të Vlorës,

### **Përfundime**

Variacioni në gjuhë është fenomen i pashmangshëm dhe përfaqëson një kompetencë gjuhësore të gjerë: aftësia për të shprehur fakte, përgjithësime dhe abstraksione të përvojave jetësore<sup>173</sup>. Shtresimi territorial në formë dialekti paraqitet më shpesh në formë të të folurit, kurse vepron nëpërmjet dallimeve gjuhësore midis rajoneve të caktuara në kuadër të një territori të caktuar gjuhësor (në të gjitha nivelet gjuhësore: në fonologji, morfologji, leksik, semantikë dhe sintaksë)<sup>174</sup>.

Leksiku, shqiptimi, strukturat sintaksore dhe format morfologjike, veçojnë apo shfaqin ngjashmëritë midis zonave të ndryshme gjeografike<sup>175</sup>. Pra, e folmja vendore nuk zhduket pa lënë gjurmë as në shtresat më të reja të popullsisë<sup>176</sup>. Me gjithë ndryshimet që pëson sistemi i të folmes tradicionale në brezat aktivë, prapëseprapë në çdo variant të ri mbetet një substrat dialektor, i cili, në shkallë të ndryshme intesiteti, vihet re edhe në shtresat e ndryshme të të folurit qytetar.

Studentët e Universitetit të Vlorës, në ligjërimin bisedor por edhe në atë akademik, shfaqin ngjyrimet e të folmeve tradicionale. Këto dallime nuk janë leksikore kuptimore të fjalëve përkatëse të gjuhës standardë por shfaqen dallime fonetike dialektore. Të tilla janë: ndërrimi i  $\hat{a} > \ddot{e}$ : *nana* për nëna, *kâma* për këmba, *hâna* në krahasim me hëna, *âshtë* – është, *âmër* – emër, *bâj* – bëj, *nântë* - nëntë, *hum* për humb, *nryshoj* në vend të ndryshoj etj. Gjithashtu, shfaqen edhe trajtat dialektore të fjalëve me rënie të *ë*-së së patheksuar fundore e me zgjatim kompesator<sup>177</sup>: *pu:n* - punë, *i ba:rdh* – i bardhë, *de:r* – derë.

---

<sup>173</sup> Rentel, V. M., & DeStefano, J. S., *Language variation: perspectives for teachers*, Ohio, 2003, f. 329.

<sup>174</sup> Ibrahim, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike*, Tiranë, 2011, f. 502.

<sup>175</sup> Rentel, V. M. & DeStefano J. S., *Language variation: perspectives for teachers*, Ohio, 2003, f. 329.

<sup>176</sup> Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standardë si dukuri sociolinguistike*, Korçë, 2013, f. 385.

<sup>177</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 223.

Studentët pohuan se kishin vështirësi për të mënjanuar plotësisht intonacionin dhe nyjetimin dialektor krahinor të disa fonemave. Të tilla janë:

Kuksi: (A) *mos hec njashtu se zysha nuk asht ktu.*

(B) *pse mor ku asht? Po t'tjert kan ardh?*

Fier: (A) *o laça, do vish ti ere?*

(B) *ik e ik, se s'vi fare un.*

Vlora (A) *ç'a bëre, mirë?* (intonacioni në ngritje i fjalës *mirë*, i jep shprehjes kuptimin e pyetjes)

Në shembujt e mësipërm u paraqitën kategori fjalësh të cilat paraqiten leksikorisht të njëjta, por fonetakisht të dallueshme nga standardi. Kjo jep shkak që përherë të duken “gjurmët” e nyjetimit dialektor ose “hibridet” fonetike, si p.sh. è për ë (< â): *nëna, bëj, bëra, përbërje* etj.<sup>178</sup>.

Fjalët dhe shprehjet e vendlindjes përdoren në një shkallë të madhe brenda grupit të ngushtë shoqëror ose me studentë që vijnë nga i njëjti mjedis administrativ. Porse, përdorimi i leksikut vendore përdoret më pak me studentët që i përkasin vendeve dhe kulturave të tjera. Elementi fonetikor dhe forma sinonimike për të njëjtin objekt apo dukuri etj., hasen më tepër në bisedat ndërkulturore. Ky tipar vërehet më tepër në ligjërimin e studentëve të vitit të parë, pasi gjatë viteve të studimit, studentët i përshtaten mjaftueshëm ligjërimin standard, duke shmangur edhe keqkuptimet që vijnë si rezultat i dallimeve ligjërimore.

Një nga tiparet më të rëndësishme të gjuhës është aftësia për të shprehur kuptimin social në mënyrë relativisht të pavarur nga fjalitë që përdoren<sup>179</sup>.

Gjeografia linguistike ndikohet nga dukuri jogjuhësore, shoqërore dhe kulturore, fetare, politike, ekonomike etj. Ndryshimet fonetike<sup>180</sup> shfaqen edhe në artikullimin e fjalëve të reja, të cilat janë krijuar si rezultat i këtyre zhvillimeve dëgjohen rëndom fjalë në variantet dialektore, si: *softuar* (software), *antori* i grupit (për: anëtari i grupit), *daunlodu* (download) etj. Ndërkohë, zotërimi i mirë i varietetit standard zhvillon aftësitë komunikative për qëllime të ndryshme dhe jep mundësi të gjithanshme për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të studentëve, si dhe për vetë formimin e personalitetit të tyre.<sup>181</sup>

Martin Haideger<sup>182</sup>, ka thënë: “Gjuha është diçka aq e rëndësishme, saqë nuk duhet t’ua lëmë vetëm gjuhëtarëve”. Çdo popull ka detyrimin dhe përgjegjësinë që të mbrojë dhe të përdorë me përgjegjshmëri gjuhën letrare.

---

<sup>178</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 223.

<sup>179</sup> Ibrahim, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike*, Tiranë, 2011, f. 502.

<sup>180</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005 f. 224.

<sup>181</sup> Balla, M., *Marrëdhëniet e sotme gjuhë standard-dialekt në shkollë*, Tiranë, 2011, f. 267.

<sup>182</sup> Qosja, R., *Kongresi i drejtshkrimit—tridhjetë vjet pas*, Tiranë, 2003, f. 36.

## KAPITULLI I KATËRT

### Taktikat e ligjërimit studentor

---

#### a. Zbunimet dhe përkëdhelitë

##### 4.a.1 Zbunimet

##### 4.a.2 Baby talk

##### 4.a.3 Nofkat

##### 4.a.1 Roli dhe vendi i nofkave e fjalëve përkëdhelëse në ligjërimitin gjinor

#### b. Sharjet dashamirëse

##### Përfundime

#### c. Zhargoni studentor vlonjat

##### 4. c. 1 Tipare leksikore të zhargonit studentor në Universitetin “Ismail Qemali”

##### Përfundime

---

#### a. Zbunimet dhe përkëdhelitë

Zbunimi dhe përkëdhelia janë dy elemente të ligjërimit afektiv, që zënë vend kryesor në ligjërimitin studentor, kryesisht atyre të rrethit të ngushtë miqësor e shoqëror. Ato mund të konsiderohen si një kalim “për inerci” i mënyrave të komunikimit miklues, ledhatues e thelbësisht joformal.<sup>183</sup>

Janë të shumta arsyet pse studentët zbunojnë apo “përkëdhelin” me fjalë njëri-tjetrit. Dikush përdor shkurtimin e emrit apo terma përkëdhelës për të afruar dikë, për ta mikluar, dikush tjetër për t’i shprehur afërsinë, dashurinë, respektin, etj, dikush

---

<sup>183</sup>Shkurtaç, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 159.

tjetër i drejtohet shokut apo shoqes me emër të shkurtuar për të shmangur emrin e tij / e saj shumë të gjatë apo emër të vjetër. Në bazë të këtyre dy strategjive vepron pragmatika gjuhësore: qoftë shkurtimi për shkak zbulimi, qoftë përkëdhelia e mirëfilltë duhet të jenë gjithmonë të përligjura nga disa rrethana jashtëgjuhësore, si: rrethana miqësore, shoqërore, familjare, intime, dhe *jo në rrethana zyrtare e formale*, gjithashtu duhet të përkrahen edhe nga çasti i ligjërimit, që do të thotë se *kjo dukuri nuk mund të veprojë kudo dhe me këdo*.

#### **4. a. 1 Zbulimet**

Zbulimi është një dukuri mjaft e përhapur në Universitetin e Vlorës. Ai haset më së shumti në biseda midis miqve të ngushtë, në kontekste e situata jo formale, siç mund të jetë mjedisi në kampusin e universitetit, në kafene etj., duke diskutuar për tematika të ndryshme, qoftë për çështje të ndryshme që i shqetësojnë studentët apo edhe për mësimet e provimet, qoftë edhe për humor, pa ndonjë arsye të veçantë pse zgjidhet pikërisht ai variant i emrit, si: *Sançe* (<Wilson) apo *None* (<Erion) etj. Pra, zbulimi ka përhapje të madhe në emrat vetjakë dhe në gjuhën e folur, shfaqen trajta të dyta të emrave të njerëzve<sup>184</sup>.

Studiuesit Shkurtaç dhe Lloshi<sup>185</sup>, dallojnë disa arsye të përdorimit të zbulimit. Ato janë të shumta duke filluar që nga arsyeja për të krijuar afrimimet me dikë, e deri tek arsyeja e *modernizimit* të emrave të vjetër. Më poshtë paraqiten më të plota shkaqet e zbulimit, të ilustruara me shembuj përkatës, të cilët vërehen në ligjërimit bisedor të studentëve të Universitetit të Vlorës.

1. Një nga arsyet më të shpeshta të shkurtimit të emrave është *prirja për të mënjeluar dy emra të njëjtë brenda grupit shoqëror*. P.sh.: një studente me emrin *Fjoralda* tregon se asaj i thërrasin *Fjori*, meqë edhe një shoqe tjetër quhej po ashtu. Për të na dalluar, - vazhdon ajo, - me përkëdheli shokët dhe shoqet na thërrasin *Fjori* dhe *Alda*. Një rast tjetër, nga dy *Ermelinda* njëriës iu ndërrua emri në *Mela*, si zbulim. Po kështu, në një grup tjetër shoqëror, ku ishin dy vajza me emrin *Aida*, njëriës i thërrasin me mbiemër *Filaj*.

• Mjaft dendur zbulimet *përdoren për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë të shprehur*, si: *Ale* (<Aleksia), *Josi* (<Josana), *Dhuri* (<Dhurata), *Flo* (<Floriana), *Ani* (<Anxhela), *Lusi* (<Lusiana), *Bana* (<Albana), *Besa* (<Besiana), *Gerta* (<Eligerta), *Driti* (<Endrit ose Dritan), *Jona* (<Erjona), *Mira* (<Admira), *Leli* (<Aurela), *Eri* (<Eriselda), *Nando* (<Ferdinand), *Gleni* (<Mariglen), *Ina* (<Redinna), *Arbi* (<Miharb) etj.

<sup>184</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 264.

<sup>185</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 235.

Gjithashtu, nga anketimet rezultoi se disa emra kanë më shumë se një trajtë të dytë për shkurtime, si: *Mali* ose *Linda* për Majlinda, *Seldi* dhe *Ari* për Ariseld, *Mela* dhe *Linda* Ermelinda, *Dari* apo *Dario* për Darius, *Dora* dhe *Ida* për Doreida etj.

**3. Modernizimi i emrave të vjetër** është një arsye tjetër që haset jo rrallë në ligjërimin studentor dhe që gjen shprehje brenda grupeve shoqërore të ngushta. Edhe pse jetojmë në një kohë kur fenomeni i vendosjes së emrave të huaj apo modern është shumë i përhapur, sërish ekzistojnë shumë raste në të cilat familjarët kanë preferuar që fëmijëve të tyre t'u vendosin emra të mirëfilltë shqiptarë, duke zgjedhur edhe emra të vjetër, që mund t'i kenë pasur prindërit ose gjyshërit e tyre. P. sh.: një vajzë studentë e quanin *Salushe*, me iniciativën e vet vajzës për të modernizuar emrin e saj që i përkiste gjyshes së saj, dhe me mbështetjen e grupit të saj shoqëror, i thërrasin *Seli* ose *Lusi*, ndërsa familjarët e vajzës i thërrasin shkurt *Lushi*. Emra të tjerë të vjetër janë: *Gjyslyme*, *Hatixhe*, *Hava*, *Selvie*, *Fersilete*, *Mexhide*, *Rukie*, *Votime*, *Granit*, *Vesid*, *Zakie*, *Zoto*, *Shaban*, *Mine*, *Nevenka*, *Këze*, *Zyber*, *Festime*, *Hamit*, *Vebius*, *Sutë*, *Shaqo*, *Rezaije*, *Refat*, *Anife*, *Bajram*, *Bako*, *Vito*, *Hurma*, *Këze*, *Nurçe*, *Resmi*, *Shame*, *Kadrije*, *Vasiljan*, *Pavlo*, *Qamile*, *Fize*, *Magbule*, *Kudadeze* etj.

Shumë vajza, por edhe djem studentë, kanë emra të cilët bazohen në besëtytni, si ato mbi vdekjen, me dëshirën për të pasur trashëgimtarë meshkuj, pra, që në familje të mos lindin më vajza, por djem, mendimi për të larguar të keqen, dëshirën që fëmijët të kishin fat etj<sup>186</sup>. Për të ilustruar po sjellim disa shembuj emrash, si: *Fatbardha*, *Imir*, *Bukurie* apo *Bukuroshe*. Ndërsa disa vajza të tjera quhen *Mjaftime*, *Mjaftore*, *Mjaftoni*, *Pushime* ose *Mbarime*, duke qenë se në fisin e saj kishin lindur vetëm vajza, ndërsa ato vetë ishin vajza e katërt ose pesta në familje dhe prindërit kërkonin të kishin një djalë. Shoqëria e shkollës i thërret shkurt *Vera* apo *Mara*.

Gjithashtu, vëmë re, sidomos, te studentët që janë nga Jugu apo nga zona e Labërisë, se ata kanë emra shumë të çuditshëm, të cilët u janë vendosur, sepse në familjet e tyre ka ndodhur ndonjë fatkeqësi ditën apo kohën kur kanë lindur ata. Fatkeqësisht, këto lloj emrash i përkasin një moshe më të madhe dhe një brezi të vjetër, si: *Vakije* (ka lindur ditën e vdekjes së babait); *Dëshpërime* (ka lindur në ditë dëshpërimi, për shkak të vdekjes së kushëririt); *Ike* (ka lindur në momentin kur e ema i ka vdekur gjatë lindjes së saj); *Zijete* (midis zisë dhe jetës); *Zia* (ka lindur ditën kur i ka vdekur gjyshja); *Zinete* dhe i janë vendosur për shkak se kanë lindur në ditë zie.

Megjithatë, vëmë re se ka edhe raste të tilla kur studentët kanë emra që janë të vjetër, por të modifikur për të mos rënë shumë në sy si të tilla: *Pikrina* (modifikim i emrit Pikërrënë, vendosur për shkak të vdekjes së babait), *Deziana* (meqënëse ka lindur ditën që i ka vdekur babai, dy gërmat e para të emrit janë marrë nga emri i të atit, ndërsa pjesa tjetër e emritdo të thotë që është në zi).

---

<sup>186</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 167.

Dikur viheshin edhe emra që shprehnin lumturinë apo gëzimin e prindërve si: *Lumturi* apo *Gëzim* ose *Gëzime* (të kenë jetë të lumtur), *Sheqere* (të jetë e ëmbël gjatë gjithë jetës) apo *Drita* (t'u shkojë jeta dritë), *Jonis*, *Fillesa* apo *Nisjeta* (me kuptimin: nisi sërish jeta), *Ylvisa* (buron nga *Ylberë*), *Jemir* (për: qofsh i mirë dhe i mbarë), *Fatlinda*, *Fatjona*, emra të rinj këta që u vendosen fëmijëve të kenë fat gjatë gjithë jetës, ose *Agur* apo *Granit* (të ketë jetëgjatësinë sa të gurit); *Rrap* (të ketë jetëgjatësinë e një rrapit); *Mbarsim*, *Xhevairë* apo *Festime* (t'i shkojë jeta mbarë).

4. Arsye tjetër që ndikon fuqishëm për të zbuluar emrat, është ***afrimiteti që duan të krijojnë studentët me njëri-tjetrin*** si edhe kur janë anëtarë të të njëjtit grup shoqëror, p.sh., vajzën e lartpërmendur të quajtur *Salushe*, shoqet më të ngushta i thërrasin *Salo*, ndërsa anëtarët e tjerë të grupit shoqëror i thërrasin *Seli* ose *Lusi*, *Stela* për Yllka, *Nori* për Dashnor, *Ina* për Lesina.

Gjithashtu, denduria e zbulimit ka lidhje me prejardhjen etnike e krahinore të folësve<sup>187</sup>. Gjatë vëzhgimit të bisedave joformale, u vu re se mbaresat më të shpeshta që përdornin studentët për të krijuar variante të tjera të emrave vetjakë, janë mbaresat *-ush(ë)* apo *-ush(e)*, *-ushkë*<sup>188</sup>. Kjo mbaresë është tipike e zonës së jugut dhe ndoshta, se Universiteti "Ismail Qemali" ndodhet në qytetin e Vlorës, në jug të Shqipërisë, i krijon përparësi përdorimit dhe përhapjes së kësaj mbarese. Të tilla janë: *Jolushe* nga Jonida, *Nandushi* për Ferdinand, *Merushkë* për Merita, *Adushe* ose *Adushkë* për Adelajda, *Inushe* apo *Inushkë* për Ines etj.

5. ***Mashkullorizimi i emrave të vajzave*** si shprehje e zbulimit apo përkëdhelisë. Shpeshherë ndodh në mjedise shoqërore të ngushta, që disa vajzave t'u thërritet me emër të shkurtuar, sikur të ishte djalë, p.sh., *Dori* (<Doriana), *Luli* (<Luljeta), *Sidi* (<Sidiola), *Eri* (<Erigerta), *Klodi* (<Klodeta), *Sali* (<Saluema), *Soni* (<Sonila) etj.

Të gjithë shembujt ilustrues pasqyrojnë një dukuri me karakter shoqëror, i cili rezulton me ndryshime gjuhësore, duke i dhënë kësaj dukurie edhe karakter gjuhësor, e cila mbështetet dhe përkrahet nga disa rrethana që lindin nga strategjia e ligjëritimit. *Zbulimi nuk ndodh gjithmonë, por vetëm në rrethana të caktuara etnolinguistike, duke i dhënë kështu dukurisë së shkurtimit apo zgjatimit të emrave karakter etnolinguistik.* Duke ndjekur me imtësi rastet e ndryshme, u konstatua se zbulimet realizoheshin duke ndjekur një rregull të njohur: "*Kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë dhe në cilin varietet*".<sup>189</sup>

Pikërisht, duke qenë se studentët përjetojnë situata të ndryshme e të larmishme, si brenda dhe jashtë mjediseve universitare (konteksti i dytë ndikon akoma më tepër në forcimin e marrëdhënieve miqësore gjatë kohës që studentët vazhdojnë studimet në universitet), ndodh që një student të ketë jo vetëm një formë të shkurtër të emrit, por edhe më shumë dhe, sidomos, të dallueshme ndërmjet tyre pikërisht nga faktorët

<sup>187</sup> Shkurtaj, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 162.

<sup>188</sup> Shih po ai, po aty, f. 163.

<sup>189</sup> Caton, S. C., *Review of: Contributions of Roman Jakobson*, United States, 1987, f. 223-260.

shoqëror e miqësor. Kështu që, trajtat apo variantet e tjera të emrave vetjakë, në një farë mënyre edhe mund të rigrupoheshin sipas rastit<sup>190</sup>:

✚ *Shkurtime të mirëfillta*, forma e zbunimit mund të zbehet apo të mos shfaqet fare me kalimin e kohës.

✚ *Zbunim ose përkëdheli*.


✚ *Shkurtime apo riemërim*.

Nga vëzhgimet e kryera, por duke u bazuar edhe te pohimet e studentëve, mund të përgjithësohet se zbulimi nuk mund bëhet gjithmonë, p.sh., kur dikush është në humor të keq, ndihet tepër i lodhur nga dita e vështirë, është i shqetësuar për provimet apo notat etj.

Gjithashtu, zbulimi nuk mund të kryet as midis anëtarëve të një grupi të ngushtë shoqëror, kur ata ndodhen në situata serioze e formale, siç janë klasa, ora e mësimit, diskutimet apo bisedat formale me pedagogët, etj. Këto fjalë nuk përdoren me njerëz që i përkasin një statusi tjetër social, që janë më të mëdhenj në moshë apo me njerëz që konsiderohen antipatikë. Ndërsa, në situata të tjera, kur studentët kanë kaluar një ditë të qetë, janë në humor ose do të marrin pjesë në ndonjë “party” (festë), atëherë ata e thërrasin njëri-tjetrin me emra të shkurtuar apo me fjalë ose shprehje përkëdhëse. Pra, *zbunimi është realizimi konkret i një taktike ligjërimore, e cila buron prej një strategjie të ligjërimin dhe është pjesë e etnografisë së të folurit*<sup>191</sup>.

Fjalët përkëdhëse apo zbulimet përdoren më tepër në ligjërimin e folur, dhe hasen më dendur në ligjërimin e vajzave, ndërsa djemtë kanë fjalor zbulues më të kufizuar. Një pjesë e studentëve i konsiderojnë fjalët përkëdhëse si shprehje tipizuese të shoqërisë së tyre, disa të jetër si fjalë “hyrëse” në bisedë, e të tjerë pohojnë se “*kështu shprehen të gjithë ata njohin*”, dhe një pakicë, rreth 15 % shprehen se fjalët përkëdhëse kanë statusin e lajkave dhe i përdorin rrallë.

Analizimi i anketave nxori në pah se nga 400 studentë (235 vajza dhe 175 djem) të anketuar për këtë çështje, rreth 90% e vajzave studente dhe 70% e djemve studentë, përdornin zbulimet midis tyre dhe në familje.




**Figurë 4.1 Përdorimi i fjalëve përkëdhëse në bazë gjinie.**

<sup>190</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 270.

<sup>191</sup> Shih po ai, po aty, f. 273.

Por, duhet theksuar se (a) 90% e vajzave të anketuara përdornin dendur shkurttime emrash dhe fjalë përkëdhelëse si me vajzat dhe me djemtë, gjithmonë duke respektuar parimin e lartpërmendur; (b) 45% e tyre përdornin këtë lloj ligjërimi me gjininë e kundërt, pra djalë - vajzë; (c) vetëm 10% e djemve të anketuar përdornin fjalët përkëdhelëse djem me djem (d) 40% e djemve studentë përdornin variante të tjera të emrit, dhe (e) 30% u drejtoheshin njëri-tjetrit me nofka, pseudonime apo sharje dashamirëse për humor.



**Figurë 4. 2 Përqindja e përdorimit të fjalëve përkëdhelëse dhe elementeve të tjerë zbulues sipas gjinisë.**

#### **4. a. 2 Baby Talk**

Një dukuri relativisht e përhapur midis studentëve të Universitetit të Vlorës, është edhe e ashtuquajtura “Baby Talk” (shqip. *Gjuhë fëmijore*), qëllimi i së cilës është të shprehurit me përkëdheli. “Baby Talk” përdoret më dendur nga vajzat, rreth 56% e tyre përdornin gjuhën e fëmijëve në komunikimet intime ose personale me njëra-tjetrën, pra në situata tepër informale dhe deri në një farë mase jashtë temave të kontekstit shkollor.

Studentët u shprehën se e përdornin të folurin e fëmijëve për arsye të ndryshme, si p.sh., për:

✚ Për zbulim, duke krijuar variante të ndryshme të emrave të anëtarëve të shoqërisë së tyre, si p.sh: *Mila* për *Mira*, *Alta* për *Arta*,

✚ Për të krijuar e treguar afrimitet.

Ky lloj të foluri shprehet në dy forma: e para është *shkurtimi sipas shqiptimit fëmijor të emrit*, dhe e dyta është *shqiptimi i fjalëve të ndryshme ose fjalive sikur i thotë një fëmijë*. Shembuj të ndryshëm të këtyre dy kategorive janë:

➤ **Fjalë**, si: *xema*, *xhemla*, *xemël* për zemër, *pilti*, *spilti* për shpirti, *culunuke* për e vogël, *të kesën* për të keqen, *psh* për përse, *mosh* për mos, *pulush* për lepurush, *bocole* për bebe etj.

➤ *Shprehje*, si p.sh., *s'më pëcen për nuk më pëlqen; tha thua për çfarë thua; ade te lali për hajde te lali; aman o xhot ça e mil (Aman o Zot sa e mirë); Ça më ka mal mali pël ty* është e folura fëminore që në gjuhën e të rriturve “përkthehet”: *Sa ma ka marrë malli për ty!; Ku içe për Ku ishe?; të tam çum xhan për të kam shumë xhan; je bël cum e butul për Je bërë shumë e bukur* etj.

#### 4. a. 3 Nofkat

Shpesh studentët përdorin edhe emra të dytë apo “nofka” nga më të çuditshmet, një pjesë e të cilave e kanë burimin te format e tyre përkëdhelëse apo zbuluese, si ata që janë përmendur më lart, por ka edhe mjaft nofka të tjera që nuk kanë asnjë farë lidhjeje, as me emrin e parë, as me ndonjë rrethanë zbuluese. P.sh.: *la pupe* i thërrasin një vajze që është e bukur dhe e përkëdhelur.

Një studente tregon se pedagogen e Kriminalistikës e thërrasin me nofkën “*nazistja*”, sepse është tepër e rreptë. Shumë nofka vihen pa ndonjë motivim të qartë dhe po ashtu, ato harrohen me kalimin e moshës dhe të viteve, sidomos me ndërrimin e mjedisit përkatës kur studentët përfundojnë studimet dhe vendosen në vende të ndryshme pune, dhe më të shumtët nuk i ruajnë kontaktet midis tyre.

Nofkat, sikurse variantet e emrave vetjakë, me qëllim zbulimin, shprehjen e afrimitetit apo përkëdhelëse, shpeshherë krijohen nga një metaforë apo krahasim dashamirës apo për humor, duke iu referuar ndonjë tipari fizik ose moral të personit, si p.sh.: *skelet* i thërrasin një djali që është shumë i dobët. *Gomar* (jo i zgjuar) apo *Lopë* (e shëndoshë), janë etiketime negative dhe studentët u japin atyre kuptime të tilla, por në situata të caktuara informale dhe marrëdhënie shoqërore tepër të ngushta, këto nofka marrin ngjyrimë humorit dhe konsiderohen si të pranueshme nga të dyja palët. Po kështu, një vajze i thërrasin *zhgarravinë*, sepse nuk është e bukur.

Nofkat e përdorura në mjediset studentore shkollore vihen pa ndonjë motivim të qartë, po ashtu, edhe kalojnë e harrohen me kalimin e periudhës së studimeve<sup>192</sup>. Një vajze që është e shkurtër i flasin *Pëllumbeshë*, ndërsa një djali të urtë i thërrasin me përkëdheli, duke nënkuptuar edhe humor tallës: *i biri i Tetos*.

Të shumta janë edhe nofkat e konsideruara nga studentët si “të bukura”, të cilat kanë për qëllim përkëdhelëse, si: *zemra, pasha, ylli, shpirti, motra* (jug. bashkëbiseduesit nuk kanë lidhje gjaku, por përdoret për të treguar se dikush të ka shumë të afërt, tamam si motër) p.sh.: *hë shpirti; ylllo, ku ishe?; zemra ime; duhet theksuar se vajzat përdorin më tepër nofka të tilla si me djemtë dhe me njëra-tjetrën. Sikurse pohojnë shumë prej studentëve të anketuara “do të mendohesha dy herë në qoftë se do t'i thoja “shpirt” një shoku. Ndërkohë që është më e lehtë t'i drejtohesha*

---

<sup>192</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 200, f. 164-165.

me “shpirti” ose “zemra” shoqes, sepse vet marrëdhënia të bën të jesh më e lirshme me një shoqe dhe më e kufizuar me një shok”. Ndërsa djemtë përdorin më tepër fjalë të tilla me vajzat dhe në komunikimin midis tyre këto fjalë hasen rrallë ose janë të një natyre tjetër, sikurse pasqyrojnë shembujt: *erdhe rrushi* (vajzë-vajzë), *zemra ime* (djalë-vajzë), *ku jo o shoku, o njësh, Xhixh merimanga, O trim, shoku i Çimi etj* (djalë-djalë).

Një nga elementet që ndikon në rritjen e përdorimit të fjalëve përkëdhelëse në mjediset shoqërore, është televizioni. Shumë prej studentëve të anketuar dhanë shembuj (fjalë dhe shprehje përkëdhelëse) të përdorura në emisione dhe spektakle të ndryshme televizive, apo dhe reklama, si p.sh. duke iu referuar batutave të spektaklit të humorit “Portokalli”, reklama e AMC me “shokun e Çimit” etj.

#### **4. a. 3. 1 Roli dhe vendi i nofkave dhe fjalëve përkëdhelëse në ligjërimin gjinor**

Përdorimi i nofkave dhe i fjalëve përkëdhelëse i nënshtrohet edhe ndarjes gjinore. Etiketimet e përdorura nga vajzat dhe djemtë studentë janë të shumta por të ndryshme nga njëra - tjetra. Pothuaj të gjithë shembujt e mëposhtëm i përkasin ligjërimin të thjeshtë.

Një vajzë mund t’i drejtohet shoqes së saj me këto fjalë përkëdhelëse: *xhike, kokrre, bukurie, bandille, bubu, mamica, pilives, kinge, zogu, flori, mendjendritur, habibe, zymbyle, ylli, shpirti, zemër, motra, hanko, bejbi, embëlsirë, xemile sweet, dashuria ime, putuqe, piti, çupke, graria, ëngjëll, o kalama, sneksi, rrushi, zonjë, bebu, trendi, amore, kukull.*

Gjithashtu, një vajzë përdor këto fjalë e shprehje për shokun apo të dashurin: *shoku, i imi, ai, shpirti im, jeta ime, mashkulli im, o jetë, bf-ja, I dashuri, dashnori, shauma ime, amshori, burri, zemra, arushi, lepurushi, dudushi, darling, bejbi, dashuria ime, bandilli, majmuni, shejtani, çuni im, çyryku im, gjysma ime, ëngjëlli im, shpirti binjak, kollona, puçi.*

Në ligjërimin mashkullor, etiketimet apo nofkat, gjithashtu kategorizohen si pozitive, por nuk mungojnë edhe ngjyrimet negative në komunikimet me njëri – tjetrin: *fakir, shoku, I goditur, çun mamaje,-gollak, qofte, qeveri, I vrar, trung, shifër, tap, I lodhur, pipistrelo, smirllëk, kungull, naçu, i mangët, kastravec, kungull, o qen, parazit, o mostrë, guak, derr, dudum, llapanjoz, zhigolo, o gallatë, karafil, spatë, karagjozllëk, burgaxhi, plako, lal, vlla, loku, stramacon, xhengo, o noku, vernoz, luvgat, binar, bos, I-sh, mbret, bukuran, matrapaz, penallti, katerfenërsh, o motra, pashallëk, baba, bob, shef, gjigand, malok, zenun, shejtan, mumje, o vip, poligon, o njeri.*


Ndërsa, një djalë i drejtohet kështu shoqes apo të dashurës: *femra ime, amorja, bukuroshja ime, gjineka ime, maj fijonse, e dashura, dashnorja, zemra, shpirti,*

lepurushja, arushja, gruaja, goca ime, bebuçe, vajza ime, budallacka ime, shushka ime, shtriga ime, dashuria ime, beb, princesha, ylli zemrës, thatuqa ime, e shtrenjta ime, rrushi, nuçja, karamelja, jeta, ylli, drita.

Ilustrimet e mësipërme përdoren në situata joformale dhe në marrëdhënie të ngushta miqësore. Mund të ndodh që *fjalët përkëdhelëse mes një grupi shoqëror mund të keqkuptohen në publik nga të tjerët.*

Shumë prej vajzave dhe djemve, rreth 89 %, pohuan se ky lloj keqkuptimi nuk ka ndodhur, sepse edhe konteksti i përdorimit të tyre është informal dhe tepër shoqëror.

Megjithatë, kishte edhe nga ata studentë, 11 %, që u përgjigjën “po”.



**Figurë 4. 3 Përqindja e keqkuptimeve të nofkave apo fjalëve përkëdhelëse të përdorura në publik.**

Disa nofka kanë edhe motive profesionale apo të jetesës së personit, si: *pikaso, llulla* etj.

Të pyetur nëse fjalët përkëdhelëse bëhen aq të përdorshme sa mund të përdoren kudo dhe me këdo studentët e anketuar u shprehën se:

- *vajzat*: fjalët përkëdhelëse bëhen aq të përdorshme saqë fitojnë status të veçantë në ligjërimin e tyre. Sipas tyre, këto fjalë apo nofka janë të pashmangshme në jetën e tyre, në ambjentet publike, kafe, rrugë, në mjediset e jashtme të universitetit dhe më pak përdorim gjejnë në mjediset e brendshme të universitetit, sidomos gjatë pushimit midis orëve të mësimin.

- *djemtë*: shprehen se këto fjalë e shprehje përbëjnë një pjesë të fjalorit të tyre por nuk kanë ndonjë rëndësi apo status të veçantë ligjërimor. Ato hasen më së shumti në mjediset publike.

### **Si dhe sa përdoren nofkat në familje?**

Nga shembujt e dhënë për këtë pyetje vërejmë se ato janë më të pakta në numër dhe larmishmëri. Pothuajse të gjithë studentet e pyetura, paraqesin si nofka ose si fjalë përkëdhelëse emrat e shkurtër të prindërve ose fjalët *mamush, bushi, motrush* etj. Ndërsa djemtë listuan emrat e shkurtër të prindërve dhe termat *plaku, plaku, burazerka* (kjo fjalë haset më së shumti në krahinën e Labërisë).

## b. Sharjet dashamirëse

Ligjërimit studentor është mjaft i pasur edhe me elemente të figurshme, të cilat kategorizohen si “sharje dashamirëse”. Kjo dukuri gjen përhapje të gjerë në ligjërimitin bisedor të studentëve të Universitetit të Vlorës. Ajo konsiderohet si shprehje e përkëdhelisë ndaj miqve të ngushtë. Ndodh që trajtat e dyta të emrit të marrin përdorim më të gjerë dhe të dalin nga grupi i ngushtë shoqëror, duke u përdorur kështu edhe nga persona me të cilët nuk kemi lidhje të ngushtë shoqërore.

Megjithatë, sharjet dashamirëse ose “nofkat” jo gjithmonë janë të pëlqyeshme ose të pranueshme nga ata të cilëve u vihen. Janë jo të pakta rastet që dikush i thërret një shoku ose shoqeje duke përdorur nofka të ndryshme me qëllim që ta inatosi. Një mënyrë e tillë “të përkëdheluri” për ironi ose tallje është e lidhur me strategjinë e ligjërimit.

Gjithashtu, në rrethin e sharjeve dashamirëse ose përkëdhelëse mund të përfshihen edhe *pseudomallkimet*, me qëllim që të krijohen situata humori, për të tallur dikë etj<sup>193</sup>. Le të paraqesim me shembuj konkret situatat e lartpërmendura.

✚ *Sharjet dashamirëse si nofka zbuuese,*

✚ *Nofka “përkëdhelëse” ironike,*

✚ *Pseudomallkimet,*

i. *Për humor*

ii. *Për të tallur*

Disa prej elementeve dhe shembujve, që u hasën në kategorinë e lartpërmendur, gjenden edhe në këto nën-ndarje:

Tabela 4. 1 Sharjet dashamirëse që përdoren brenda mjedisve universitare (jashtë auditorit).

|  | Në mjediset e universitetit (jashtë auditorit)  |   |
|--|---|---|
|  | <u>Për vajzat</u>   | <u>Për djemtë</u>   |
| <b>Etiketime të ndryshme në lidhje me karakterin ose veprimin, zgjuarsinë dhe paraqitjen e jashtme</b> | <i>Kafshë, majmune, dhia, pilivesa<br/>Shtrigë, mizerje, hajdute, kopjace, e poshtër<br/>budallaqe, daune, shushkë, je me probleme,</i> | <i>dele rudë<br/>Fshatar, mizerje, i poshtër, sorollatës<br/>Budalla, Mostër, veshuk, karrabush, o robo, budalla i lindur, i prapambetur,</i> |

<sup>193</sup> Shkurtaç, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 164.

Ma. Dorian Klossi

|  |   |  |
|--|---|--|
|  | <i>Shëmtira, shtrigë,<br/>kokboshe, e lajthitur,<br/>kopjace,</i> | <i>majmun, djalë i mirë i mamit,<br/>inJORANT i ditur, gogoli,<br/>solloratës,</i> |
|--|---|--|

Gjithashtu, janë të shumta fjalët dhe shprehjet që studentët mundohen t’i përdorin jashtë mjediseve universitare. Ndonëse një pjesë e leksikut studentor pretendohej të përdoret vetëm jashtë këtyre mjedis, vëzhgimet e kryera pohuan se shumë prej këtyre fjalëve dhe shprehjeve, dhe jo vetëm, përdoren dendur brenda mjediseve universitare, duke lënë mënjanë auditorët.

**Tabela 4.2 Sharjet dashamirëse që përdoren jashtë mjediseve universitare.**

| <b>Mjediset jashtë universitetit</b>  |   |
|---|---|
| <u>Për vajzat</u>   | <u>Për djemtë</u>   |
| <i>Ik moj pulë, më plase, Fjona (marë nga filmi vizatimor Shrek), e shëmtuar, zhulse, shejtane, Mavri, shushudake, Ema Bovari, “Menekshe” Idiote Pipiricka, zhulse,</i> | <i>Buf, laro, trangull, shoko, Nasho, ku je ti djali: a ke gjujt ndonjë femër sot, të rëntë dreqi, gjyshi i shtëpisë, vandal, rob Zoti, trake, çyryk, të hëngërt dheri, Don zhuan legena, idiot, Zhuls,</i> |

Pothuaj në të gjithë shembujt e lartpërmendur shfaqen ngjyrimet subjektive që lindin nga marrëdhënia vetjake e ligjëruesit me bashkëbiseduesin. Në shumë raste, të ashtuquajtura *sharje dashamirëse*, të përdorura në kontekstin shoqëror, kanë statusin e fjalëve përkëdhelëse. Në qoftë se, këto sharje dashamirëse përdoren jashtë kontekstit shoqëror e humoristik, ato do të shfaqnin kuptim keqësues (pezhorativ), si p.sh. *budallaçkë, qyqe, shtrigë, djall etj.* Pra, emocionet, vlerësimet e qëndrimet e atij që flet lënë gjurmë në fjalët dhe shprehjet që përdoren<sup>194</sup>.

Çdo fjalë përkëdhelëse ka konotacionet e saj dhe ngjyrimet kuptimore varen më së shumti nga situatat ose kontekstet gjuhësore e sociale. Shumë prej studentëve të anketuar pohuan se përdorimi i fjalëve të kësaj kategorie është i rëndësishëm në komunikimin që realizohet në grupin e tyre shoqëror por edhe jashtë tij.

*Sharjet dashamirëse* kategorizohen edhe sipas përkatësisë gjinore. Vajzat dhe djemtë përdorin fjalë dhe shprehje të ndryshme me funksionin e sharjeve dashamirëse. Le të përmendim disa prej tyre:

<sup>194</sup> ShkurtaJ, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 27.

Sharje dashamirëse të përdorura nga femrat: *Shushkë, shtrigë, zogu Tunës, trupeshk, trutharë, o kungull, fshatare, ngele gdhë, gthithe jetës, rrosapie, malok, bitch, dhi, dhi e zgjebosur, e ngordhur, mashtruese, leshe, e lodhur, i/e injorante, lezbike, idiote, i/e trashë, homo, o kafshë, rob i trashs, rob i leshts, llapush/e, lolo, debil/e, i/e mangst, gomar/e, fyçkë, qofte, buf/e, buçe, pilivese, budalla, budallaçkë, i/e çmendur, kokëbosh/e, kurvickë, shpifësirë e vogël, dele, lopë, nepërkë me dy koka, zhapik me tuta sportive, kaleshe, UFO, shushkamen/e, histerike, zgjebe, e pështirë, kok-palarë, vrromë, katunare, leshe, trutharë, mashtruse, gaforre, laraskë, buçe, tutkune, harixheshk, e trashë, lumadhe, mumje, shimpaze, fshatare, dele, o lagja, injorante, gjysmake, shushkë, lezbike dreqit, majmune, budallaqe, kurvë, matufe, biligaçe, qyqe, debile, qife, smirushe, kancer, bitç, duçe, kuçedër, bishtpërdredhur, karagjoze, bombë, lopë etj.*

Sharjet dashamirëse të përdorura nga meshkujt: *O pall, o pikëpyetje, legen, trap, pederast, i/e shuar, matuf/e, gjysmak, pallosh, mashtrues/e, leshko, pusht, servile, çerr, spatë, kafshë, hundëmadh, kokëmadh, llapush, o i/e vrrarë, smirush, o dru, bundër, qoftë, parazit, gomar, lolo, injorant, debil me patentë, çun mami, spiun, të fala plakës, drogaxhi, mallist, gomar, lyrash, pisllek, servil, pervers, plesht, o mëz, pede, gdhë, çyryk, gjysmak, kafkë, barbon, pall, trap, legen, madha faka, llosh, zall, k\_r, laro, drogë, gazep, molomen, kërrnasht, taverrec, leshko, budall, drrasë, lamash, pusht, gei, lezbik, injorant, pykë, trupeshk, debil, Karagjoz, o lumadh, o kafshë, kokqyp, demode, i trashë.*

Sikurse vërehet nga shembujt e mësipërm, një pjesë e konsiderueshme e lëndës së mbledhur i përket ligjërimit të shkujdesur.

Ndonëse ka ndryshime të dukshme leksikore midis dy kategorive, ndodh që shprehjet ose sharjet dashamirëse të përdoren nga të dyja gjinitë. Fakt është se meshkujt kanë një përdorim më të madh të fjalorit me fjalë vulgare. Një femër mund të thotë “*e trashë*” por meshkujt përdorin një fjalë më të rëndë me shokët e tyre, ata mund t’i drejtohen shokut të tyre me fjalën vulgare “*pallë*” por shoku i tij nuk e keqkupton këtë sharje sepse ajo është mënyra e të drejtuarit që kanë zgjedhur në grupin e tyre shoqëror. Është i pamohueshëm fakti që përdorimet më të shumta të sharjeve dashamirëse vijnë nga gjinia femërore, vajzat kanë kaq shumë shprehje dhe sharje të tilla që i përdorin me shoqërinë e tyre në mjedise të ndryshme. Një vajzë mund të drejtojë këtë fjalë shoqes së saj : “*idiote*”, por një djalë shokut të tij do i drejtohej me këtë shprehje: “*trap*”, e cila është më e rëndë. Nëqoftëse një vajzë do thoshte “*shushkë / shushkamen*”, një djalë do përdorte shprehjen “*pall*”. Një nga ato shprehjet shumë vulgare që një vajzë do mund të përdorte do ishte “*buçe*”, një djalë në këtë rast do thoshte “*baxhellë*” ose “*bundër*”. Ekzistojnë raste të shumta kur djemtë dhe vajzat mund të përdorin të njëjta shprehje për t’ju drejtuar dikujt që bën pjesë në rrethin e tyre shoqëror. Disa nga shprehjet që janë të njëjta dhe që përdoren nga të dyja palët janë këto: *o fshatar/e, zogu i Tunës, debil/e, idiot/e, i/e ngordhur, o*

*mashtrues/e, leshe/leshko, o i/e lodhur, rob i trashë, llapush/e, bitch, lezbike / gei, gomar/e, i/e mangët, qofte, çerr/e, buf/e, karagjoz/e.*

Pra, këto shprehje ose sharje janë thjesht fjalë dashamirëse që individët përdorin në rrethin e tyre të ngushtë shoqëror sepse nuk mund ti përdorin këto sharje me njerëz që kemi pak marrëdhënie apo nuk i njohim, sepse mund të ndodhin keqkuptime, kur personat në fjalë mund të ndihen të ofenduar, edhe pse qëllimi ynë nuk ka qenë t'i bëjnë ata të ndihen keq. Qëllimi i këtyre shprehjeve është shprehja e afrimitet me personat të cilëve u referohen me këto lloje sharjesh dashamirëse. Sipas shembujve të marrë në konsideratë del në pah *konkluzioni*, meshkujt përdorin shprehje me vulgare dhe femrat përdorin një numër më të lartë të sharjeve dashamirëse. Pra sharjet dashamirëse të përdorura nga vajzat janë më të shumta në numër dhe më të shumëllojshme.

Megjithatë, ndryshimet e shumta në sjelljen sociale të anëtarëve të grupeve të ndryshme, vajzave apo djemve, vërtetuan se përdorimi i fjalëve përkëdhelëse tregon pak ose asgjë për vërtetësinë e miqësisë<sup>195</sup>. Ndërsa në rastin e antipative, përdorimi i nofkave është i shumëllojshëm dhe shpeshherë qesharak. Ndonëse, fjalët përkëdhelëse janë më së shumti të ndjera, ka edhe shumë raste kur përdoren si ironi, apo janë të shtirura. Emocioni lë gjurmë në mënyrën e të shprehurit, sidomos intonacioni pasqyron ngjyrimin leksikor që merr fjala ose shprehja në kontekste të caktuara.

### **Përfundime**

Mund të shprehem se taktikat e ligjërit bisedor të studentëve janë element i rëndësishëm i ligjërit të thjeshtë, sidomos te vajzat. Ato janë sinonim i një të foluri joformal dhe shoqëror. Sikurse pohojnë shumë prej studentëve, komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore do të ishte e “ftohtë” pa përdorimin e këtyre fjalëve dhe shprehjeve.

Gjithashtu, mënyrat më të përdorura për realizimin e zbulimit janë përdorimi i prapashësive të zvogëlimit e të përkëdhelës, apo shkurtimi i emrave me anën e sinkopimeve, apokopimeve<sup>196</sup> apo procedurave të përziera: shkurtim dhe prapashësim apo riemërim, gjithmonë në kuadër të përkëdhelës apo përdorimi i nofkave ose riemërimeve pa lidhje a ngjashmëri tingullore me trajtën e emrit zyrtar<sup>197</sup>.

Studiues të ndryshëm shqiptarë, si Lloshi dhe Shkurtaç<sup>198</sup> etj., kanë paraqitur disa nga motivet e përdorimit të këtyre dukurive, sidomos të zbulimit:

---

<sup>195</sup>Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 160-161.

<sup>196</sup>Shih po ai, po aty, f. 264.

<sup>197</sup> Shih po ai, po aty, f. 270.

<sup>198</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 273.

1. Shmangia e emrave të gjatë apo të vështirë për t'u shqiptuar në të folurin e shpejtë.

2. Mënjanimi i dy emrave vetjak të njëjtë brenda grupit shoqëror. Zbukurimi apo riemërimi i emrave që bazohen në bestytini të ndryshme.

3. Riemërimi në rastet e përdorimit të emrave të vjetër ose bazuar në bestytini të ndryshme prej të cilave burojnë një sërë emrash përçmues e keqësues për vajzat, por edhe për djemtë.

4. Mashkullorizim i emrave për përkëdheli (duke u bazuar thjesht në shkurtim apo cilësi e personit<sup>199</sup>). Gjatë procesit të zbulimit të emrave përdoren dendur edhe nofkat apo sharjet dashamirëse.

Si rezultat, duke u bazuar në trajtimin e mësipërm mund të nxjerrim këto përfundime:

(a) Emrat vetjakë mund të kenë më shumë se trajtën zyrtare ose dhe ndodh që trajtat e dyta kthehen në trajtën kryesore të identifikimit të personit. Ky zëvendësim i trajtës së parë me trajtën e dytë ndodh vetëm në situatat joformale dhe mjediset tepër familjare, duke nxjerrë në pah anën subjektive të folësit dhe marrëdhëniet që ekzistojnë midis bashkëbiseduesve.

(b) Mund të ndodh që trajtat e dyta të emrave vetjak të mos kenë asnjë lidhje me trajtat e para. Krijimi i tyre bazohet në motivet jashtëgjuhësore<sup>200</sup>.

(c) Krijimi i trajtave të dyta të emrave vetjak të krijuara me prapashtesa.

(d) Trajta të dyta që vijnë nga shkurtimi i trajtave të para pa ndonjë ndërrim tjetër tingullor:

a. Trajta të dyta të dala vetëm nga pjesa e parë e trajtës së parë që është shkurtuar: *Albi* nga *Albana*, *Besi* nga *Besion*, *Dori* nga *Doriana* apo *Dorina*, *Luli* nga *Lulzim*, *Edi* nga *Eduard*, *Elti* nga *Elton*, *Petro* nga *Petrin*, *Juli* nga *Juliana*, *Elvi* nga *Elvira*, *Genta* nga *Gentiana*, *Ada* nga *Adelajda* etj.

b. Trajta të dala nga pjesa fundore e trajtës së parë që është shkurtuar: *Toni* nga *Elton*, *Neli* nga *Daniel*, *Mali* nga *Ermal*, *Gysi* nga *Ergys*, *Ina* nga *Albina*, *Ada* nga *Suada* etj.

c. Trajta të dyta të përfutuara nëpërmjet cungimeve dhe ndërrimeve të ndryshme tingullore<sup>201</sup>. Në këtë kategori ndodh “modernizimi” i emrave të tillë, si: *Kozi* nga *Këze*, *Seli*, *Lushi*, *Salo* për *Salushe*, *Meri* nga *Mereme*, e kështu me radhë për *Zije*, *Vakije*, *Manushaqe* etj.

---

<sup>199</sup> Shkurtaj Gj. *Sociolinguistika*. Botimet Toena. Tiranë 2005 f. 273.

<sup>200</sup> Shih, po ai, po aty., f. 280.

<sup>201</sup> Shih, po ai, po aty, f. 297.

Të pyetur *për perceptimin e tyre se cila gjini përdor më tepër zbunimet, nofkat dhe përkëdhelitë*, vajzat dhe djemtë u përgjigjën kështu: vajzat përdorin më tepër këtë lloj të foluri, ndoshta prej natyrës së tyre, që janë më të dashura, më të brishta e më të lirshme në të shprehur, si dhe më romantike në këtë drejtim. Me njëra-tjetrën ato përdorin emrat e shkurtër, gjithashtu, edhe mjaft fjalë përkëdhelëse, si: *ylli, zemra, rrushi, shpirti etj*; ndërsa me djemtë ato përdorin *gënjeshtar i vogël, dembel, zemra ime, lepurushi, lali, o flori, shpirti, shoku, manki* (nga ang < Monkey, shqip. < majmun), *i poshtër, palace, noku, kururosh, William Levi, zemla e logël, shejtan, ore dreq, pupushi im, o zogu, bufi, ore ndyrësisë apo qelbësirë* me dialekt vlonjat. Megjithatë, ka disa raste kur vajzat nuk lënë përshtypje të mirë gjatë përdorimit të këtyre fjalëve, sidomos tek djemtë. Ata mund të tallen ose i ripërdorin me ironi fjalët e një vajze kur ajo thotë: *O rrushi, zogu etj*.

Ndërsa, për **përshtypjet që lënë djemtë kur përdorin fjalë të tilla** vajzat dhe djemtë e anketuar shprehin mendime të ndryshme:

--vajzat: pohojnë se nëse midis bashkëbiseduesve të përfshirë në ligjërime ekzistojnë marrëdhënie të mira shoqërore, atëherë nuk përbën ndonjë pengesë ose keqkuptim përdorimi i fjalëve të tilla të cilat konsiderohen si “fjalë shoqërore” në këtë kontekst. Por, në kushtet e një shoqërie vetëm formale përdorimi i këtyre fjalëve do të shkaktonte keqkuptim në komunikim dhe si rezultat vajzat krijojnë opinion jo të mirë për bashkëbiseduesin.

-djemtë: shprehin se ata djem që përdorin në mënyrë të tepruar fjalët përkëdhelëse, nofkat dhe sharjet dashamirëse me vajzat, konsiderohen si “don zhuan”, që duan me patjetër të duken përpara vajzave ose edhe si “ngacmues me klas” p.sh. *do mi japësh mua ata sytë e bukur, kjo më lë pas mbi tokë, zëri i bukur, ta du zemrën etj*.

Për të kuptuar rëndësinë e këtyre fjalëve studentëve iu kërkua që për një ditë të mos përdornin fjalë të tilla me askënd dhe në asnjë vend. Rezultati i pohuar prej 97 % e studentëve ishte i pritshëm. Pothuaj të gjithë e kishin të pamundur shmangien e termave të tillë, si shkurtimin e emrave, përdorimin e nofkave, sharjeve dashamirëse dhe fjalëve përkëdhelëse. Shumë u shprehën se e kishin të pamundur të mos përdornin fjalë e shprehje të tilla, kjo vjen edhe për shkak të rutinës së tyre ligjërimore, sepse bashkëbiseduesit e tyre i përdorin këto fjalë, si dhe këto mënyra të shprehjes janë tipar i grupit të tyre shoqëror.

Hetimet dhe hulumtimet e kryera në bashkësinë shoqërore të studentëve, dhe përkatësisht në grupet e ngushta shoqërore nxorën në pah shembuj të shumtë të të dukurisë së zbunimit dhe taktikave të tjera ligjërimore, të cilat përdoren si shprehje e qëndrimit subjektiv të folësit ndaj një shoku / shoqeje të afërt.

### **c. Zhargoni studentor vlonjat**

Në sociolinguistikën evropiane e më gjerë janë realizuar një sërë studimesh kushtuar zhargoneve të studentëve, ku mund të përmenden: studimet e Teresa e William Labov *Social and language boundaries among adolesencts*, 1992, H. T. Webster, J. *Some notes on old underground slang, College english*, 1943, Louis Kuethe *Unconventional english, American Speech Journal*, 1937, Jonathan Lighter *Is slang a ëord for linguists*, 1978 Harold W. Bentley *Slang today and yesterday: Dictionary of american slang; Slang, phrase and idiom in colloquial english and their use*, 1935. Ndërsa në sociolinguistikën shqiptare janë të pakta punimet e gjuhëtarëve tanë në këtë drejtim, megjithatë, mund të përmendim kontributin e vyer të prof. Gjovalin Shkurtaj, *Në gjurmët e zhargonit studentor*, Tiranë, 2004.

Zhargonet e studentëve kanë rëndësinë e tyre, sepse përbëjnë një pjesë të gjuhës. Sipas Shkurtaj (2004:213), të rinjtë e universiteteve kanë pasur dhe kanë disa tipare ligjërimore të tyre, që janë emërtuar si një lloj i veçantë i të folurit apo si “zhargoni studentor”<sup>202</sup>. Ky lloj të foluri synon të krijojë një “kod” të posaçëm shprehjeje midis anëtarëve të rrethit studentor. Vlen për t’u theksuar se pasi studentët përfundojnë studimet e larta dhe shkëpusin lidhjet me shoqërinë e universitetit, ata i mënjanojnë fjalët dhe shprehjet tipike që përdorimin më parë<sup>203</sup>.

Ky lloj komunikimi midis studentëve përdoret më së shumti kur nuk janë të pranishme raportet formale, të hierarkizuara në ndonjë mënyrë<sup>204</sup>. Pra, është në përdorim një ligjërim që e siguron komunikimin e drejtpërdrejtë gjatë bisedave të ndryshme, i cili më së shumti karakterizohet nga tiparet e ligjërimit bisedor, por nuk janë të pakta rastet ku biseda mbizotërohet edhe nga tipare të ligjërimit të lirë apo të shkujdesur.

Ligjërimi bisedor është varianti që merr standardi kur përdoret në të folur e në biseda të lira, kur norma nuk ruhet plotësisht, por u nënshtrohet ndryshimeve që kërkojnë rrethanat e fushat e marrëveshjes gjuhësore, formimi kulturor i folësit, vetë lloji i ligjërimit ose synimet stilistike

Meqenëse forma themelore e komunikimit të zhargonit studentor është dialogu i drejtpërdrejtë dhe i njëkohshëm, atëherë kumtimi gojor midis studentëve merr natyrë bisedore<sup>205</sup>. Ky tipar theksohet më tepër nga numri i vogël i pjesëmarrësve në bisedë.

<sup>202</sup> Fjala *zhargon* rrjedh prej gjuhës frënge që do të thotë edhe të folur popullor. Kjo fjalë daton nga shek. XI. Është një “gjuhë” jointelektuale, e çuditshme ose edhe gjuhë apo dialekt barbar, hibrid, dialekt i thjeshtësuar në fjalor e gramatikë dhe i përdorur për komunikim në mes njerëzve të ndryshëm.

<sup>203</sup> Shkurtaj, GJ., *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2005, f. 211.

<sup>204</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 160-161.

<sup>205</sup> Po aty, f. 162-163

Sipas Prof. Lloshit: “Bashkëbiseduesit mbështeten në mjedisin përreth, në situatën e krijuar dhe në përvojën e përbashkët.” Përveç tipareve gjuhësore, zhargoni studentor plotësohet edhe me mjete ndihmëse të komunikimit, siç janë elementet paragjuhësore, si: gjestet, mimika, intonacioni, toni i zërit, etj.

#### 4. c. 1 Tipare leksikore

##### të zhargonit studentor në Universitetin “Ismail Qemali”

Më poshtë paraqiten disa vëzhgime rreth ligjërimit studentor, duke parashtruar disa tipare të përgjithshme të “zhargonit studentor” :

1. Një pjesë mjaft e madhe e zhargonit studentor përbëhet nga metaforat e perifrizat e figurshme për **profesorët**, duke nisur me shkurtime *prof* “profesor”. Në këtë çështje të parë vihet re se ligjërimet e studentët e universitetit të Vlorës dhe të Tiranës kanë të përbashkët nofkat, etiketimet për tiparet fizike e cilësitë morale të pedagogëve<sup>206</sup>.

Duke vazhduar me **nofkat** e shumta për ta duke u bazuar **në lëndët** që ata japin mësim, si p.sh.: *Zoti Mesjeta apo historiani* (pedagogu i historisë); *erdhi vdekja* (pedagogu i bio-etikës); *doktor Adhamudhi* (pedagogu i histori-mjeksisë); *anatomistja* (pedagogia e biologjisë); *ndrikulla, miss letërsia, shkencëtari i letërsisë, tregimtarja, poetja e shkollës* (pedagogu/ia e letërsisë) dhe *bebisiteri* (pedagogia e letërsisë për fëmijë); *gjuhëtari, morfologjia, zanorja apo Pedagogu i gojës* (për pedagogun e gjuhës shqipe); *erdhi Kanti ose Oratori* (pedagogu i Filozofisë); *psikopatologi, e çmendura, psikologia e shkalluar, pedagogu i mendjes ose edukatori i studentëve* (pedagogët e psikologjisë); *Anormalja apo aftësia* (pedagogia e Tipet e handikapit); *Mendjendrituri, Anjshtanji, Pitagora, teorema, i godituri nga Zoti apo i zgjuari i shkollës apo ferri* (për pedagogët që japin matematikë); *erdhi ky gjuhëtari* (pedagogu i gjuhës shqipe); *i edukuari, Qytetari i nderit, Bilbili i shkollës apo pasqyra e të ardhmes* (për pedagogun e edukatës qytetari); *piktori, duararti, skulptura, peneli, bojaxhiu, Pikaso ose artisti i shkollës apo artisti i Vlorës* (pedagogu i edukimit artistik); *Ja e drejta e robit* (për pedagogun që jep lëndën E drejta e njeriut); *pedagogia e jashtme ose krem karameli* (pedagogia e gjuhës angleze).

Të shumta janë edhe “poezitë e shkurtra” që përdoren me humor apo ironi për pedagogët duke i ngjitur atyre tipare të lëndëve që japin mësim gërshetuar me tiparet fizike apo të aftësive profesionale.

Një grup studentësh të degës së Parashkollorit, viti i parë i studimit, moshë 20-26 vjeç, shprehen kështu:

<sup>206</sup> Shkurta, GJ. , *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2005, f. 212-213.

Lënda Handikap: “*Ja ku po vjen handikapja-topolakja*  
*Sytë ngjyrë lakra.*”

Lënda Psikologji: “*Presorja e psikologjisë vetëm na hipnotizon*  
*Sa hyn ajo në klasë,*  
*Mendja vetëm për gjumë n’a shkon.*”

Lënda Gjuhë: “*Si ajo nuk ka në botë,*  
*Gjuhë flet e gjuhë thotë,*  
*Standarden e qan me lot,*  
*Një fjali s’e ngatërron dot.*”

Lënda Matematik: “*Profesor Matematika, nji, e dy, e tri,*  
*Djalë i bukur, djalë i ri,*  
*Orën e mësimit,*  
*E bën lëmsh e li*”

Lënda e edukatës qytetare: “*Edukata, presori thotë, për çdo gjë ju ndihmon,*  
*Ai pyet e pyet e pyet, por ka një problem,*  
*Për çdo gjë përgjigjet vetë.*”

Lënda Anglisht: “*Presore e anglishtes shumë e edukuar dhe e brishtë,*  
*Por qetësisht, jua bën rrup-sup të gjithëve,*  
*Pa dallim moshe, seksi.*”

Lënda Letërsi për fëmijë: “*Për sa kohë ti je e mirë,*  
*Letërsia është yll me bisht,*  
*Por sa herë që ti ndryshon,*  
*Letërsia na shkallon.*”

Lënda Edukim artistik: “*E bukur si vet emri, e lehtë dhe tërheqëse,*  
*Por presori bën si i vështirë,*  
*Në fund del se është shumë i mirë.*”

Të shumta janë edhe **shprehjet ironizuese për pedagogët e ndryshëm**, si p.sh: *Është bërë pishman që ka lerë* (kur pedagogu flet ngadalë, me përtesë); *erdhi ajo që ha gazeta ose papagalli* (flet shumë); *tani do dëgjojmë RD apo na i thartoi trutë me zor* (kur pedagogu fillon e bëhet i mërzitshëm me ato që thotë); *më në fund mësoi edhe Shimpazeja të flasë* (jo fort e bukur si paraqitje dhe e pakuptueshme kur flet); *këtij i ka vdek berberi* (model flokësh i çuditshëm); *erdhi kjo bisha, hajt ta dëgjosh*

tani!, *Obobooo*, kemi një orë me këtë shtrigën! (kur pedagogia është tepër e rreptë dhe jotolerante); *delikatja* (i thonë një pedagogeje që flet me kujdes dhe me gjeste të theksuara femërore); *teacher embëlsia* (për një pedagoge që është e afrueshme dhe e hapur me ata); *3D-ja* (i thonë një pedagogu që është i mirë informuar për të rejat e fundit teknologjike); *e gjithëditura* (i thonë një pedagogu që është i gjithanshëm, por ndoshta në mënyrë edhe ironike kur pedagogu nuk është kompetent në lëndën e vet); *idhulli im i gramatikës* (për pedagogen e gramatikës); *sot kemi mësim me Kuçedrën e Fizikës* (për mësuesen e fizikës); *greku* (pedagog që flet me theks grek).

Një studente e gjuhës angleze tregon se njërit nga pedagogëve ia kanë vënë nofkën ironizuese *Sandër mafishja*, *i biri i tetos*, emri i personazhit të komedisë së njohur “Pallati 176”, sepse pedagogu në pamje të parë krijonte përshtypjen e një njeriu të urtë e të qetë, por në të vërtetë është i rreptë dhe ironik. Po ajo tregon se një pedagogu tjetër ia kanë vënë emrin *Hitleri apo Diktatori*, pasi është shumë i rreptë, ndërsa një tjetri *Londinezi*, sepse ka studiuar në Londër dhe herë pas herë flet me pasion për eksperiencën e tij atje. Ndërsa, dy pedagogoet e metodikës i thërrasin *Borëbardha* (me kuptimin e kundërt, sepse është tepër ezmere) dhe *modelistja* (me ironi sepse mundohet të vishet bukur sipas modës por duket si adoleshente); *ai edhe në gjumë fle me kollaro* (sepse pedagogu mban gjithmonë kollaro).

Ndërsa pedagoges së gjuhës shqipe, një grup studentësh të degës së pedagogjisë i thërrasin *Mësuesja e njerëzve të ardhshëm e të kulturuar*, duke iu referuar lëndës së gjuhës shqipe, ndërsa *Edukatorja e të pabindurve* apo *Bukuroshja e fjetur*, thërritet pedagogia e Letërsisë; *Skërfyelli* ose *Kallami* i gjatë, janë shprehjet për humor për pedagogun e letërsisë; *Vibrantja*, është një tjetër etiketim për pedagogen e letërsisë për fëmijë sepse lëviz shumë kur shpjegon mësimin.

Një student i degës së Juridikut tregon se në grupin shoqëror të tij përdorin këto nofka për pedagogët: *Drakula* apo *Nëna e Shtrigës* i thonë një pedagogu/e tepër të rreptë dhe pa takt në sjellje; *Beu*, sepse vishet bukur dhe mbahet me të madh; *Mamica*, i thonë një pedagogeje që ka gjoks të madh; *Zëçjerrëti*, sepse ka zë të çjerrët por edhe acarues; *Fatosi me kaçurrela*, në rastet kur pedagogu është i nevrikosur; *Bisha e kriminalistikës* (për pedagogen e lëndës së Kriminalistikës); *Ora me zile*, është shprehja ironike që një grup studentësh përdorin për pedagogen e tyre e cila është mjaft e qetë në të folur sa gati të vë në gjumë, shprehje tjetër që përcjell këtë kuptim është edhe *Do flemë një çik gjumë* (në orën e mësimit me pedagogen e lëndës së Kushtetutës); *Ekzekutuesja*, etiketohet pedagogia e të Drejta Penale, gjithashtu, ajo etiketohet edhe si *Thuthuqja*, sepse flet me [th]; *Trëndafili*, quhet me humor pedagogia e lëndës së Kushtetutës sepse i mban flokët e kapura topuz.

**Tiparet fizike** janë një element tjetër karakterizues i zhargonit studentor vlonjat si p.sh.: *vipja* (pedagoge që vishet bukur), *vishet si nuse fshati* (vishet keq, pedagogia e italishtes), ose *sportisti* (për një pedagog që nuk vishet në mënyrë formale); *konti apo Bred Pitt-i* (për dikë që vishet gjithmonë shik dhe në mënyrë elegante); *i ka këmbët si cilindër ose këmbështrembra* (të shtrembra, pedagogia e letërsisë) apo *i ka*

*këmbët si pirosti* (për pedagogen e frëngjishtes, sepse ka këmbë të gjata dhe të holla); *ecën sikur ka samar, kuazimodo* (pedagogia e psikologjisë ecën me kurriz) apo *kurriz pikëyetja* ose *notredami* (sepse pedagogu është trupgjatë dhe ecën me kurrizin e përkulur); *gjatoshi* ose *Koçi i Ollgës* ( për pedagogun e matematikës sepse është shumë i gjatë); *Tigri, pitbulli* (për dikë që është trupmadh); *sponxh bobi* ose *xhuxhmaxhuxhi* (kur një pedagog ka trup të shkurtër dhe është i shëndoshë); *yll i vogël lart në qiell* ose *Ja dhe “gjysma”* (pedagoge trupvogël); *pinguini* (etiketojnë një pedagog që është trupvogël dhe i shëndoshë); *po flet qukapiku* ose *mungon kastravec i tejdkushëm* (pedagog i gjatë dhe i dobët që jep një lëndë të lehtë) apo *erdhi shtangisti* (me kuptimin e kundërt: i hollë dhe i gjatë); *kokëqepa* (për kokë vogël); *bida* (femër mesogrua dhe shumë e shëndoshë); *vetullshigjeta* (sepse ka vështrim të rreptë); *kokë lakra* ose *kokëkashta* (sepse ka flokë të verdhë); *faqe gropa* (pedagogia e anglishtes); *Lesh lyeri, biondi me lesh të bardhë, sepse i lyen flokët pavarësisht nga moshja e madhe; katërfenershi* (mban syze); *në qoftë se diku i ka vdek berberi, këtij nuk i ka lindur akoma* (kur pedagogu/ia ka model flokësh të çrregullt); *çupulina* (pedagoge me fytyrë ëngjëllore, si vajzë e vogël).

Një pedagogu studentët i thonë Kaçurrelsi, erdhi Fantoci me kaçurrela, tullac me gërsheta ose Qerosi me flokë apo ka flokë të bukura ky tullaci, Doktor Flori, sepse nuk ka flokë, kurse një tjetër i thonë Barbi silikon, sepse i pëlqen shumë vetja. Ndërsa një studente tjetër tregon se në grupin e ngushtë shoqëror një pedagogu trupvogël i thërrasin Vogëli i nënës; Fytyrë shtypura i thonë një tjetër pasi ka fytyrë të shtypur dhe katrore; Sot paska hipur në kat të dytë, i referohen studentët ndonjë pedagogeje që vesh taka shumë të larta; Pedagogu si boksier, gjysma e kokës rruar me brisk, gjysma extension, shprehje e përdorur në rastet kur pedagogët nuk kanë flokë në pjesën e sipërme të kokës por vetëm mbrapa saj; ndërsa pedagoges së anglishtes që vishet bukur e në përshtatje me mjedisin akademik i thonë Sporti fashion; Kokëlëpirsja, i thonë një tjetër sepse ka kokë të madhe; Shakira, sepse ka flokë të thinjur e të ashpër; kurse një tjetër i thonë Kokë pakrehuara ose Ka bërë sherr me parukieren, sepse i mban flokët në model të çrregullt, gjoja si moderne.

**Mosha** është një tjetër kategori që studentët kanë krijuar shprehje apo etiketime humoristike ose ironizuese. Kategoria e moshës ndahet në dy drejtime: pedagogë me moshë të madhe dhe pedagogët e rinj, si p.sh.: *babagjyshi, gjyshi, plaku i moçëm, ka një moshë me gjyshin tim, pensionisti, dinozauri i fundit i mbijetuar, do një refresh ky, sepse i ka ngelur kalendari në luftën e dytë botërore*, (pedagog i madh në moshë); *gjyshja e letërsisë* (pedagoge e moshuar e letërsisë); *k'tej pensionist dhe më flet si 20 vjeçar* (kur një pedagog flet me pasion dhe energji); *pensionisti që do vetëm qetësi* (sepse pedagogu i letërsisë është në moshë të madhe dhe nuk toleron zhurmat në klasë); *në mes të jetës ose mazllëmi* (pedagogu i fizikës); *kacagjeli* ( për pedagogët e rinj në moshë dhe janë të rreptë që në momentin e ardhjes në punë);

Nuk mungojnë edhe nofkezimet mbi bazën e ***cilësive të pedagogëve apo hamendjeve morale për ta dhe natyrës së pedagogëve*** si p. sh., *ky rri sikur i ke*

*ngrënë bukën, kur pedagogu është natyrë e qetë; të bën me dhimbje kokë, në rastet kur pedagogët bëjnë shumë pyetje në orën e mësimit; mendjemadh, gjarpër, trendy, vajti pesëdhjetë vjeç, por prapëseprapë natyrë xhovanile ngeli, për dikë që është në moshë të madhe dhe paraqet sjellje të një moshe më të re; është bërë xurxull sot (për një pedagog që pi shume dhe është gati gjithnjë në gjendje gjysmë të dehur); makarena ose Adoleshentja e vonuar, i thonë një pedagogeje, sepse megjithëse është moshë e madhe, vishet si gocë e re dhe jo në përshtatje me moshën apo mjedisin akademik; klloune (pedagoge që bën tualet të rëndë ose do të duket si vajzë e re); ky është ende në kohën e xhaxhit (sepse pedagogu shfaq disiplinë të rreptë pune dhe nuk është tolerant); qefllia, qefllesha, për pedagogen e laboratorit të infermieristikës; ka marrë diplomën për edukatë, për ata pedagogë që ironizojnë së tepërmi studentët; lekistja, për një pedagogë që “është e tmerrshme për të rrjepur studentët nga lektë”; në këtë kategori përfshihen edhe termat *votove?* – *votova*, të cilët nënkuptojnë kur studentët kanë dhënë lekë për të marrë notë pozitive në provim.*

Pjesë identifikuese e fjalorit të studentëve që përdoren për identifikimin e pedagogëve janë edhe *shprehjet që disa pedagogë përdorin në momente apo situata të ndryshme informale*, si p.sh.: *do kalosh kur të hipi gomari në majë të fikut, kur të bëjë kaposhi vezë, në 36 gusht (vetëm në këto raste do të merrni notë kaluese); më zuri goja lesh (ngela duke ju thënë të njëjtën gjë); ju ka hipur mendja në majë të flokut (jeni bërë mendjemëdhën timer dhe nuk dëgjoni se çfarë ju thuhet);*

Po kështu për identifikimin përdoret edhe ***mënyra e të folurit që karakterizon pedagogë të ndryshëm brenda dhe jashtë orës së mësimit:***

*pulë e ngordhur, kasetë e vjetër kur pedagogu/ia flet ngadalë; makinë e prishur, papagall apo bilbil për dikë që flet shpejt ose vetëm flet dhe nuk bën dialog me studentët; flet në ajër, flet sikur pjerdh miu, në rastet kur pedagogu flet me zë të ulët dhe ngadalë; rock ‘n roll, në rastet kur flet me zë të lartë, por nuk kuptohet, sepse është i paqartë; enigmatikja, për pedagogen e stilistikës, sepse flet për mësimin me zë të qetë, por asnjë nuk e kupton.*

2. Një “arsenal” i tërë ***nofkash*** dhe ***shkurtimesh ironizuese*** përdoren nga studentët ***për lëndët*** e ndryshme që zhvillojnë në ***fakultetet përkatëse***, si:

- (a) *Psikopati* për lëndën e psikologjisë apo filozofisë;
- (b) *Kozmatologji* për lëndën e biologjisë,
- (c) *Qorrrat* për lëndën e matematikës,
- (d) *English* ose *anglofoni* apo *angleze*, për gjuhën e huaj,
- (e) *Tralalaja* për lëndë që konsiderohen të lehta, sidomos të profilit shoqëror;
- (f) *Shkenca* për degën e matematikës;
- (g) *Të drejtat e kafshëve* për lëndën “Të drejtat e njeriut”, dega juridike;
- (h) *ABC-ja, era cikël* ose *bebushat*, për lëndët e Ciklit të ulët;

- (i) *Luftërat dhe tokat*, ose me ironi fjalëpaka për lëndët që zhvillohen në degën e Histori-Gjeografisë;

3. Gjithashtu, zhargoni studentor mbizotërohet nga *metaforat* dhe *etiketimet* që ata i bëjnë njëri-tjetrit *në bazë të degës së studimit*, si p.sh.:

Tabela 4. 3 Etiketimet që studentët i bëjnë njëri-tjetrit në bazë të degës së studimit

| <b>Dega e studimit</b>   | <b>Etiketime pozitive.</b>  | <b>Etiketime negative.</b><br>(për të etiketuar ose ironizuar profilet apo fakultetet e njëri-tjetrit, kur studentët nuk përfaqësojnë denjësisht degën ku studiojnë)  |
|--------------------------|---|---|
| <b>Gjuhët e huaja</b>    | <i>përkthyesit, zysha, evropianët, anglezët</i>   | <i>ekstra-komunitarët, ja dhe anglishtja e avancuar, pipin, integrimi evropian, jashtëtokësorët, e bënë shqipen sallatë ruse.</i>   |
| <b>Infermeri</b>         | <i>Infermierët e ardhshëm, Doktorët, bisturia, gjëlpëra, bisturia, zëvendës mjeku, bluzat e bardha.</i> | <i>Doktor Gjëlpëra, mama mia, dolën këta të bisturisë, alinët, gjoja mjekët, infermierët e vdekjes, kasapët, ruajtësit e shëndetit njerëzor, doktorët e gjëlpërave në b_th, bluzat e zeza, doktorët e paaftë.</i> |
| <b>Biologji</b>          | <i>biologët</i>   | <i>mikroskopistat, domatelog, doli shkenca e tokës dhe e njeriut</i>  |
| <b>Histori-gjeografi</b> | <i>Arkeologu, historiani.</i>   | <i>Gurë stralli, kockë- zbuluesi, qeramika shekullore, të vjetrit e shekullit, këta të epokës së majmunit, erdhën profesororeshat historike-gjeografike,</i>  |
| <b>Gjuhë-letërsi</b>     | <i>Gazetarët, gjuhëtar i mbaruar, Naim Frashëri, Migjeni, zyshat</i>                                    | <i>llafollogët, oratorët, telendarët (kur flasin shumë), pedagogët e ardhshëm, fëmijëria, Homeri shqipëtar</i>  |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <b>Pedagogji,<br/>psikologjisë,<br/>cikli i ulët,<br/>parashkollor</b> | <i>Edukatorja-<br/>edukatorse,<br/>mësonjësja,<br/>edukatorët e<br/>ardhshëm,<br/>psikologët<br/>enigmatikë</i>   | <i>çerdhja, kopshti, mësuskat, parashikuesit e të<br/>ardhmes, lexuesit e mendjes, psikopatët, të<br/>mençurat, filozofët, edukatorët e bebelinove,<br/>mësuesët e lodhur, më i zgjuari i budallenjve,</i>   |
| <b>Biologji</b>  | <i>Biologët,<br/>eritrocitet, qelizë,<br/>adhurojnë<br/>natyrën dhe<br/>kafshët</i>   | <i>mikroskopistat, domatelog, doli shkenca e<br/>tokës dhe e njeriut, kopshti zoologjik</i>  |
| <b>Juridik</b>   | <i>Avokatët,<br/>gjukatësit,<br/>deputeti i<br/>ardhshëm, ky do<br/>na nxjerrë nga<br/>burgu, lek-<br/>shumtit,<br/>superiorët, neni,<br/>rregullatorët e<br/>botës</i> | <i>mëndjemëdhenjtë, kokë shteti, juridiksat,<br/>prokurat e vitit, avokatët e popullit,<br/>lekmëdhenjtë, të korruptuarit, lekistat,<br/>juridiksat, drejtësia e shtetit, ata që shikojnë<br/>nga xhepat, mbrojtësit e të drejtës dhe<br/>kriminelëve, lekmëdhenjtë e arshëm,<br/>mashtruesat, do n'a shtohen Ramat e<br/>Berishat, Juripalla, korrupsion ligjor</i> |
| <b>Biznes</b>  | <i>lek mëdhenjt,<br/>ekonomistët e<br/>vendit</i>   | <i>të shifruarit, llogaritarë, 1+1=3</i>   |
| <b>Inxhinieri<br/>navale</b>   | <i>Marinarët, detar<br/>ët</i>  | <i>Peshkatarët, navigatorët</i>  |
| <b>Inxhinieri<br/>elektrike</b>  | <i>Rregulluesit apo<br/>punonjësit e<br/>korentit</i>   | <i>Lesh dredhurit</i>  |
| <b>Inxhinieri<br/>mekanike</b>   | <i>Çelës anglez</i>   | <i>Katër fenerësh (sepse shumë prej studentëve<br/>të kësaj dege mbajnë syze optike)</i>   |
| <b>Informatik</b>  | <i>Windowsat,<br/>Ervin Ruci</i>  | <i>mikrosolistat</i>   |
| <b>Fizik</b>   | <i>fizikantët,<br/>Njutoni,<br/>Radhërfordi</i>   | <i>Anjshtanjët, shkencëtarët, bateria</i>  |

4. Të shumta janë edhe shprehjet që përmbajnë terma specifike të profileve të ndryshme të studimit, si p.sh.

(a) **terma gjuhësor e letrarë:** *kontekst, koncept, tip Homerik* (për dikë që i pëlqen poezitë ose krijon poezi); *je si pikëpyetje* (jo e bukur); *bën si Naimi apo Naimi i dytë, Shekspiri i dashuruar* (kur përdorin fjalë dashurie); *sot i ezauruam të gjitha* (nuk kemi më për çfarë të flasim); *kujdes vetiçencën* (fol mirë); *gjuhëtar analfabet* (i paditur); *zanore e hapur* (e shëndoshë); variant i lirë ose elektron i lirë (beqar); *mos e "hiperbolizo" muhabetin tani* (mos e ekzagjero); *je si "roman"* (ke shumë për të thënë); *nuk di ende ç'është kallzuesi; të është mbushur koka me fjalë; ke e zhargonin copë; llafollogji; më je bërë si Kadareja; u bëre si Naimi me libra në gji;*

(b) **terma të fushës së matematikës:** *si ekuacion*, kur i referohet në femre të bredhur; *është në fuqi të dytë, për vajzat ose djemtë që janë në një lidhje dashurie; sa mëson kjo matrica* (vajzë e shëndoshë);

(c) **terma të mekanikës:** *e ke kokën si çelës anglez; shtylla elektrike* (kur dikush është i gjatë); *erdhi fytyrë salduari* (fytyrë me akne); *i ka këmbët si shkopinjin xhezi* (këmbë të gjata dhe të holla);

(ç) **terma të fushës së informatikës:** *na iku pini; je full* me kuptimin e kundërt që nuk di gjë nga mësimet; *i është djegur ram-i ose i është bërë truri "shut down"*, kur nuk kupton diçka; *ke nevojë për update; bëj një like dhe pastaj share;*

(d) **terma të gjuhëve të huaja:** *nuk kam mësuar fare, jam out;*

(dh) **terma të pedagogjisë dhe lëndëve që zhvillohen aty:** *ke handikap në tru* (nuk je mirë); *psikopatologji; je zbukuruar nga Arti i së bukurës* (lënda e vizatimit);

(e) **termat të fushës së juridikut:** *ligjet e një prokurori;*

(f) **terma të degës së infermierisë:** *vitaminat* (vajzat e bukura); *mutacion gjenetik;*

5. Po ashtu, në mënyrë figurative studentët shprehen edhe **për mësimet, notat dhe provimet** etj. si p.sh.:

(5.a) **Fjalë dhe shprehje për mësimet:** *po ky leksioni kinez që nuk mësohej fare...*(leksion i vështirë për t'u kuptuar); *na janë bërë këto mësimet si burri i nënës; mësimet dhe vetëm mësimet* (për të shprehur lodhjen nga mësimet); *notë motivuese ose demoralizuese; plasi bomba* (kur merret notë jo kaluese); *provimi i mendjes* (i psikologjisë); *provimi i të folurit* (letërsisë); *kemi provimin e gojës* (të gjuhës shqipe); *provimin e jashtëm* (gjuha angleze);

(5.b) **Fjalë dhe shprehje për notat:** nota 4 (katër): *zero me kapele, mora katër këmbët e pulës/dhisë, morre një katranas, e marrë katijushk, katër me bisht/yll, zero me xhufkë, më dha fshesën për këtë vit, dhjetë/dysh me kokë poshtë, as pesën nuk e morra dot, mora dhjetë me kokë poshtë;* nota 5 (pesë): *e more një yll sot, pesë me mik*

*ose pak e saktë, e morra një pesë me shkelma, morra një peshore, pak e saktë mor burrë; nota 8 (tetë): me shaka i thërrasin teta-teta-teta, nënta e dhjeta marrim në shkollë; nota 9 (nëntë) dhe 10 (dhjetë): nëntë me kokë lartë; dhjeta as nuk ëndërrohet; dhjetë me yll; like a boss (shprehje që përdoret kur dikush ka marrë vlerësim me notë dhjetë);*

(5.c) **Fjalë dhe shprehje për provimet:** *fillimi i sezonit të provimeve: tani është koha për botën tjetër, erdhën sërish prapë mandatat/ të flamosurat, filloi stresi, do përmbysët bota tani apo erdhi dieta / vdekja / tufani (filloi sezoni i provimeve), filloi tortura, erdhi stuhia ose tani do bjej tërmet (filloi provimi); na iku petlla; më iku pini; erdhi ora e vdekjes; boh, torturë tani;*

(5.c.1) **shkalla e vështirësisë së provimit:** *provim bomb, e kishte bërë helm provimin, siç është vetë (shumë i vështirë); provim pënd i lehtë (tepër i lehtë); provim qesharak, provim koti ose provim copë-copë; provim pa lidhje me lëndën; provim bastard.*

6. Të shumta janë edhe **termat paragjykes për studentët e vitit të parë**, pavarësisht profilit të studimit, si p.sh:

**Terma etiketues për humor:** *buzëqumshiti; fillestar; viprarista; ushtar fruthi; minorenët; kalamanj, të vegjlit-pikolinot (nga italishtja: të vegjël), picirrukët, bebat, fëmijët e kopshtit, kolongiçat; dudumat; të ndorjturit; kësulkuqja, bibat, klloçka (për ndonjë studentë që përsërit vitin e parë sepse nuk ka marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët); diletantë-amator-fillestar; adoleshentët; vipi; interesanti; e lodhur; kalamanj gjimnazi; njerëzit e humbur;*

**Shprehje ofenduese:** *e vogël është, do mësojë; u bë kjo vitparisija; këta të vitit të parë janë llahtar; erdhën këta të vegjlit dhe hapën sytë; ja këto mizat; si pula të shushatura, si në psiqatri; erdhi fshatë në qytet, hapi rrugën se të vret; morri i vrarë dhe bishtin përpjetë; e dinë se janë akoma në gjimnaz; bën si e padalë; vjen kjo nga maja e malit dhe hapi sytë; mollarët; ka ardhur mall i ri; erdhi rryli; shpëtuan nga zinxhiri; zero kilometër; sapo e kanë marrë patentët, kujdes se të përplasim;*

7. Në ligjërimin studentor shpesh përdoren edhe **fjalë e shprehje me ngjyrim negativ për studentët konviktore**<sup>207</sup>, si p.sh:

(7.a) për **vajzat konvikto** janë shumë **fjalë etiketuese:** *bredharake, pularia, shushkë, të shëmtuarat, katundaret, piset, kokëpalarat; pabukse, “shenjëtoret”, kokëpalara, “të ndersmet”; shtëpiaket; prostitutat; zogu; debilet; lyrashe;*

<sup>207</sup> Shumë fjalë dhe shprehje në këtë kategori i përkasin Ligjërimin të shkujdesur. Me qëllim shmangien e përsëritjes së shembujve dhe kategorizimeve, ky material është paraqitur vetëm në këtë nënçështje.

(7.b) **togfjalësha dhe shprehje ironizuese:** *pulat e Patosit, Fështi në festë (fshati në festë), u hap byrektorja, hapen si vaji në lakra, bishtë përdredhurat, u bë kjo konviktorja; goca të mbara; konviktoje mo vlla; të pa lara; të bredhurat që kemi dëgjuar .....; vishen keq; beqaret e përjetshme; qenka lëshuar nga hekrat (nuk është në kujdesin prindëror); vjen darka, mbledh zagaret te dritarja; bukuroshet e konviktit; ja pronarja e hotel Bolonjës; kjo kokë pa krehura; ja dhe turistet e hotelit me pesë yje; erdhi fshati në qytet, hapu, hapu se të vret, të tjerat i di vetë; fytyrë plastika (kur bëjnë tualet të rëndë); lënë mësimin për një kafe; ju duket vetja si në tapet të kuq (të rëndësishme); zogjtë e korentit; kopej; elektrone të lira; dhitë e Çipinit; goca të “mbara”; dinë vetëm të pispillosen;*

(7.c) Ndërsa, për **djemtë konviktorë** janë shumë **terma etiketues:** *fshatari, katunari; lumadhi, ordiner, pabuksat, barkëtharët, jabanxhi, barbona, emigrantë; gjela; drogaxhinjt; dudum; “çupëzat”; merhuma (jo të zotët e vetes); zhulsat; kokëpalarët; të shkalluarit; zhurmuesit; aguridha; alabakë; kokështëllungat; brekëgrisurit; hallexhinjtë;*

(7.d) **togfjalësha dhe shprehje ofenduese** duke iu referuar **pamundësisë së kushteve** kur nuk kanë një higjienë personale, si p.sh.: *erdhi ky këllira ose nuk e merr përsipër as lavazhua (tepër i pistë); ndiz aspiratorin (kur vjen era djersë); ka traktora në kokë (ka parazitë); u ha drekën bota; reparti ushtarak; djem barbona; djem mamaje; erdhën emigrantët (konviktorët); çunat e repartit; harrojnë të lajnë sytë; kolopuçat e mamit; mister fshati; burgu 213; gjithçka ngrënësit; morracët e konviktit;*

Përveç fjalëve dhe shprehjeve të përcaktuara sipas gjinisë, në zhargonin studentor qarkullojnë edhe mjaft etiketime ironizuese ose duke nënkuptuar konceptin e kundërt, për konviktin, si p.sh.: *hotelet luksoze me kushte very meravigliose, hotel me pesë yje ose janë tamam s’i me pushime në Dubai (sepse konvikti nuk ka kushte, shprehja e dytë gjithashtu paraqet edhe konotacion që studentët konviktorë janë të lirë të bëjnë çfarë të duan sepse nuk iu kërkon njeri llogari); shtëpia e fëmijës ose shtëpia e lirisë (studentët konviktorë janë larg familjeve të tyre dhe u mungon kujdesi familjar); shkolla e pulave; koteci apo kotec pulash (dhoma e konviktit, sepse është e vogël), stadiumi i futbollit; zonë e minuar; lëvizja e qytetit; qyteti stupida për qyteti i studentit; Na është bere shkolla si spitali, edhe pse nuk na pelqen hic duhet te vemi etj.*

8. Në ligjërimin studentor shpesh përdoren edhe **figura letrare** e ndryshime **kuptimore të çuditshme**, si p.sh.: toponimet për të shprehur ndonjë gjendje të caktuar në formë eufemistike kështu, fjalia “*më ka ardhur teza nga Vithkuqi*” është shprehja e përdorur nga studentët e universitetit të Tiranës<sup>208</sup>, gjithashtu edhe në universitetit të Vlorës kjo shprehje evidentohet me kuptimin *Hallat ose tezet nga Amerika*, që shpreh kuptimin “*më kanë ardhur menstruacionet*”; *do të çojë në Babicë* me kuptimin “*do të rrah për vdekje*”; “*Është nga kurva me lesh*” për dikë që është nga krahina e

<sup>208</sup> Shkurtaç, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 212.

Kurveleshit; “*erdhe nga Korça*” me kuptimin “u kujtove më në fund”; *Bjeri nga Kina*, domethënë “larg e larg”; *dolën çunat nga burgu i Spaçit* shpreh kuptimin që “dolën studentët nga konvikti” etj.

9 . Një element i rëndësishëm i zhargonit të studentëve në Universitetin e Vlorës është edhe përdorimi i disa ***metaforave karakterizuese përshkruese të tipareve fizike, karakterit, sjelljes:***

(9.a) për vajzat, si: *milingona, miza, zogu, arushe, lepurushe, sorrë, laraskë, Yll-o, zonjushë, mësonjëse, kokolusha, xhevrie, grifshë, guapa, shtrigë, kokë mushkë; më je veshur si ylber* (plot me ngjyra); *ja kjo me dy predha atomike, ajo që ka parakolpin e madh, Pamela Andersoni* (për vajzat që kanë gjoks të madh); *Xhenifer Lopez* etj.

(9.b) për djemtë, si: *arush polar, rrusha, akulllore, çokollatë, fenomeni, king, student i dashur, o shoku student, vllai, sybukri, bukuroshi, ai tipi, mostër; kalë* (trupmadh); *trushkukur, me këtë që the ke fituar një lavatriçe të prishur apo rri e rri, këput ndonjë shalqi* (flet pa logjikë); *të ka lënë gjermani mbrapa* (nuk duhet të ekzistosh); *kaçarrelsi apo kongolezi* (për djalë që ka flokët kaçurrela); *kokë-patatja* (kokëfortë); *erdhi Arnold Zhvazenegeri* (djalë me trup të madh e të bëshëm); *me ato veshë që paska, ka rrezik të fluturojë ose i ka veshët si elefant* (kur dikush ka veshë të mëdhenj) etj.

(9.c) Për të ofenduar (duke iu referuar paraqitjes së jashtme), si: *xhuxhi* kur dikush është i shkurtër; *anemikja apo ti moj vajzë sikur ha miza*, përdoret për vajzat studente që janë shumë të dobëta; *kafsha ose egërsira* i referohet vajzës ose djalit student që ka sjellje të ashpër; *andromali* për dikë që ka sjellje të çuditshme; *bufe ose karrabacë, e ke barkun si betonjere; apo qofte e prishur* kur një vajzë është goxha e shëndoshë; *bufi* për studentat djem të shëndoshë; ndërsa *karkalec* përdoret për një djalë tepër të dobët; *tharanukja*, për vajzat tepër të dobëta; *erdhi ky gjigandi* (shprehje antonimike, për dikë që është shumë i shkurtër); *po kalon kjo një pa pesë nga toka* (për vajzat që janë të shkurtra); *shalëhardhi* (për një vajzë ose djalë që i ka këmbët e gjata dhe të holla); *e ka flokun sikur e ka futur në lavatriçe dhe i ka bërë centrifugë* (për vajzat që i mbajnë flokët në mënyrë të çrregullt); *dele rudë, lesh dhie* (për ndonjë vajzë që i ka flokët e verdhë); *pyjoli*, është etiketim për ata djem me flokë tepër të dendur; *është veshur si në vitet’70* (sidomos për vajzat kur nuk vishen bukur apo me modë); *flet sikur e ke futur në korent* (kur dikush ka probleme të folurin); *ik ‘re gomar* (budalla); *trapace* (me vithe të mëdha); *vronjace* (pisanjose); *ja hoqe zarin apo i ka ikur bleta nga kosherja*, me kuptimin nuk ka logjikë; *i ke dhëmbët si ndërtime pa leje; ke bërë patinim me dy kilogram stuko* (kur një vajzë është lyer shumë); *miset që tronditën dhenë, të bukurat e dheut, hirushet e bukura apo bëjnë si goca ministrash*, janë etiketimet që i referohen vajzave.

Shprehje e fjalë për njerëzit me lëkurë të bardhë, pa pigment: s’ka parë diell me sy, vezë e prishur, qumështor, si baltë muri, majmun bjond.

(9.d) Shprehje e fjalë të tjera që përshkruajnë karakterin apo tiparet fizike të studentëve janë: *Katërkëmbësh* (kur dikush është i shkathët); *delikate, pulë, qull* (vajzë ose djalë shumë i urtë); *balonë e shfryrë* (e shëmtuar); *tollombacë në fryrje* (e shëndoshë); *noisy* (vajzë apo djalë me buzë të trasha); *ballkoni* (kur një vajzë ka veshur bluzë të hapur përpara); *tellali*, quhet individ i cili flet shumë; *shreku, dumbo, gjyshi* ose *babai* janë etiketime për studentët në moshë të madhe; *femër gei* apo *mashkull lesbike*, janë etiketime ofenduese për vajzat apo djemtë që në sjelljen e tyre paraqesin tipare të gjinisë së kundërt;

10. Shumë të përdorshme në ligjërimin studentor janë *shtrembërimet e fjalëve* apo *përmbysja e tyre*, si p.sh.: *tha po bën* ose *aç nëb* për “çfarë po bën?”; *stikokalops* në vend të “stilolaps”; *shel* për “lesh”; *fjalë banane* për “fjalë banale”; *nacu* në vend të “çuna”; *OK, kim në zhlop* (kur studentët thonë i do të ikim në plazh); *makarunde* (makarona); *salço pulço* (salçiçe); *çokurrele* (kaçurela); *mak semin nate* për “kam mësim tani”; *mak mivrop* për kam provim; *ërim ëmush* (shumë mirë); *op* (po); *zjav* (vajzë); *tirp ëm* (më prit); *inat* (tani); *mivrop* (provim); *ësalk* (klasë); .

Në mënyrë të veçantë përdoret kjo mënyrë të foluri për të përmendur fjalë të rënda, gjë që ndodh sidomos te meshkujt, si: *thuba* “by..”, etj. Po ashtu, *për efekte eufemistike* e gjithnjë edhe humoristike në zhargonin studentor përdoren edhe emërtime, si: *llapore* (puthje me llapë) etj.

11. Shpesh në ligjërimin studentor përdoren *shkurtime e fjalëve apo shprehjeve të gjata*, ku shquajmë sidomos:

(11.a) *dukuri që i përket gjuhës së folur*, gjatë bisedave të interlokutorëve që kanë familjaritet me njëri-tjetrin, si p.sh.: *Çpb* (çfarë po bën?); *Flm* (faleminderit!); *mngj* (mirëmëngjes); *do vemi në shk* (shkollë); *cel* (celular); *nr* (numër); *shtëp* (shtëpi); *po bëjmë pak mhb* (muhabet); *sms* (mesazh në celular); *hi* (çkemi); *gëz* (gëzohem); *Tkm* (të kam motër); *tpf* ose *uç-uç* (të puth fort); *kls* (kalofsh super); *mbq* (më bëhet qejfi); *o psiko* (psikopat); *klm* apo *klk*, për shprehjet “kalofsh mirë” apo “kalofsh keq”; *noku* (zemër); *prb* (problem); *sps* (sepse) etj.

(11.b) *dukuri që i përkasin gjuhës së shkruar informale*, sidomos mesazhet e shkruara në telefonat celular [apo shkrimet në fletore gjatë bisedave personale, p.sh.: *tkxh* (të kam xhan); *mj...* (moj...!); *tdsh* (të dua shumë); *tkz* (të kam zemër); *nsr* (nesër); *thm t ms vi n shk nsr* (them të mos vi në shkollë nesër); *si kalv st?* (si kalove sot?); *pz* (për Zotin!); *dsh* (detyra shtëpie); *shm bkr* (shumë e bukur); *ntn* (natën); *njs* (nejse); *x* (puthje); *Klb* (kalofsh bukur!); *Klm* (kalofsh mirë!); *sps* (sepse); *sps* ose *skp* (s’ka përse); *prsh* (përshëndetje) etj.

12. Nga studimet etnolinguistike dhe sociolinguistike të hulumtuesve të huaj e vendas, është vërtetuar se shumë bashkësi gjuhësore, krahas varieteteve gjuhësore të zakonshme, përdorin një ose më shumë varietete gjuhësore, të cilat kanë një numër të

kufizuar përdoruesish dhe karakter mjaft artificial<sup>209</sup>. Këto të folme të fshehta shërbejnë për të komunikuar, porse në të njëjtën kohë përjashtojnë nga komunikimi ata që janë jashtë grupit përkatës. Funkzioni social i komunikimit realizohet i plotë, duke e forcuar kuptimin e identifikimit të atyre që janë brenda grupit.<sup>210</sup>

Duke u bazuar në studimet e prof. Gj. Shkurtaj<sup>211</sup>, zhargonet e studentëve shqiptarë dhe grupet e ngushta shoqërore në të cilën ata bëjnë pjesë, karakterizohen deri diku *nga e folura e fshehtë*. Ky lloj komunikimi verbal u përket jo vetëm disa personave por edhe situatave a rasteve të caktuara.

Mënyrat e formimit të tyre janë të ndryshme e të shumta, por më të përdorurat janë: përmbysja e fjalëve, zëvendësimi ose shtimi i prapashtesave a i pjesëve të ndryshme (tinguj ose rrokje) në përbërjen e fjalëve për të krijuar moskuptim nga ai që nuk e di kodin përkatës, etj.<sup>212</sup> Më poshtë paraqiten më të detajuara tiparet e formimit të gjuhës së fshehtë të studentëve.

Në këtë kategori përfshihen edhe *e folura mbrapsht* apo *pjesërisht mbrapsht*, me qëllim që të mos kuptohet se çfarë është duke u thënë ose për efekt humori, si p.sh.: *neqi* për “qeni”; *rutulf* për “flutur”; *mak misëm* (kam mësim); *ad jiv rëp ëjn ra* (do vij për një orë); *ëj ëmush e rukub* (je shumë e bukur); *artam emi* (motra ime); *imehokat jatsap* (takohe mi pastaj); *nëb op ac* në vend të thuhet “çfarë po bën?”; *is qu ënaujq?* (si ju quajnë?); *maj rusëm* (jam sëmurë); *an uaç nëkok* (na çau kokën për dikë që flet shumë); *irbil* për libri; *tnedusti* për student; *kun iv dot* ka kuptimin “nuk vi dot”; *imeshih resëm* për shihemi nesër; *ëm uki irurti* për më iku truri; *od novohem kap* (do vonohem pak); *u mendça tos* (u çmenda sot); *as e mështuar oja* (sa e shëmtuar ajo);

Një lloj i zhargonit të studentëve është edhe të *folurit me f*, me *ëu*, me *g* ose me *xi*”, që përftohet duke e ndarë fjalën në rrokje dhe pas secilës rrokje futet një *f* + rrokjet e secilës fjalë, ndërsa grupet tingullore –*ëu/xi* ndjekin rregullin: rrokje e fundit +*ëu / xi*, p.sh.,

*Të folurit me “f”*, shprehjet: “mësuesja jonë është shumë e mirë” në të folur thuhet “*mëfësufuefesfëjafa jofënofëfështëfë shufëmëfë efëmifërëfë*”; “unë jam në vit të parë” në biseda informale dhe për humor thuhet “*ufunëfë jafëmëfë nëfë vifëtifë tëfë pafërëfë*”; *shkofo* për shko; *ifidjofotefë* për fjalën idjote; *rrifi ufurttëfë për rri urtë*; *çafa pafa thuafa* (çfarë po thua?); *psefe mife thuafe ktofe gjeferefeafe* (pse mi the këto gjëra?).

*Të folurit me f* i nënshtrohen edhe emrat e përveçëm si për shembull: *Adefelafa* për Adela; *Brufunifildafa* për Brunilda; *Lafarefencafa* për Lorenca, etj.

<sup>209</sup> Cardona, G. R., *Introduzione al' etnolinguistica*, Milano, 1976, f. 92.

<sup>210</sup> Shih: Po aty, f. 92.

<sup>211</sup> Shkurtaj, GJ., *Etnoografia e të folurit të shqipes*, Tiranë 2005, f. 194-210.

<sup>212</sup> Shih: Po aty, f. 195.

**Të folurit me “ëu”** përdoret në shprehjet ose fjalitë e tipit: “Çfarë po bën?” në të folur thuhet “*ça po bëu?*”; “unë rri këtu” shprehet “*unë riëu ktuëu*”; ndërsa fjalia “unë vajta në shkollë në mëngjes, tani po pi kafë me shokët” për humor thuhet “*unë vajtëu shkollëu mëngjesëu taniëu piëu kafëu shokëu*”; ose fjalia “unë do iki pastaj të pi kafë” thuhet “*unëu ikëu pastëu pirëu kafëu*”;

**Të folurit me “xi”:** fjalia “mirë jeni ju?” në të folur paraqitet “*mirxi jënxi junxi?*”; *mirënxi; faleminderxit; çabënxit* (çfarë po bëni); *kudo venxit* (për ku do të veni?);

**Të folurit me “g”** nënkupton që fjalëve ose shprehjeve të përdorura të tipit u vendoset bashkëtingëllorja **g** në mes të zanoreve dhe në të folurin e lirë shprehen kështu *çuna, iku fare ky, mos fol kot: çugunagët, igukugu fagare kygu, mogos fogol kogotos; ça po begën për çfarë po bën; regahat për rehat; igika për ika; çdo gjë është pëgfegte për çdo gjë është perfekte; të ugej shugumë me kuptimin të urrej shumë;* .

Vihet re se në rastet e lartpërmendura, folësit janë munduar të ruajnë ritmin e të folurit dhe në këtë mënyrë kanë hequr disa fjalë të fjalisë ose disa shkronja të fjalëve, por pa ia cenuar kuptimin fjalëve apo fjalisë në tërësi.

a. Por, shndërrimi kryesor i të folmeve të fshehta ndodh në fushën e leksikut dhe aty pjesa më interesante u përket shndërrimeve semantike<sup>213</sup>: TDSH, ky akronim është polisemantik: “të dua shumë” është kuptimi i parë, i cili është gjenerik dhe “të dal nga shtëpia” është kuptimi i dytë dhe i panjohur për pjesën tjetër jashtë grupit; i ke marrë detyrat, është një shprehje që studentët e përdorin përpara se të fillojë provimi dhe ka kuptimin “i ke bërë kopjet gati?”; yll-yll, shpreh kuptimin e kundërt “dukesh shumë keq”, apo siç thonë studentët “katastrofë fare je”; ty po të prisnim, nënkupton “tani e gjete të vish”; sa do rrish, nënkupton “do të rrish edhe shumë apo kur do të ikësh?”;

b. Sharjet dashamirëse konsiderohen deri diku tipar tjetër i të folur të fshehtë. Qëllimi i tyre është që të krijohen situata humorit, për të tallur dikë etj

Le të paraqesim me shembuj konkret situatat:

**Tabela 4. 4 Sharjet dashamirëse të përdorura nga studentët brenda dhe jashtë mjediseve universitare (jashtë auditorit).**

|                            | Në mjediset e universitetit (jashtë auditorit) |                                     | Mjediset jashtë universitetit         |                                    |
|----------------------------|--|-------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------|
|                            | <i>Për vajzat</i>                              | <i>Për djemtë</i>                   | <i>Për vajzat</i>                     | <i>Për djemtë</i>                  |
| <b>Etiketime në lidhje</b> | <i>Shtrigë, mizerje, hajdute, kopjace,</i>     | <i>Fshatar, mizerje, i poshtër,</i> | <i>Mavri, shushudake, Ema Bovari,</i> | <i>Don zhuan bobozar (rrugaç);</i> |

<sup>213</sup> Shih: Po aty, f. 196.

|  |  |   |  |   |
|--|--|---|--|---|
| <b>me karakterin ose veprimin</b>                  | <i>e poshtë; erdhe<br/>moj mortje;<br/>mbylle gojën<br/>grifshë;<br/>bukuroshe;</i>  | <i>sorollatës;<br/>shtriga ime;<br/>skufse (do të<br/>dijë gjithçka);<br/>të rëntë rrufeja;</i> | <i>“Menekshe”<br/>legene femër;<br/>ndryrësirë e<br/>vogël;</i>  | <i>hajvan; bërte<br/>t si njeri<br/>pylli; prototip</i> |
| <b>Etiketime në lidhje me zgjuarsinë</b>           | <i>budallaqë,<br/>daune, shushkë,<br/>je me probleme;</i>  | <i>Budalla;<br/>burdhuqe;</i>   | <i>Idiote</i>  | <i>legena,<br/>idiot, kafshë e<br/>zgjuar</i>           |
| <b>Etiketime në lidhje me paraqitjen e jashtme</b> | <i>Shëmtira;<br/>mortje; moj dreq<br/>sa e mirë që<br/>je; bukuroshe; je<br/>e bukur si<br/>sinfoni; sy<br/>bukra,</i>   | <i>Mostër;<br/>shpifësirë;<br/>trokaliçe; yll-<br/>yll-yllll;</i>                               | <i>Pipiricka,<br/>zhulse,<br/>zgjebse</i>  | <i>Zhuls, thatar<br/>uqi; gjigand;<br/>buf i vogël;</i> |
| <b>Shprehje të ndryshme</b>                        | <i>Të hëngërt<br/>dheri; shtriga<br/>ime e vogël; first<br/>lady (me kuptim<br/>pozitiv);<br/>shejtane;<br/>Kafshë,<br/>majmune, dhia,<br/>pilivesa;<br/>kuçedër; mackë;</i> | <i>Të filloi 3<br/>fazori? (bën<br/>gjëra të<br/>çmendura); dele<br/>rudë</i>                   | <i>O furfule (e<br/>papjekur); krip<br/>majtëza ime e<br/>vogël;<br/>grifsha; u të<br/>hëngërt (mezi<br/>të kam);<br/>Macja ime<br/>tekanjoze; o<br/>lopa ime,<br/>nxito se na<br/>vajti vonë;</i> | <i>Ylli; rrushi;<br/>mostra; Buf;<br/>maçok i keq;</i>  |

Megjithatë, sharjet dashamirëse ose “nofkat” jo gjithmonë janë të pëlqyeshme ose të pranueshme nga ata të cilëve u vihen. Janë jo të pakta rastet që dikush i thërret një shoku ose shoqeje duke përdorur nofka të ndryshme me qëllim që ta inatosi. Një mënyrë e tillë “të përkëdheluri” për ironi ose tallje është e lidhur me strategjinë e ligjëritit.<sup>214</sup>

13. Gjithmonë mbi të njëjtin tip të metaforizimeve apo perifrazimeve për humor, studentët përdorin mjaft *togfjalësha me fjalë të huaja*, ku shquajnë sidomos fjalët e gjuhës angleze, italiane, greke dhe turqizmat:

(13.a) Fjalë të *huazuara nga anglishtja*, si p.sh. *yes* (po); *no* (jo); *slou moshën* (slow motion “me ngadalë”); *uot* (what “si?”); *redio* (radio); *jam full* (i ngopur) etj.

<sup>214</sup>Labov, T., , *Social and language boundaries among adolescents*, United States, 1992, f. 340.

(13.b) Fjalë të huazuara nga italishtja, si p.sh.: *kançeloje* (fshije); *çerto* (sigurisht); *amore* (i/e dashur); *sidorela come la manorela* (shprehje pa ndonjë kuptim të caktuar, përdoret vetëm për qëllim humori ose ironie); *manxhare* (të hamë); *ke te pasa?* (çfarë ke?); *come, come* (si, si); *vestiti uguali*, kur dy persona janë veshur pothuajse njësoj.

(13.c) Në mëtimet e zhargonit studentor përdoren, sipas një fryme popullarizuese, edhe formime të tilla metaforike nga *turqishtja*<sup>215</sup>. Duhet theksuar se fjalë apo shprehje të tilla kanë kuptim të përgjithshëm dhe lidhen me fusha të ndryshme të jetës si politika, ekonomia apo përshkrimi i tipareve të jashtme dhe i karakterit të njerëzve, si p.sh.: *kolltuk qafir* (deputet); *bëlldym çengel* (spirancë e anijes); *shyqyr llastik* (prezervativ); *Asllan* (si Luan, me sfond erotik); *Kapllan* (tigër, me kuptimin e kundërt); *tamam* (mirë); *ziq* (kandar); *çorbë* (supa ose çfarë kemi dreqosur); *azgan dajak* (truprojë);

(14.) Gjithashtu, ajo që bie më shumë në sy në lidhje me huazimet janë **përsëndetjet**. Vendin e parë e zë përsëndetja *ciao* (it. ç'kemi) Të shumëpërdorshme janë edhe përsëndetjet: *bye*, *hi*, si dhe falënderimet *thank you*, *grazie etj.* .

(14.d) Përdorim të gjerë gjejnë edhe *fjalët që lidhen me dashurinë*. Huazimet më të shumta në këtë drejtim janë nga gjuha angleze dhe italiane, si p. sh.: *tezoro mio*; *my love*; *amore*; *honey*, *sweety*.

Sikurse u vu re nga shembujt e mësipërm, fjalët e huaja kanë pësuar **ndryshime në formë e në përmbajtje**. Fjalët e huaja janë marrë dhe përpunuar ashtu si fjalët shqipe.

(15) Një mënyrë tjetër e të folurit në ligjërimin studentor është edhe përzierja ose shkrirja e kodeve<sup>216</sup>. Përfshirja e ndonjë **fjale, togfjalëshi** apo e një copë fraze **në gjuhë të huaj**, sidomos në italisht, anglisht dhe greqisht, *si vijim i të folurit në shqip* dhe, natyrisht, për të qeshur dhe për më tepër në mjedise miqësore e intime, p.sh.

(15.a) *Fjalë të huazuara nga gjuha italiane: miru çao* (ita.<ciao, alb.<mirupafshim); *çivedjamo nesër* (ita.<ci vediamo, alb.<shihemi nesër); *shumë grazie* (ita.<grazie, alb.<shumë faleminderit); *shkojmë a kaza* (ita.<a casa, alb.<ikim në shtëpi); *vdiqa për të menaxhare* (ita.<menaggiare, alb.<drejtuar); *bene shyqyr Zoti* (ita.<bene, alb.<mirë); *kome je?* (ita.<come, alb.<si je?); *çao, shihemi dopo* (ita.<ciao, alb.<mirupafshim, ita.<dopo, alb.<pastaj); *grand ide* (ita.<grande, alb.<shumë e mirë); *faleminderit tanto* (ita.<tanto, alb.<shumë); *je shumë stupido* (ita.<stupido, alb.<budalla); *dua një kiamato* (kafe: ita.<makiato); *në rregullalora* (në rregull atëherë); *mamasita*;

<sup>215</sup> Shkurtaç, GJ., *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë 2005, f. 194-210.

<sup>216</sup> Shih: Po aty, f. 199

(15.b) *Fjalë të huazuara nga anglishtja*, si: *OK*, *faleminderit* (ang.<okay, alb.<në rregull); *pliz*, më ndihmo pak (ang.<please, alb.<të lutem); *sit daun në karrige* (ang.<sit down, alb.<ulu); *shumë thankju* (ang.<thank you, alb.<faleminderit); *ajm uatçin ju me bishtin e syrit* (ang.<I am watching you..., alb.<po të shikoj ty...); *thanks* (ang.<thanks, alb.<faleminderit); sa *uanderful!* (ang.<wonderful, alb.<e bukur"); *kull* (ang.<cool, alb.<fantastike); *do tak later* (ang.<later, alb.<më vonë); *Hani* (ang.<Honey, alb.<zemër); *Suiti* (ang.<sweetie, alb.<shpirt); *do bëj DJ-in* (do laj enët); *këtë fustanin e ke bjutiful* (ang.<beautiful, alb.<për shumë i bukur);

(15.c) *Fjalë të huazuara nga greqishtja*, si: *shumë efkaristo* (gre. <efkaristo, shqip.<faleminderit); *nuk ka lefta* (gr.<lefta, shqip.<para); *ik ore stodhjal*; *ik qesu*, me kuptimin "ik që këtu".

(16) Në më të shumtën e rasteve, kombinimi i fjalëve të shqipes me fjalët nga italishtja, anglishtja apo greqishtja, shoqërohet me një përpjekje për ta intonuar të folurin sa më shumë nga gjuha e huaj përkatëse, si p.sh.. *paskam një kiamatë të humbur* (ciamata "thirrje telefonike"); *Po shkoj në home* (po iki në shtëpi), *të ka lënë cervelua* (truri). Në raste të tilla dalin shfaqje të atilla kur fjalia është gati krejtësisht në gjuhë të huaj dhe vetëm një fjalë e saj mbetet në shqip, si p.sh: *I'm so keq* (ndihem keq); *Let's ikim home* (hajde të ikim në shtëpi); *jam bizi* (busy) shpreh kuptimin e dyfishtë (I) jam e zënë tani, kam punë (II) kam të dashur; *non ti posso aiutore dot* (nuk të ndihmoj dot); *non ti voglio fare* (nuk të kam xhan fare); *listen to mua* apo *vieni con mua* (më dëgjo mua apo hajde me mua); *Ç'kemi tezero!* (ç'kemi shpirti!); *Ciao yll bote!* (ç'kemi yll bote!); *Po ku je o star!* (po ku je o yll!); *vëlla, je shumë crazy*, është një shprehje që studentët nga qyteti i Vlorës e përdorin me kuptimin "je i çmendur".

Ndryshe nga çfarë ndodhë me huazimet në gjuhën shqipe (shumë fjalë të huaja bëhen pronë e leksikut të shqipes), fjalët e shprehjet e huaja që karakterizojnë zhargonin studentor kanë jetëgjatësi të shkurtër dhe nuk janë të ngulitura në gjuhë.

## PËRFUNDIME

1. Studentët përdorin terma të shumtë e të larmishëm në të folurin e përditshëm, gjatë orëve të mësim, por edhe jashtë auditorit. Kjo larmishmëri fjalësh përdoret për të shprehur mendime të ndryshme apo për të përshkruar e interpretuar ngjarje e situata në të cilat ata marrin pjesë. Pikërisht në këto situata informale, që klasifikohen në këtë punim, studentët e degëve të ndryshme përdorin leksik dhe stil të ngjashëm të të shprehurit dhe të komunikuarit, përse u përket:

- a. termave dhe ngjyrymeve të tyre në biseda rreth mësim,
- b. në mënyrën e të komunikuarit gjatë orës së mësim, e jashtë saj

c. për të treguar eksperiencat e përditshme.

2. Zhargonet e studentëve kanë rëndësinë e tyre, sepse përbëjnë një pjesë të gjuhës. Të rinjtë e universiteteve kanë pasur dhe kanë disa tipare ligjërimore të tyre, që janë emërtuar si një lloj i veçantë i të folurit apo si “*zhargoni studentor*”. Ky lloj të foluri synon të krijojë një “kod” të posaçëm shprehjeje midis anëtarëve të rrethit shoqëror, kryesisht (apo vetëm) studentor. Vlen për t’u theksuar fakti se pasi studentët përfundojnë studimet e larta dhe shkëpusin lidhjet me shoqërinë e universitetit, ata i mënjanojnë fjalët dhe shprehjet tipike që përdorin më parë.

3. Punimi bën një përpjekje për të trajtuar e interpretuar, veçoritë e këtij “kodi ligjërimor” të të rinjve universitarë. Diferencat e sjelljes gjuhësore të studentëve në lidhje me leksikun specifik, kuptimet diferenciale të thënieve, shoqëruar nga analiza e proceseve fjalëformuese të cilave u nënshtrohen fjalët e shprehjet e përdorura prej të studentëve, janë drejtimet kryesore ku mbështetet studimi.

4. Pjesa më e madhe e gjendjeve të ndryshme gjuhësore është mbledhur nëpërmjet anketimeve me pyetësor apo atë spontan. Në studim morën pjesë 290 studentë të degëve të ndryshme studimi.

5. Duke u bazuar në analizën e tipareve gjuhësore të lartpërmendura arrihet në përfundimin se **veprimtaria ligjërimore është drejtpërdrejt e lidhur më çështjet psikologjike e sociologjike**. Sipas Rekanatit<sup>217</sup> (1981:19), aktet ilokucionare karakterizohen si akte shoqërore që karakterizohen nga marrëdhëniet, pra sjellja gjuhësore pasqyron sjelljen sociale. Lidhjet shoqërore të ruajtura përmes bashkëbisedimit shërbejnë:

- a) për të organizuar veprimin,
- b) për të lindur mirëkuptimin dhe
- c) për të shpërndarë informacion përmes grupeve të ndryshme shoqërore (Peer groups) ose komunitetit studentor.

Një përqindje e madhe e studentëve të anketuar, kanë pranuar se gjatë bisedave me miqtë e tyre të ngushtë, brenda (jo në klasë) dhe jashtë mjediseve universitare, ata përdorin shumë fjalë e shprehje të cilat shërbejnë si tregues të anëtarësisë së tyre shoqërore, duke nisur nga universiteti, si komuniteti më i madh shoqëror i studentëve, tek grupet shoqërore të studentëve në bazë fakulteti e departamenti, deri tek grupet e vogla sociale që krijohen midis studentëve të degëve të ndryshme ose grupet me bazë gjinore. Të gjitha shprehjet individuale ose të grupit shoqëror, zbulimet dhe sharjet dashamirëse ndaj anëtarëve të grupit social përdoren për të shprehur afrimet, dashuri, apo për humor, etj. Pra, lidhja midis realitetit dhe identitetit, rebelimi ose llojet e konsumimit, ndjenja e zhgënjimit dhe kërkimi i një statusi vetjak vlejné për të

---

<sup>217</sup> Rekanati (1981:19) dhe formula e tij e komunikimit: “Duke thënë një frazë në një situatë komunikimi, një folës kryen një lloj akti shoqëror, i përcaktuar prej marrëdhënies që ndërtohet me anë të thënies, mes folësit dhe auditorit”

përshkruar subkulturën e të rinjve, kjo shpjegon edhe shmangiet e tyre në rrafshin e zgjedhjeve gjuhësore.

6. Gjithashtu, në kuadër të implicititetit bisedor, veçoritë e këtij “kodi ligjërimor” të të rinjve universitarë duhet të përkrahen edhe nga çasti i ligjërimin, që do të thotë se **kjodukuri nuk mund të veprojë kudo dhe me këdo** (Dykro 1972 : 21). Të gjitha shprehjet të këtij ligjërimi duhet të jenë gjithmonë të përligjura nga disa rrethana jashtëgjuhësore, si: rrethana miqësore, shoqërore, familjare, intime, dhe jo në rrethana zyrtare e formale. Konteksti fizik, social e gjuhësor shpie në autonominë e akteve të ligjërimin studentor dhe mund të vlerësohet se “marrëdhënia bashkëbiseduese është element bazë i veprimit të organizuar që lidh bashkë individët në grup<sup>218</sup>”.

7. Koncepti i “vendit” (si një vend në vetvete) ose i vendndodhjes fizike dallon identitetin e subjekteve bashkëbiseduese. Kjo realizohet në aktin e bashkëbisedimit nëpërmjet çdo fjale e cila formulohet duke u nisur nga “çfarë jam unë për ty, cili je ti për mua”, gjithashtu duke respektuar kontekstin fizik. Marrëdhëniet sociale midis studentëve kushtëzohen më tepër nga vendi i realizimit të bisedës sesa nga elemente të tjera si për shembull: tematika e bisedës. Pra, mënyra e të folurit është kushtëzuar nga konteksti psiko-social dhe sjellja gjuhësore pasqyron sjelljen sociale. Në këtë mënyrë shpjegohen edhe shmangiet e studentëve në rrafshin e zgjedhjeve gjuhësore.

8. Të rinjtë, gjithmonë, kanë gjeneruar terma të ligjërimin të bisedor, si rezultat, kultura rinore, qëndrueshmëria relative dhe ndryshimi në krijimin e leksikut të të rinjve, është vendi i duhur për të studiuar këtë dukuri gjuhësore<sup>219</sup>. Termat e këtij “kodi” të posaçëm shprehjeje midis anëtarëve të rrethit shoqëror, kryesisht studentor, harrohen pas disa vitesh, pasi pas përfundimit të studimeve të larta përdoruesit e tyre i shkëpusin lidhjet me njëri-tjetrin, me shoqërinë e universitetit, dhe ata i mënjanojnë fjalët dhe shprehjet tipike që përdornin më parë. Ky pohim është vërtetuar nga studentët që vazhdonin ciklin e dytë të studimeve dhe si rezultat i shkëputjes nga shoqëria e “vjetër”, denduria e përdorimit të atij fjalori specifik ishte shumë e pakët.

9. Ky ligjërim karakterizohet nga tipare të shumta, si për shembull: **metaforat, perifrazat e figurshme e nofkat** për profesorët, lëndën që ata japin mësim, cilësitë e tyre morale, paraqitja e jashtme, mosha e natyra e karakteri; **shprehje ironizuese dhe etiketimet** për degën e studimeve, notat, provimet; **shtrembërimet e fjalëve; termat ofendues** për studentët e vitit të parë të studimeve, paraqitjes së jashtme; **figura letrare të çuditshme; shkurtimet e fjalëve e shprehjeve**. Si rezultat, zhargoni studentor pëson një zgjerim të brendshëm, në kuptimet e fjalëve, në thëniet e ilustrimet, etj.

10. Fjalori bisedor, i lirë studentor pasqyron tërësinë e ngjyimeve emocionale dhe strukturën kuptimore të fjalëve, sinonimet, homonimet e antonimet dhe vlerat e

---

<sup>218</sup> Allen dhe Guy, cituar nga Ghiglione dhe Trognon, 1993 : 267.

<sup>219</sup> Labov, T., *American Speech*, Vol. 67, No. 4 339-366, 1992, f. 65

shtresimet stilistikore, fjalëformimin, dialektizmat e terminologjinë. Prandaj, **nëpërmjet analizimit të fjalorit zbërthehen të gjitha ato njësi që zbulojnë lidhjet dhe përdorimin e fjalëve në gjuhën e gjallë, në ligjërimin studentor.**

11. Gjithashtu, për të qenë “ndryshe” nga të tjerët, të rinjtë përdorin një leksik evropian: **huazimet e fjalëve e togfjalëshave të huaja dhe përshëndetjet.** Rreth 30% e studentëve të anketuar pohuan se huazimet lindnin nga dëshira për t’u barazuar me të rinjtë evropianë. Huazimet janë kryesisht **huazime leksikore** (p.sh.: **look** {<anglisht} “ndaj e paska ndryshuar lookun kjo?”; **flash** {<anglisht} “erdhi e iku flesh”); **news** {<anglisht} “a ke ndonjë njuz për të thënë?”; por mund të jenë edhe **huazime gramatikore** (morfema fjalëformuese a struktura sintaksore të cilat shtjellohen më tepër në një nën-çështje tjetër). Sikurse u vu re nga shembujt e mësipërm, fjalët e huaja kanë pësuar **ndryshime në formë e në përmbajtje.** Fjalët e huaja janë marrë dhe përpunuar ashtu si fjalët shqipe. Fjalët që merren nga gjuhët e huaja i **nënshtrohen sistemit fonetik e gramatikor** të gjuhës marrëse, d.m.th. shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit të saj, eptohen sipas klasave gramatikore dhe sipas rregullave përkatëse. **Përdorimi i dendur i huazimeve** bën të lindë te të rinjtë bindja e të qënimit më të përparuar sesa shtresat e tjera të shoqërisë dhe kjo bindje **forcon solidaritetin** midis tyre dhe **ndjenjën e identifikimit.**

Zhargoni studentor karakterizohet nga të folme të thjeshta që “shquhen për një ngjyrë humoristike, si dhe nga një karakter fshehtësie jo të thellë”. Fjalët e ligjërimin bisedor në më të shumtën e rasteve janë sinonime me fjalët asnjane. Gjithashtu, shumë fjalë e shprehje të ligjërimin bisedor lidhen me jetën shkollore dhe jetën e përditshme. Përdorimi i tyre vihet re sidomos në të folur. Frazologjia gjuhësore e pasthirrmat janë karakteristikë për këtë ligjërim.

## KAPITULLI I PESTË

### Sociolekti i të rinjve në mjediset universitare të Vlorës

---

- a. Të folurit “Peer Groups” kundrejt përdorimit vetjak të gjuhës
  - 5.a.1 Përkufizime të ndryshme të Sociolektit
  - 5.a.2 Tipare të sociolektit.
  - 5.a.3 Gjuha e fshehtë e bashkësive gjuhësore studentore
  - 5.a.4 Përdorimi vetjak i gjuhës në marrëdhënie me gjuhën e grupit
- b. Ligjërimi i shkujdesur, pjesë e sociolektit studentor Vlonjat
  - 5.b.1 Përkufizime të ndryshme të Ligjërimin të shkujdesur
  - 5.b.2 Vendi dhe roli i ligjërimin të shkujdesur në gjuhën shqipe
  - 5.b.3 Funkcionet e ligjërimin të shkujdesur
  - 5.b.4 Përdorimet e ligjërimin të shkujdesur

Rast studimi 5

Njohja e termit dhe frekuenca e përdorimit të tij për:

etiketimin e njerëzve, sipas ndarjes gjinore dhe ndarjes Jug / Veri

b. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi dhe përdorimi i shprehjeve sinonimike të ligjërimin të shkujdesur

b.1. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi

b. 2. Përdorimi i shprehjeve sinonimike të ligjërimin të shkujdesur

Rast studimi 6

a. Etiketime në bazë të degës së studimit.

b. Etiketime për njerëzit

c. Etiketime për studentët sipas performancës akademike

d. Etiketime për aktivitetet shkollore

e. Etiketime për aktivitetet jashtëshkollore

Rast studimi 7

5. c .5 Vendi dhe roli i huazimeve në ligjërimin e shkujdesur

c. Gjuha e internetit dhe mesazheve elektronike

Përfundime

---

**a. Të folurit “Peer Groups” kundrejt përdorimit vetjak të gjuhës**

**5.a.1 Përkufizime të ndryshme të sociolektit**

Shpesh, grupmoshat e reja kanë "gjuhën" e tyre, i njohur me përkufizimin gjuhësor *Variacion i ligjëratës i përdorur nga një grup i caktuar*. Penelope Eckert (Penelope Eckert) shprehet se gjatë aktit të komunikimit realizohet një nga tiparet e rëndësishme të gjuhës: *transmetimi i kuptimit social*<sup>220</sup>. Katrin Loren Bishop (Catherine Lauren Bishop) cilëson sociolektin si *gjuha e një grupi social, sikurse bashkësia shoqërore e gjuhësore e studentëve*<sup>221</sup>. Trudgill përkufizon sociolektin si *varietet që më tepër përshkruan mjedisin shoqëror të folësve sesa origjinën e tyre gjeografike*<sup>222</sup>. Kështu, gjuha e përdorur pasqyron tipare të grupit shoqëror, ku përfshihen ndryshorët: *gjini, moshë, klasë shoqërore etj*<sup>223</sup>. Për këtë arsye termat sociolekt dhe dialekt social do të përdoren në mënyrë të ndërsjellë<sup>224</sup> në këtë punim.

Bashkësia shoqërore studentore dhe nëngrupet që e përbëjnë atë, kanë krijuar gjuhën e tyre, sociolektin, i cili njëkohësisht formëson dhe përforcon lidhjet shoqërore të grupit<sup>225</sup>.

Nga studimi mbi elemente të ndryshme të ligjërimit studentor vërehet se *zhargoni i përgjithshëm studentor, sociolekti, idiolekti, karakteristikat e ligjërimit sipas gjinisë e mjedisit administrativ, zbunimi, përkëdhelitë dhe “sharjet dashamirëse” zënë vend të veçantë në ligjërimin verbal të studentëve, duke i dhënë karakter bisedor komunikimit jashtë auditorit. Këto tre elemente janë dukuri me karakter gjuhësor e shoqëror dhe zbatoheshin në rrethana që buronin nga strategjia e ligjërimit. Ato ndjekin parimin e njohur: “Kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë dhe në cilin varietet”*.

**5.a.2 Tipare të sociolektit**

Sociolekti shënjon veçantinë e një grup shoqëror nga të tjerët. Ai pasqyron (a) marrëdhëniet e brendshme të grupit, (b) eksperiencën dhe përjetimet e individëve si anëtar të grupit<sup>226</sup>.

---

<sup>220</sup> Roberts, J., *Review of: Style and Sociolinguistic Variation by Penelope Eckert; John R. Rickford*, United States, 2003, f. 856.

<sup>221</sup> Bishop, L., *Investigating idiolect and youth sociolecty*, United States, 2008, f. 1.

<sup>222</sup> Trudgill, P., *A glossary of Sociolinguistics*, Oxford, 2002, f. 122.

<sup>223</sup> Lewandowski, M., *Sociolect and registers—A contrastive analysis of two kinds of linguistic variation*, Poloni, 2010, f. 61.

<sup>224</sup> Hudson, R. A., *Sociolinguistics*, Cambridge, 1996 f. 241.

<sup>225</sup> Lewandowski, M., *Sociolect and registers -A contrastive analysis fo two kinds of linguistic variation*, Poloni, 2010, f. 62.

<sup>226</sup> Grabias, S., *Jezyk wzachowaniach spolenczynch*, Lublin, 1994 , f. 239.

Nga pikëpamja sociologjike, do të theksonim se përdorimi i të njëjtës gjuhë brenda grupit jep ndjesinë e përkatësisë, e të qenët pjesë e një grupi të caktuar shoqëror. Komunikimi nëpërmjet një gjuhe të fshehtë, sa bisedore aq edhe e shkujdesur, përjashton nga bashkëbisedimi këdo që nuk i përket atij grupi shoqëror. Bisedat dhe pyetësorët e zhvilluar me studentë të grupeve të ndryshme shoqërore, evidentuan disa nga arsyet e variacionit gjuhësor për shkak të grupmohës së njëjtë:

- (1) të rrisin identitetin e tyre kulturor
- (2) të identifikohen me njëri-tjetrin
- (3) të përjashtojnë të tjerët nga grupi i tyre.

Një përqindje e madhe e studentëve të anketuar, kanë pranuar se në biseda me miqtë e tyre të ngushtë, brenda (jo në klasë) dhe jashtë mjediseve universitare, ata përdorin shumë fjalë e shprehje të cilat shërbejnë si tregues të anëtarësisë së tyre shoqërore, duke nisur nga universiteti, si komuniteti më i madh i shoqëror i studentëve, tek grupet shoqërore të studentëve në bazë fakulteti e departamenti, deri tek grupet e vogla sociale që krijohen midis studentëve të degëve të ndryshme ose grupet me bazë gjinore.

Sipas Grabias<sup>227</sup>, dallohen tre tipare kryesore të dialektit social të grupit:

**Fshehtësia**—aftësia për të kodifikuar informacionin në mënyrë që të jetë i kuptueshëm vetëm për anëtarët e grupit.

**Veçantia**—përdorimi i leksikut ndryshe nga ai i bashkësive të tjera gjuhësore.

**Aftësia shprehëse**—figurshmëria leksikore për të pasqyruar përjetimet e grupit, ku përfshihen: fjalët e reja apo kuptimet e reja që i bashkëngjiten fjalëve ekzistuese etj.

Shprehjet individuale ose të grupit shoqëror, zbunimet dhe sharjet dashamirëse ndaj anëtarëve të grupit social përdoren për të shprehur afrimitet, dashurinë, për humor etj. Pjesa më e madhe e këtij fjalori paraqet ngarkesë të madhe emocionale, duke u gërshetuar edhe me fjalë e shprehje të ligjërit të thjeshtë.

Ndërsa, Lewandowski<sup>228</sup> dallon tre shtresa të leksikut të grupit:

- (1) **Fshehtësia**—aftësia për të kodifikuar informacionin në mënyrë që të jetë i kuptueshëm vetëm për anëtarët e grupit.
- (2) **Veçantia**—përdorimi i leksikut ndryshe nga ai i bashkësive të tjera gjuhësore.
- (3) **Aftësia shprehëse**—figurshmëria leksikore për të pasqyruar përjetimet e grupit, ku përfshihen: fjalët e reja apo kuptimet e reja që i bashkëngjiten fjalëve ekzistuese etj.

---

<sup>227</sup> Shih po ai, po aty, f. 247.

<sup>228</sup> Lewandowski, M., *Sociolect and registers—A contrastive analysis of two kinds of linguistic variation*, Poloni, 2010, f 76.

Punimi ynë i ka pasur parasysh këto trajtesa teorike dhe të gjitha shtresat e leksikut janë shqyrtuar dhe pasqyruar në punim. Më poshtë paraqiten shembuj të fjalorit të grupit, gjuha e komunikimit të përditshëm dhe e folmja e fshehtë dhe analizim i detajuar i ligjërimit të shkujdesur, si pjesë e rëndësishme e sociolektit studentor.

(a) Grupi i parë: *zemra, o motër, hallall, arush, më shkule, je e paparë o gjë e egër, Ik vrit veten!; leje fare; unë jo se s'dua, po s'mundem; kontrollo pinin, të ka ikur fiqiri etj.*

(b) Grupi i dytë: *Dak dak; bukuleshk; amigo; kosmirënjohëse; portokaqielli; Sha bone, sha bone; hë la, më thuaj; Ta bën borxh ai/ajo; U prish dynjaja fare;*

(c) Grupi i tretë: *Bën sikur ke çliruar Shqipërinë!; Interestorante; Miza; uç- uç; shdukusu; e zeleşme; je legen (dashamirëse);*

(d) Grupi i katërt: *Kamiato; BMV portokalli; varja; mendje e ligë; Atë e di unë; palaço njeri; atë e di unë!; hajde nesër; puç – puç, o motër etj.*

(e) Grupi i pestë: *kuçe mia; qype; e zuri 5 mitushi; e me çupa; surrat shëmtut; daun; kokbosh; të kam pelltuqe; je shumë dele; hajde puthemi tashi;*

(f) Grupi i gjashtë: *ke punuar ndonjë çik sot; le nam; up the villa; I'm hopeless; je si qeni i komshiut tim; e çau tavanin me kokë; u... ga me lot; dëgjo këtu, ti dukesh edhe më bukur kur dëgjon sesa kur flet; a mos ja fut kot;*

(g) Grupi i shtatë: *më mirë mos fol e lerë të tjerët të mendojnë se je budalla sesa të flasësh e t'ua heqësh dyshimin; po iki pak deri në kryeministri (tualet); urithi; Tili; Doruntina; lëkurë gjarpri;*

(h) Grupi i tetë: *big ears; muçaço; ugly boy; idiot-thing; grupi; avadan; axhituese; beracaku; deformim nofullë; të të them një gjë unë ty; killeri; fol moj mirë; inkandeshenti; modeli; arbërore;*

(i) Grupi i nëntë: *lali, do dalim për një xhiro sot; shoqe na bëj një laik (ang. < like, shqip. < pëlqim); u plakëm në shkollë dhe asgjë nuk mësuam; si thua për një kofi breik (ang. < Coffee break, shqip. < për një kafe);*

(j) Grupi i dhjetë: *bufe; pilivesa; nxirre luanin; je prapa bote; fytyrëpatate (e shëndoshë); dhelpër (dinake); oratore; ecën si patok; o njish; i ka marë era trutë; trutharë; Simba;*

Brenda grupit, komunikimi është më i ngushtë, më i lidhur. P. Sh.: kur studentët takohen me njëri-tjetrin, përshëndeten në mënyra të ndryshme: *Ç'kemi plako? Si ke kaluar babush? Përshëndetje princeshë! Ku ishe se më mori malli? O buçkula ime...si të kam? Hë moj çupë, nga ke humbur ti? Ç'kemi zemra, ça do bëjmë sot? Do shkojmë për mësim apo për kafe? etj.*

Në shembujt e mësipërm, fjalët *plako*, *babush* dhe *princeshë* janë fjalë që shprehurin një emërtim në një mënyrë jo të drejtpërdrejtë por të nënkuptuar (*ang. sleng*), si p.sh.: *princeshë* nënkupton vajzë e bukur, e sjellshme.

Ndërkohë, secili grup shoqëror ka shprehjet e tij tipike dhe nga mbledhja e materialeve u vu re se shprehjet janë të ndryshme nga njëra-tjera. Ka dhe fjalë të cilat kanë përdorim të gjerë, si: “*O ëmbëlsirë*”, “*bukurane*”, “*O ylli*”, “*O seksi*”, “*O shpirti*”, “*O rrushi*”. Kuptimet e këtyre fjalëve dhe shprehjeve marrin ngjyrim humori dhe nuk keqkuptohen, sepse përdoren brenda një grupi, i cili e di qëllimin e përdorimit të tyre. Duhet të themi se leksiku që përdoret me shoqërinë e ngushtë dhe që është tipik i një grupi shoqëror të caktuar, paraqitet më tepër si shprehje dhe në fjali të plota Këtu përmendim fjalitë si: “*Dëgjo këtu ti, se dukesh më bukur kur dëgjon sesa kur flet*”, “*Më mirë mos fol e lëri të tjerët të mendojnë se je budalla sesa t’ua heqësh dyshimin*”, “*Po iki pak deri në kryeministri*”, “*O bjonde e ke radhën sonte*” etj.

Shembuj të tjerë janë:

Përshendetjet e djemve:

(A) *Ome naçu, e le orën e parë eeeee?!*

(B) *Ik ere...*

(C) *T’fala plakës.*

Përshendetjet e vajzave:

(A) *Paçim çupa. Shihemi nesër.*

(B) *Paçim piti logël.*

(C) *Paçim xhemla. Të dua çum – çum.*

(B) *Se duroj dot ktë k..... është xhelozë në kulm*

(C) *Shyqyr që iku se na çau .....*

Disa prej fjalëve të lartpërmendura përdoren nga shumë grupe shoqërore, në biseda mes miqsh apo në komunikimet virtuale ose mesazhet elektronike. Arsyeja më e shpeshtë e përdorimit të tyre është krijimi i atmosferës dhe ndjesisë e të qenit të ngjashëm dhe në një nivel. Tipar karakterizues i shembujve të lartpërmendur është edhe *baby talk*, i cili krijon më tepër afrimitet nëpërmjet përdorimit të gjuhës së fëmijëve.

Shumë studente pohuan se përdorimi i tillë i gjuhës është zbavitës dhe deri diku komik: “*Kur unë dhe shoqet e mia mbledhemi bashkë duket sikur jemi të huaja, pasi përdorim aq shumë shprehje që vetëm ne arrijmë ti kuptojmë. Kjo fillon që në momentin e parë që takohemi duke u përshëndetur me shprehjen tonë tipike: Ç’kemi çavol!*”

Nga vëzhgimet tona vërehet se 15 % e të anketuarve përdorin fjalë të huaja në vend të fjalëve shqip, për arsye të gjatësisë së fjalës, sidomos në rastet e përshëndetjeve:

**Tabela 5.1** Përdorimi i përshëndetjeve në gjuhë të huaja në vend të atyre shqip, në biseda joformale.

|                   |                         |
|-------------------|-------------------------|
| <i>Hi!</i>        | <i>Përshëndetje!</i>    |
| <i>What's up?</i> | <i>Si keni kaluar?</i>  |
| <i>Bye!</i>       | <i>Mirupafshim!</i>     |
| <i>Thanks!</i>    | <i>Faleminderit!</i>    |
| <i>See you!</i>   | <i>Shihemi më vonë.</i> |

Ndërsa, në tabelën e mëposhtme paraqiten fjalët dhe shprehjet angleze që përdoren më së shumti nga vajzat dhe djemtë studentë:

**Tabela 5.2** Përdorimi i fjalëve të huaja nga vajzat dhe djemtë në biseda joformale.

| <b>Djemtë</b>              | <b>Vajzat</b>        |
|----------------------------|----------------------|
| <i>See you later!</i>      | <i>Ciao!</i>         |
| <i>Run!</i>                | <i>Tezoro.</i>       |
| <i>The game is over!</i>   | <i>My love.</i>      |
| <i>Go now.</i>             | <i>Kiss- kiss.</i>   |
| <i>Bëj një like.</i>       | <i>Bëj një like.</i> |
| <i>Ma hoqe pinin fare.</i> | <i>Sms.</i>          |

Shembujt e pasqyruar nga grupet shoqërore paraqesin të njëjtën dukuri. Përdorimi i leksikut të tyre të veçantë ndodh vetëm në praninë e anëtarëve të grupit dhe sa më shumë shprehje apo fjalë me përdorim të kufizuar të ketë në gjuhën e tyre, aq më emocionues është komunikimi. Nëse ndodh që këto fjalë e shprehje të fitojnë përdorim përtej bashkësisë shoqërore që i përdor atëherë ato konsiderohen si të përditshme, si gjuhë e zakonshme dhe e humbasin ngjyrimin emocional.

Gjithashtu, duke u bazuar në shembujt dhe pohimet e lartpërmendur, mund të shprehemi se gjuha e grupit paraqitet si një shumësi idiolektesh të udhëhequra nga disa tipare tipizuese të përbashkëta.

### **5.a. 3 Gjuha e fshehtë e bashkësive gjuhësore studentore**

Pavarësisht përdorimit me tepri ose jo të elementeve gjuhësore të gjuhës së grupit, në këtë lloj komunikimi, bashkësitë e ndryshme gjuhësore të studentëve përdorin një sërë varietetesh gjuhësore duke nisur nga ato më të zakonshmet e deri tek ato që kanë një numër të kufizuar përdoruesish dhe karakter artificial<sup>229</sup>. Ekziston mundësia e përdorimit të një gjuhe informale brenda grupit. Ka raste kur gjuha në grup është aq e pasur me shprehje dhe fjalë indirekte sa që dikush që nuk është pjesë e grupit nuk arrin ta kuptojë bisedën. Ky tipar përcaktohet si **gjuha e fshehtë** që i përket një grupi të caktuar dhe ka për qëllim ruajtjen e fshehtësisë së mesazheve të përcjella ndërmjet anëtarëve të grupit dhe përjashton gjithë ata që nuk janë anëtarë të grupit shoqëror, duke forcuar kuptimin e identifikimit të atyre që janë brenda grupit. Pra, duke u përdorur për këtë qëllim, funksioni social i të folmeve të fshehta realizohet i plotë<sup>230</sup>.

*Grupe të ndryshëm studentësh kanë krijuar gjuhën e tyre të fshehtë (sekrete), duke i bashkangjitur fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme kuptime të cilat janë të kuptueshme vetëm për anëtarët e grupit. Më poshtë janë të ndara fjalët, shprehjet dhe kuptimet (të cilat i përkasin ligjërit të shkujdesur) përkatëse sipas grupeve të intervistuar:*

(a) Grupi i parë: *TKJ*, shprehje e përdorur midis vajzave dhe djemve, anëtarë të grupit, me kuptimin “*të kam jetë (të dua shumë)*”; *J.SH.B*, me kuptimin “*je shumë e bukur*”; *TKSHXH*, është shprehja e cila “përkthehet” në “*Tarzani kalon shumë xhungla*”, shprehje tjetër kjo që në vetvete mbart tjetër kuptim: *djalë që ka shumë të dashura*; *TKS*, shprehje me dy kuptime: “*të kam zemër*” dhe “*kafazi i zogut*”, kuptimi i dytë është i dyfishtë, sepse në këtë rast i referohet organit gjenital të femër, duke u kthyer kështu në shprehje të ligjërit të shkujdesur; “*s’jam për sonte*” është kuptimi i akronimit *SPS*; *Mos parko, vetëm për të shoqëruar*, kjo shprehje nënkupton se “*kur klasa është bosh, nuk duhet të hyjë askush përveç çifteve të dashuruara*” etj.

(b) Grupi i dytë: *MHB*, përveç kuptimit “*muhabet*” në gjuhën e fshehtë ka kuptimin “*më hahet bukë*”; *FLM*, është shkurtimi i fjalës “*faleminderit*”, por brenda grupit të ngushtë shoqëror merr kuptimin “*fli me mua*”; *Femra që është femër duhet ta mbajë vetën*, kjo është një shprehje që nuk do të thotë vetëm që “*vajzat duhet t’i kushtojnë rëndësi pamjes së tyre të jashtme*”, por kuptimi i vërtetët apo vazhdimi i saj është “*Femra që është femër duhet ta mbajë veten.....duhet të ketë patjetër një të dashur*”; ndërsa, kur djemtë duan të krijojnë lidhje jo serioze dhe me vajza që kanë pasur lidhje dashurore më përpara, atëherë ato përdorin shprehjen “*vetëm me patentë apo vetëm gra pa burra*” etj.

<sup>229</sup> Shkurtaç, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipës*, Tiranë, 2004, f. 187.

<sup>230</sup> Shih po aty, po ai, f. 194.

(c) Grupi i tretë: *do vete në shkollë nesër*, ku fjala shkollë ka kuptimin “i dashur” dhe e gjithë shprehja ka kuptimin e fshehtë “nesër do takoj të dashurin”; *do takoj Mirën*, gjithashtu ka kuptimin “do takoj të dashurin”; *do marrim kafe dhe karamele*, e more gazetën, të dyja këto fjalë nënkuptojnë “paketën e cigareve”; *linja në studio* (përqendrohu), *futu në linjë* (kur duan të tërheqin vëmendjen e dikujt), *e prupe kokën* (erdhe më në fund) etj.

(d) Grupi i katërt: *hë mo lale do dalim ndonjë xhiro sot*, nënkupton takim me të dashurin/dashurën ose kryerje të marrëdhënieve seksuale; *motra a ma bën një like*, kjo shprehje ka kuptim e aprovimit të mendimit; *si thua për një coffee break tani* dhe shprehja vazhdon (*se na lodhe*); *kape pak këtë foton këtu, grand fare është*; *po le nam o njeri* kur dikush nuk është veshur bukur; *sa vapë sot*, përdoret në rastet që një vajzë ka veshur fund shumë të shkurtër;

Shprehjet dhe fjalitë janë të ndërhuara sipas rregullave të sistemit gjuhësor, ndërsa fshehtësia leksikore që qëndron tek fjalët është tipari që karakterizon këtë lloj të foluri<sup>231</sup>. Grupe të ndryshme shoqërore përdorin shprehje të ndryshme nga njëri-tjetri, por ndodh që këto shprehje të përdoren nga disa grupe shoqërore, siç është: *Linja në studio* (tregohu më i vëmendshëm), *futu online* (kur duan vëmendjen e dikujt), *e prupe kokën* (erdhe më në fund), *o po ti e ke të pjekur në 24 orë 8 të rri sahati*; *u plakëm në këtë shkollë dhe asgjë nuk kemi mësuar* e shumë shprehje të tjera që i japin bisedës ngjyrim dhe e bëjnë atë më emocionale e “tërheqëse”.

Përdorimi i gjuhëve të fshehta është mjaft transparent, ndërsa formimi i tyre nuk është i tillë. Disa prej mënyrave për formimin e tyre, të përdorura nga studentët e Universitetit “Ismail Qemali”, dhe jo vetëm janë<sup>232</sup>: përmbysja e fjalëve, zëvendësimi apo shtimi i prapashtesave a i pjesëve të ndryshme me përbërje të fjalëve për të krijuar moskuptim nga ata që nuk e dinë kodin përkatës.

Shndërrimet më të shumta semantike të të folmeve të fshehta realizohen në fushën e leksikut.

(1) kalime semantike mbi bazën e metaforës, p.sh. *kungulli* për kokë etj.

(2) përdorimi i dendur i antonimisë, domethënë, fjala merr kuptimin e kundërt sidomos në ligjërimin femëror<sup>233</sup>, ato që quhen sharje dashamirëse apo përkëdheli ose të shprehura në formën e sharjeve lëvduese, p.sh. *mortje, shtrigë e keqe*.

***E folura e fshehtë*** mund të karakterizohet edhe ***sipas ndarjes gjinore***. Hulumentimi i shembujve të dhënë nga vajzat e djemtë për gjuhën e fshehtë nxori në pah se të dyja gjinitë përdorin dendur gjuhën e fshehtë në komunikimet ndërpersonale brenda të njëjtës gjini, pra, meshkuj - meshkuj, femra – femra. Le të shohim disa prej tyre:

<sup>231</sup> Shkurtaj, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipe*, Tiranë 2004, f. 204.

<sup>232</sup> Shih po aty, po ai, f. 196.

<sup>233</sup> Shih po aty, po ai, f. 197.

(meshkujt)

- s'kam ku e gjej **pllakën tani** ("pllaka" simbolizon armën)
- kemi mbetur **piramidë** (kemi mbetur pa lekë)
- ai **shoku ime** (e dashura)
- e **mirë ajo vera** ("vera" nënkupton lëndë narkotike)
- hëngra darkë të mirë mbrëmë** (krewa marrëdhënie seksuale)
- do **fus rrobat në lavatrice** (do kryej marrëdhënie seksuale)
- bëj kujdes se ke të zinj** (kujdes se është policia)
- ke **ndonjë gjë të mirë** (ke drogë)?
- më sill pak hekurin** ("hekuri" simbolizon "armë")
- me **atë ça bëre** (si e le muhabetin me të dashurën)
- e **solle porosinë** (kur pret diçka nga një shokë)
- e **solle plaçkën** ("plaçka" simbolizon "drogën") etj.

(femrat)

- e **moj ajo** ("ajo" simbolizon "ai" në mënyrë për mos u kuptuar)
- je lodhur ndopak?** (kopjove?)
- pive kafe mbrëmë?** (dole me të dashurin?)
- u bë vapë tani** (s'më pëlqen kush erdhi)
- ajo ka dalë me shoqen** (ka dal me të dashurin)
- shiko zogun që po fluturon** (shiko kush po kalon)
- folë me kushëririn** (folë me të dashurin)
- më shkruaj një mesazh** (ma përshkruaj atë djalin)
- po kalon zogu i Tunës** (vajzë skandaloze)
- sa mot i keq** (kur sheh ndonjë djalë të shëmtuar)
- hë djalë apo vajzë?** (si shkoj puna?): vajzë (mirë), djalë (keq)
- shtyhej me bukë** (ishte djalë i mirë)
- do ha specë** (do pi cigare)
- do blej çokollata** (do blej lines) etj.

Në ligjërimin e fshehtë mashkullor, mbizotërojnë shprehjet për substancat narkotike, të dashurën dhe marrëdhëniet seksuale, ndërsa në të folurën e fshehtë të

vajzave përdorim të gjerë kanë fjalët për të dashurin, dhe më pak shprehje për tematika të tjera. Pra, disa të folme të fshehta, më shumë sesa disa personave apo grupeve shoqërore të caktuara, u përkasin situatave a rasteve të caktuar.

Shumë prej të folmeve të fshehta të grupeve të ndryshme shoqërore të studentëve kanë si pjesë përbërëse të leksikut të tyre edhe fjalë të huazuara nga gjuhë të huaja, sidomos nga anglishtja, italishtja, greqishtja etj. Gjuha turke ka ndikim më të vogël, p. sh. *Asllan* për dikë që është i fortë, *llastik* për prezervativ etj.

Si element fshehtësie përdoret shpesh *-fri* etj., që u shtohet rrokjeve të çdo fjale<sup>234</sup>.

Si përfundim, këto të folme private ose gjysmëprivate krijohen në grupe të vogla dhe shumë të lidhura<sup>235</sup>. Ato shërbejnë për komunikimin e një numri të kufizuar njerëzish dhe në situata të caktuara të jetës së tyre dhe nuk përdoren gjithmonë<sup>236</sup>.

Këto të folme, edhe pse kanë në strukturën e tyre fjalë të huaja, bazohen në sistemin gramatikor të shqipes<sup>237</sup>. Pra, emrat, përemrat, foljet lakohen dhe zgjedhohen sipas gramatikës së gjuhës shqipe.

#### **5.a.4 Përdorimi vetjak i gjuhës në marrëdhënie me gjuhën e grupit**

Gjuha në sistemin e saj ofron mjetet gjuhësore për të shprehur mendimet, ndjenja, qëndrimet etj. Përzgjedhja e këtyre mjeteve gjuhësore përcjell informacione për folësin. Pra, elemente si intonacioni, zgjedhja e fjalëve, ndërtimet gramatikore, idiomat etj., pasqyrojnë kush jemi, nga vijmë, çfarë na pëlqen etj. Shumëllojshmëria e kombinimeve të këtyre tipareve gjuhësore pasqyrohet në repertorin vetjak të folësve<sup>238</sup>. Ndërsa, përdorimi i një grupi të caktuar tiparesh nga një grup shoqëror përbën stilin. Kështu, nga idiolekti kalohet në sociolekt. Sociolekti ka të bëjë me gjuhën, komunikimin dhe interpretimin e bisedave të ndryshme brenda një grupi të caktuar<sup>239</sup>. Në grupet shoqërore të studentëve mbizotërojnë më së shumti tipare gjuhësore të stilit të grupit dhe tiparet e idiolektit u nënshtrohen trysnisë së stilit ligjërimit të grupit. Kjo justifikohet me arsyen për t'u ndjerë pjesë e grupit.

Ndërsa, gjatë realizimit të komunikimit, studentët e anketuar si individë të veçantë folës nuk shfaqën vetëm “solidaritetin” gjuhësor me qëllim që të tregojnë përkatësinë në një grup apo bashkësi shoqërore të caktuar, por ata shfaqën edhe

---

<sup>234</sup> Ky element i formimit të gjuhës së fshehtë është trajtuar më gjerësisht në nënçështjen *Zhargoni studentor*, Kapitulli 4 dhe *Tipare morfologjike: proceset fjalëformuese*, Kapitulli 7.

<sup>235</sup> Shkurtaç, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 199.

<sup>236</sup> Shih po aty, po ai, f. 201.

<sup>237</sup> Shih po aty, po ai, f. 204.

<sup>238</sup> Johnstone, B., *The individual voice in language*, United States, 2000, f. 405.

<sup>239</sup> Shih po aty, po ai, f. 409.

individualitetin gjuhësor<sup>240</sup>. Pra, në ligjërimin e folur, studentët shfaqin konformizmin dhe solidaritetin gjuhësor.

Krahas shembujve të shumtë të përdorimit të gjuhës sipas ndarjes së bashkësive shoqërore, janë të shumtë rastet e tjera kur individi ruan gjuhën dhe identifikohet prej veçantisë së tij/saj gjuhësore duke përdorur në mënyrë të kufizuar fjalorin apo tipare të tjera gjuhësore. Të tilla janë:

**Student nga Lushnja:** *qyqja, të hëngërt mortja, se ja ke fut kot fare; mo surrat shëmtut; e re ti; boll hëngre o bark-derr; mnjesi; nontën për natën e mirë; jam romentik persën* [nga ang. < romantic person (njeri romantik)]

**Student nga Vlora (1):** *mos bëj kot; mos na fol me banalitetet tani; pelltuqe ose dele për njerëzit që ka inat; jam sedosur; ik o ik; ajd ciu tani; “xhaxhi”; “burri”; mizerje dreqit; çmontim minash; ku je moj motër;*

**Student nga Vlora (2):** *o vëlla; a derbar; kadal o kadal; I full you; hapu dhé; shpërthe aty; prindi femër; madhore; ex momooo; ndaje mendjen; interesing; delenxhesh; si farfalina që jemi; kush të ftoi ty në dasmë; ec or ec; ti të mek; unë të varros; andra; pa lidhje; picërrim i theksuar sysh; fiks o ça; qorre;*

**Student nga Fieri:** *O Zot i madh; ç’është ky kusur; e tha edhe radioja mbrëmë; u kënaqëm aman; mbaj mend kur kam qënë i ri...;*

Folësi shfaq në gjuhë individualitetin, pra shpreh diçka vetjake që e dallon nga të tjerët<sup>241</sup>. Strukturat e repertorit individual përfshijnë karakteristika si: timbri i zërit, karakteri vetjak, individual i të folurit njerëzor, përzgjedhja e fjalëve, ngjyrimet leksikore dhe strukturat gramatikore. Ato bëjnë që një folës të dallohet nga një tjetër në “tregun gjuhësor” sikurse e cilëson prof. Shkurtaj. Aty përfshihen të gjitha mënyrat e formulimit të mesazhit<sup>242</sup>. Kjo vlen më së shumti, në rastet e fjalëve përkëdhelëse, sharjet dashamirëse apo nofkat e gjuhën e fshehtë etj. Gjithashtu, të folurit individual paraqet edhe një informacion plotësues për folësin, p.sh. nga cili qytet / krahinë është.

Shprehjet individuale janë të shumëllojshme dhe të kuptimeve të ndryshme. Edhe në këtë rast mund të themi se gjen hapësirë dukuria e keqkuptimit ndërkulturor. Raste të tilla janë të shumta, si p.sh. *ti do rrahur njëherë, he moj bishtpërdredhur, ti je nam fare* etj.; por shprehje të tilla individuale përdoren në më të shumtën e rasteve në situata ku ato mund të kuptohen lehtë dhe nuk marrin kuptimin negative. Kemi shprehjen “*më mirë vonë sesa kurrë*” e cila mund të merret në kuptimin e saj të parë e pozitiv, por mund të përdoret dhe si ironi në situatën ku shprehja ka kuptimin se ndoshta është tepër vonë dhe nuk ka më vlerë të vazhdojë ato që janë për t’u bërë. Kemi shprehjet e tjera si “*a mo mos ja fut kot*”, “*uhhh, është si shpirt*”, “*nencnc sa e*

---

<sup>240</sup> Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2000, f. 77.

<sup>241</sup> Shih po ai, po aty, f. 77.

<sup>242</sup> Gumpers, J. S., *Linguistic and social interaction in two communities*, United States, 1964 f. 137.

*mirë njëra*” që gjithashtu kanë dy kuptime, pozitiv dhe negativ kur përdoret me ironi apo tallje.

Arsyet e mospërdorimit të shpeshhtë të tipareve të gjuhës së grupit janë të shumta dhe të ndryshme, si: mospëlqimi i fjalëve përkëdhelëse me tepri të cilat shpeshherë konsiderohen si lajka, dëshira për të qenë vetvetja apo të veçantë etj. Në këtë mënyrë, individi projekton veten e tij në ligjërim si folës<sup>243</sup>.

Gjuhëtarë si W. Von Humboldt<sup>244</sup> dhe K. Vossler<sup>245</sup> janë shprehur se ndryshimet në sistemin gjuhësor janë rezultat i zgjedhjeve krijuese të individit, duke theksuar kështu rëndësinë e individit në ligjërim. Individi përzgjedh tipare gjuhësore që formësojnë ligjërimin e tij: *çfarë thotë, si shprehet dhe çfarë kuptimi përcjell*. Por vullneti i tij / i saj për të zgjedhur kushtëzohet *nga kufizimet gramatikore dhe sociale*. Kufizimet gramatikore përfshijnë kuptueshmërinë e fjalisë apo mesazhit të transmetuar; ndërsa kufizimet sociale nënkuptojnë pranimin ose jo të tyre nga bashkësia gjuhësore<sup>246</sup>. Kur dikush përdor *llahtar, dreq edhe kjo punë, e ke myt* etj., paraqet një varg shkeljesh të normës gjuhësore dhe përcjell ngjyrimet individuale për të shprehur aprovim, kundërshtim apo konstatim.

E njëjta dukuri ndodh edhe në ligjërimin e brendshëm të grupit: fjalë dhe shprehje sinonimike me të folurin individual, të cilat paraqesin shmangie të normës letrare. Të gjithë mesazhet kanë referentë të ngjashëm dhe të kuptueshëm nga pjesa tjetër e bashkësisë gjuhësore, ndonëse shumë ndërtime janë jogramatikore. Natyrshëm lind pyetja: cili është funksioni i tyre në procesin e komunikimit?<sup>247</sup> Nëse përzgjedhja midis varianteve sinonimike apo gramatikore ose jogramatikore, i përket individit atëherë ngjyrimet e mesazheve të tij do të ishin të pakuptueshme për folësin dhe kjo do të çonte në keqkuptim ndërmjet interlokutorëve. *Përzgjedhja gjuhësore kushtëzohet nga marrëveshje gjuhësore të cilat shërbejnë për kategorizimin e ligjëratave joformale, teknike, vulgare, të drejtpërdrejta, humoristike etj.*

Pra, siç thekson studiuesi Gj. Shkurtaç *gjatë bashkëveprimit gjuhësor, bashkëbiseduesit veprojnë si individë dhe si anëtarë të grupit*<sup>248</sup>. Kur, si dhe pse individi përdor gjuhën dhe ligjërimin lidhet me qëllimin, situatën, tematikën dhe kontekstin social të realizimit të bisedës<sup>249</sup>. Edhe gjuhëtarët antropologë si Sapir<sup>250</sup>,

---

<sup>243</sup> Johnstone, B., *The individual voice in language*, United States, 2000, f. 405.

<sup>244</sup> Humboldt, W., *Linguistic variability and intellectual development*, Miami, 1971 f. 682.

<sup>245</sup> Vossler, K. *Positivismus und idealismus in der sprachwissenschaft*, United States, 1904, f. 278.

<sup>246</sup> Gumpers, J. S., *Linguistic and social interaction in two communities*, United States, 1964 f. 138.

<sup>247</sup> Shih po ai, po aty, f. 138.

<sup>248</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë 2000 f. 77.


<sup>249</sup> Johnstone, B., *The individual voice in language*, United States, 2000, f. 405.

<sup>250</sup> Sapir, E., *Selected writings of Edward Sapir in language, culture and personality*, California, 1949 f. 590.

Hymes<sup>251</sup> dhe Friedrich<sup>252</sup> në shumë punime të tyre kanë theksuar rëndësinë e përqasjes së gjuhës nga perspektiva individuale dhe sociale. Pra, vlerësohet folësi si individ dhe folësi si anëtar i një bashkësie shoqërore dhe gjuhësore. Sjellja gjuhësore e individit folës është gjithmonë e kushtëzuar nga pikëpamja shoqërore. Sipas Hymes, kompetenca gjuhësore është “aftësi personale” që realizohet në kontakte ndërpersonale gjuhësore<sup>253</sup>. Si rezultat, studimi i gjuhës së grupit shoqëror duhet të fillojë nga gjuha e individit. Kompetenca gjuhësore e individit është e ndryshme, ndërsa e studiuar si pjesë e grupit, ligjërimi i individëve shfaq ngjashmëri me të folurin e pjesës tjetër të grupit<sup>254</sup>.

Gjuha e çdo grupi paraqet ngjashmëri (shkurtime, zbulime, nofkat, mbisemantizim të kuptimit e deri tek elemente gramatikore), sikurse shfaqet edhe heterogjene në lidhje me ngjyrimin kuptimor, leksikon, gjuhën e fshehtë etj. Labov shprehet se “*gjuha e grupit ndryshon kur anëtarët e grupit përdorin struktura dhe modele të ndryshme për të komunikuar midis tyre*”<sup>255</sup>. Idiolekti dhe sociolekti, së bashku, varen nga kodi gjuhësor i përdoruesve. Kodi gjuhësor përfshin element sintaksor, semantik dhe pragmatik<sup>256</sup>.

**Si konkluzion**, studimi mbi këtë çështje rezultoi se 96 % e studentëve përdorin fjalë e shprehje që janë tipike të grupit të tyre shoqëror; ndërsa 4 % e tyre nuk shfaqnin interes në përdorimin e këtyre tipareve ligjërimore.



**Figurë 5.1** Përqindja e përdorimi të gjuhës së fshehtë brenda grupit shoqëror.

<sup>251</sup> Hymes, D., *In vain I tried to tell you: Essays in native American ethnopoetics*, Philadelphia, 1981, f. 74.

<sup>252</sup> Friedrich, P., *The language parallax: Linguistic relativism and poetic indeterminacy*, Texas, 1980, f. 86.


<sup>253</sup> Hymes, D., *In vain I tried to tell you: Essays in native American ethnopoetics*, Philadelphia, 1981, f. 99.

<sup>254</sup> Johnstone, B., *The individual voice in language*, United States, 200, f. 411.

<sup>255</sup> Labov, W., *Sociolinguistic Patterns*, Philadelphia, 1972, f. 277.

<sup>256</sup> Louwse, M., *Semantic variation in idiolect and sociolect: Corpus linguistics. Evidence from literary texts*, Memphis, 2004, f. 207-208.

Ndërsa, 79 % e studentëve apo grupeve shoqërore karakterizohen nga përdorimi i gjuhës së fshehtë brenda grupit. Ndërsa 21 % e të anketuarve paraqitën tipare të një gjuhë informale por jo të fshehtë apo me kuptime të dyfishta.



**Figurë 5. 2** Përqindja e përdorimi të regjistrit të veçantë por jo të fshehtë brenda grupit shoqëror.

Gjuha, apo mënyra e të folurit ndryshon në varësi të bashkëbiseduesit. Biseda e tyre është e mbushur me tema që atyre u intereson. Përdorimi i batutave dhe kuptimeve të veçanta të fjalëve e shprehjeve të ndryshme, i japin bisedës një ngjyrim emocional dhe joformal. Gjuha e grupit është një gjuhë spontane, është një fjalor i madh ku çdo fjalë ka shpjegimin e vet.

Ndonëse janë të shumtë shembujt, kur ligjërimi individual e shfaq individualitetin dhe origjinalitetin e tij në komunikim, ligjërimi i secilit student përfaqëson në një farë mase kulturën gjuhësore personale, por edhe atë familjare dhe të mjedisit administrativ nga vjen<sup>257</sup>. Si rezultat, ligjërimi individual, i parë nga këto dy këndvështrime, paraqet jo vetëm ndryshime por edhe ngjashmëri, si: fonetike apo leksikore në komunikim.

### **b. Ligjërimi i shkujdesur, pjesë e sociolektit studentor Vlonjat**

Sociolekti studentor, pa iu referuar ndonjë dallimi gjinor, administrativ, etj, karakterizohet nga në një pjesë të konsiderueshme të tij nga Ligjërimi i Shkujdesur<sup>258</sup>. Të rinjtë, gjithmonë, kanë gjeneruar terma të ligjërimin të shkujdesur, si rezultat, kultura rinore, qëndrueshmëria dhe ndryshimi në krijimin e leksikut të të rinjve, është vendi i duhur për të studiuar këtë dukuri gjuhësore.

Ligjërimi i shkujdesur dhe kodi i tij janë tregues të mirë për të dalluar largësinë shoqërore dhe kulturore të adoleshentëve nga grup-moshat e tjera, si dhe të vet grupeve të ndryshme midis adoleshentëve.

<sup>257</sup> Dorian, N. C., *Varieties of variation in a very small place: social homogeneity, prestige norms and linguistic variation*, United States, 1994, f. 634.

<sup>258</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 173.

Pikërisht në situatat, që do të klasifikohen në këtë nën çështje, të rinjtë dhe nëngrupet e tjera të kësaj kategorie përdorin leksik dhe stil të ngjashëm të të shprehurit dhe të komunikuarit, përse u përket ngjyrimeve që ata u japin termave dhe bisedave për eksperiencat e përditshme.

Trajtimi i kësaj teme ndihmon në analizimin dhe interpretimin në thellësi të karakteristikave të të folurit të lirë të kësaj kategorie; e cila gjithmonë është karakterizuar nga 1-përdorimi i të folurit të përditshëm duke i dhënë atij ngjyrime të ndryshme; 2-është burim i vazhdueshëm i procesit të fjalë-formimit; 3-ndryshimet e shumta gramatikore e fonetike të fjalëve dhe fjalive.

Objektivat gjuhësore të kësaj nënçështjeje janë:

- (a) Përcaktimi i vendit dhe rolit të ligjërimit të shkujdesur në gjuhë.
- (b) Funksionet e ligjërimit të thjeshtë në ligjërimin e folur studentor.
- (c) Përcaktimi i tipareve gjuhësore dhe sociolinguistike të këtij regjistri.
- (d) Paraqitja e situatës aktuale të ligjërimit të lirë në bashkësinë gjuhësore të studentëve.
- (e) Kategorizimi i lëndës gjuhësore (fjalë, fraza dhe ngjyrime kuptimore) sipas situatave të përdorimit.

### **5.b.1 Përkufizime të ndryshme të Ligjërimit të shkujdesur**

Janë të shumta përkufizimet për ligjërimin e shkujdesur të cilat paraqesin edhe kontradikta midis tyre. Ndër to mund të përmenden:

S. J. Hayakawa (1941:194-195) e quan slang *“poezinë e jetës së përditshme, e cila pasqyron me gjallëri emocionet njerëzore për jetën dhe eksperiencat e tyre”*. Ndërsa Walt Whitman e konsideron këtë ligjërim si *“pasqyrën e varfërisë mendore”*<sup>259</sup>.

Michael Adams shprehet se *“ligjërimi i shkujdesur nuk është thjesht fenomen leksikor, por një praktikë gjuhësore që buron nga sjelljet socioale të individëve dhe grupeve shoqërore. Ky ligjërim është shënjes i solidaritetit të grupit të shoqëror”*<sup>260</sup>.

Në fjalorin Merriam-Webster, botimi i II, paraqitet një përkufizim më i plotë dhe racional duke e cilësuar ligjërimin e shkujdesur si fjalor jo-standard, i përbërë nga fjalë dhe konotacione me karakter tërësisht informal dhe nuk njihet kufij fizikë apo rajonalë, i cili përbëhet më së shumti nga fjalë dhe shprehje të sajara ose fjalë që kanë pësuar ndryshime arbitrare, shkurtime, figura letrare që paraqesin kuptime me intesitet të lartë keqësues (pejorativ) që fitojnë përhapje të gjerë në bashkësinë

---

<sup>259</sup> Dumas, K. B., & Lighter, J., *Is slang a word for linguists?* United States, 1975, f. 5-17.

<sup>260</sup> Adams M. *Slang: the people's poetry*. [www.grammar.about.com/od/rs/g/slangterms.htm](http://www.grammar.about.com/od/rs/g/slangterms.htm)

gjuhësore ose dalin shumë shpejt nga përdorimi. Po aty shkruhet (f. 19 a/1) nuk ka asnjë test që të vërtetojë me objektivitet dhe plotësisht ligjërimin e shkujdesur, sidomos kur një fjalë studiohet jashtë kontekstit. Gjithashtu, asnjë fjalë nuk konsiderohet krejtësisht sleng, dhe shumë fjalë standarde mund të fitojnë konotacione ose përdorime të ligjërimin të shkujdesur. Ky pohim thekson idenë se ngjyrimet kuptimore janë faktor të rëndësishëm, por jo determinant të këtij ligjërimi.

Sipas American Heritage Dictionary (1969, f. xlvi) ligjërimi i lirë etiketohet më tepër si stil gjuhe sesa si regjistër apo nivel informaliteti. Tipari dallues i tij është qëllimi për të krijuar efekte retorike për të kundërshtuar, mosrepsektuar, apo ekzagjeruar. Një fjalë që shënjon vetëm kuptimin të drejtpërdrejtë (literal) nuk është slang. Ligjërimi i lirë gjithmonë karakterizohet nga konotacione të forta, përveç kuptimit të parë. Ngjyrimet janë të qëllimshme, shpeshherë agresive dhe joformale.

Ligjërimi i thjeshtë që përdoret nga studentët e Universiteti të Vlorës, pasqyron shumë prej tipareve të lartpërmendura, ndonëse nuk mund të përfshihet tërësisht vetëm në një prej përkufizimeve. Sikurse shprehet V. Burdova (2009: 13) ligjërimi i thjeshtë i studentëve është një stil jostandard komunikimi ndërmjet studentëve, i cili karakterizohet nga shumë tipare të cilat kushtëzohen nga vendi, koha, situatat ligjërimore etj. Krijuesit dhe përdoruesit janë të rinjtë studentë. Origjinaliteti, krijimtaria, informaliteti dhe mënyra jostandarde e shprehjes së emocioneve bëjnë që ky ligjërim të jetë një nga elementet gjuhësore të komunikimit studentor<sup>261</sup>.

### **5.b.2 Vendi dhe roli i ligjërimin të shkujdesur në gjuhën shqipe**

Ligjërimi i lirë është tipar i rëndësishëm i të rinjve. Disa studiues e cilësojnë atë si *gjuha e dytë*<sup>262</sup>, krahas asaj bisedore e cila pasqyron dallimin e kulturës dhe mentalitetit të të rinjve kundrejt brezave të tjerë më të mëdhenj në moshë.

Çdo brez i ri në kohë të ndryshme ka pasur kodin e vet të thjeshtë. Gjithashtu, çdo gjuhë ka ligjërim të shkujdesur, sepse çdo gjuhë ka në fjalorin e saj, fjalë që pranohen ose jo nga shumica e shoqërisë dhe dallohen nga popullariteti që fitojnë fjalët dhe shprehjet e këtij ligjërimi në gjuhë<sup>263</sup>.

Disa gjuhëtarë të tjerë, shpeshherë, e *etiketojnë ligjërimin e thjeshtë si regjistër*, që përdoret në situata të veçanta. Ky ligjërim lind dhe zhvillohet në shkollat e mesme dhe të larta, por ka përdorim të gjerë edhe në shumë situata informale. Rastet e studiuara tek studentët e Universitetit të Vlorës, vërtetojnë se ligjërimi i shkujdesur nuk është as gjuhë, dialekt apo regjistër i zakonshëm. Ligjërimi i thjeshtë, ose i quajtur ndryshe sleng, huazon një sërë termash nga regjistra të ndryshëm. “Bar”,

<sup>261</sup> Dumas, K. B., & Lighter, J., *Is slang a word for linguists?* United States, 1975, f. 5-17.

<sup>262</sup> Kratz, H., *What Is College Slang?* United States, 1964, f. 189.

<sup>263</sup> Juachoerin, *The grammar of Slan*, California, 2004, f. 5.

“tullë”, “e bardhë”, me kuptimin substanca narkotike, e kanë origjinën nga regjistri i përdoruesve të këtyre substancave, ndërsa “ke ndonjë të qerasme” e ka origjinën në ligjërimin e shkujdesur rinor.

Pra, Sleng-u huazon nga regjistrat sikurse gjuha huazon nga gjuhët e tjera apo nga dialektet e saj.

*Së pari*, ligjërimi i thjeshtë është burim për pasurinë e gjuhës me neologjizma. Është për t’u theksuar se funksioni shprehës realizohet i plotë në ligjërimin e shkujdesur. Gjithashtu, ky ligjërim shënjon shprehje të reja me kuptim keqësues (pezhorativ), sikurse janë etiketimet apo shënjimete me ngjyrim keqësues (pezhorativ) për përshkrimin e situatave, ngjarjeve, emocioneve apo njerëzve si: *dyrdymen*, *i mefshtë*, *handikapat* etj. Leksik i tillë mund të mos vlerësohet si tepër negativ për shkak të paqartësisë kuptimore.

*Së dyti*, ky ligjërim pasuron gjuhën me njësi kuptimore që krijon në të. Figurshmëria në gjuhë është burim për shumë prej kuptimeve të reja. Fjalët si *diamand* është diçka e mrekullueshme, *helmi* është kuptimi metaforik për alkoolin, *mirë* nënkupton “keq” nëse shprehet në mënyrë ironike. Ndodh që shumë kuptime u bashkëngjiten arbitrarisht fjalëve standard, p.sh: *zoçkë* është fjala e ligjërimi të lirë për “vajzë e re” dhe *pulë* ose *kollçkë* nënkupton “grua”.

Sikurse vërehet nga shembujt e lartpërmendur, secila fjalë shqiptohet dhe shkruhet njësoj si forma standard. Ajo çfarë ndryshon është kuptimi dhe konteksti i përdorimit.

*Së treti*, ligjërimi i shkujdesur pasuron gjuhën me forma të reja të fjalëve. Karakteristikë janë shumëllojshmëria e proceseve fjalëformuese të cilat janë të shumta. Të tilla janë: vendosja e morfemave brenda rrënjës, duke krijuar kështu një fjalë tjetër si: *unëu nukëu mësimëu*; disa forma të shkurtuara të fjalëve, si *celi* për celular, *neti* për internet etj.

Në dekadën e fundit, emri *pjeshkë* fitoi popullaritet në kulturën rinore me kuptimin e saj të dyfishtë: femër tërheqëse seksualisht. Sipas Mecken: “kur një risi fiton tepër popullaritet në bashkësinë gjuhësore, ajo rrallëherë konsiderohet si e tillë për një kohë të gjatë<sup>264</sup>”, p.sh. fjala *pjeshkë* me referencialin e ri “femër tërheqëse.” Shtrirja gjeografike e përhapjes së shënimit të dytë të kësaj fjale ishte shumë e madhe, sa që fitoi shumë shpejt një vend të rëndësishëm në fjalorin e të rinjve dhe jo vetëm. Tashmë, referenciali i dytë i fjalës *pjeshkë*, është i ngulitur në ligjërimin e shkujdesur, por ajo nuk përbën më risi, duke humbur kështu “magjinë” e saj. Ndoshta kjo ka ndodhur, sepse fjala shumë shpejt mori ngjyrim apo përdorim banal midis përdoruesve të saj.

Pra, figurshmëria që bie në sy në shumicën e fjalëve të këtij ligjërimi shfrytëzohet për të krijuar efekt nëpërmjet një të menduari jo të zberthyer, që bie në

---

<sup>264</sup> Mencken, H. L., *The American language*, New York, 1948, f. 644.

kundërshtim me modelet e gjuhës, por edhe me mendësinë shoqërore e më mirësjelljen e kohës.<sup>265</sup> Në rastin e përdorimit të ligjërit të shkujdesur, figurshmëria në gjuhë pasqyron këndvështrime të ndryshme të perceptimit të realitetit, marrëdhënieve sociale etj., duke përdorur struktura e variante të veçanta të leksikut, fonetikës, e gramatikës.

Po ashtu, konkludojmë se ligjërimi i shkujdesur nuk është një *e keqe* në gjuhë apo ka gramatikë të gabuar. Aty përfshihen fjalët për substancat narkotike, alkoolike, cigaret, marrëdhëniet seksuale sepse ato janë disa nga temat e bisedave dhe jetës së të rinjve.

### **5.b.3 Funksionet e ligjërit të shkujdesur**

Meqenëse, të rinjtë përballen me probleme të identitetit, të zgjedhjes së miqve me të cilët ndajnë të njëjtat vlera e qëndrime, dhe eksperiencat të përditshme, atëherë bashkësia folëse e studentëve e zgjeron repertorin e vet dhe nëpërmjet variacioneve ata shprehin dëshirat dhe parapëlqimet, veçantinë e grupit shoqëror, dhe prirjet e tyre krijuese me ngjyrimet të theksuara pozitive ose negative të fjalëve dhe shprehjeve<sup>266</sup>. Shumë prej termave të përdorura prej tyre, shprehin aprovim (hata fare/llahtar), kundërshtim (hiç), emërtojnë njerëzit (katundari, frikacaku etj), cilësojnë ngjarjet si të gëzueshme ose të mërzitshme (kot fare), të suksesshme ose të dështuara.

Gjatë bisedave të lira me studentë, u evidentuan disa faktorë, që janë më së shumti faktorë social sesa gjuhësor, të cilët ndikojnë në përdorimin dhe përhapjen e ligjërit të shkujdesur:

Informaliteti: pjesa më e madhe e ligjërit të lirë realizohet në situata dhe kontekste joformale.

- Informaliteti: pjesa më e madhe e ligjërit të lirë realizohet në situata dhe kontekste joformale.
- Risi.
- Nxitje e marrëdhënieve sociale.
- Krijim afriteti ose miqësisë së ngushtë.
- Përkatësi ose identifikimi i grupit. Për të treguar se janë anëtarë të një grupi të caktuar shoqëror.
- Përshkrim me konotacione të forta pozitive / negative për ngjarje, persona të ndryshëm etj.
- Jetë e shkurtër e leksikut dhe ngjyrimet kuptimore.

---

<sup>265</sup> Juachoerin, *The grammar of Slang*, California, 2004, f. 2.

<sup>266</sup> *Pragmatics, The Language in Class*, Ohio, 2007, f. 237.

Faktorët e fundit, sidomos faktori i fundit, paraqiten si “mënjanim (deviancë) gjuhësore e pranueshme” dhe në këtë mënyrë tregojnë se janë “në modë” ose siç shprehen studentët “trendy” ose “in fashion”.

Të gjitha fjalët dhe shprehjet që i përkasin këtij ligjërimi janë përzgjedhur nga dy burime: nëpërmjet pyetësorëve është mbledhur fjalori i studentëve të Universitetit të Vlorës dhe artikulli i realizuar nga gazeta Panorama<sup>267</sup>, interpretimet semantike të fjalorit të paraqitur në këtë artikull, iu prezantuan studentëve të cilët shprehën mendimin e tyre për përdorimin ose jo të atij korpusi fjalësh e shprehjesh, kuptimet që ata i bashkëngjisnin shprehjeve të ndryshme dhe sinonimet me shprehjet e dhëna.

Analizimi i situatave të ndryshme dhe vëzhgimet e bisedave informale, nxorën në pah edhe një arsye tjetër të përdorimit të këtij ligjërimi. Ligjërimi i shkujdesur krijohet edhe në kushtet kur biseda komunikuese realizohet nën presionin e emocioneve negative, si: stresi, inati, etj. Në këto kushte, bashkëbiseduesit shfaqën një ndërgjegje dhe identitet tjetër. Megjithatë, konteksti dhe ligjërimi i këtyre marrëdhënieve sociale, duket se pranohet dhe zbatohet lirshëm nga kultura rinore.

Dy tendenca u evidentuan në ligjërimin e shkujdesur:

1. Termat sleng vazhdojnë të konsideron si slang, edhe pas disa vitesh përdorimi.
2. Termat që zhduken, nuk përdoren më nga studentët.

Vlen për t’u përmendur fakti se kalimi i termave sleng nga nënkultura, të përfaqësuar nga grupe të ndryshme, te kultura mbizotëruese (dominante) e studentëve në nivel universitar, kushtëzohet nga bashkëveprimi midis këtyre dy grupeve.

#### **5.b.4 Përdorimet e ligjërimin të shkujdesur**

Afrimiteti ndërmjet bashkëbiseduesve të rinj është element kryesor në ligjërimin e thjeshtë. Në këtë rast ndodh zhvendosje ose gërshetim i elementeve gjuhësore ndërmjet dy ligjërimeve, *atij bisedor dhe të shkujdesur* (dukuri që në anglisht njihet me termin: code-switching midis ligjërimin bisedor and sleng). Gjatë bisedave joformale, në të cilat folësit bashkohen nga interesa të përbashkëta, ndodh që këto dy ligjërime të ndërthuren; leksiku gjallërohet nga kombinimi i fjalëve bisedore dhe të shkujdesura dhe një pjesë e konsiderueshme e informacionit shprehet nëpërmjet faktorëve jashtëgjuhësor.

Interesa të veçanta dhe aktivitet e ndryshme të studentëve, pasqyrohen nëpërmjet termave që studentët i krijojnë dhe prezantojnë si terma slang. Gjatë kategorizimit të termave sleng të mbledhura nga studentët e Universitetit të Vlorës, u përcaktuan tre kategori kryesore:

---

<sup>267</sup> Gazeta PANORAMA, *Të ndihesh “inorant” përballë një adoloshenti*, Tiranë, 2012, f. 1.

- (1) Kategoria e emërtimit dhe etiketimit të njerëzve.
- (2) Kategoria e përshkrimit të mënyrë pozitive / negative të njerëzve, aktiviteteve dhe vendeve.
- (3) Kategoria e përshkrimit të kohës së lirë, argëtimit (duke përfshirë mbrëmjet argëtuese, marrëdhëniet intime fizike, përdorimin e substancave alkoolike e narkotike).

Janë të pakta termat Sleng që përshkruajnë aktivitete shkollore, edhe pse studentët pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalojnë në universitet, por edhe shumë prej termave të këtij ligjërimi i përdorin në mjediset e universitetit, jashtë auditorit.

(a) Fjalë dhe shprehje për mësimet: *na janë bërë këto mësimet si burri i nënës; mësimet dhe vetëm mësimet* (për të shprehur lodhjen nga mësimet); *plasi bomba* (kur merret notë jo kaluese); provimi i mendjes (i psikologjisë); *kemi provimin e llapës ose gojës (të gjuhës shqipe)*;

(b) Fjalë dhe shprehje për notat: *mora katër këmbët e pulës/dhisë, morre një katranas, e marrë katijushk, më dha fshesën për këtë vit, nota 5 (pesë): e more një yll sot mora një peshore, pak e saktë mor burrë*; nota 8 (tetë): *me shaka i thërrasin teta-teta-teta, nënta e dhjeta marrim në shkollë*; 10 (dhjetë): *like a boss* (shprehje që përdoret kur dikush ka marrë vlerësim me notë dhjetë);

(c) Fjalë dhe shprehje për provimet: *erdhën sërish prapë mandatat/ të flamosurat, filloi stresi, do përmbysët bota tani apo erdhi dieta/ vdekja/ tufani* (filloi sezoni i provimeve), *filloi tortura, erdhi stuhia ose tani do bjej tërmet* (filloi provimi); *na iku petlla; më iku pini; erdhi ora e vdekjes*; (c.1) shkalla e vështirësisë së provimit: *e kishte bërë helm provimin, siç është vet [ (shumë i vështirë provimi); provim bastard*.

Shembuj të tjerë të ligjëritimit të thjeshtë, në lidhje me pedagogët, studentët e vitit të parë të studimit, apo konviktorët janë paraqitur gjerësisht në nënçështjen e *Zhargonit studentor vlonjat*.<sup>268</sup> Ligjërimi i shkujdesur përdoret për shumë arsye, por kryesisht ai shpreh qëndrime emocionale të folësit në lidhje me emërtimin e sendeve e veprimeve të njerëzve; për pjesët e trupit, paranë, ushqimet, përdorimin pijeve alkoolike apo narkotike, marrëdhëniet seksuale, dallimet raciale, sportin, muzikën etj.

**I/e dashur** ~ shpirti, honey, zemra ime, lepurshi/ja;

**Femër e përdalë** ~ pare e kuqe, laraskë pa bisht, kuçkë me shtatë koka

**Vajzë me shumë të dashur** ~ stan i pjerdhur, tren me rimorkio.

**Vajzë pa të dashur** ~ kilometër zero

**Djalë pa të dashur** ~ faqekuq, djalë i gjyshes

**Homoseksualët** ~ lule pranvere, pederast me mustaqe,

<sup>268</sup> Për të shmangur përsëritjen e kategorizimeve, shumë ilustrime paraqiten vetën në atë nënçështje.

**Substancave narkotike** ~ bitch, bar (hashash); e kuqe, bukë (heroinës); miell/ e bardhë/ tullë (kokaina);

**Marrja e substancave narkotike** ~ heq një vizë, ke ndonjë të qerasme, një i trazuar, një koktej.

Studentët përdorin terma të ndryshëm sleng për të njëjtin kuptim, por secili prej këtyre termave shpreh ngjyrim të ndryshëm në lidhje me termat e tjerë, p.sh.: *më iku truri, jam tym, e kam trurin me pushime, më iku zari* etj.

Ligjërimi i shkujdesur pasqyrohet si një stil gjuhë, që thyen rregullat e formalitetit, dhe qëllimi kryesor është krijimi i ngjyimeve kuptimore – emocionale. Nëse një fjalë përdoret në kuptimin denotativ, atëherë ajo nuk mund t'i përkasë ligjërimin të lirë, i cili karakterizohet nga përdorimi i konotacioneve të forta, të cilat janë të qëllimshme, shpeshherë agresive dhe joformale<sup>269</sup>.

Analizimi i termave apo shprehjeve Sleng, rezultoi në kategorizimin e disa nënkulturave midis studentëve të Universitetit të Vlorës:

✚ Nën-kultura e studentëve që mësojnë ose siç quhen ndryshe “*akademikët*”, “*budallenjtë*” apo “*truri*”;

✚ Nën-kultura e studentëve që kalojnë më shumë kohë duke u argëtuar (party—mbrëmje, etj);

✚ Nën-kultura e studentëve që konsiderohen si “normal” apo “të thjeshtë”, të quajtur në zhargonin studentor si “*masa*”, “*të shumtët*” apo “*askushi*”;

✚ Nën-kultura gjinore, duke përfshirë etiketimet që vajzat dhe djemtë përdorin për njëri-tjetrin apo shprehje që konsiderohen tipike për vajzat apo djemtë.

Pra, nënkulturat reflektojnë strukturën sociale të shkollës. Ato janë produkt i qëndrimeve, vlerave, e burimeve ekonomike të studentëve, prindërve të tyre, etj. Duke qenë se, studentët kalojnë shumë kohë në universitet, një pjesë të kohës në shtëpi, apo duke folur në telefon, kafene e ngjarje të ndryshme argëtuese; në të gjitha këto situata, ata vetëm flasin dhe në një farë mase përdorin edhe ligjërimin formal apo të shkujdesur.

Një nga vështirësitë e analizimit të Ligjërimin të Shkujdesur, ishte mungesa e studimit të plotë të këtij ligjërimi duke u mbështetur vetëm termat, kuptimet e mbledhura.

Përhapja dhe përdorimi i Sleng-ut, në përgjithësi, apo i termave të veçantë nga segmente të ndryshëm të studentëve janë elemente që kërkojnë studim të mëtejshëm e të thelluar, ndoshta në nivel më të gjerë sesa kampusi universitar, duke përfshirë kulturën rinore vlonjate. Kjo mund të konsiderohet si temë për studime të tjera.

<sup>269</sup> Dumas, B. K., & Lighter, J., *Is slang a word for linguists?* United States, 1978, f. 12-13.

Faktorë tjetër që pengoi identifikimin e plotë të termave Sleng, të studentëve të universitetit të Vlorës, ishte mjedisi administrativ dhe kultura gjuhësore e sociale që kanë studentët. Shumë prej tyre vijnë nga vende të ndryshme të Shqipërisë dhe bartin kulturën e vendlindjes së tyre (duke përfshirë kulturën shoqërore dhe familjare). Të gjithë këto elemente krijojnë një mjedis social heterogjen. Disa terma apo variante të tyre reflektojnë dialektin lokal apo rajonal. Gjithashtu, *stili vetjak i shfaqes së personalitetit* ndikon në stilin e ligjërimit, duke përfshirë zgjedhjen e fjalës, si: *mos e shqep, mbylle speqin* për mos fol më; por *vendndodhja sociale* (nëse individi është anëtar i grupit, lider apo përjashtuar nga grupi) është faktorë i rëndësishëm në analizimin e përdorimit të Ligjërimit të Shkujdesur.

Krahas përqsasjeve teorike, është realizuar analizimi praktik i ligjërimit të shkujdesur. Pyetësorët e ndryshëm të zhvilluar për këtë qëllim kishin synim:

- (a) Prezantimin sa më të plotë dhe të saktë të terminologjisë së ligjërimit të lirë të studentëve të Universitetit “Ismail Qemali”, në qytetin e Vlorës;
- (b) Kategorizimin i leksikut të këtij ligjërimit sipas tematikave të paracaktuara;
- (c) Analizimin e tipareve gjuhësore dhe sociale të këtij stili ligjërimit.

### **Rast studimi 5**

Për evidentimin e përhapjes dhe përdorimit të termave Sleng, u përdorën disa mënyra, p.sh.: 286 studentë të degëve të ndryshme u kërkua të qarkonin, midis 100 fjalëve të listës, ato terma Sleng që i përdornin në kampus. Ndërsa, 200 studentëve, të grupit prej 486 studentësh, u duhej që përveç qarkimit të shkruanin edhe kuptimin e termave.

Vështirësia në studimin e termave Slang lind nga fakti se Sleng gjendet më së shumti në ligjërimit verbal dhe rrallë ndodh që të shkruhet. Si rezultat, ekziston problemi i paraqitjes grafike të termave. Për shembull, termi *uotsap* (ang. < what’s up?), duhet të shkruhet si një apo dy fjalë?

Çështje të tjera në studimin e përhapjes së ligjërimit të shkujdesur në komunitetin studentor përfshijnë:

- (a) njohjen e termit dhe frekuenca e përdorimit të tij;
- (b) kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi;
- (c) frekuenca e përdorimit të termave;
- (d) përdorimi i termit sipas gjinisë;
- (e) përdorimi i leksikut në bazë të ndarjes Jug / Veri;
- (f) sinonimet e përdorura për terma;

(g) termat më tepër apo më pak të përdorur.

Për realizimin e mbledhjes së lëndës gjuhësore u anketuan 300 studentë të degëve të ndryshme në Universitetin e Vlorës.

**(A) Njohja e termit dhe frekuenca e përdorimit të tij.**


**Tabela 5.3 Përqindja e subjekteve që përdorin termat e ligjërimit të shkujdesur.**

| 1. Terma për njerëzit %     |      |                         |      | 2. Terma për “konsumimin e substancave narkotike dhe alkoolike” % |     |
|-----------------------------|------|-------------------------|------|---|-----|
| Zar                         | 9%   | Ai është 8 pa dhjetë    | 54%  | E tërheq  | 83% |
| Rozgo                       | 24%  | Skorpions               | 13%  | Është i bomë  | 75% |
| Hajdar                      | 16%  | Lekist                  | 96%  | I fus një tegel   | 64% |
| Pallosh                     | 77%  | Zog nate                | 8%   | E pi birrën me gjithë shishe                                      | 56% |
| Karallo                     | 15%  | Toç kuklle              | 6%   | E zezë  | 24% |
| Katunare prestigjoze        | 8%   | Lavazhier               | 3%   | Cigare e dredhur  | 88% |
| Bishë fare, Vajzë kopertine | 100% | Zdroms                  | 1%   | Qumësht pa ngjyrë   | 30% |
| Goc për shpi                | 81%  |                         |      | Uji me erë  | 29% |
| Çun tavoline ose nobël      | 46%  | 3. Termat e aprovimit % |      | Kafshatë që s’kapërdihet  | 23% |
| Kardinall                   | 7%   | Është fibër             | 84 % | E kuqe  | 76% |
| Llosh                       | 1%   | Pompozitet              | 17 % | Kallo   | 18% |
| Dari                        | 2%   | Trendy                  | 91 % | Çokollatë   | 54% |
| Rural                       | 11%  | E papame                | 92 % | Miell   | 84% |
| Alpin                       | 14%  | Gjigand                 | 29 % | Kërp  | 12% |
| Dashnor i rregullt          | 37%  | Është njish             | 41 % |   |     |

Ma. Dorian Klossi

|                                      |     |   |     |                         |     |
|--------------------------------------|-----|---|-----|-------------------------|-----|
| Bërthamë e thyer                     | 9%  | I ka vdek nona atij muhabeti  | 8%  |                         |     |
| Baloja ose qylaxhiu                  | 11% |   |     |                         |     |
| Kuçedra                              | 70% | <b>4. Termat e mungesës së aprovimit dhe ofendime të ndryshme.</b><br>% |     |                         |     |
| Karafil                              | 67% | Është për t'i fut çorapen në gojë                                       | 24% | Rrangallë               | 56% |
| Zjarrmi                              | 65% | Na zuri treni ose autobuzi  | 16% | E ke hap krahun         | 44% |
| Tutorë                               | 5%  | Vari teneqen  | 65% | Na ka fik derën         | 28% |
| Fashkull                             | 9%  | Haspi karalloi  | 6%  | Do të shkrij komplet    | 9%  |
| Brigadieri ose shefi i rrobaqepësisë | 5%  | Të tërheq zvarrë / të thy në mes / të çaj gojën                         | 94% | Drazhlla                | 2%  |
| Parkingu i vjetër                    | 16% | Aut   | 80% | Ka mërdhif              | 13% |
| Bundër                               | 4%  | Jashtë orbite   | 87% | I ka fut ujë komerdarja | 11% |
|                                      |     | Të honkshin qentë   | 21% | Gore                    | 7%  |

Rezultatet e mësipërme tregojnë frekuencën e përdorimit të termave dhe shprehjeve të ndryshme për të etiketuar njerëzit, për substancat narkotike dhe alkoolike, termat e aprovimit dhe të kundërshtisë. Në bisedat joformale, termat dhe frazat e ligjërimit të shkujdesur, vërehet një diferencë e madhe në përdorimi e tyre. Termi më i përdorur për etiketimin e njerëzve, pozitiv apo negativ, është *bishë fare*, 100 %, i cili pasohet nga *lekist* 96 %, *katundare* 81 %, *pallosh* 77 %, *kuçedra* 70 % etj. Termat më pak të përdorur në këtë kategori janë: *zdroms* 1 %, *lloshi* 1%, *dari* 2 %, *lavazhier* 3 %, *bundër* 4 %, *toç kuklle* 6 % etj.



Figurë 5.3 Termat më shumë dhe më pak të përdorur për etiketimin e njerëzve.

Terma të tjerë që përdoren shpesh në ligjërimin verbal joformal në tematika të veçanta, si “konsumimi i lëndëve narkotike apo alkoolike” janë: *cigare e dredhur, e tërheq, miell, është i bërë, e kuqe* etj.

Gjithashtu, mbi 80 % e studentëve i përdorin ose i njohin këto terma.

*Trendy, i paparë*, janë dy termat më të përdorur për përshkrimin e njerëzve dhe situatave.

Termt kryesor për të shprehur kundërshti apo ofendim janë *të thyej në mes* 94 %, *jashtë orbite* 84 %, *aut* (ang. <out, shqip. < dikush që nuk është mirë nga ana mendore) 80 %, të cilët ndiqen nga terma të tjerë si *varja* 65 %, *rrangallë* 56 %. Të rinjtë studentë, shpeshherë, u shprehën se në ligjërimet e tyre dëgjohen dhe përdoren më tepër terma kundërshtues dhe ofendues, sesa terma aprovues. Tiparet paragjuhësore, si toni i zërit, shpeshherë merr ngjyrime tallëse dhe ironike, ndërsa mimika dhe gjuha e trupit etj., përdoren në funksion të qëllimit të tyre ligjërimor. Këto elemente jogjuhësore ndihmojnë që një term me denotacion pozitiv të fitojë ngjyrime negative. Në këto raste, dukuria e ndërsjellë e ndryshimit të ngjyrimeve kuptimore nuk realizohet. Sikurse paraqitet në tabelë, studentët njohin dhe përdorin një numër të madh shprehjesh kundërshtuese, ofenduese sesa aprovuese.

Konkluzioni i mësipërm mund të kushtëzohet edhe nga fakti që studentët u prezantuan me një numër të caktuar shprehjesh. Për këtë arsye, do të përcaktojmë se përfundimi i arritur vlen vetëm për ato terma me denotacion pozitiv që fitojnë ngjyrim keqësues (pezhorativ). Pra, studimi nuk tregon se leksiku i ligjërimin të shkujdesur përdoret më tepër si shënjes negativ sesa pozitiv apo që gjuha e nënkulturave shoqërore studentore ka më tepër ngjyrim dhe përdorime negative.

**Tabelë 5.4 Përqindja e njohjes ose jo të kuptimit të termave të ligjërimin të shkujdesur (djem: 140, vajza: 160)**

| <b>Përkufizimi i termave dhe shprehjeve</b>                      | <b>% e studentëve që kanë shprehur të njëjtin kuptim</b> | <b>% e kuptimeve të tjera</b> | <b>% e studentëve që nuk kanë përcaktuar asnjë kuptim</b> |
|--|--|-------------------------------|---|
| <i>E tërheq</i> (merr substanca narkotike)                       | 87 %   | 2 %                           | 1%  |
| <i>Katunare luksoze</i> (vajzë që do të bëhet me doemos moderne) | 88 %   | --                            | 12 %  |
| <i>Zar</i> (servil)  | 9 %  | 52%                           | 39 %  |
| <i>Ta çaj gojën</i> (lloj kërcënimi)                             | 92 %   | --                            | 8 %   |
| <i>Të thyej në mes</i> (lloj sharjeje)                           | 90 %   | --                            | 10 %  |

*Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës*

Ma. Dorian Klossi

|   |       |      |      |
|---|-------|------|------|
| <i>Të tërheq zvarë</i> (mënyrë për të treguar forcën)   | 93 %  | --   | 7 %  |
| <i>E vdes fare</i> (kur bënë diçka shumë mirë)  | 62 %  | 27 % | 11 % |
| <i>E myt komplet</i> (ke nderuar veten)   | 49 %  | 37 % | 16 % |
| <i>Rozgo</i> (i rëndomtë)   | 24 %  | 58 % | 18 % |
| <i>Hajdar</i> (i paaftë)  | 16 %  | 48 % | 42 % |
| <i>Pallosh</i> (i trashë)   | 77 %  | 16 % | 7 %  |
| <i>Më ka ik petlla</i> (jam shumë i shqetësuar)   | 82 %  | 10 % | 8 %  |
| <i>Punon</i> (merret me punë të pista)  | 52 %  | 34 % | 14 % |
| <i>Si 200</i> (djalë i prapambetur në mendime dhe paraqitje)                                  | 53 %  | 34 % | 13 % |
| <i>Palltek</i> (lloj sharjeje që përdorin të rinjtë midis tyre)                               | 24 %  | 55 % | 21 % |
| <i>Karallo</i> (budalla, jo i zgjuar)   | 15 %  | 67 % | 18 % |
| <i>Mos më çaj tallamandrën</i> (mos më mërzit shumë)  | 73 %  | 20 % | 7 %  |
| <i>Katunare prestigjioze</i> (vajzë që përpiqet të jetë në modë)                              | 81 %  | 12 % | 7 %  |
| <i>Është gabriela</i> (rrobë e përdorur dhe e blerë me çmim të lirë)                          | 51 %  | 11 % | 38 % |
| <i>Me haspi</i> (gjasme)  | 16 %  | 9 %  | 76 % |
| <i>Është bishë fare</i> (vajzë tërheqëse seksualisht)   | 100 % | --   | --   |
| <i>Dredhje beli</i> (e anashkalon bisedën)  | 15 %  | 70 % | 15 % |
| <i>Është fibër</i> (vajzë me trup të bukur)   | 95 %  | --   | 5 %  |
| <i>Vari teneqen</i> (mos i jep rëndësi)   | 64 %  | 12 % | 24 % |
| <i>Duam harem</i> (festë)   | 83 %  | --   | 17 % |
| <i>Na zuri treni ose autobuzi</i> (u mërzitëm me atë lloj bisede)                             | 24 %  | 55 % | 21 % |
| <i>Dhe produkte të tjera ushqimore</i> (shprehje për t'i dhënë fund një bisede të mërzitshme) | 7 %   | 36 % | 59 % |
| <i>Më fal se të fika llullën</i> (me ironi: të bezdisa)                                       | 12 %  | 33 % | 54 % |
| <i>U fiksova fare</i> (e humba toruan)  | 74 %  | --   | 26 % |
| <i>Ka në mend me e mor</i> (do të fejohet me...)  | 82 %  | --   | 18 % |
| <i>Për ty boj pesë vjet burg</i> (mënyrë për të   | 64 %  | --   | 36 % |

*Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës*

Ma. Dorian Klossi

|  |       |      |      |
|--|-------|------|------|
| ngacmuar vajzat)   |       |      |      |
| <i>Për Zotin</i> (lloj betimi)                                   | 100 % | --   | --   |
| <i>Hahet</i> (vajze/djalë simpatik)                              | 32 %  | 41 % | 27 % |
| <i>Bashkëjeton një herë në javë</i> (takohen rrallë)             | 17 %  | 63 % | 20 % |
| <i>Të rrafitë ngordhja</i> (mallkim)                             | 63 %  | 20 % | 17 % |
| <i>Ia fut për kënaqësi</i> (flet përçart)                        | 73 %  | 16 % | 11 % |
| <i>Për shkepje</i> (për argëtim)                                 | 17 %  | 20 % | 63 % |
| <i>Ai është: hyr, mirë ardhsh, mirë se të gjeta</i> (nuk kupton) | 63 %  | 20 % | 17 % |
| <i>Na u llash trapa</i> (u mërzitëm duke pritur)                 | 59 %  | 26 % | 15 % |
| <i>Futja vrapit</i> (ik se na mërзите)                           | 52 %  | 49 % | 9 %  |
| <i>Ka mërdhif</i> (ka mbaruar komplet si njeri)                  | 64 %  | 27 % | 9 %  |
| <i>Paske dalë kabriolet</i> (për një vajzë me bluzë dekolte)     | 91 %  | --   | 9 %  |
| <i>Ballkon</i> (për vajzat që kanë gjoks të madh)                | 81 %  | 12 % | 7 %  |
| <i>Lici</i> (polici)   | 75 %  | 18 % | 7 %  |
| <i>Bordellacion</i> (shkolla)                                    | 49 %  | 37 % | 24 % |
| <i>Tdf</i> (të dua fort)   | 91 %  | --   | 9 %  |
| <i>Hallat nga Amerika</i> (mestruacionet)                        | 44 %  | 29 % | 27 % |
| <i>Kthesa e Kamzës</i> (vajzë me këmbë të shtrembërta)           | 66 %  | 25 % | 19 % |
| <i>Pompa</i> (zemra)   | 73 %  | 22 % | 5 %  |
| <i>Kuti votimi</i> (vajzë që ka pasur shumë të dashur)           | 75 %  | 21 % | 4 %  |

Tabela e mësipërme paraqet përqindjen e subjekteve që i njohin termat e ligjërimit të shkujdesur dhe kuptimet që shënjojnë këto terma dhe fraza. Në shumicën e rasteve, studentët kanë shprehur të njëjtin kuptim sikurse shembulli i dhënë. Në raste të tjera, si *palltek*, *hajdar*, *karallo*, *dredhje beli* etj., studentët e anketuar shprehën më tepër se një përkufizim, përveç kuptimit të dhënë. Vetëm dymbëdhjetë terma nga pesëdhjetë terma të pyetësorit u përcaktuan vetëm me një kuptim: *për Zotin*, *katundare luksoze*, *të çaj gojën*, *të thyej në mes*, *paska dalë kabriolet* etj. Ndërsa, frazat *me haspi*, *dhe produkte të tjera ushqimore*, *për shkepje* kanë përqindjen më të lartë të mospërcaktimit të asnjë kuptimi.

Këto rezultate tregojnë variacionin e përdorimeve apo kuptimeve të reja që përftojnë termat dhe frazat, ose zbehjen e kuptimeve të vjetra ose hamendësimet në lidhje me kuptimet e leksikut të dhënë. Çështje kryesore e studimit tonë është shqyrtimi i dallimeve apo tipareve të termave sleng sipas ndryshorëve: *gjini, mjedis gjeografik*. Lënda gjuhësore nuk është analizuar sipas klasës sociale dhe ekonomike të studentëve dhe familjeve të tyre.

**Tabela 5.5 Leksiku i ligjërimit të shkujdesur që njihet më tepër nga djemtë dhe vajzat.**

| <b>Leksik që njihet më tepër nga djemtë (nr=140)</b>             |                               |                                  |
|--|-------------------------------|----------------------------------|
|  | % e djemve që njohin leksikun | % e vajzave që e njohin leksikun |
| <i>Zar</i> (servil)  | 24 %                          | 6 %                              |
| <i>Ta çaj gojën</i> (lloj kërcënimi)                             | 88 %                          | 41 %                             |
| <i>Të thyej në mes</i> (lloj sharjeje)                           | 78 %                          | 38 %                             |
| <i>Të tërheq zvarë</i> (mënyrë për të treguar forcën)            | 59 %                          | 41 %                             |
| <i>E vdes fare</i> (kur bënë diçka shumë mirë)                   | 67 %                          | 33 %                             |
| <i>Rozgo</i> (i rëndomtë)  | 31 %                          | 14 %                             |
| <i>Hajdar</i> (i paaftë)   | 22 %                          | 9 %                              |
| <i>Pallosh</i> (i trashë)  | 81 %                          | 54 %                             |
| <i>Pompa</i> (zemra)   | 95 %                          | 5 %                              |
| <i>Kthesa e Kamzës</i> (vajzë me këmbë të shtrembërta)           | 40 %                          | 10 %                             |
| <i>Bordellacion</i> (shkolla)                                    | 78 %                          | 22 %                             |
| <i>Për shkepje</i> (për argëtim)                                 | 36 %                          | 22 %                             |
| <i>Ai është: hyr, mirë ardhsh, mirë se të gjeta</i> (nuk kupton) | 85 %                          | 15 %                             |
| <i>Na u llash trapa</i> (u mërzitëm duke pritur)                 | 78 %                          | 22 %                             |
| <i>Futja vrapit</i> (ik se na mërzite)                           | 66 %                          | 34 %                             |
| <i>Ka mërdhif</i> (ka mbaruar komplet si njeri)                  | 89 %                          | 11 %                             |
| <i>Paske dalë kabriolet</i> (për një vajzë me bluzë dekolte)     | 88 %                          | 23 %                             |
| <i>Ballkon</i> (për vajzat që kanë gjoks të                      | 66 %                          | 54 %                             |

*Çështje të variacionit gjuhësor në mjedisin universitar të qytetit të Vlorës*

Ma. Dorian Klossi

|  |      |      |
|--|------|------|
| madh)  |      |      |
| <i>Lici</i> (polici)   | 76 % | 24 % |
| <i>Për shkepje</i> (për argëtim)                                 | 36 % | 22 % |
| <i>Ai është: hyr, mirë ardhsh, mirë se të gjeta</i> (nuk kupton) | 85 % | 15 % |
| <i>Bashkëjeton një herë në javë</i> (takohen rrallë)             | 38 % | 17 % |
| <i>Të rraftë ngordhja</i> (mallkim)                              | 12 % | 5 %  |
| <i>Ia fut për kënaqësi</i> (flet përçart)                        | 88 % | 22 % |
| <i>Ka në mend me e mor</i> (do të fejohet me...)                 | 61 % | 39 % |
| <i>Për ty boj pesë vjet burg</i> (mënyrë për të ngacmuar vajzat) | 83 % | 17 % |
| <i>Vari teneqen</i> (mos i jep rëndësi)                          | 92 % | 85 % |
| <i>Duam harem</i> (festë)  | 67 % | 33 % |
| <i>Me haspi</i> (gjasme)   | 24 % | 6 %  |
| <i>Është bishë fare</i> (vajzë tërheqëse seksualisht)            | 99 % | 90 % |
| <i>Dredhje beli</i> (e anashkalon bisedën)                       | 25 % | 12 % |
| <i>Vari teneqen</i> (mos i jep rëndësi)                          | 92 % | 85 % |
| <i>Duam harem</i> (festë)  | 67 % | 33 % |
| <i>Kuti votimi</i> (vajzë që ka pasur shumë të dashur)           | 95 % | 5 %  |
| <i>Rozgo</i> (i rëndomtë)  | 31 % | 14 % |
| <i>Hajdar</i> (i paaftë)   | 22 % | 9 %  |
| <i>Pallosh</i> (i trashë)  | 81 % | 54 % |
| <i>Më ka ik petlla</i> (jam shumë i shqetësuar)                  | 84 % | 72 % |
| <i>Punon</i> (merret me punë të pista)                           | 66 % | 34 % |
| <i>Si 200</i> (djalë i prapambetur në mendime dhe paraqitje)     | 69 % | 7 %  |
| <i>Palltek</i> (lloj sharjeje që përdorin të rinjtë midis tyre)  | 24 % | 7 %  |
| <i>Karallo</i> (budalla, jo i zgjuar)                            | 29 % | 10 % |

|   |                               |                                  |
|---|-------------------------------|----------------------------------|
| <i>Mos më çaj tallamandrën (mos më mërzit shumë)</i>  | 84 %                          | 16 %                             |
| <b>Leksik që njihet më tepër nga vajzat (nr=160)</b>  |                               |                                  |
|   | % e djemve që njohin leksikun | % e vajzave që e njohin leksikun |
| <i>E myt komplet (ke nderuar veten)</i>   | 32 %                          | 52 %                             |
| <i>Katunare luksoze (vajzë që do të bëhet me doemos moderne)</i>                              | 25 %                          | 75 %                             |
| <i>Tdf (të dua fort)</i>  | 33 %                          | 79 %                             |
| <i>Hallat nga Amerika (mestruacionet)</i>   | 12 %                          | 88 %                             |
| <i>Për Zotin (lloj betimi)</i>  | 42 %                          | 68 %                             |
| <i>Hahet (vajze/djalë simpatik)</i>   | 43 %                          | 57 %                             |
| <i>Dhe produkte të tjera ushqimore (shprehje për t'i dhënë fund një bisede të mërzitshme)</i> | 4 %                           | 17 %                             |
| <i>Më fal se të fika llullën (me ironi: të bezdisa)</i>                                       | 5 %                           | 11 %                             |
| <i>U fiksova fare (e humba toruan)</i>  | 50 %                          | 62 %                             |
| <i>Na zuri treni ose autobuzi (u mërzitëm me atë lloj bisede)</i>                             | 12 %                          | 26 %                             |
| <i>Për Zotin (lloj betimi)</i>  | 42 %                          | 68 %                             |
| <i>Është fibër (vajzë me trup të bukur)</i>   | 86 %                          | 89 %                             |
| <i>Është gabriela (rrobë e përdorur dhe e blerë me çmim të lirë)</i>                          | 15%                           | 95 %                             |
| <i>Katunare prestigjoze (vajzë që përpiqet të jetë në modë)</i>                               | 21 %                          | 79 %                             |
| <i>E myt komplet (ke nderuar veten)</i>   | 32 %                          | 52 %                             |
| <i>Katunare luksoze (vajzë që do të bëhet me doemos moderne)</i>                              | 25 %                          | 75 %                             |
| <i>E tërheq (merr substanca narkotike)</i>  | 48%                           | 70 %                             |

Në tabelën e përcaktimit të njohjes dhe përdorimit të leksikut të ligjërimit të shkujdesur sipas gjinisë frazat më të përdorura nga djemtë studentë janë: *tërheq, ta çaj gojën, pompa, kthesa e Kamzës, ka mërdhif, ka dalë kabriolet, vari teneqen, është*

*bishë, kuti votimi etj. Ndërsa, është fibër, u fiksova, për Zotin, hallat nga Amerika, katundare etj., janë frazat më të njohura nga vajzat studente.*

*Më fal se të fika llullën, produkte të tjera ushqimore, janë dy frazat më pak të njohura dhe më pak të përdorura nga vajzat e anketuara. Është e vështirë të shpjegohet pse termi e tërheq, që përdoret për përdorimin e substancave narkotike, njihet më tepër nga vajzat sesa nga djemtë. Gjithashtu, është e paqartë pse frazat për Zotin, u fiksova fare, është fibër, njihen më tepër nga vajzat dhe bordellacion, lici për polici, futja vrapit njihen më tepër nga djemtë.*

**Tabelë 5. 6 Përqindjet në njohjen e leksikut të ligjërimit të shkujdesur sipas ndarjes: Jug / Veri**

| <b>Leksik që njihet më tepër në Jug (nr=184)</b>  |   |   |
|---|---|---|
|   | <b>% e termave që njihen më tepër në Jug</b>  | <b>% e termave që njihen më tepër në Veri</b> |
| <i>Ta çaj gojën</i>                               | 92 %  | 47 %  |
| <i>Alabak pa klas</i>                             | 62 %  | 22%   |
| <i>Na fiku derën</i>                              | 48 %  | 14 %  |
| <i>Gjigand</i>                                    | 76 %  | 44 %  |
| <i>Ia fut për kënaqësi</i>                        | 62 %  | 39 %  |
| <i>Është grup fare</i>                            | 72 %  | 38 %  |
| <i>Lavazhier</i>                                  | 55 %  | 40 %  |
| <b>Leksik që njihet më tepër në Veri (nr=116)</b> |   |   |
|   | <b>% e termave që njihen më tepër në Veri</b> | <b>% e termave që njihen më tepër në Jug</b>  |
| <i>Me haspi</i>                                   | 47 %  | 12 %  |
| <i>Alpin</i>                                      | 42 %  | 6 %   |
| <i>Zar</i>  | 84 %  | 10 %  |
| <i>Llosh</i>                                      | 68 %  | 12 %  |
| <i>Drazhlla</i>                                   | 61 %  | 3 %   |
| <i>Ka mërdhif</i>                                 | 56 %  | 26 %  |

Dallimet leksikore, termat më tepër të njohur prej studentëve me origjinë nga Jugu dhe Veriu i Shqipërisë, paraqiten në tabelën 18. Analizimi i leksikut sipas ndarjes gjeografike, nuk nxori asnjë dallim tjetër përveç njohjes dhe përdorimit të termave dhe frazave nga studentët e Veriut dhe të Jugut. Fraza si: *Ta çaj gojën, Alabak pa klas, Gjigand, Është grup fare* njihen dhe përdoren më tepër nga studentët

e Jugut; dhe *Zar, Drazhlla, Llosh, Me haspi* njihen dhe përdoren më tepër nga studentët e Veriut. Gjithashtu, nuk u vërejt asnjë ndryshim kuptimor të leksikut të paraqitur. U hasën vetëm hamendësime në lidhje me ngjyrimet kuptimore që mund të shënjonte një term apo frazë e caktuar, në rastin kur studentët nuk i njihnin fjalët dhe shprehjet në pyetësor.

Disa terma të ligjërit të shkujdesur ose i ashtuquajtur Sleng<sup>270</sup>, konsiderohen të tillë për disa vite, por janë të pakta ato terma të cilat kanë jetëgjatësi në përdorim. Dallime të pakta u vunë re në shpeshinë e përdorimit të një termi apo fraze nga studentët të vitit të parë dhe atyre të vitit të tretë. Studentët e vitit të parë, pavarësisht, degës së studimit, vazhdojnë të përdorin një pjesë të leksikut të shkujdesur i trashëguar nga shkolla e mesme. Ndërsa studentët e vitit të dytë dhe të tretë, tashmë janë të shkëputur deri diku nga ndikimi i shoqërisë së shkollës së mesme, apo botëkuptimi që shoqëron këtë grupmoshë dhe tashmë përdorin leksik të thjeshtë rreth aktiviteteve jashtëshkollore, duke përfshirë leksikun për substancat alkoolike dhe narkotike, etiketime të njerëzve sipas statusit të tyre, e dashura / i dashuri etj. Studentët e vitit të tretë të studimit, pohuan se ata përdorin Sleng me të njëjtën shpeshi si në vitet më. Ky ndryshim lidhet me ndryshimin e faktorit ndikues të jashtëm, ose me atë çfarë është “në modë” në kohën e tashme.

## **b. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi dhe përdorimi i shprehjeve sinonimike të ligjërit të shkujdesur**

### **b.1. Kuptimi i mesazhit të përcjellë nga folësi**

Ligjërimi i shkujdesur studentor karakterizohet nga shumëllojshmëri leksikore për të përcjellë mesazhe dhe kuptime të pashtjelluara. Fjalët dhe shprehjet e këtij ligjërimi, të nxjerra jashtë kontekstit që i karakterizon përcjellin kuptime të tjera, të cilat janë të mirëshpjeguara në fjalorët e ndryshëm. Ndërsa, kuptimi i përfutur në situatat ligjërimore joformale shpeshherë është produkt i çastit ligjërimor ose kushtëzohet nga rrethanat socio-gjuhësore<sup>271</sup>. Sikurse vërehet në shembujt e mëposhtëm, pothuajse të gjitha fjalët dhe shprehjet e këtij ligjërimi karakterizohen nga dykuptimësia. Ato shënjohen dy ose më shumë njerëz, ngjarje apo dukuri.

**I huaji** (kjo shprehje përdoret për studentët që studiojnë gjuhët e huaja, për dikë që është i ri në klasë apo në mjedise të ndryshme).

---

<sup>270</sup> Me fjalën Sleng, do të nënkuptojmë: Ligjërimin e shkujdesur dhe të gjithë tiparet karakterizuese të tij.

<sup>271</sup> Reves, H. F., *What Is Slang?: A Survey of Opinion*, United States, 1926, f. 218.

**I pakuptueshmi** (përdoret për dikë që studion gjuhë të huaj, për dikë që përdor fjalë të mëdha ose për dikë që nuk e kupton kur bisedon me të.)

**Ciu-ciu** (përdoret për studentët e pedagogjisë, për dikë që nuk e ka mendjen kur bisedon me të).

**Paskan turnin** (përdoret për studentët e infermierisë ose kur dikush flet më shumë se ç’duhet).

**Matematicienët** (përdoret për studentë të matematikës, për dikë që kryen shumë shpejt llogari matematikore ose për dikë që është shumë i zgjuar).

**Shkenca vetë** (përdoret për studentët e fizikës ose për njerëzit që hiqen si të zgjuar).

**Inxhinieri** (përdoret për studentët e inxhinierisë ose për dikë që flet me terma inxhinierie).

**Ligji, shteti** (përdoret për studentët e drejtësisë, për dikë që është mendjemadh, për dikë që hiqet si kryetar grupi ose për dikë që nuk dëgjon të tjerët por do të bëjë si i thotë mendja).

**Më janë gjerbur buzët** (përdoret kur do diçka për të pirë ose kur të janë tharë buzët nga i ftohti).

**Të martë e mira** (përdoret kur diçka shkon keq, kur në një situatë të caktuar nuk do të mallkosh me fjalë të rënda ose kur mallkon dikë në mënyrë përkëdhelëse).

**Mamasita** (përdoret për femrat e bukura, si shprehje midis një çifti ose si shprehje mes shoqesh).

**E thith** (përdoret për dikë që merr lëndë narkotike, për dikë që e pi shumë duhanin ose për dikë që i kupton gjërat shumë shpejt).

**Fshatare me klas** (përdoret për femrat që janë mendjemëdha, për femrat me origjinë nga fshati, për femrat që hiqen si të zgjuara ose për femrat që vishen me rroba të shtrenjta).

**E qan fare** (përdoret për dikë që di të bëjë shumë mirë diçka ose me ironi kur nuk di të bësh diçka).

**Kam dalë nga shinat** (përdoret kur dikush bën vetëm gabime ose kur nuk e ke mendjen kur të flasin).

**Si në kohën e xhaxhit** (përdoret kur dikush vishet me rroba që kanë dalë nga moda ose kur dikush në një shoqëri të caktuar ka mendime që nuk përputhen me kohet e sotme).

**Ma bëri jetën malore** (përdoret kur dikush të bezdis, kur dikush të bën shumë pyetje, kur e urdhëron dikë shumë herë ose kur lodhesh shumë).

**I ka dalë boja** (përdoret për një objekt të vjetër, për një shaka që nuk ka më sens ose për një veshje të vjetër).

**Për hesap të vet** (përdoret për dikë që nuk e vret mendjen se çfarë i thonë të tjerët ose kur bën diçka pa i pyetur të tjerët).

**Ta shqyej gojën** (është një lloj kërcënimi ndaj dikujt, shprehje që përdoret ndaj dikujt që ke inat ose kur do të trembësh dikë).

**Ha bukën kot** (përdoret për dikë që nuk të hyn në punë për asgjë, për një njeri dembel ose për një njeri që nuk është i zgjuar).

**Më ka ikë tepeleku** (përdoret kur je lodhur shumë, kur dikush të ngrë nervat, kur je nën presion të një problemi ose kur të dhemb koka).

**Si pikëpyetje** (përdoret për dikë që ka një shprehje të habitur në fytyrë ose për dikë që nuk të kupton në asnjë moment).

**Është si dritë** (përdoret për femrat e bukura, për njerëzit e mirë ose midis një çifti).

**Ma hoqi pinin** (përdoret kur sheh një femër të bukur, kur dikush flet dhe ti nuk kupton asgjë ose kur sheh një makinë luksoze).

**Për ty e ha plumbin** (përdoret kur e do shumë dikë ose kur ngacmon dikë me ironi).

**I është djegur llamba** (përdoret për dikë që është sëmurë ose për dikë që është jashtë çdo bisede).

**Mendjendrituri** (përdoret për dikë që është shumë i mencur, për nxënësin më të mirë të klasës ose me ironi për dikë që nuk merr vesh fare).

**Jashtë orbite** (përdoret për dikë që nuk e kupton bisedën ose kur dikush nuk e ka mendjen kur i flet).

**Të rëntë rrufeja** (përdoret si lloj përkëdheljeje mes miqsh ose si lloj mallkimi kur je i inatosur me dikë).

**U trashëm** (përdoret kur në një bisedë dikush flet shumë dhe të tjerët mërziten, kur rri shumë në një vend ose kur nuk kupton kur mësuuesi shpjegon).

**I ka vdek nona atij muhabeti** (përdoret kur një punë do të kryhet së shpejti ose kur bëhet fjale për diçka që e dinë të gjithë).

**I shuar** (përdoret për dikë që është i lodhur nga jeta, kur dikush rri dhe nuk bën asgjë ose për dikë që nuk zgjidh dot vetë asnjë problem).

**E hodha lumin** (përdoret kur merr provimin, kur shpëton nga një situatë e vështirë ose kur shërohet nga një sëmundje).

**Çfarë fatkeqësie** (përdoret kur nuk kalon klasën, kur të ndodh diçka e keqe ose kur nuk të plotësohet një dëshirë).

**Bombë fare** (përdoret për një femër të bukur, për një situatë të bukur ose kur sheh një makinë të bukur).

**Të hap barkun** (përdoret kur flet për dikë që nuk e ke qejf, për një bisedë banale ose kur nuk të pëlqen një lloj ushqimi).

**Të kall datën** (përdoret kur trembesh nga diçka, kur bëhët fjalë për një film horror ose kur trembesh nga një njeri i frikshëm).

**Do ta tundim sonte** (përdoret kur do të thuash që do të bësh festë, kur dehes ose me ironi për të thënë që do të studiosh).

**Kaq e patëm** (përdoret kur ngel në një lëndë, kur qesh për një kohë shumë të shkurtër ose kur pret që dikush të të bëjë keq).

**Të bëj peshk** (përdoret kur e kërcënon dikë, kur do ta trembësh dikë me fjalë ose kur e detyron dikë të bëjë çfarë ti do).

**Më iku truri** (përdoret kur sheh një makinë, një femër ose mashkull të bukur, kur je i lodhur nga shkolla ose nga puna ose kur dikush të mërzit duke folur).

**Vari qillot** (përdoret për njerëzit që nuk të kuptojnë, për diçka që nuk e arrin dot, për diçka të keqe që ka ndodhur ose kur nuk do ta vrsësh mendjen për asgjë).

**Ti këpusësh kokën** (përdoret për një femër ose mashkull të bukur ose si një lloj kërcënimi kur dikush të mërzit).

**Zë vendin kot** (përdoret për dikë që nuk të hyn në punë për asgjë, për dikë që nuk mëson ose për dikë që nuk e bën mirë punën e vet).

**Nuk mbush mirë ky** (përdoret për dikë që nuk të kupton ose për dikë që nuk të dëgjon kur i thua diçka).

**E kam ndarë mendjen** (kur e di që nuk do ta kalosh provimin ose kur ke vendosur të bësh diçka).

**E humba fare** (përdoret për dikë që nuk është i vëmendshëm, kur hutohesh ose kur harron diçka).

Studentët u shprehën se në jetën e përditshme ata shkëmbejnë ide dhe mendime me njëri-tjetrin për tematika të ndryshme. Mënyra që ata zgjedhin për të komunikuar, pra fjalët e përdorura në të folur, ndryshojnë në varësi të personit të cilit i referohen, marrëdhënieve sociale midis tyre dhe në varësi të vendit ku gjenden. Kështu pra, mënyra e ndërveprimit në mjedisin universitar, në familje ose jashtë mjedisit të universitetit është e ndryshme.

Gjuha, sikundër është shprehur gjuhëtari zviceran Ferdinand de Saussure<sup>272</sup> është një “sistem shenjash” ku shenjat janë vetë fjalët të cilat shihen si formë dhe kuptim. Mënyra e përdorimit të fjalëve dhe konotacionet e reja që ato përftojnë gjatë komunikimit, kushtëzohet nga mesazhi dhe tematika e bisedës.

---

<sup>272</sup> Joseph, J. E., *Ferdinand de Saussure*, United States, 1987, f. 228,


**b. 2. Përdorimi i shprehjeve sinonimike të ligjëritimit të shkujesur.**

Krahas termave dhe shprehjeve të paraqitura në pyetësor, studentët paraqitën një numër të konsiderueshëm shprehjesh sinonimike. Më poshtë paraqiten disa prej mënyrave të ndryshme të të shprehurit për të njëjtin kuptim.

**Ta çaj gojën / Të thyej në mes / Të tërheq zvarrë:** ta çaj ballin; ta shqyej gojën; të thyej brinjët; të bëj copa; të heq zvarrë; të tërheq osh; t'i shkul flokët; të ha gurmazin; të këpus; të thyej kockat / brinjët; të bëj gropën; ia mora shpirtin; ta fus kokën te rrota e makinës;

**Është për ti fut çorapen në gojë / të honkshin qentë:** ta vdesësh; ta rrahësh, ta grish; të heqësh zvarrë; të vraftë perëndia; të rëntë bomba; të rëntë ; zjarri; të shtyptë makina; e bëj peshk;

**Më ka ik petlla:** njeri i trashë; dyrdymen;



Figurë 5. 4 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.

**Rural komplet:** fshatar fare; injorant fare; fshati në festë; ffashtar; katnar; dhjar;

**Alpin:** malok; i trashë; derr; injorant; nordik;


**Aut:** down; në botën e tij; jashtë orbite; jashtë loje; ka ik për lesh;

**Zdroms:** ordiner; i rëndomtë; barbon; legen;

**Toç kukulle:** marionetë; lodër; leckë; budalla;

**Gjigand:** njeri flori; super njeri; djalë bob;

Ma. Dorian Klossi



Figurë 5.5 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.

**Bërthamë e thyer:** plakë; shtrigë; kllaçkë; beqare e stazhionuar; i ka ik koha;


**Është bishë fare:** nam fare; shum hot; super sexy; arushe; dy metra pelë;

**Punon:** merret me mall; punëtor i ndershëm; punëtor i madh; njeri i zoti;

**Makinë e tipit të fundit:** arushe; bishë; kukull; zemër

**Si 200:** dawn; aut; shtet më vete; ishin vitet 1970;

**Është gabirela:** dolçe gabi; te gabulet; rroba të firmosura;



Figurë 5.6 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.


**Haspi karalloi:** qepe gojën; mbylle llapën; mbylle sqepin; mos e shqep;

**Dredhje beli:** mos e dridh bishtin; mos e dridh muhabetin si zuzkat;

**Vari teneqen:** vari lesht; varja; lëre fare; vari bidonat;

**Mos më çaj tallamandrën:** mos më çaj kokën; mos më fut katër fazorshin; mos më çaj toroçilën;

**Na zuri treni ose autobuzi:** na çmende; na stresuat nervat; më çave kokën; na hoqe trurin;



Figurë 5.7 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.


**U fiksova fare:** ika fare; e humba; ika për lesh; jam spat; ma hoqe trurin;

**E ka kap ai / ajo:** është e tij; e ka zënë; goca e filanit;

**Për ty boj pesë vjet burg:** për ty harroj babë e nënë; për ty shes lopën;

**Për ty i vras të tërë;** të vdes unë për ty;

**Qafsha për Zotin:** qafsha plakën; me vdektë plaka me vdektë; për Baba Tomorrin; për kokë të plakut; për Zotin;



Figurë 5.8 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.


**Jashtë orbitës:** jashtë loje; jashtëtokësor; i fluturon mendja; ka pjerdhur; e humba mendjen fare;

**Na u llash trapa:** u trashëm; na iku jeta kot; prit gomar të mbijë bar;

**Kjo po kjo Britny Spears:** Shakira; si Madona; zogu i Tunës;

**Paske dalë kabriolet:** ik vishu moj se u ftove; do sëmuresh; ka krizë copash;

**I ka fut ujë komerdarja:** merr ajër; me zhavorr; thith ujë; janë çarë tubacionet; me shumë kilometra; e shpuar; zarba;




Figurë 5.9 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.

**Baret ku njihen vajza** bordello; gjendje civile;

**Tip delikat:** lule mos më prek; kujdes mos thyhesh; ai është “Uaaa mami...”;

**Bashkëjeton një herë në javë:** takohen një herë në hënë; shihemi për Pashkë; takohemi pas pesë vjetësh;

**Kthesa e Kamzës:** harku i triumfit; shalë shqyer; këmbë pirosti;



Figurë 5.10 Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura.


## Rast studimi 6

Studentët plotësuan me fjalë dhe shprehje të thjeshta sesi shprehen për këto kategori: emërtime të ndryshme të studentëve në bazë të degës së studimit, të ngelësh apo të marrësh notë kaluese në provim, të mungosh në orën e leksioneve apo seminareve, për studentët që mësojnë dhe ata që nuk mësojnë, pushimet e festat, përshkrimin e situatave qesharake apo të frikshme, internetin, festat, substancat e ndryshme alkoolike e narkotike, për të dashurën / dashurin etj. Rezultatet paraqiten si më poshtë:

### (a) Etiketimet në bazë të degës së studimit

Epitetet që përdoren për studentet e degëve të ndryshme janë të shumta. Në më të shumtën e rasteve kemi vetëm një fjalë që i personifikon ata si student. Disa nga epitetet mund të kenë kuptim negativ por dhe pozitive në raste të ndryshme. Shembujt janë të ndryshëm dhe këtu mund të përmendim fjalën “*gjykuesi*” në degën e Drejtësisë. Kjo fjalë merr kuptim pozitiv në rastin kur biseda është serioze dhe përdoret në termat e asaj fushe. Ndërsa në kuptimin negativ përdoret kur ironizohet profesioni i një studenti dhe përdoret fjala “*gjykuesi*” për ta bërë të ndihet keq.

Në raste të tjera kemi shprehje të cilat përdoren kundrejt studenteve të degëve të ndryshme si: *jakat e bardha*, *pedagogu i ardhshëm*, *naimat e ardhshëm* apo *b\*th-shpuesit* ku kjo e fundit konsiderohet ofenduese për ata student të cilët studiojnë për mjekësi.



Figurë 5. 11 Etiketimet në bazë të degës së studimit.


### (b) Etiketime për njerëzit

Për sa i përket etiketimeve për pedagogët, rektorin, etj., studentët ishin mjaft krijues duke krijuar dhe përcaktuar anëtarë të stafit akademik e jo vetëm nëpërmjet ngjyimeve pozitive dhe keqësuese (pezhorative). Pedagogët etiketohen negativisht, si *drakula*, *shtriga*, *mësonjësi*, *kuçedër*. Ndërsa *profi* përdoret si shkurtime i emrit

profesor. Etiketimet e madhja, shefja përdoren për t'iu referuar shefave të departamenteve.

Të shumtë janë etiketimet pozitive për rektorin e universitetit, si p.sh: *bosi, shefi, koka e madhe, gjenerali, njëshi, truri, i madhi, agai, pronari, baza, kapua*.

Dukuria e etiketimit ka përdorim të gjerë duke përfshirë edhe njerëz të cilët kanë funksione dytësore në institucion, të tillë janë: roja i institucionit dhe pastrueset. *Polici i shkollës, spiuni, dogana, gardiani, Van Dami, roje burgu, kufiri i shtetit; laro; spiun fuksi; Bardhyli; Kasëmi; dogana* janë disa etiketime me funksion tallës dhe për humor për rojën e shkollës. Ndërsa, pastrueset shpeshherë etiketohen si *pastërtoret, shërbyesja, fshirësja, Bedria, lecka* etj.



**Figurë 5. 12** Etiketime të ligjërimit të shkujdesur për njerëzit.

### (c) Etiketime për studentët sipas performancës akademike

Duke pasur parasysh cilësitë e shokëve dhe shoqeve të klasës, studentët shfaqën krijimtari dhe origjinalitet për përcaktimin e studentëve sipas kategorive të mëposhtme:


--student shumë i zgjuar dhe studion shumë: *ky është Xhimi neutron; ; UFO; ; talenti; figura e klasës; gjeni; është njësh; i paparë; ; peshkopi; i çmenduri; ; koka e klasës; Anjashtanj; gjeni; gllabërues njohurish; i shkarë; i zgjuari i shekullit; figura; nderi; perifani i klasës* etj. Pavarësisht shumëllojshmërisë së termave për këtë kategori, termat *Anjshtanji, i zgjuari, i shkarë nga trutë*, janë më të përdorshmet në bashkësinë gjuhësore studentore.

Shembuj të tjerë me kuptim metaforik janë *tru i zhvilluar, tru-ndritur, i shkarë nga trutë, i ikën truri duke mësuar*. Në këtë rast, fjala *tru* fiton ngjyrim metaforik bazuar në lidhjen midis trurit si organ i trupit të njeriut i rëndësishëm për realizimin e procesit të menduarit. Ndërsa, *b\_ \_zgjuari* është një tjetër etiketim që ka fituar kuptim keqësues (pezhorativ) si rezultat i bashkimit të dy fjalëve të thjeshta: emër + mbiemër. *Handikopat* është etiketimi keqësues (pezhorativ) që krijohet si rezultat i bashkimit të pjesëve të fjalëve *handikapat* dhe *psikopat*. Pra, duke përdorur fillimin

e fjalës së parë dhe pjesën e fundit të fjalës së dytë është përftuar fjala e re *handikopat*, kuptimi i së cilës bazohet në kuptimet e të dyja fjalëve kryesore.

--studentë që ndjek rregullisht leksionet por nuk mëson: ky lloj studenti përshkruhet nëpërmjet termave dhe frazave të larmishme që përdoren më së shumti për ofendim, tallje: *do të bëhet shkencëtar; ai që mëson për të tërë; dështak; s'je për shkollë; kur bën edhe ti sikur di; daun fare; "njësh" i shkollës; turisti; hajde shul e ik lloz është ky; barboni; pallosh; i godituri; leshko; kokë-tallash; bën shkollë nate; kokëbosh; zombi; njëshi pas dyshit; kapadai; i ka ngelur ora; dru është i shkreti; e ka trurin fushë; s'i kap mirë radari; mëson aq shumë sa bëhet shkencëtar; shkencëtari i ardhshëm; i bukri-shejtanit; zë vendin kot; karagjoz etj.*

--studentë dembel: mjaft etiketime hasen edhe në këtë kategori. Të tilla janë: *e ha bukën kot; ky kot që rron; i panevojshëm; qullash; i rraskapitur; i vdekur; i lodhur; parazit; qylaxhi etj.* Gjatë analizimit të këtyre termave dhe frazave etiketuese u vërejt se shumë prej tyre përdoren në gjininë mashkullore ndonëse mund t'i referohen gjinisë femërore. Në këtë kategori mbizotërojnë mbiemrat, por gjenden edhe mjaft emra që luajnë funksionin e mbiemrit si: *turist; zombi; i vobektë* ose në sintagma emërore apo fjalë të përngjitura të formuara nga emër + folje, emër + mbiemër apo emër + emër, si *trutharë; derr dembel; çuni i mamit;*. Ndërsa foljet përdoren më së shumti në lidhje me fjalë të tjera duke formuar shprehje foljore të ndryshme: *i ngrohu vezët ky; s'ia thotë fare; se vret fare; e ka kap gjumi; rri në hije etj.* Termat *i vobektë; myqyfyf; shushkarel* në mënyrë figurative përshkruajnë një person që është dembel dhe pothuajse i pazoti që të bëjë diçka. *I shuar fare* është një tjetër etiketim negativ që bazohet në mbiemrin *i shuar*, i cili rrjedh nga folja *shuaj*. *Trashamen* është termi që bazohet në foljen kalimtare *trash*<sup>273</sup>, e cila shërbën si rrënjë për krijimin e një sërë fjalësh të tjera të përbëra, si: *trashaluq; trashamënësi, trashanik etj.* Në fjalorin Shqip – Anglisht, të Pavli Qesku<sup>274</sup>, 1999, shënohet mbiemri *trashaman* i cili shënjon kuptimin *trashaluq* (njeri i shëndoshë), në rastin tonë fjala *trashaman* ka pësuar ndryshim në drejtim të fonetikës dhe semantikës: pra kemi zëvendësimin e zanores /a/ me zanoren /e/ dhe nga kuptimi *trashaluq*, tashmë fjala e re e krijuar *trashamen* ka fituar kuptimin *njeri dembel dhe i pazoti*.



**Figurë 5. 13** Etiketimet e ligjërimit të shkujdesur për studentët sipas performancës akademike.

<sup>273</sup> Pavli, Q., *Fjalori shqip – anglisht*, Tiranë, 1999, f. 921.

<sup>274</sup> Shih po aty, po ai.

**(d) Aktivitetet shkollore**

Kjo nënkategori përfshin terma e fraza me kuptim të figurshëm sipas gjashtë çështjeve të përcaktuara:

--të ngelësh në provim: në lidhje me këtë nënçështje termat më të përdorur janë: *ngela; e humba; s'e mora dot; s'ma dha* etj. Kuptimi i tyre figurativ nënkupton marrjen e notës negative në provimin përfundimtar. Shembuj të tjerë janë: *më la; e lash vet; ika për lesh; s'ma dha shtriga; ma futi; herën tjetër me kismet; isha drras fare tek kjo lëndë; i bëra naftën; e hëngrta kot; u dogja; e mori lumi; më shkoi në gërrje; doli vajzë* etj. Në të gjithë shembujt vërehet përdorimi i figurshmërisë letrare dhe ngjyrimet emocionale që përcillen prej tyre. Në të gjitha rastet e paraqitura mbizotërojnë shprehjet foljore të shkurtra dhe të paplota duke lënë të nënkuptohet mesazhi. Përdorimi i këtij leksiku jashtë kontekstit, do të krijonte paqartësi dhe keqkuptim në komunikim.

--të kalosh në provim: fjala më e përdorur në këtë kategori është *e mora*, e cila përdoret nga 90 % e studentëve kur marrin notë pozitive në provimin përfundimtar. Fjalë dhe shprehje të tjera të përdorura nga bashkësia gjuhësore e studentëve janë: *ia hodha; shpëtova; ia hodhëm edhe këtë herë; normal që do kalonim; jemi njësha; kalova plako; e vai...; m' a dha më në fund; e qava; e mora vizën; ia çova bukën burrit* etj. Edhe në këtë rast vërehet mbizotërimi i shprehjeve foljore të paplota dhe të realizuar brenda kontekstit të përcaktuar.


--të mungosh në mësim: *i bëra naftën* është shprehja më e përdorshme nga studenët në këtë kategori. Kjo shprehje, si dhe shprehja *ika pa doganë* në mënyrë figurative përcjellë mesazhin e *lënies së orëve të mësimit*. Shprehjet emërore *ora e kafes* apo *ora e bredhjes* formohen duke përdorur si fjalë kryesore emrin *ora* dhe emrat *kafë* dhe *bredhje*, të cilët funksionojnë si mbiemra nëpërmjet shtimit të mbaresës *-s* dhe *-es*. Shprehje të tjera të përdorura për këtë qëllim janë: *hajde të ikim, se vdiqëm këtu; shumë krizë këto leksionet, hajde t'i lëmë; uff plasëm; e prisha muhabetin; dal nga blloku; vjen një herë në shekull në leksion; i paprezentshmi* etj.

--të mësosh: të shumta janë shprehjet e përdorura për këtë qëllim. P.sh: *shtrydh trurin; plasi sytë; do bëhem vajzë studioze; e kapa fillin; po marrë dituri; m'u futën në tru; i qava me lot; do qaj mësimit* etj. Të gjitha frazat kanë përdorim të figurshëm dhe kontekstual.

--tema e diplomës: në këtë kategori janë të paktë shembujt e sjellë nga studentët, si p.sh: *hallet e fundit, shqyrr që po mbarojmë se na hëngrën librat*.

--pushimet, festat: *çlodhje, relaks* janë dy termat më të përdorshëm për këtë qëllim. Fraza të tjera ku mbizotëron figurshmëria janë: *jetë qejfi; do mbledhim eshtrat;; dalim për ajër; pall ariu*. Termat *liberta; vakancë; time out; antistres* janë huazuar nga gjuhët e huaja, italiane dhe angleze, dhe në shqip ruajnë të njëjtën formë

si në gjuhën e huaj, ndërsa kuptimi ka fituar ngjyrimë të tjera si në rastin e fjalës *liberta*, *time out*, *antistress*. Ato shënojnë kuptimin e *lirisë*, *pushime*; *kohë çlodhëse*.



Figurë 5. 14 Etiketime për aktivitete shkollore.


#### (e) Aktivitetet jashtë shkollore

Një larmishmëri shprehjesh të ligjërit të shkujdesur mund të përfshihen në nënçështjet e kësaj kategorie.

--situata qesharake: Nëse diçka është për të qeshur apo argëtuese ajo përshkruhet si: *gallatë* apo *gjigante*. Mbiemri *histerike* përdoret dendur në rastet e përshkrimit të ngjarjeve tepër qesharake. Ndërtimet folje + emër, gjithashtu mbizotërojnë në shprehjet e përdorura për këtë qëllim: *la me lot*; *zbardh dhëmbët*; *lamë brinjët*; *e dhj\_rë fare plako* etj. Krahas tyre, vërehen edhe përdorimet të fjalive me një fjalë, pra fjalia përbëhet vetëm nga një folje, si: *u zgërdhi*; *u gajasëm*; *u fëlliq*. Ndërkohë shprehja emërore *shpërthim gazi* përbëhet nga emri *shpërthim* i bazuar në foljen *shpërthej* dhe shoqërohet nga emri *gaz* + mbaresa *i*. Duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e fjalëve dhe shprehjeve të përdorura në këtë situatë kanë konotacione negative.

--situata tepër argëtuese: nëse diçka është fantastike, zakonisht studentët e përshkruajnë si *super* apo *paparë*. Leksiku për këtë nënçështje është mjaft i zgjeruar dhe përfshin terma dhe fraza, si p.sh. *qefe*; *e madhe kjo*; *është yll plako*; *e shkatërrove krejt*; *ma mbylle gojën*; *na dërrmove brinjët*; *gjigante*; *high fare*; *Hallall*; *të lumtë b\_theta*; *fiks fare*; *ditë me diell*; *e zjarrtë*; *e pakopjueshme*. Në disa shprehje të leksikut të përdorur për përshkrimin e situatave argëtuese apo shumë të bukura, vërehen edhe disa fjalë vulgare, megjithatë funksioni i tyre në këtë kontekst është pozitiv.


--situata të këqija: *e dhj\_rë* është fjala më e përdorur për këtë qëllim. Në funksionin e mbiemrit, kjo fjalë rrjedh nga emri *dhj\_s*. shembuj të tjerë janë: *u dregos*; *është kot*; *ta shpif*; *vari lesht*; *baltë fare*; *tmerr fare*; *shitty situation* nga anglishtja *situatë shumë e keqe*; *copë-copë*; *e shtarur*; *të hap barkun*; *u pordh situata*; *mizerje* etj.



Figurë 5. 16 Etiketime të ligjërimimit të shkujdesur në bazë të aktiviteteve jashtë shkollore.

-- Fjalët e shkujdesura për celularin: fjalët apo shprehjet më të përdorura në këtë kategori janë shkurtime të fjalës *celular*, si: *celi* ( e cila i nënshtrohet ndryshimeve morfologjike duke shtuar mbaresën -i); *teli*; *rreli*; *foni*; *cërja*; *alo-alo*; *mobili*; *antistresi*; *posta zanore* etj. Gjithashtu, hasen edhe format humoristike për celularin, të cilat shoqërohen me ndryshime të strukturës së brendshme të fjalëve, si p.sh: *tallafoni*; *cenlunlari*; *celucari*.

-- internet: vetë termi *internet* është shkurtime i fjalës së përbërë në anglisht<sup>275</sup> (*internet* < *international networks*, *shqip.* < rrjeti ndërkombëtar i sistemeve kompjuterike). Fjala e shkujdesur më e përdorur për internet është shkurtime i saj në *neti* apo *net*. Shembuj të tjerë të përdorur me qëllim humori, janë: *tërneneti*; *linja në studio*; *neti që na mbeti nga kurbeti*.



Figurë 5. 17 Fjalët më të përdorshme të ligjërimimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

--konsumimi i pijeve alkoolike: në këtë nënkategori vërehet përdorimi i një larmishmëri fjalësh e shprehjesh figurative e metaforike. Të tilla janë: *hajt të jap një gotë*; *shkojmë tek vendi qenit*; *të bëhemi spatë*; *shkojmë t'ia valojmë*; *të bëhemi xurxull*; *për pjaçere*; *për lëng*; *marrim dozën tonë*; *kush e ka radhën sot*; *bëhemi*


<sup>275</sup> <http://en.wikipedia.org/wiki/Internet>

dërrasë; shkojmë për ndonjë qelq; të lagim grykën; do vemi tek baza; do pimë një kafe të gjatë; marim ndonjë të shpejtë; një të ftohtë etj.

--të dehesh: kjo është nënkategoria që përfaqësohet nga një numër i madh shprehjesh të shkujdesura figurative, si: *bëhemi dru, tym, apo dërrasë; të helmohemi; u bë karroqe fare; nuk shënon mirë sot; u bë daulle; është trashur; u ngroh mirë mbrëmë; filani u bë deputet; është bërë karro; shoko, je bërë muço apo karnavale; i mori trutë; ka ardhur në formë; më zuri shiu; po tundet si lavjerës; llanxë; gërnetë; dërrasë; dhogë; uji i bekuar; zjarri; c4 etj.*

--substancat narkotike: **bar** (është huazuar nga fjala shqipe bar<sup>276</sup>); *çaj mali; e bardhë; miell; ashtu; boçe; gonxhe; bar jeshil; marijuanë; bar i keq; bimë me kërcell; syth; kek; mall; lule; trefletsh; vizë; e kuqe; mall apo malli i radhës; ilaç bio; pimë ndonjë të zi; do shohim lule; i ha hunda; e tërheq; do e tymosim sot etj.* Të gjithë termat dhe frazat kanë pësuar shtrirje metaforike të kuptimit duke përdorur fjalë të leksikut të përditshëm bisedor e standard. Pra, vërehet një mbisemantizim dhe desemantizim i leksikut në këtë nënkategori. Gjithashtu, shprehjet, si: *e tërheq; i fus një tegel; e bën vizën sa tavolina; e thith; e merr; e hoqi vizën; e nuhas; i ha hunda; i fus një vijë; i fut një të tërhequr; i bën zbor mallit; e bën vizën 1 metër; të thithur ai ore; e ka zënë; në botën e tij; i shushatur komplet* janë disa nga shprehjet që përdoren për konsumimin e substancave narkotike.

--mbrëmjet festive dhe argëtuese: ndonëse leksiku për këtë nënçështje është i pakët, të gjithë të anketuarit përdorën më tepër të njëjtat fjalë dhe shprehje. *Qejf* dhe *aheng* janë dy fjalët që përdoren më shpesh për etiketimin e mbrëmjeve festive. Fjala *qejf* përcjell konotacione pozitive apo negative në varësi të situatës dhe mesazhit të përcjellë. Shprehje të tjera janë: *hajde ta tundim; do vemi për t'u shkundur; xhëng-xhëng; filloi tërbimi; do e djegim fare; do shkallmojmë sot; do shkrijmë talentin; llahtar fare.*



Figurë 5. 18 Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

<sup>276</sup> Fjalori elektronik shpjegues: BAR I m. sh. 1. bot. Bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë që nuk drunjëzohet, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër, e cila mbin e dendur në livadhe e në vende të tjera dhe shërben kryesisht si ushqim për kafshët; përmb. tërësia e bimëve të këtij lloji, që rriten vetë në livadhe, në ara etj.; mbulesa e gjelbër me këto bimë; lëndinë. Bar i gjelbër. Bar i njomë (i ri, i thatë).

--të dashurin / të dashurën dhe përfundimin e lidhjeve dashurore: duke pasur parasysh dy nëndarjet e para, duhet të theksojmë se disa etiketime janë të përbashkëta për femrat dhe meshkujt, sikurse janë fjalët e huazuara nga gjuha e fëmijëve, *piti* dhe *bebuçi*. Etiketimet që hasen në ligjërimin mashkullor të studentëve për të dashurën janë të shumta dhe të larmishme. Ngjyrimet pozitive mbizotërojnë jo vetëm në fjalët që në vetvete shënojnë referent me kuptim pozitiv, por edhe në ato fjalë të cilat shprehin ngjyrimet keqësuese (pezhorative), duke e theksuar akoma më tepër rolin e kontekstit dhe marrëdhëniet sociale në ligjërim, i cili fiton ngjyrimet të një komunikimi të lirë dhe të thjeshtë. *Femra ime; pjeshka; jeta ime; ketrushe; ajo e imja; e prenotuara; goca e filanit; ylli; bukuroshe; e mirë; dashuria ime; jeta ime; princesha; Loku; Noku; zogu; rrushi; amorja; dashnorja; kuçka e tij* (përcjell tipare sociologjike negative e vulgariteti); *thatuja ime* (vërehet rënia e mbaresës –*ike* dhe zëvendësimi i saj me –*ja*); *kotele; zemërushe* (në këtë rast është shtuar prapashtesa –*ushe*); *dhelpira ime; budallaçka apo shushka ime* (këto fjalë përdoren si fjalë përkëdhelëse); *shpirti im binjak* etj.

Ndërsa për të dashurin, ligjërimi femëror i studentëve të Universitetit të Vlorës, përmban më së shumti fjalë dhe shprehje që përcjellin kuptim pozitiv, si: *kollona; bejbi; zemra; shpirti; o jetë; i ëmbli im; arushi; çokollate ime; kollona; burri i jetës; bubush; jarani; zembra; lali; arush; zymbyl; lepurush; majmun; dreq; çyryky im* (në tre shembujt e fundit vihet re përdorimi i dukurisë së përkëdhelëse); ndërkohë hasen edhe shembujt të cilët përcjellin ngjyrimet seksuale: *dashnori i asaj; banania; hamshori*; përdorim të gjerë gjejnë edhe fjalët e huazuara nga gjuhët e huaja, si anglishtja apo italishtja: *my sweetie; amore; love; honey; tezero* etj.

Lidhjet dashurore të të rinjve studentë shoqërohen edhe nga ndarjet. Në këtë rast përdoren disa fraza, të cilat kanë përdorim të ngushtë kontekstual dhe karakterizohen nga figurshmëria letrare. Të tilla janë: *i dhashë fund; e la; s'e ka më; kaq e patëm; u fik zjarri; s'ia vlen më; në të s'ëmës vafsh* (shprehje e përdorur më tepër nga vajzat); *s'bëhej më; këputi fillin; përfundoi kapitulli; e preva me të; hap rrugën për të tjerë; kapitull i mbyllur; e hoqa qafe; e lamë këtë muhabet; boll me kaq; s'ka më ne; i japim fund këtu; e lëmë këtë muhabet; kaq e patëm; fundi i tunelit* etj.

--marrëdhëniet seksuale: tipar i përgjithshëm e mbizotërues në këtë tematikë është vulgariteti i përdorur, sidomos prej gjinisë mashkullore, që i cilëson disa shprehje si tërësisht tabu (*ia çava tunelin; ia shtriva kabullin; ia çava pjeshkën; ia d\_rdhja brenda; i rashë; ia futa; i shqeva shalët; ç'u kënaqa; ja bëra asaj; ta pastroj se ka zënë ndryshk; e shtypa; të pastroj tubot* etj). Ndonëse, të shumta janë edhe shprehjet që përcjellin ndjenjë dhe emocione pozitive, si p.sh: *dua të ndjej; kam nevojë për ty; çlirojmë energji; gili-vili; flemë shpejt sonte; ndezim furnelën; unë kam djallin, ti ke ferrin; Perëndisë, t'ia bëjmë nderin* etj. Konteksti, edhe një herë, luan rol vendimtar në zberthimin kuptimor të kësaj frazeologjie.

--vajza dhe / ose djem të paraqitshëm: në këtë nënçështje vërehet përdorimi i disa fjalëve etiketuese që përdoren nga të dyja gjinitë, si: *super; sa hot ky / kjo; seksi* etj. Në lidhje me vajzat e bukura dhe seksualisht tërheqëse, shumë djem studentë paraqitën këto shprehje: *alamat femre; ça pjeshke; pelë; bishë fare është; bombë; dy metroshe; të hëngsha parakolpin; kardinale; qenke pjeshkë pa push; sa ma paske ballkonin; rrushi; çfarë ylli; grep fare; yll, yll, yll; alamat malli; art më vete; hajde bishë hajde; ça shale; ça gjoksi; ta kishe njëherë këtë; si rrush; bombë fare* etj. Ndërsa vajzat e kufizojnë leksikon e tyre në fjalë e shprehje duke shmangur deri diku ngjyrimet vulgare dhe ofenduese. P.sh: *djalë super; sa hot ky; seksi guy; zeshkan; goxha kallëp; ia vлека; të merr më qafë; ta heq petllën; i ngrëshëm; qenka si vetëtimë* etj. Në të dyja kategoritë, vërehen fjalë të huazuara nga gjuhët e huaja, sidomos nga anglishtja. Pra në këtë kategori dhe jo vetëm, mund të shprehemi se mbizotëron dukuria gjuhësore e bilinguizmit në marrëdhëniet ndër-gjinore, vajza-djem, në rastet e pëlqimit, studentët përdorin disa shprehje, si: *e markove tekstin; e kam fiksim; e hodha grepën; po dal për gjah; më hoqe trurin* etj. Shprehjet e paraqitura karakterizohen nga figurshmëria dhe përdorimi i një kodi të fshehtë që nënkupton dhe përcjell mesazhe që mund të shkodohen vetëm nga anëtarët e grupit shoqëror ose ata që e njohin dhe përdorin këtë kod.


--vajza që bëjnë tualet të rëndë etiketohen në mënyra të ndryshme: *është patinuar; ka vënë llaç; kam harruar pa vënë stuko; ti heq një vijë syve; të kallangjosem; -te ngjyhem; të zbukurohem* etj. Pothuaj të gjithë shembujt përdoren me konotacione negative.

--homoseksualitetin: *homo* (shkurtimi i fjalës *homoseksual*), *gei*<sup>277</sup> (ang. < gay, alb.< term ofensiv për homoseksual; janë fjalë të thjeshta që bazohen në stereotipitë e krijuara për paraqitjen dhe sjelljen e personave me shmangie (deviancë) seksuale, *lesbo* (term ofendues që bazohet në shkurtimin e fjalës *lesbikë*); *ai shoqja; ai motra; i shoqatës; i fushës; froço; fushor; e ke mendjen femër; femashkull* (bashkim i dy fjalëve të pavarura *femër* dhe *mashkull*); *pede* (shkurtim i fjalës *pederast*); *zogu; lulja; i bie daulles* etj. Pjesa më e madhe e këtij leksiku përdoret për etiketimin e djemve që paraqesin shmangie (devijancë) seksuale dhe shumica e këtyre fjalëve dhe idiomave karakterizohen nga ngjyrimet të forta vulgariteti dhe janë tepër ofenduese.

--për njerëzit jo të zgjuar apo të ngathët në mendime ose veprime: ***trushkulur*** (fjalë e përbërë nga dy rrënjë *tru + shkul+ ur* -mbaresë) është fjala më e përdorur nga studentët për të nënkuptuar një person që nuk është shumë i zgjuar; *s'ia thotë fare; i ka ikur bleta me pushime; i ka shkarë mendja; në pesë dërrasa, i mungojnë dhjetë; ka koshere pa bletë; mendje kungull; është foli murit; hu gardhi; sa i vrarë ky; copë-copë; budalla; gjysmak; hu gardhi; gdhë; matuf; i trashë; kokëqyp; debil; trap; legen; dudum; guhak; leshko; trupeshk; mangut; trutharë ; tutkun; teveqel* etj. Pra vihet re ngjyrimi metaforik me përdorim të ngushtë i shprehjeve për të etiketuar dikë

<sup>277</sup> <http://en.wiktionary.org/wiki/gay>


që nuk mendon dhe vepron me zgjuarsi. *Kokëqyp; truzog; trupeshk* (fjalë të përbëra nga emër + emër: kokë + qyp, tru + zog, tru + peshk); *trung; teveqel; çyryk; matuf; molomen; dudum; gdhë; leshko; i leshtë; i rrjedhur; i shkalluar* etj., përcjellin kuptim keqësues (pezhorativ) dhe ofendues.



**Figurë 5. 19** Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

--Mënyra e të shprehurit në telefon dallon dhe ndryshon midis gjinive. Dallimet më të shumta vëzhgohen në bisedat e zhvilluara me shokët dhe shoqet dhe bisedat që realizohen me të dashurin apo të dashurën. Kur përgjigjet në telefon një mashkull gjatë bisedave me shokët): *hë re pall; hë 're vlla; daku, ku je ti?; ça do ore; hë ore; buongiorno; më jep ca lek borxh; ore i madh; o gjigand; hajt ik pirdhu tani; ik tani, hajt mbylle; ik hajde;* (kur e telefonon shoqja/e dashura): *hë moj; alo; o shtrigë; urdho; po; hë zemër; hë moj ça bën; hë ça do* etj. Shprehja më e përdorur në bisedat telefonike midis shokëve është *hë 're vlla*, kjo frazë ka përdorim të gjerë në komunikimet që realizohen midis djemve që i përkasin zonës së Labërisë, më përkatësisht nga qyteti i Vlorës. Frazja e përdorur më shpesh nga studentët e qyteteve të tjera janë: *hë re pall; ore i madh*. Termi më i përdorur nga studentët, pavarësisht origjinës së tyre vendore, është: *hë shpirti; zemra, ç'kemi*.

Kur përgjigjet në telefon një femër (kur e telefonon shoku/ i dashuri): *alo; po zemër; ç'kemi shpirti*, janë shprehjet më të përdorura në bisedat telefonike midis vajzave dhe të dashurve të tyre; *po; urdho; ç'kemi, si je ylli im ç'kemi; hë jeta; ciao zemër; paçim jeta të puth*. Ndërsa kur e telefon një shoqe, përdoren shpeshherë këto shprehje që fillojnë bisedën: *hë moj shtrigë; ku je ti moj; motra ça po bën; he moj zemër si je?; hë bufe; ik zhduku tani* etj. Shprehjet më të përdorura në këtë komunikim janë: *ku je ti moj; motra ça po bën*.



Figurë 5. 20 Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore: bisedat telefonike brenda dhe jashtë gjinisë.

--Shprehje të ndryshme ofenduese: në ligjërimet joformale hasen së tepërmi fjalë dhe shprehje me qëllim ofendimin e të tjerëve. Ndonëse, edhe në rastet më ekstreme të përdorimit të shkujdesur të gjuhës, vërehen përdorime të shprehjeve ofenduese me qëllim përkëdhelës ose për efekt humori<sup>278</sup>. Lënda e mbledhur për këtë qëllim është e shumtë dhe do të paraqesim disa prej tyre: *më desktruktive fare; leshko; më sfirove; erdhi abnormali; o gjë e egër; hiqe putrën; ku i ke dhinë (mendjen); ti je out of mind; i merr fjalët me cepa (keqkuptohet); çapërpik (nuk kuptohet kur flet); u bëmë si këmbët e dhisë; je unconscious fare; leshe; puriq; sy plasur; të hëngërt dheri; je shumë kot; o njeri pylli; kërmë; torollake; matuf; je krizë fare; të rënë vetëtima; xhirues (gënjeshhtar; bën si barbon; bastard; qime shëllirë; buzhgall; mish me dy sy; derdenek (budalla); etj.*

-- Në kategorinë e fundit përfshihen fraza dhe fjalë që përdoren në situata të ndryshme që ndodhin në jetën e përditshme, përveç situatave të lartpërmendura. Sikurse është vërejtur nga analizimi i shembujve të lartpërmendur të Ligjërimit të Shkujdesur, mbisemantizimi, figurshmëria letrare, kodet e fshehta, mënyra të ndryshme të fjalëformit janë tipare karakterizuese edhe të këtyre frazave: *bëji replay; koncentracione plako; ambjentalizohu baby; e sefvova; naxhi im (xhani im); o robo shtegëtohu (nisu, ik që këtu); e katranose; snuk; pjo; ça ka t3 (çfarë ka të re?); vërtë; sa rem ke në poxha? (sa lek ke në xhep?); më trashe (më lodhe me të njëjtën bisedë); nuk të lëshojmë pa ta marë Skënderbeun (pesëdhjetëmilekë); hapi fenerët (shiko ku ecën); u hapën si vaji në lakra (i harruan të gjitha rregullat e jetesës); t'u ngjallën koçinaret (fillove të tregosh karakterin e vërtetë); po s'pate kokë, do kesh këmbë (nëqoftëse nuk i bën gjërat saktë, do t'i bësh gabim); sa rrotë që je; u këput në b\_th me këtë dhuratë (dhuratë pa vlerë); u bëra derr; mos e bëj me bojë (mos e tepro); bëj pauzë (mos fol më); bëji refresh mendjes ose bëji update trurin; na iku petlla*

<sup>278</sup> Shih nënçështjen *Sharje Dashamirëse*, Kapitulli: Taktikat e ligjërimit bisedor.

(mendja); *na u bë jeta malore* (e vështirë); *mysybet vajti kjo punë* (vajti keq); *je tërbuar fare*; *bjeri këmbës* (ik); *shkrepe* (thuaje); *më është djegur karta e zërit / karta grafike* (jam ngjirur); *naçut e lagjes* (çunat e lagjes); *mavri me bojë* (më keq s' bëhet); *kjo është Afrika style* (për dikë që vish rroba me shumë ngjyra); *te ura akoma ti* (kur dikush nuk ka kuptuar diçka); *na zuri treni* (bisedë e mërzitshme); *jeton në shekullin e pestë* (për dikë që nuk ndjek modën); *m'u bëre si gjirokastrite* etj.

Analizimi më i detajuar semantiko-gramatikor do të paraqitet kështu:

*I fus një të dredhur*- nga ana gramatikore fjala *dredhur* është e saktë. Fjalja është paraqitur me shprehje foljore. Nga ana kuptimore është e kuptueshme nga pjesa më e madhe e shoqërisë dhe është një shprehje për të treguar se personi që flet është përdorues i lëndëve narkotike.

*Për kokë të plakës* – Nga ana gramatikore si fjalja është e saktë, paraqitet nëpërmjet një shprehje emërore. Nga ana kuptimore është shprehje që kuptohet lehtësisht nga të gjitha grupet. Paraqet një mënyrë për të shprehur një lloj betimi.

*Kape ujkun* - Nga ana gramatikore është e saktë. Nga ana kuptimore është një fjalë që nuk kuptohet nëse nuk njohim kontekstin e bisedës. Kjo shprehje përdoret për t' i shprehur dikujt ndjenjën e urgjencës.

*E vret lart* – nga ana gramatikore është një shprehje e saktë. Nga ana kuptimore është lehtësisht e kuptueshme dhe përdoret për dikë që tregohet mendje madh.

## **Rast studimi 7**

Hera-herës studentët krijojnë fjalë të reja të cilat nuk mund të gjenden në asnjë fjalor apo libër. Për të qenë më praktikë dhe për të dhënë shembuj konkret në mbështetje të kësaj nënçështje, në vijim analizohen disa shprehje tipike të studentëve, të cilat shpeshherë janë tepër specifike dhe përdoren vetëm në grupe të caktuara.

*"Jam sedosur"* -shprehje e krijuar nga studentët anglishtfolës e cila rrjedh nga fjala *sad* –sed- e trishtuar, dhe është pikërisht ky kuptim që përcjell një student kur e përdor fjalën *sedosur*. Kjo është një shprehje tipike e cila nuk mund të kuptohet nga çdokush, sepse është një formë e re që nuk gjendet në asnjë fjalor dhe nuk është përmendur më parë. Fjala *sedos*, e cila mbart peshën kuptimore të shprehjes, është fjalë e prejardhur rrënjë e së cilës është mbiemri *sad* dhe nga ana leksikore përdoret për të treguar një gjendje humori jo të këndshme.

*"Ku ke humb o biancoporta / whitegate"* - Janë të paktë ata që mund ta kuptojnë këtë frazë për të mos thënë që është e pakuptueshme, sepse termat *biancoporta / whitegate* nuk ekzistojnë në asnjë gjuhë të huaj në këtë kuptim që mbart shprehja. Kjo pohohet duke u bazuar në faktin se termat *whitegate* dhe *biancoporta* janë përkthyer

në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fjala e përbërë e gjuhës shqipe “*derëbardhë*” pa ndjekur asnjë rregull të përkthim-interpretimit. Mund të tingëllojë e çuditshme, por është një shprehje e krijuar dhe e përdorur nga studentët anglishtfolës në të dyja konotacionet, pozitive ose negative. Kështu që, nëse një student i drejtohet dikujt me këtë shprehje, ai mund ta përdorë atë në mënyrë simbolike, pra ironikisht, për të thënë që nuk i është kushtuar kohë apo vëmendje kohët e fundit ose mund të përdoret thjesht si një përshëndetje ashtu si edhe “*Hi*” apo “*Hello*”.

“*Do e gjerbim ndonjë kafe?*”- kjo është një fjali pyetëse, e cila përdoret për të shprehur një ftesë ose një ofertë siç mund të shpreheshim në anglisht, përmban foljen *gjerbim* në vend të foljes *pimë*. Kjo folje nuk përdoret në gjuhën formale në ligjërimin akademik, madje as edhe në atë bisedor, pasi kjo folje është një fjalë e vjetër e cila nuk përdoret nga brezat e ditëve të sotme, duke qenë se është dhe mbetet një fjalë arkaike. Prej këtij shembulli mund të arrijmë në mendimin e thjeshtë se: termat, frazat dhe fjalitë e përdorura në ligjërimin e shkujdesur ndryshojnë nga njëri brez në tjetrin ku disa i mbijetojnë kohës dhe përcillen në brezat pasardhës dhe të tjera asimilohen ose zëvendësohen me forma të ngjashme.

“*Përmjellet*” - është një shprehje e vjetër arkaike, jo shumë e përdorshme e cila ka kuptimin që po zbardhet.

“*Sagllam*”- shprehje dialektore, e cila ka kuptimin "saktë”.

“*Fshakull*”: fjala nga Shqipëria e mesme dhe është epitet që përdoret për djemtë homoseksual, nënkupton ironi.

“*Koksi*”: fjala *koksi* vjen nga fjala *kokë*, është përdorur në mënyrë figurative. Fjala *koksi* përdoret për personat që janë Biznesmen të fuqishëm, njerëz me pushtete etj.

“*Mos më bëj si xhixhërk mua*”: fjala *xhixhërk* është një lloj zogu. Kjo shprehje është përdorur në mënyrë figurative dhe nënkupton *mos u bëj llafazan*. Në ligjërimin e shkujdesur përdoret edhe forma tjetër sinonime e saj: *fol qetë se më ngrite nervat*.

Këto shprehje janë aq të veçanta sa iu ngjajnë kodeve të fshehta të komunikimit brenda grupit, sepse paraqesin vështirësi për të kuptuar domethënien e tyre. Kuptimi i referentit të shënjuar realizohet vetëm në një kontekst të paracaktuar dhe në marrëdhënie të ngushta sociale. Gjithashtu, mënyra e formimit të këtyre fjalëve dhe shprehjeve është e veçantë. Në rastin e termit *fshakull* ka ndodhur shkrirja e shkronjës së parë të emrit *femër* me emrin *mashkull*, duke zëvendësuar rrokjen e parë *-ma-* me shkronjën *-f* dhe me metatezë. Pra, *femër* + *mashkull*= *fshakull*. Në raste të tjera, vërehet shtimi i parashtesës *për-*, i mbaresave *-ur*, *-im* etj.

### **5. b .5 Vendi dhe roli i huazimeve në ligjërimin e shkujdesur.**

Krahas tipareve të mësipërme, në ligjërimin e thjeshtë studentor vërehet një përdorim i gjerë i fjalëve të huaja. Ky tipar nuk i përket vetëm këtij ligjërimi, por gjendet në ligjërimin bisedor, pra në zhargonin studentor, në gjuhën e grupit dhe gjithashtu përdoret si dallim gjinor<sup>279</sup>.

Pra, në leksikon e shkujdesur zënë vend edhe fjalët e huazuara nga gjuhët e tjera, si anglisht, italisht, turqisht. Përdorimi i këtyre fjalëve dhe frazave të caktuara sjellin nuancë kuptimore më të veçantë.

Huazimet më të spikatura në fjalorin studentor janë:

(a) Huazime nga gjuha italiane: [*vakancë*] (vacanza, shqip.< pushime), [*amorja*] apo [*amoruço*] (amore, shqip.< i/e dashur), [*nudo*] (nudo, shqip.< i zhveshur, pa rroba; këtu përdoret me kuptimin: *njeri që kuptohet shumë shpejt*), [*tutorë*] (tutore, shqip.< tutorë; këtu ka kuptimin: *udhëheqësi i grupit shoqëror*), [*barbon*] (barbone, shqip. < i pastrehë; këtu shpreh konotacionin: *studentët konviktorë*), [*per piacere*] (per piacere, shqip.për kënaqësi), [*sanitara*] (sanitare, shqip.< pastruese), [*kardinal*] (cardinale, shqip.< kardinal, kryesor, thelbësor; këtu shpreh ngjyrimin: *vajzë ose djalë fisnik*), [*vulgar*] (vulgare, shqip.< vulgar; ngjyrimi i nënkuptuar është: *njeri i rëndomtë*), [*neutron*] (neutrone, shqip.< neutron; në ligjërimin e shkujdesur fiton ngjyrimin: *vajzë apo djalë beqar*), [*froço*] (frocco, shqip.< homoseksual; përdorimi i kësaj fjale në variantin italisht shpreh përbuzje dhe ofendim), [*i maturuar*] (maturato, shqip.< vajzë / djalë i pjekur, i matur; këtu përdoret me ngjyrim tallës dhe ironik), [*axhitus*] (agitato, shqip.< i shqetësuar; konsiderohet etiketim negativ), [*fantastike*] (fantastico, shqip.< fantastik; përdoret për të theksuar kuptimin pozitiv në lidhje me një person, ngjarje apo dukuri), [*fratelinua*] apo [*sorelina*] (fratellino apo sorellina, shqip.< vëlla, motër; këtu përdoret me kuptimin: *shok ose shoqe e ngushtë*) etj.

(b) Huazime nga gjuha angleze: [*bizi*] (buzy, shqip.< i zënë me punë; në ligjërimin e shkujdesur fiton ngjyrimin: *djalë apo vajzë me të dashur*), [*net*] (net, shqip.rrjetë; këtu përdoret si shkurtimi i fjalës *internet*), [*bebisiteri*] (babysitter, shqip.< dado; kjo fjalë përdoret për të etiketuar negativisht studentët e degës së Pedagogjisë), [*lol*] (laugh out loud, shqip.< qesh me të madhe), [*gei*] (gay, shqip.< mashkull homoseksual; përdorimi i kësaj fjale në variantin anglez shpreh përbuzje dhe ofendim), [*aut*] (out, shqip.< jashtë; përdoret për të nënkuptuar *dikë që nuk është mirë nga ana mendore*), [*hakerat*] (kackers, shqip.< hakerat; nënkupton jo vetëm djalë me njohuri të mira nga informatika, por *djalë që di të bëjë për vetë vajzat*), [*pliz*] (please, shqip.< të lutem; përdoret për të theksuar kuptimin dhe

<sup>279</sup> Vendi që zënë fjalët e huaja në ligjërimin bisedor, zhargonin studentor dhe fjalët e huaja të përdorura nga të dyja gjinitë janë trajtuar më hollësisht në nënçështjet përkatëse. Në këtë pjesë trajtohet vetëm vendi dhe roli i fjalëve të huaja në ligjërimin e shkujdesur.

krijuar situatë familjariteti), [*king*] (king, shqip.< mbret; në ligjërimin e shkujdesur fiton kuptimin: *djalë i bukur*), [*nju entri*] (new entry, shqip.< hyrje e re: nënkupton: *anëtarë i ri i grupit shoqëror, ose i/e dashura/i i ri i dikujt*), [*mani*] (money, shqip.< para), [*xhast smail*] (just smile, shqip.< vetëm qesh; përdoret me kuptim pezhorativ për *dikë që qesh shumë edhe në rastet kur duhet të jetë serioz*), [*trendy*] (trendy, shqip.< e modës;), [*skorpions*] (scorpions, shqip.< akrep; këtu shpreh ngjyrimin: *djalë modern*) etj.

(c) Huazime nga gjuha turke. *Mavri, rehatllëk, beu, pasha, derman, myqe, avaz, kapadai* etj,

Shumë prej huazimeve të përdorura nga studentët kanë hyrë në gjuhën shqipe të paprekura, pa pësuar asnjë ndryshim. Të tilla janë: *vakancë, per piaçere, bebisiter, amore, relaks, thanks, brilant, aut, barbon, mani, kardinal, fringo, çao* etj.

Të shumta janë huazimet që kanë hyrë në gjuhën shqipe duke iu përshtatur normave dhe rregullave të gjuhës tonë. Disa fjalë kanë pësuar ndryshime strukturore në sajë të shtimit të mbaresave karakteristike të shqipes. P.sh: *amorja, tiçëri, fratelinua, hakerat, axhitues, pashai* etj.

Tipar karakterizues i një kategorie fjalësh është gjinizimi i tyre. Vajzat dhe djemtë përdorin fjalë të ndryshme nga njëri – tjetri. Fjalët që përdoren më së shumti nga djemtë janë: *fibër, relaks, drazhdlla, pasha, froço, nju entri, bizi, net* etj. Ndërsa, vajzat përdorin më shumë fjalët: *pliz, king, brilante, amore, trendi, fratelino, bebi, gei, axhitues, vakancë* etj.

Arsyet e përdorimit të fjalëve të huaja janë të shumta. Sikundër është përmendur më lart: tendenca e grupit të ngushtë shoqëror për të përdorur fjalë të huaja, prirja për t'u dukur interesant apo modern etj., janë disa nga shkaqet pse të rinjtë përdorin dendur leksik të huaj.

### c. Gjuha e internetit dhe mesazheve elektronike

Një tipar tjetër i ligjërimin të shkujdesur që është bartur edhe në përditshmërinë reale, sidomos në institucionet arsimore, është gjuha që të rinjtë përdorin në rrjetet sociale dhe në shkëmbimet e mesazheve elektronike. Kjo në një farë mënyre, është edhe një pasqyrë e kulturës gjuhësore të të rinjtë<sup>280</sup>. Barbarizmat, shkurtesat ose akronime, të shkruarit në dialekt, përdorimi i fjalëve me më shumë se një kuptim, gjuha e fshehtë etj., pra përdorimi i një kodi të veçantë janë disa elemente që hasen më së shumti në komunikimet e realizuara me çdo mjet që përcjell një kuptim, ligjërim ose informacion. Ky ligjërim është praktik, i shpejtë dhe i shpenguar.

<sup>280</sup> Krasniqi, V., "Hi, flm, sps..." - gjuha "moderne" e të rinjve, Tiranë, 2013, f. 1.

Të shumtë janë shembujt për ilustrimin e kësaj nënçështjeje. Po sjellim disa prej tyre: *përgj* (përgjigje), *mrgj* (mirëmëngjesi), *t* (të), *x* (për), *nsr* (nesër), *tak* (takohemi), *univ* (universitet), *cu* (see you, nga anglishtja për takohemi më vonë), *puç* (të puth), *thnx* (thanks nga anglishtja për faleminderit), *ps* (pse), *prsh* (përshëndetje), *fb* (facebook), *çkm* (çkemi), *nk* (nuk ka...), *tpf* (të puth fort), *tak* (takohemi), *gjs* (gjes për mirëmëngjes) etj.

Materiale nga rrjetet sociale, si Facebook apo Twitter, ku pasqyrohen në biseda tiparet e lartpërmendura janë të pafundme, p.sh:

*(A) Ndihme: çfare duhet t bej, se nuk arrij t dergoj dot msg nga cel im galaktik.*

*(B) Nuk te ndihmoj dot.....kam info vetem per tel ufotik*

*(A) NDIHME! E kam me vertet. Behet fjale x galaxy 4.*

*(A) je sh mbrapa se 4 e ka anash ate butonin q ai yti no 1 e ka siper.*

*(C) Hidhe poshte se nuk ben me*

*(D) Po ti nuk dergon dot e-maile apo thjesht mesazhe?*

*(E) hahahaha!!!gruaja ime po qesh me t madhe!!dhe po m thot q kto telashe ka galaktiku!!!!*

*(A) – (C) e mendova q dikush do ma thoshte dhe kete por e mora rezikun n sy, hihhi*

*(E) kujdes se do te te zere korenti se kane rryme te larte ata lloj cel...i love samsung c 32 12*

*(Ë) hihihihihihih!!sikur kaq te besh dhembin me celularin tim nuk ta nderoj!!!!!!*

*(F) rrofsh A..., me ke ber t ndihem shumeeee mire me kte status....m se fundi dhe nj si mua, "problematike" me high tech!*

*(G) po c'pate o ydhi,e kishë mire iphon-in me ekran t thyer*

*(GJ) Pa marre patenten nuk e nget dot galaktikun*

*(H) do kurse???*

Përhapja e gjuhëve të huaja, sidomos e anglishtes, dhe përdorimi masiv i mjeteve elektronike, më konkretisht i internetit, shoqërohet me një ndikim të madh edhe në mjedisin kulturor e gjuhësor shqiptar. Impaktin (shtysën) më të madh, përdorimi i anglishtes e ka në bashkësinë gjuhësore – shoqërore rinore. Multilinguizmi dhe larmia

gjuhësore ndihmojnë në ruajtjen dhe përforcimin e diversitetit (larmmishmërisë) kulturor e gjuhësor<sup>281</sup>.

### **Përfundime**

**Ligjërimi i lirë** dhe efekti i tij në bashkësinë gjuhësore: mendojmë se ky punim ka analizuar gjerësisht termat dhe tiparet gjuhësore të ligjërimit studentor, duke u përqendruar në taktikat e këtij ligjërimi, por edhe në zhargonin dhe ligjërimin e shkujdesur si pjesë të rëndësishme e kulturës rinore.

Rezultatet e anketave nxorën në pah përgjithësime të rëndësishme në lidhje me përdorimin dhe funksionet e ligjërimit të shkujdesur të studentëve të Universitetit “Ismail Qemali”. Termat sleng janë tipare karakterizuese të kulturës rinore dhe përdorimi i tyre ligjërimor është shprehje e identitetit të kulturës sociale të të rinjve. Nëngrupet sociale të ndryshme reflektojnë strukturën sociale të komunitetit social studentor në të cilin bëjnë pjesë<sup>282</sup>. Nëngrupet shoqërore, në vetvete, janë produkt i qëndrimeve, vlerave dhe besimeve të grupmohës së tyre, të prindërve, të komunitetit shoqëror të vendlindjes etj.

Gjatë studimit të ligjërimit të lirë, përveç leksikut dhe përkufizimeve, iu kushtua vëmendje përhapjes së këtij ligjërimi dhe përdorimin e termave të veçantë nga segmente të ndryshme të kulturës rinore. Në shoqërinë shqiptare, variacioni social i këtij ligjërimi është ende i pa eksploruar.

Përdorimi i ligjërimit të shkujdesur vlen më së shumti për të etiketuar grupet sociale, dhe përshkruar stereotipitë e njëri-tjetrit. Në studimin tonë, u gjetën disa kategori, si: të zgjuarit (në këtë kategori përfshihen studentët që mësojnë shumë), miss-et (etiketohen vajzat e bukura dhe që i kushtojnë rëndësi paraqitjes së jashtme), askushët ose masa ose popull i thjeshtë (të gjithë ata studentë që nuk dallohen për ndonjë tipar të veçantë) etj.

Hulumtimi shkencor mbi lëndën gjuhësore të mbledhur, ndihmoi në arritjen e disa përfundimeve për ligjërimin e shkujdesur:

- (1) Ligjërimi i shkujdesur është burim formimi fjalësh dhe kuptime të reja. Neologjizmat, risitë, figurshmëria dhe shumëllojshmëria kuptimore, shoqëruar nga tipare sociologjike, si: vulgariteti, tallja dhe ofendimi, karakterizojnë terminologjinë e këtij ligjërimi. Ky leksik lind dhe krijohet nga nevoja që kanë të rinjtë për të lënë përshtypje të mirë apo të duken modernë përpara të tjerëve, si në të folur, në veprime etj. Pra, sleng konsiderohet si tipar gjuhësor shprehës i kohës moderne që studentët jetojnë. Për këtë arsye, ligjërimi i shkujdesur

---

<sup>281</sup> Xhafa, D., *Language and society in context of globalism*, Korçë, 2013, f. 165.

<sup>282</sup> Labov, T., *Language barriers among adolescents*, United States, 1992, f. 346.

është i hapur ndaj prurjeve të reja dhe fjalëve standarde ekzistuese, dhe luan rol vendimtar në krijimin e shumë fjalëve të reja.

- (2) Ky regjistër dallohet nga një sërë tipare gjuhësore që pasqyrojnë stilin e jetës së përdoruesve të tij dhe tregojnë përkatësinë e individit kundrejt bashkësisë shoqërore që bën pjesë;
- (3) Ligjërimi i shkujdesur studentor zë vend të rëndësishëm krahas stileve të tjera ligjërimore që përdorin studentët;
- (4) Përdorimi i ligjëritit të thjeshtë, shpeshherë, konsiderohet si antikonformizëm kundrejt formalitetit dhe normave sociale e gjuhësore. Për këtë arsye në leksiku i tij përmban një shumëllojshmëri shprehjesh të shkujdesura, përdorimi i të cilave kushtëzohet nga konteksti vendor, kohor dhe ai social<sup>283</sup>.
- (5) Krijuesit dhe përdoruesit më të shumtë të këtij stili ligjërimor janë të rinjtë. Origjinaliteti, shkalla e lartë e informalitetit, shprehësia emotive karakterizojnë ligjërimin e thjeshtë studentor.
- (6) Shumë prej termave dhe frazave të ligjëritit të shkujdesur kanë funksion tallës, ofendues, vulgar. Konotacionet negative shprehen nëpërmjet kuptimit figurativ gjatë përdorimit të metaforës, metonimisë, krahasimit, thënieve dhe idiomave popullore etj. Vulgariteti që shprehin disa terma shpeshherë lidhet me tematikën e bisedës, sidomos në rastet e marrëdhënieve seksuale dhe përshkrimit të vajzave dhe djemve me paraqitje të mirë fizike.

Në ligjërimin bisedor dhe të lirë të studentëve, rëndësi të veçantë në kuptimin e fjalëve luan edhe konteksti, i cili del në rolin e *aktualizuesit semantik*. Ndonëse studiues Shkurtaaj ka cilësuar se roli i kontekstit nuk duhet ekzagjeruar, sepse ai nuk është kurrë absolut<sup>284</sup>, në ligjërimin e shkujdesur konteksti realizon, aktualizon këtë ose atë kuptim të fjalës. Në këtë ligjërim, pothuajse, çdo fjalë merr kuptim të dyfishtë. Në shumicën e rasteve studentët, dhe jo vetëm, e përdorin ligjërimin e thjeshtë pa e kuptuar. Ata përdorin shprehje e fraza të ndryshme, pa qënë të vetëdijshëm se ky lloj komunikimi është informal dhe shpesh i pa kuptueshëm nga persona të tjerë që nuk janë pjesë e grupit. Pra, ligjërimi i shkujdesur funksionon si urë komunikimi midis anëtarëve të grupit dhe njëkohësisht shërben si pengesë për të gjithë ata që nuk i përkasin një grupin të caktuar shoqëror.

Krahas tipareve të lartpërmendura, karakteristikë tjetër e këtij ligjërimi është leksiku jostandard, fjalët dhe shprehjet, kuptimet e të cilave karakterizohen nga ngjyrimet ekstreme pozitive dhe keqësuese (pezhorative). Fjalët e reja apo të ndryshuara arbitrarisht, format e shkurtuara, figurat letrare me shumë kuptime ose risitë verbale, intonacioni, ritmi i të folurit, theksi i veçantë që fitojnë disa fjalë si

---

<sup>283</sup> Department of Linguistics., *Language Files*, Ohio, 2007, f. 412.

<sup>284</sup> Shkurtaaj, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 223.

pasojë e zgjatjes së rrokjeve, shqiptimi i pasaktë apo shkurtimi i tingujve ose grupe tingujsh etj., janë elementet kryesore të ligjërimit të shkujdesur studentor.

Ligjërimi i shkujdesur nuk u përket vetëm studentëve, por gjen përdorim të madh në përshkrimin e situatave shkollore dhe atyre jashtë shkollore. Në këtë rast, ia vlen të përmendim etiketimet pozitive dhe negative për pedagogët, lëndët e ndryshme, për studentët që mësojnë, për festat argëtuese, substancat narkotike dhe alkoolike etj. Përshkrimi që vërehet në këto situata paraqet perceptimin e realitetit sipas këndvështrimit të studentëve. Ligjërimi i shkujdesur, në përgjithësi, është i kufizuar nga konteksti, koha dhe vendi i realizimit të bisedës<sup>285</sup>, duke nënkuptuar kështu se ai mund të kuptohen vetëm nga një bashkësi shoqërore e caktuar, sikurse është bashkësia shoqërore e gjuhësore e studentëve dhe nëngrupet e saj. Zakonisht, ligjërimi i shkujdesur krijohet dhe zotërohet shpejt nga individi me qëllim për të qënë pjesë e grupit shoqëror.

Analiza psikolinguistike e diskursit të të rinjve konkludoi se gjuha ndikohet së tepërmi nga sjellja sociale. U vu re se, kur të rinjtë përdorin termat sinonimik në kontekste informale, ato shënjojnë të njëjtin referent, por reflektojnë konotacione të ndryshme, pozitive apo negative.

Ligjërimi i shkujdesur karakterizohet nga (1) tipare të ndryshme gjuhësore, duke përfshirë fusha si: gramatika, semantika, fonologjia etj., (2) tipare sociologjike, të cilat krijohen si rrjedhojë e funksioneve të shumta të këtij ligjërimi.

Tiparet sociologjike që u evidentuan në punim janë:

**Tabelë 5.7 Tiparet sociologjike të evidentuara në ligjërimin e shkujdesur.**

| Tipare sociologjike              | Terma të ligjërimit të shkujdesur | Kuptimi i përgjithshëm i termave    |
|----------------------------------|-----------------------------------|-------------------------------------|
| Përkatësia sipas grupit shoqëror | <i>bukë</i>                       | <i>Substancë narkotike: heroinë</i> |
| Informaliteti                    | <i>Skënderbe</i>                  | <i>50 mijë lekë</i>                 |
| Ekonomizimi i kohës              | <i>TDSH</i>                       | <i>Të dua shumë</i>                 |
| Jetëgjatësi e shkurtër e termit  | <i>Trung</i>                      | <i>Budalla</i>                      |
| Funksioni ofendues dhe agresiv   | <i>Trashamen</i>                  | <i>Student që nuk mëson</i>         |
| Originalitet                     | <i>Leje një mujore</i>            | <i>Pushimet</i>                     |

<sup>285</sup> Department of Linguistic., *Language Files*, Ohio, 2007, f. 407.

|                                 |                        |  |
|---------------------------------|------------------------|--|
| Funksioni “për humor”           | <i>Van Dami</i>        | <i>Roja e institucionit</i>                                  |
| Vulgaritet                      | <i>Pederast</i>        | <i>Homoseksual</i>   |
| Tematika me përdorim të ngushtë | <i>Bar</i>             | <i>Hashash</i>   |
| Risi                            | <i>Reli</i>            | <i>Celulari</i>  |
| Ngjyime seksuale                | <i>Zoçkë</i>           | <i>Vajzë e bukur</i>   |
| Dëshira për të lënë përshtypje  | <i>Burri i jetës</i>   | <i>I dashuri</i>   |
| Terma me përdorim lokal         | <i>Kardinale</i>       | <i>Vajzë e bukur</i>   |
| Ndryshim i ngjyimeve kuptimore  | <i>Të ka ikur pini</i> | <i>Të ka ikur mendja (nuk je në rregull nga ana mendore)</i> |
| Fshehtësia                      | <i>Do takoj Mirën</i>  | <i>Do takoj të dashurin</i>                                  |
| Spontanitet                     | <i>I jashtmi</i>       | <i>Për studentët e gjuhëve të huaja</i>                      |

Në studim u dalluan dy lloje të leksikut të ligjërimit të shkujdesur: (a) leksik i përgjithshëm, (b) leksik me përdorim të kufizuar. Përkatësisht, do të veçojmë temat dhe tiparet gjuhësore që njihen dhe përdoren pothuaj nga gjithë bashkësia gjuhësore studentore, të cilat përbëjnë ligjërimitin e thjeshtë që konsiderohet i përgjithshëm. Porse, gjuha e përdorur nga anëtarët e një grupi shoqëror për të treguar përkatësi dhe solidaritetet përkufizohet si leksik i kufizuar. Gjatë ligjërimit hasen raste kur leksiku i kufizuar përdoret për të treguar përkatësinë gjinore, moshore, identitetin dhe statusin social. Të tilla janë: *zoçkë* përdoret më tepër nga djemtë e rinj ose adoleshtët, ndërsa vajzat përdorin *hamshori* ose *bashkëshorti* për të dashurin.

Arsyet e përdorimit të leksikut të përgjithshëm dhe të kufizuar është shmangia e normave dhe formalitetit gjuhësor, duke zëvendësuar kështu forma gjuhësore standarde dhe shprehje klishe, si, psh: *morëm dozën tonë për pimë diçka*.

Analizimi i lëndës gjuhësore të ligjërimit të shkujdesur, vërteton se disa fjalë mund të kenë përdorim të përgjithshëm dhe specifik në varësi të kontekstit të përdorimit, p.sh: fjala *bar* në përdorimin standard ka kuptimin: Bimë e njomë që nuk drunjëzohet, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër, e cila mbin e dendur në

livadhe<sup>286</sup>, në leksikon e përgjithshëm të ligjërimit të shkujdesur *bar* fiton kuptimin e lëndës narkotike: marihuanë, ndërsa në leksikon me përdorim të kufizuar termit *bar* i shtohet ngjyrimi me sfond seksual: qime pubike të mashkullit dhe femrës.

Analizimi i leksikut të ligjërimit të thjeshtë nxjerr në pah një sërë çështjesh në lidhje me qëndrueshmërinë dhe ndryshimet që shfaqin në përdorim dhe ngjyime kuptimore. Termat e aprovimit zëvendësohen më shpejt sesa termat e kundërshtimit. Termat lindin, krijohen në një nënkulturë të veçantë<sup>287</sup>. Aktivitetet sociale dhe tendencat e fundit moderne, etiketohen më tepër sesa aktivitetet tradicionale.

Sa i rëndësishëm është kontakti social midis grupeve shoqërore në përhapjen e ligjërimit të shkujdesur në mjedise të ndryshme gjeografike? Po rriten apo zvogëlohen dallimet gjuhësore midis femrave dhe meshkujve? Përgjigjet e këtyre pyetjeve konkretizohen nga analizimi i të dhënave të pyetësorëve të mësipërm. Një vëzhgim i dytë, ndoshta pas dy vitesh, do të tregonte se cilat terma janë ende në përdorim dhe cilat terma dhe fraza kanë fituar përdorim të gjerë në komunikim.

Përgjigje të tjera dalin në pah nga shqyrtimi i tipareve sociale që i përkasin secilit term apo frazë sleng. Të dhënat gjuhësore për dallimet nënkulturore paraqiten në 65 % të termave të përcaktuara sipas kategorive.

Këto terma paraqesin prova për dallimet nënkulturore, p.sh. vajzat dhe djemtë përdorin për të njëjtin kuptim dy terma të ndryshëm të cilët përcjellin edhe rolet gjinore në komunikim. Njohja e termit pasqyron vendin që një term zë në komunikimin verbal joformal.

Studime të shumta sociolinguistike nga gjuhëtarë të huaj vërtetojnë se kultura rinore nuk është homogjene nga pikëpamja gjuhësore. Ky pohim u vërtetua edhe në këtë studim. Ishte me vlerë përcaktimi i kufinjve social të nënkulturore, me qëllim përcaktimin se kush është anëtar i një subkulture dhe efektin që grupi ka tek individit, gjithashtu edhe leksikon e grupeve të tjera si nënkultura gjuhësore.

Shpeshherë gabohet kur cilësohet gjuha e të rinjve si një stil i vetëm. Ky përgjithësim nuk është aspak i vërtetë. Gjuha e të rinjve paraqet disa tipare të përbashkëta, por jo të gjithë flasin njësoj; gjuha e të rinjve paraqet ndryshime të mëdha dhe ndoshta më shumë sesa çdo grupmoshë tjetër. Pikërisht, këto ndryshime e përkufizojnë gjuhësisht grupmoshën rinore<sup>288</sup>.

Të rinjtë luajnë me gjuhën, e transformojnë atë duke lënë aty gjurmët e tyre. Ky fenomen gjuhësor nuk shoqërohet gjithmonë me tipare pozitive. Shpeshherë, në

<sup>286</sup> Fjalori elektronik shpjegues: BAR I m. sh. 1. bot. Bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë që nuk drunjëzohet, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër, e cila mbin e dendur në livadhe e në vende të tjera dhe shërben kryesisht si ushqim për kafshët; përmb. tërësia e bimëve të këtij lloji, që rriten vetë në livadhe, në ara etj.; mbulesa e gjelbër me këto bimë; lëndinë. Bar i gjelbër. Bar i njomë (i ri, i thatë).

<sup>287</sup> Labov, T., *Language barriers among adolescents*, United States, 1992, f. 349.

<sup>288</sup> Eckert, P., *Adolescent Language*, United States, 2001, f. 15.

gjuhën e të rinjve vërehet një farë varfërie dhe shtampëzimi i të folurit si dhe shumë fjalë të huaja të panevojshme, ndërtime gramatikore të huaja, që nuk i përshtaten natyrës së shqipes dhe janë fryt i përkthimit të keq nga gjuhët e huaja<sup>289</sup>.

Zhvillimet e vrullshme që kanë ndodhur në fushën teknologjike, sociale, kulturore, ekonomiko-politike në shoqërinë mbarëbotërore janë pasqyruar së tepërmi në mjetin më të rëndësishëm komunikues, në gjuhë. Ligjërimi dhe leksiku i studentëve ndikohen së tepërmi nga teknologjia moderne dhe mediet.

---

<sup>289</sup> Shkurtaç, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 33-34.

## KAPITULLI I GJASHTË

### Kundrime leksiko-semantike te ligjërimi studentor në Universitetin e Vlorës

---

- a. Karakteristikat e bisedave dhe tiparet ligjërimore jashtë auditorit
  - b. Shkelje të normës standarde në ligjërimin e folur dhe të shkruar brenda dhe jashtë auditorit.
    - 6.b.1 Elementi fonetik
      - 6.b.1.1 Gabimet në fushën e fonetikës e fonologjisë në ligjërimin bisedor
      - 6.b.1.2 E folmja tradicionale vendore
    - 6.b.2 Leksiku
      - 6.b.2.1 Tipare leksikore të gjuhës së folur jashtë auditorit
      - 6.b.2.2 Tipare leksikore të ligjërimin të shkujdesur
  - c. Prurjet e reja leksikore
  - d. Përfundime
- 

#### a. Karakteristikat e bisedave dhe tiparet ligjërimore jashtë auditorit

Ligjërimi bisedor dhe kodi i tij janë tregues të mirë për të dalluar distancën sociale e kulturore të përdoruesve të këtij ligjërimi. Kultura rinore është vendi më i mirë për të studiuar të folurin bisedor. Qëndrueshmëria dhe ndryshimi në formimin e fjalorit të rinisë dhe veçoritë gramatikore të saj, janë çelësi për kërkim në ligjërimin bisedor<sup>290</sup>.

---

<sup>290</sup> Brown, R., *Complexity and order in teenagers' speech in Psycholinguistics*, New York, 1970, f. 85.

Komunikimi i realizuar në mjediset e universitetit (por jashtë auditorit) karakterizohet nga tipare të ligjërimit bisedor, tipare të cilat ndeshen shpesh në bisedat në jetën e përditshme, në familje, punë, në situata shoqërore, në marrëdhëniet e zakonshme të argëtimit, kulturës, etj, sepse ky lloj ligjërimi siguron komunikim të drejtpërdrejtë, nëpërmjet formës së tij themelore të kumtimit gojor: dialogu.<sup>291</sup>

Në bisedat e zhvilluara me studentët e universitetit të Vlorës, u vu re se zgjedhja e fjalëve, strukturat gramatikore dhe veçoritë leksikore janë disa nga ndryshimet që bëjnë dallimin midis të folurit akademik dhe atij bisedor. Tipar kryesor i përcaktimit të veçorive të ligjërimit bisedor është aspekti pragmatik. Faktorët që duhen marrë në konsideratë gjatë analizës së leksikut bisedor dhe karakteristikave të tij janë: rastet e përdorimit të termave bisedore; *statusi* - lidhja që kanë bashkëbiseduesit me njëri-tjetrin; *tema* dhe *qëllimi i bisedës*; *gjinia* dhe *mosha*.<sup>292</sup>

Në tabelën e mëposhtme jepen disa prej *situatave* që karakterizojnë të folurin bisedor<sup>293</sup>.

**Tabela 6. 1 Elementet që përcaktojnë tiparet e ligjërimit bisedor**

| <b>Situata</b>      | <b>Statusi</b> | <b>Rastet e përdorimit</b> | <b>Tema</b>                   |
|---------------------|----------------|----------------------------|-------------------------------|
| Familja             | Prindërit      | Shtëpi                     | Planifikimi i pushimeve       |
| Arsim               | Studentë       | Pas orës së mësimi         | Shembuj të ndryshëm           |
| Shoqëri             | Miqtë          | Kafene                     | Probleme e biseda të ndryshme |
|                     |                | Telefon                    |                               |
| Aktivitete të tjera | Internet       |                            |                               |

Bisedat e përditshme shpesh kanë karakter tepër informal, sidomos atëherë kur bashkëbiseduesit e njohin mirë njëri-tjetrin. Në këtë rast ndodh një zhvendosje e lehtë apo gërshetim midis ligjërimit bisedor dhe ligjërimit të shkujdesur. Duke pasur parasysh, se këto dy lloj ligjërime kanë disa tipare gramatikore, fonologjike dhe leksikore të përbashkëta, si edhe një pjesë e madhe e informacionit jepet ose plotësohet nga faktorët jashtëgjuhësor, mund të përcaktohen këto tipare që karakterizojnë bisedën<sup>294</sup>:

<sup>291</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f.162.

<sup>292</sup> Shih po ai, po aty, f. 333.

<sup>293</sup> Sager, H., *Language, Culture and Communication*, Standford, 1971, f. 58.

<sup>294</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhes Shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 332.

- a. Përfytyrimet
- b. Mbizotëron konkretja dhe jo abstraksioni dhe shkalla e lartë e nënkuptimit
- c. Gjatë bisedës del subjektiviteti dhe origjinaliteti i ligjëruesit

Nevoja për komunikim të papërgatitur e të pandërprerë, si dhe përsëritja e vazhdueshme e rrethanave, bën që gjatë bisedës të shfaqen hapur emocionet, subjektivizmi dhe individualiteti.

Në ligjërimin bisedor studentor dallohen dy lloje thëniesh: **konstatuese** dhe **ekzekutuese**<sup>295</sup>, si p.sh.: *vdiqa nga koka, jam e lodhur, u mërzita* (thënie konstatuese) dhe *boll tani, hajde ikim, etj* (thënie ekzekutuese).

Tipare të rëndësishme të bisedës janë fillimi, rrjedha e bisedës dhe mbyllja e saj. *Fillimi i bisedës* ka karakter ritual, p.sh.: me përsëritjet: *Si jeni? Si kaloni? Çkemi?* Në këtë rast, përgjigjet janë të parashikueshme<sup>296</sup>.

Ndërkaq, *rrjedha e bisedës*, ka ndërprerje të natyrshme për shumë arsye (folësi mund të marrë frymë, të mendohet pak, etj) ose nxjerrja e tingujve paragjuhësorë (*Ëë....., Hëm.....*). gjithashtu, dëgjuesi nuk është i heshtur, por mund edhe të mbështetë bisedën (*Tamam. E kuptoj. Ke të drejtë. Thua? Mos more! Ç' thua? Ua!* etj, deri në nxjerrjen e tingujve jashtëgjuhësorë).

*Mbyllja e bisedës* parashikohet nga tërësia e rrethanave. Tregues janë intonacioni dhe thëniet përmbyllëse, si: *mirë atëherë se do flasim prapë....., dakord, shihemi më vonë, etj.*

Në bisedë, gjithashtu, vihet re përdorimi i shprehjeve parazite, si: *domethënë, atëherë, (i) thashë unë...., etj.*

Ndërsa dukuria e ndërprerjes ndodh mjaft shpesh në rrjedhën e bisedës<sup>297</sup>.

## **b. Shkelje të normës standarde në ligjërimin e folur dhe të shkruar brenda dhe jashtë auditorit**

Në nënsisteme të ndryshme të shqipes letrare bashkëjetojnë dukuri fonetike e gramatikore e elemente të tjera gjuhësore të dialekteve deri edhe ato që përbëjnë dallimet kryesore, siç janë: *ë*-ja e theksuar, rotacizmi e jorotacizmi, grupet e zanoreve *ue/ua*, shumësi i emrave mashkullorë me prapashtesat *-a* e *-e*, *-a* e *-ër* e të tjera.

---

<sup>295</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhes Shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 333.

<sup>296</sup> Shih po ai, po aty, f. 335.

<sup>297</sup> Tipari i ndërprerjes së bisedës nga bashkëbiseduesi është shtjelluar në nënçështjen e ndryshorit sociolinguistik: gjini.

Megjithatë, për aq sa kemi pasur mundësinë për t'i vëzhguar këto në shkrimet e studentëve të të gjitha viteve, është për t'u theksuar se gabimet janë më të pakta në lidhje me këto tipare dalluese midis variantit letrar dhe dialekteve të shqipës, ndërsa në ligjërimin e folur të gjithë elementet e lartpërmendura janë tipare mbizotëruese në biseda të lira.

Ligjërimi i folur dhe i shkruar i studentëve pasqyron element formal dhe informal, të cilët vihen re më së shumti në kontekstin e përdorimit. Në gjuhën e përdorur në klasë (studentë-pedagogë, studentë-studentë) dhe në hartimin e detyrave të ndryshme, si detyra kursi, ese, etj., gjuha bazohet në normat dhe rregullat e drejtshqiptimit e drejtshkrimit, të gramatikës e leksikut, si p.sh. *pjesëtim, përpjesëtim, dimëroj*. Ndërsa në komunikimin informal (student-student), ligjërimi paraqet shkelje të ndryshme të normës letrare, duke anuar më së shumti nga tiparet bisedore ose të lira.

Gjuha standarde e variantit të folur karakterizohet nga një varg i gjatë shkeljesh të ligjeve gjuhësore, të cilat i përkasin të gjitha fushave të gjuhësisë: fonologji, fonetik, morfologji, sintaksë, semantik, etj., duke krijuar nyjëtime tingujsh, rrokjesh e fjalësh në shpërpjestim me kriteret drejtshqiptimore të njësive gjuhësore

Në të shkruar, gabimet kryesore bëhen në fusha të tjera, kryesisht në zbatimin e rregullave gramatikore dhe për shkak të mospërgatitjes së duhur gjuhësore dhe mosinteresimit për zotërimin e normës letrare në të shkrim.

### **6.b.1 Elementi fonetik**

Me gjithë përpjekjet e studentëve për përdorim sa më të mirë dhe të plotë të gjuhës standarde në auditorët e universitetit, ata nuk mund t'i shmangen plotësisht ndikimit të të folmes vendore. Shumë fjalë dhe shprehje edhe pse i përkasin një fjalori më të specializuar dhe libror, në shumë raste shqiptohen sipas variantit dialektor<sup>298</sup>, geg apo toskë. Ky tipar vërehet më së shumti tek studentët e vitit të parë të studimit.

#### **6.b.2.1 Gabimet në fushën e fonetikës e fonologjisë në ligjërimin bisedor**

Ndër gabimet më të shpeshta në fushën e fonetikës e fonologjisë në ligjërimin bisedor të studentëve (brenda dhe jashtë auditorit) janë:

- 1) luan rol intonacioni: tinguj të panyjëtuar qartë;
- 2) efekte prozodike paragjuhësore;

---

<sup>298</sup> Me shqiptim dialektor do të nënkuptojmë intonacionin dhe theksin me të cilat shqiptohen fjalët dhe jo ndryshimet e brendshme të strukturës së fjalisë.

3) stil jo i plotë i shqiptimit, p.sh., “*ë*” e patheksuar; “*i*” e patheksuar në diftongje del si [j]--[idjot] në vend të [idiot]. Shembuj të tjerë janë: *t’mir’*, *m’vdiq*, *mir’mir’*, *të mit’ bashk’ do flem’ jasht’ t’uroj*, *k’të* etj.

4) Fjalët që shqiptohen me dy thekse: [‘kafe] apo [kafe’];

5) Nën ndikimin e emocioneve (për përkëdheli ose përçmim) ndodhin ndërrime fonetike të gjatësisë së zanoreve, theksit, bashkëtingëllore. Këto tipare mbizotërojnë më tepër në bisedat intime apo përkëdhelitë (puç- puç);

6) Cungimet, rrëgjimet fonetike dëshmohen qartë me numërorët e përbërë [shtatdhjet];

7) Dukuritë fonetike ndërthuren qartë me shkurtime që prekin flajët, sidomos togfjalëshat: përmendja vetëm e dy shifrave të fundit për vitet [i dystenjëshi];

8) Shkurtohen togjet emëruese, [Shih te *Fonetika*];

9) Emrat e përvetçëm dalin dendur në trajtën e shkurtuar;

10) Prirja e përgjithshme, kryesisht tek shqipfolësit veriorë të standardit, është shqiptimi pa zanoren *ë*, sidomos në ligjërimin e shpejtë<sup>299</sup>. Nga ana tjetër, prania e –*ë*- së ruan strukturën fjalëformuese të fjalës dhe siguron në të folur një komunikim më të kapshëm; reduktimi i saj do të krijonte një grup bashkëtingëlloresh gati të pashqiptueshëm ose të shqiptueshëm me shumë vështirësi, si *dëgjoj*, *kërcej*, *luaj*, etj.

11) Vihet re mbizotërimi i nyjëtimit diatopik i fonemave në përdorimin zyrtar i nyjëtimit diatopik i fonemave në përdorimin zyrtar të gjuhës standarde, pra një nyjëtimit dialektor. Shpeshherë-e-ja në pozicionin midis dy bashkëtingëlloreve hundore *m-n* nuk nyjëtohet si e mirëfilltë, por artikullohet me prirje nazaliteti, p.sh.: *elemente*, *dokumente*, etj.

12) Dukuri e shkeljes së gjuhës standarde nga ana e studentëve (të Shqipërisë veriore) është edhe shkrirja e togjeve zanore: *ua*, *ue*, *ie*, *ye*, në sistemin emëror e foljor në rastet kur ato duhet të ruhen të plota, si p. sh. *me fitu*, *ka mendu*, *me pranu*, etj.

13) Nazalizimi i vokaleve është një tregues tjetër i përdorimit të gabueshëm të gjuhës standarde, si p.sh. *pesë*, *emër*, *zemër*, *vend*, etj.

14) Përdorimi i varianteve territoriale të fonemave zanore e bashkëtingëllore;

---

<sup>299</sup> Çeliku, M. (2011) *Për një përpërësim të mëtejshëm të shqipes standarde...* Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, fq: 333-334.

Tabelë 6. 2 Përdorimi i fjalëve standarde në të folmen vendore.

| <i>Standardi</i> | <i>Si e Shqiptojnë studentët</i> |
|------------------|----------------------------------|
| Njoh             | Njef                             |
| Humbur           | Hup                              |
| Zgjuar           | Zgjujt                           |
| Eshtë            | Asht                             |
| Bëhet            | Bahet                            |
| Të gjithëve      | Tanve                            |
| Hëngërsha        | Hangsha                          |
| Erdhe            | Ardh                             |
| Qumësht          | Taml                             |
| Duke             | Tuj                              |
| Shqipëri         | Shqipni                          |

15. Përngjashmime e rënie tingujsh të papranueshme për shqiptimin letrar;
16. Zhbuzorëzimi i /y/ -së në /i/;
17. Humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /r/;
18. Mospërdorimi i glotales [h];
19. Shqiptimi më i pëparmë e ndonjëherë edhe afrikatizimi i mesgjuhorëve /q, gj/ në /ç, xh/;
20. Këmbimi i /h/-së me /f/-në;
21. Ndërrimi i /nj/-së në /j/;
22. Monoftongimi i grupeve të zanoreve /ie/ dhe /ue/ në zanore të rëndomta të gjata.

Elementi fonetik në shqiptimin e huazimeve, sidomos të anglicizmave, në gjuhën shqipe paraqet këto tipare:

**Shqiptimi i diftongut** /ei/ në /ai/ si në fjalën Eng. *spray-* /sprei/, Alb.- *sprai*; ang. *event* – /i'vent/, shqip. – *event*, kjo fjalë ka pësuar dy ndryshime, (I) zanorja e përparme e mbyllur angleze /i/, në shqip shndërrohet në zanoren e përparme të mesme /e/, (II) në fjalën angleze theksi bie në rrokjen e dytë, ndërsa në shqip, theksi bie në rrokjen e parë. Fjala angleze *select* /si-lekt/ bëhet *selektuj-uj*, zanorja e mesme /i/ shndërrohet në zanoren e përparme të mesme /e/; ndërkohë numri i alofoneve rritet duke shtuar zanoren gjysëm të mbyllur /o/ dhe qiellzoren /j/. Të njëjtat ndryshime pësojnë edhe fjalët: *select* – *selekt-uj*, *launch* – *lanç-uj*, *start* – *start-uj*, *test-uj*, *klik-uj*, etj.

Por, duke shkuar më tej, procesi i dallimit të tipareve të normës gjuhësore në mjedise të tilla përmban në vetvete rregullsinë dhe thjeshtësinë e formave të ndryshme foljore, fonetike dhe morfologjike. Ky proces që natyrisht është zhvilluar gradualisht për një kohë të gjatë për të arritur mënjanimin e formave që kanë pasur një përhapje të ngushtë dialektore por nga ana tjetër kërkesa për të gjetur një analogji për të pasur një formë më të motivuar nga ana e ndërtimit gramatikor.

### **6.b.1.2 E folmja tradicionale vendore**

Gjuha vendore është tipar i rëndësishëm i përcaktimit të mjedisit administrativ të studentëve. Të shumta janë dallimet fonetike të studentëve nga Jugu dhe Veriu. Forma më karakteristike fonetike për t'ju përmbajtur normës së sistemit foljor janë përqendruar më tepër duke mbajtur parasysh në mënyrë të ndërsjellë prirjet e dy dialekteve kryesore të gjuhës. Ndryshimet fonetike shfaqen në artikulin e fjalëve të reja, të cilat janë krijuar si rezultat i zhvillimeve ekonomike, politike, elektronike etj. Të tilla janë<sup>300</sup>:

(a) Fjalët dhe termat që në gjuhën letrare mbarojnë me *-ë* të patheksuar, në të folmet e qyteteve veriore, si Lezha, Shkodra, Hasi etj., e rrëzojnë atë dhe i përshtaten atyre fonetike të simotrave lokale, duke pësuar edhe një zgjatim komesor të zanores së temës: *adre:s*, *anali:z*, *baler:n*, *bibliote:k* etj. Gjithashtu, është shtuar denduria e përdorimit të fonemës *u* etj.

(b) Shqiptohen pa *ë* edhe fjalët e termat që në gjuhën letrare kanë në përbërje të tyre *ë* të patheksuar, para – ose pas theksit, duke iu përshtatur edhe ato natyren fonetike të së folmes<sup>301</sup>, si p.sh: *aftsi* (aftësi), *antar* (anëtar), *argtim* (argëtim) etj.

(c) Fjalë dhe terma që në gjuhë letrare kanë trajta të rotacizuara në të folmet gege shfaqen pa rotacizëm, p.sh: *emnore* (emërore), *femnor* (femërore), *hapsin* (hapësirë) etj.

(d) Fjalë dhe trajta që përmbajnë grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, *ngjnë* të folmen vendore përdoren në trajta të asimiluara, përkatësisht në *m'/m*, *n'/n*, *n*, *nj*, si p.sh. *bashkinllore* (bashkëtingëllore), *datlinje* (datëlindje), *miblersoj* (mbivlerësoj) etj. Por ka edhe disa fjalë që përdoren si në gjuhën standard: *ambulancë*.

Në të folmet vendore vërehen edhe dallime etimologjike ose dallime në përbërjen fonematike të së njëjtës fjalë në dy të folme të ndryshme, p. sh: fjala *dimër* në disa të folme në variantin Toskë ka fonemat *d*, *i*, *m*, *ë*, *r*, dhe në disa të folme në variantin

---

<sup>300</sup> Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 224.

<sup>301</sup> Shih po ai, po aty, f. 225.

Gegë ka fonemat *d, i, m, ë, n*. Këto dallime shpjegohen me zëvendësimin e një fonemë, që është bërë në disa të folme për shkaqe fonetike<sup>302</sup>.

Sikurse vihet re në të gjithë shembujt e lartpërmendur zëvendësimet fonematike nuk kanë prekur sistemin fonologjik të të folmeve nga ana strukturore dhe funksionale, sepse zëvendësimet janë bërë me fonema që i kanë të folmet<sup>303</sup>. Pra në këto raste paraqiten vetëm dallime në dendurinë e përdorimit të fonemave, si: *murzitem* (mërzitem) etj.<sup>304</sup>.

Pra, në ligjërim bisedor dhe atë të lirë të studentëve që përfshihen në arealin me hapësirë që përfshin të folmen e qytetit të Vlorës, fshatrave përreth Mifolit dhe Selenicës, të folmet e Beratit, Skraparit, Tepelenës vërehet përdorimi i një inventar prej shtatë fonemash zanore të shkurtra<sup>305</sup>:

ĩ y ũ

ě ě ǒ

ǎ

Ndërsa në të folmet e studentëve që përfshihen në arealin e të folmeve të Elbasanit Librazhdit, Hasit, Kukësit etj., karakterizohet nga një inventar prej shtatëmbëdhjetë fonema zanore. Në këtë inventar mungojnë zanorja e theksuar *ě* dhe *o* hundore, e cila zëvendësohet nga *a*-ja hundore, që hyn në kundërvënien me *ě*-në<sup>306</sup>.

ĩ y ũ

i: y: u:

ĩ y ũ

ě ě ǒ

e: o:

ē ā

ǎ

a:

Të folmet e këtij realiti janë të njëjta nga ana fonologjike por kanë diferenca nga ana fonetike: të folmet Verilindore dallohen nga to të Shqipërisë së mesme në timbrin e zanoreve të shkurtra, të cilat janë më të hapura.

Tipar dallues fonetik i gegërishtes, p.sh. zanorja *a* në vend të *ě*-së (bëj- baj), togu zanor (mësue- mësue) janë mënjeluar nga përdorimi i strukturës fonetike dhe morfologjike të normës standarde të mbështetur në dialektin toskë. Po ashtu shumë forma me një tejfundore si (krijuame, punuame, pranuame, plotësuar...) janë mënjeluar nga përdorimi, por janë ruajtur forma si (shkruajmë, bëjmë etj.)

<sup>302</sup> Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 177.

<sup>303</sup> Shih po aty, f. 177.

<sup>304</sup> Shembuj të shumtë për pasqyrimin e kësaj pjese janë përmendur kapitullin: *Ndryshorët Sociolinguistikë*, në nënçështjen: Diferencat sipas ndryshorit *mjedis administrativ*.

<sup>305</sup> Gjinari, J., & Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003 f. 178.

<sup>306</sup> Shih po aty, f. 181.

Një femomen tjetër që ndodh është dhe huazimi i dialekteve nga njëri - tjetri. Në fillim duket si tipar i parëndësishëm por shkëmbimi i tepërt i leksikut të të folmeve të ndryshme vendore tashmë është realitet.

Kjo ndikon shumë në të folurën joformale të studentëve. Përdorimi i dialektizmave është element që zë vend në ligjërimin e studentëve, dialektizma të cilat nuk kanë përdorim në gjuhën standarde por gjejnë përdorim në zonat krahinore, fshat ose në qytetin e studentëve.

## **6.b.2.2 Leksiku**

### **6.b.2.1 Tipare të gjuhës së folur jashtë auditorit**

Leksiku studentor që i përket gjuhës së folur jashtë auditorit paraqet një sërë tiparesh:

(1) Shfaqet dendur polisemia e emrave dhe foljeve. Përdorimi ndeshet në pozicion të pavarur dhe në togje të gatshme, për komunikim, për shembull: *rri urtë, rri në këmbë, më rri mirë* etj.

(2) Togje me semantikë jo të saktësuar, por të paqartë: *ç'e ke atë zë, ç'e ke atë libër* etj.

(3) Cungimi i togjeve që duket te ruajtja e trajtave të shkurtra.

(4) Përdorimi i fjalëve në mënyrë të figurshme, p.sh.: Ky s'ka për të na **kaluar** (për të marrë notë pozitive); Mezi po pres të vi vera, të vemi në plazh, që të na **freskohet** mendja nga kjo shkolla (qetësohemi) etj.

(5) Përdorimi i figurave letrare me prirje për shndërrime të figurshme: figurat letrare (tropet) dhe shumëllojshmëria kuptimore janë ndër elementet që i japin komunikimit tipare bisedore. Ligjërimi bisedor dhe ai i shkujdesur i studentëve dallon për përdorim të tepruar të fjalëve dhe shprehjeve me kuptime figurative dhe të shprehjeve idomatike që mund të konsiderohen figura letrare<sup>307</sup>.

(a) Përdorimi i krahasimeve në fjali, p.sh.: *Ne jemi (si) **fenomena!** Është (si) karafil.*

(b) Përdorimi i epiteteve për të pasuruar kuptimin; gjenden më tepër mbiemra si epitete por edhe emra. Epiteti me funksionin e etiketimit pozitiv apo keqësues (pezhorativ) përdoret më tepër brenda grupit të ngushtë shoqëror, dhe jo vetëm: *smiro, naç, pilives, shtrigë, smirushe, majmun, o bukurane, ëmbëlsirë, mamasita, kokoshurth, tuli, axhitusi, killeri, urithi, laro, inkandeshenti, syzja, qerosi, çapaçuli xhirues, qyrtyk, delenxhes, zgjidhës, beracak, çopërpik, buzhgall.* Epitetet përdoren

---

<sup>307</sup> Drew, P., & Holt, E., *Figures of speech: "Figurative expressions and the management of topic. Translation in conversation"*, Cambridge, 1998, f. 495.

për të përshkruar njerëz dhe veprimet e tyre. P.sh: për dikë që do të bëhet medoemos modern përdoren shprehjet: *katunare lukzose, fshatare e civilizuar* etj.; për dikë që ka pretendime: *tip delikat, namusqar* etj.; për djemtë e mirë përdoren: *i respektueshëm, djalë flori, gjigand*; epitetet që përdoren për të dashurën janë: *zjarrmi, rrushi, zemra, piti* etj. Ndërsa epitetet që shprehin ngjyime negative janë më së shumti për pedagogët dhe për studentët e profileve të ndryshme:

(b.1) pedagogët etiketohen, si: *profi, shtriga, kuçedra, e gjithëditura, e zgjuara e shekullit, babagjyshi, kacagjeli* etj.,

(b.2) studentët e profileve të ndryshme emërtohen: *të ndriturit, llogaritarët, lekmëdhenjtë* (studentët e biznesit), *të mençurit, të prapambeturit* (studentët e psikologjisë e pedagogjisë), *Anjshtanji, shkencëtari* etj., janë etiketimet për studentët e degës së fizikës etj.

(c) Përdorimi i sinonimeve të shumta për një shprehje të caktuar. Format sinonimike nuk paraqesin vetëm mënyra të ndryshme të të shprehurit. Mbi të gjitha ato shënjojnë ngjyime kuptimore dhe konotacione të ndryshme. Disa paraqiten në formë ironie ose hiperbolizojnë kuptimin e shprehur. Disa prej tyre janë: *roja i shkollës* ndryshe etiketohet pozitivisht ose me ironi si: *portieri, gardiani, bodigardi i derës* (ang., < bodyguard, shqip. < truproje); ndërsa për termin *rektor* studentët përdorin këto sinonime me ngjyime pozitive: *kapua, shefi, i madhi, njëshi, koka, bosi* etj.;

(d) përdorimi i metaforës për emërtimin e njerëzve apo ngjarjeve të ndryshme. Të tilla janë: për vajzat dhe djemtë që kanë më shumë se një lidhje dashurore përdoren *tren me shumë tunele, çezmë me shumë burime* etj.

(dh) ironia është një tjetër figurë stilistike që shpreh tallje ose nëpërmjet intonacionit shprehja nënkupton të kundërtën. Shembuj të ndryshëm janë: *u bë shumë vapë këtu*, kur vjen dikush që është i papëlqyeshëm nga grupi shoqëror; *ja dhe banda në xhiro* përdoret për t'iu referuar një grupi tjetër vajzash apo djemsh që nuk kanë afrimetet midis tyre; *qenke shëndoshur, të numërohen brinjët*, kur dikush është dobësuar apo shëndoshur shumë.

(e) Sarkazma e shprehur në formën e ironisë therëse, demaskuese dhe në disa raste është e pamëshirshme, si p.sh: *dëgjo këtu ti, se dukesh më bukur kur dëgjon sesa kur flet. Më mirë mos fol e lëri të tjerët të mendojnë se je budalla sesa të flasësh e t'jua heqësh dyshimin* etj.

(ë) Asteizmi për të qortuar dikë me qëllim që ta lavdërojmë. Shprehje të tilla janë: *të hëngërt mortja ty. Erdhe ti moj. Hë moj dele. Patuqe.* Për dikë që është shumë i zoti në diçka përdoren shprehjet: *e vdes fare, e qan, po e kapi ai me dorë e ka kapur gjarpri, e ke mbyt komplet, ia luajte fenë.*

(f) Eufemizmi përdoret në ligjërimin bisedor studentor me qëllim zëvendësimit e fjalëve të pahijshme me fjalë më të lehta, si: *sa e shtarur je* (e neveritshme), e rëndomtë (vulgare), *i paaftë* në vend të *i trashë, tutkun, gdhë, dërrasë, parazit* etj.

(g) Arkaizmat kanë përdorim të ngushtë në zhargonin studentor. Ato janë rezultat i të folmeve të mjedisve familjare ose të folmeve vendore. Të tilla janë: *tenxhere, në kohën e Baba Qemos, ç'më je veshur si kallogre* etj.

(gj) Krahinorizmat hasen dendur në ligjërimet e lira të studentëve.

Shpeshherë fjalët dhe shprehjet e vendlindjes janë burim keqkuptimesh ndërkulturore. Shembuj të të folmeve vendore janë: *mushmolla, hurma, kaki, baxha, komshije, gjitone, nashi, qumështuar; lale, vllai, lalkë; cuc, koce, çupë, vajzë; veni për vendi; mos rras apet në punët e mia për mos fut hundët në punët e mia; fli në dafina* etj.

(1) Përdorimi i fjalëve që theksojnë anën emocionale, p.sh.: ***Bombë fare!; Grand pushime!*** O Zot, hajde merru me këto ***dreq provimesh! Aleluja!*** Më në fund *relaks dhe plazh!*

(2) Përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve që përdoren në rrjete të ndryshme sociale, p.sh.: *frendsa; omg; ma nis në inboks* (inbox);

(3) Përdorimi i fjalëve të huaja, sidomos, huazimet nga gjuha angleze / italiane, p.sh.: *neiborhutsa; kull (cool); grand; super; kis-kis* (kiss-kiss);

(4) Nuk janë të pakta edhe huazimet strukturore e semantike nga gjuhët e huaja. Tashmë ka hyrë në përdorimin mediatik, ndikimi i së cilës vërehet edhe në kulturën rinore, përkthimet e shprehjeve të ndryshme, si: *to share (with)* “kam të përbashkët diçka, me dikë”, “*mirë për ty*” sipas modelit të shprehjes *good for you*. Në këtë rast, folësit mendojnë në gjuhë të huaj dhe e përkthen në shqip.

(5) Numërori *tre* përdoret për të dyja gjinitë, në gjuhën popullore paraqitet: *tre goca, tre pikë, tre djem*, etj në vend të *tri vajza, tri pikë, tre djem*.

Në këtë ligjërim vërehen edhe të meta<sup>308</sup>. Një farë standardi i drejtshqiptimit po arrihet më fort në një mënyrë të shpejt tek studentët e vitit të tretë të studimit dhe atyre në nivelin e studimeve të ciklit të dytë. Këta studentë, rreth 67%, duket se kanë lënë mënjanë tiparet dialektore, pra formën e folur të gjuhës letrare jo vetëm nga karakteristikat fonetike të dialekteve, por edhe nga timbri dallues i të folmeve.

Në mjediset universitare, jashtë auditorit, vërehet shmangie nga norma sidomos në gjuhën e folur por edhe në atë të shkruar. Fjalë dhe shprehje të shkurtuara dëgjohen dendur në bisedat e lira mes miqsh. Të tilla si: *Ça ke me mua?* < *Ça* < *Çfarë* (apakopa); *edhe sa min.* < *minuta* (apakop); *1 sek; asIher; pshmb.; BMV; TDSH* (të dua shumë); *ktë muabet* < *këtë muhabet* (sinkopa); *ship* < *shtëpi* (sinkopa); *gjys'* < *gjysmë*

<sup>308</sup> Lafa, E., *Gjuha e medias sot—probleme dhe detyra*, Tiranë, 2000, f. 13.

(apakopa); të shumtat janë edhe metatezat e përdorura me ngjyrimë kuptimore: *makiato* > *kamiato*, *lezetshme* > *zeletçme*, *puth* > *thup*, *na u trash llapa* > *na u llash trapa* etj.; dëgjohen shpesh shtrembërime të fjalëve me funksion stilistikor (përkëdheli apo afrimetet) të shoqëruara nga formime vetjake prapashtesore apo kompozita me qëllime stilistikore: *puç*, *ncuq*, *xemla*, *kukla*, *mos u mëzhit*, *të djelëm do*, *o tutul*, *budadhaqe*, *bubulesh*, *kosminjohëse*, *portokaqielli*, *interestorante*, *shdukusu*, *plincesha*, *piciluke* etj.

### 6.b.2.2 Tipare të ligjërimit të shkujdesur

Në *ligjërimin e shkujdesur*, gjithashtu, hasen fjalë nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, midis tyre gjenden edhe fjalë të zakonshme shqip, të cilave iu janë bashkëngjitur kuptime të reja, shpeshherë të pazakonta dhe të veçanta. Gjithashtu, elemente të tilla si: *intonacioni*, *ritmi i artikulimit të fjalëve dhe shprehjeve*, *pasaktësia e artikulimit*, *mos shqiptimi i disa tingujve ose grupe tingujsh* janë disa prej tiparet ligjërimore të shkujdesura.

Tipare të tjera mund të përmendim: përdorimi i mbiemrave më kuptim pozitiv për të shprehur kuptim keqësues (pezhorativ) me qëllim ekzagjerimin e të shprehurit (*ai është një idiot fenomenal*). Përdorimi i fjalëve të ashtuquajtura tabu ose vulgare janë një element tjetër dallues i këtij ligjërimi. Ato gjejnë përdorim të gjerë të tematika të tilla si: marrëdhëniet seksuale, apo organet gjenitale të femrave dhe meshkujve. Pra, vulgariteti mund të konsiderohet si tipar karakterizues i ligjërimit të thjeshtë në kulturën rinore. Si rrjedhojë, përdorimi i tepruar i shprehjeve të tilla është gjithmonë nën kritikën e brezave të tjerë. Megjithatë, fjalët dhe shprehjet iu nënshtrohen edhe proceseve semantike, duke fituar kështu kuptime të tjera dhe si rezultat ato shndërrohen në figura letrare si metafora, sinonimia, metonimi etj. Pra, fjalët dhe shprehjet mund të fitojnë përdorime të reja. Ato mund të shkurtohen, disa prej tyre fitojnë status më të madh përdorimi, disa të tjerave u shtohen kuptime vulgare etj.

Të shumta janë edhe shmangie të tjera nga norma, të cilat bien në kategori të ndryshme si: mosrespektim i rregullave të drejtshkrimit e drejtshqiptimit, mospërshtatje në kohën e foljeve dhe mospërshtatje e mbiemrave, gjinia etj. Për të ilustruar këto shmangie po sjellim disa shembuj si: *lesh lesh* < *lesh-lesh*, *më mërzhini* < *më mërzhiti*, *detyrën e kursit e bëra mira* < *detyrën e kursit e bëra mirë...* *Pastaj mbaron provimi* < .....do të mbarojë provimi, *fund vitit* < *fundvitit*, *si t'ia nis për të shkruajtur* < *si t'ia nis për të shkruar*, *morra katër këmbët e pulës* < *mora katër këmbët e pulës*, *erdhën sërish mandatat* < *erdhën sërish mandatat*, *tani do bjej tërmet* < *tani do bjerë tërmet*, *provim pend i lehtë* < *provim pendë i lehtë*, *kokë palara* < *kokëpalara*, *bishtë përdredhura* < *bishtpërdredhurat*, *fytyrë plastika* < *fytyrëplastika*, *tharanukja* < *thatanukja*, *kocomeli ime* < *kocomeli im*, *leje fare* < *lëre fare*, *t'a bën borxh* < *ta bën borxh*, *ti zhvat* < *t'i zhvat*, *nji dhjeçe* < *një dhjetëshe*, *shifena* <

shihemi, *u thuj* < *thuj*, ...*skam impuls* < ...*s'kam impuls*, *ta tregoj unë qefin* < ..... *qefjin*, *folim pastaj* < *flasim pastaj*, *roja* < *rroja* etj.

Ligjërimi i shkujdesur përmban fjalë dhe shprehje informale, si dhe përdorime joformale të leksikut formal. Të tilla janë: kur një vajzë është seksualisht tërheqëse ajo cilësohet si “*bombë*”. Pra, në leksik vërehen fjalë të reja dhe kuptime e përdorime të reja të fjalëve ekzistuese. Tipar i rëndësishëm i ligjërimi të shkujdesur, është jo vetëm krijimi i fjalëve dhe kuptimeve të reja, por edhe krijimi i lidhjeve të reja gramatikore midis fjalëve.

Pra, leksiku i këtij ligjërimi mund të konsiderohet si inovativ, sepse vazhdimisht pasuron gjuhën standarde në mënyra të ndryshme<sup>309</sup>.

Përfundimisht, një mori shprehjesh janë thjesht fjalë ose shprehje të sajuara. Këto fjalë krijohen nëpërmjet zëvendësimit të emrit origjinal me një fjalë tjetër bazuar në një nga atributet e fjalës së parë.

Tiparet e lartpërmendura, së bashku me shprehje dialektore, sikurse përmenden më poshtë, formojnë pjesën më të madhe të ligjërimin të lirë të studentëve në Universitetin e Vlorës. Gjithashtu vihet re se një pjesë e fjalëve të ligjërimin të lirë renditen shpeshherë krahas togjeve të fjalëve të njëjta, pra hasen më shpesh në shprehje të përbëra.

Përveç kuptimit të drejtpërdrejtë, shumë fjalë përdoren edhe me kuptim të figurshëm, që nuk mund ta kishim përpara. Janë krijuar togfjalësha të rinj. Janë zgjeruar kufijtë e **polisemisë** së shumë fjalëve. Le të shohim disa prej tyre:

“*E bën vizën sa tavolina*”: fjala *vizë* nënkupton mënyrën e përdorimit të një lloji lënde narkotike.

“*Çerr*” - nga ana gramatikore është e saktë dhe hyn tek epitetet. Nga ana kuptimore është fjalë që kuptohet lehtësisht nga çdo individ dhe përdoret për të përshkruar dikë që është vartës i dikujt.

“*Ti je dele fare*” - Kjo është një shprehje krahinore, e cila përdoret kryesisht nga studentët që vijnë nga qyteti i Fierit dhe përdoret me konotacion negativ. Kjo shprehje ka përdorim joformal, nga ana gramatikore nuk ndjek asnjë rregull të veçantë formimi dhe as nuk i shmanget ndonjë rregulli të rëndësishëm. Për t’u theksuar është kuptimi leksikor i saj që karakterizohet nga ngjyrimet negative. Për ta përmbledhur, kur studentët përdorin këtë shprehje ata nënkuptojnë se personi tjetër nuk është shumë i zgjuar për të kuptuar se si funksionojnë gjërat. Situata të tjera në të cilat theksohet më tepër kuptimi i kësaj shprehjeje janë: *E si mund ta zgjidhesh ti këtë ushtrim kur ti je dele fare?* Në këtë rast nënkupton që nuk je mjaftueshëm i zgjuar për ta zgjidhur atë ushtrim, ose: *Ti je dele fare/a ka ndonjë gjë që ti mund ta kuptosh?* Kuptimi në këtë rast është përsëri negativ por më i theksuar.

<sup>309</sup> Juachoerin., *The grammar of slang*, Berkeley, 2006, f. 1.

“*Ti dukesh më bukur kur flet*”- kjo është një shprehje e cila përdoret në mënyrë ironike. Në rastet kur dikush flet për gjëra të cilave ti nuk u kushton rëndësi, të mërzhisin ose kur dikush flet pa fund pa shprehur atë që vërtetë do të thotë, atëherë studentët përdorin një shprehje të tillë.

“*Po shkoj deri në zyrë*”- nëse e merr këtë shprehje të mirëqenë, pra nëse i referohesh kuptimit të drejtpërdrejtë që mbart fjala *zyrë*, është e vështirë të kuptohet se çfarë realisht do të thotë dikush kur e përmend këtë shprehje, e cila nga ana gramatikore i përmbahet rregullave të gramatikës së gjuhës shqipe. Ajo që dallohet dhe vlen të diskutohet është ana kuptimore, pra leksikore. Për t’ju kthyer edhe njëherë kuptimit të kësaj shprehjeje, *po shkoj deri në zyre* përdoret në rastet kur themi *po shkoj në tualet*. Kjo është një shprehje që mund të konsiderohet si individuale dhe që përdoret brenda dhe vetëm në një grup të caktuar, por mund të jetë e përdorur dhe lehtësisht e kuptueshme edhe nga grupe të tjera sociale të cilat përdorin shprehje të ngjashme sinonimike si “*po shkoj në drejtori*” etj.

“*Shiko zogun që fluturon.*”- një fjali e përbërë nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur të lidhura me njëra tjetrën nëpërmjet lidhëzës filluese *që*, përdoret si një shprehje e cila shërben si kod në komunikimin brenda grupit. Kjo pohohet duke u bazuar në faktin që shprehja “*shiko zogun që po fluturon*” përdoret për të thënë shiko kush po kalon, pra kuptimi i saj qëndron larg nga ajo që arrin të perceptohet në momentin e parë që dëgjohej kjo shprehje. Në këtë rast, fjala *zog* përdoret në mënyrë simbolike për të thënë *njeri* dhe folja *fluturon* nënkupton *kalon*.

“*U bë vapë këtu tani*”. Kjo është një fjali e thjeshtë dëftore e përbërë nga një folje në formën joveprore, kundrinori *vapë*, ndajfolja e vendit *këtu* dhe ndajfolja e kohës *tani*. Nëse do ti referohemi anës leksikore edhe kjo shprehje përdoret me kuptim figurativ dhe mbart nota ironie. Nëse do ta marrin të mirëqenë, në kuptimin e saj të drejtpërdrejtë do të kuptonim një situatë të karakterizuar nga rritja e temperaturës, por në të vërtetë ajo që kërkon të shprehë folësi kur përdor këtë shprehje, është mospëlqim ndaj pranisë së dikujt.

“*Kokëqyp*” - është një fjalë e përbërë e formuar nga dy fjalë të thjeshta: *kokë* dhe *qyp* që përkatësisht janë dy emra. Kjo fjalë përdoret për t’iu referuar dikujt me të cilin ke një shoqëri të afërt dhe e përdor në mënyrë konfidenciale ose mund të përdoret edhe me konotacion negativ për t’iu referuar dikujt që nuk është mjaftueshëm i zgjuar për ti kuptuar dhe vlerësuar disa situata.

“*Do ta derdhim sonte*”- kjo është një fjali e thjeshtë dëftore e cila iu përmbahet rregullave gramatikore të sintaksës së gjuhës shqipe dhe që përbëhet nga një folje në kohën e ardhme dhe ndajfolja e kohës *sonte* që janë në funksionin e një rrethanori. Kjo shprehje përdoret për të thënë që *do të pimë sonte*, pra kuptimi i saj është i fshehur dhe përdoret me konotacion pozitiv. Pra këtu mungojnë kuptimet e mundshme ironike që do ta bënin këtë shprehje të përmbante nota kuptimore negative.

*“E moj motër xhani e”* - Kjo shprehje është pak ose aspak e hasur në tekste dhe kudo ku përdoret gjuha formale, zyrtare. Kjo pohohet duke u bazuar në faktin se kjo shprehje i përngjan aty shprehjeve frazeologjike të krijuara, përdorura dhe transmetuara vetëm gojarisht. Konotacioni i saj është pozitiv duke u nisur nga shembulli praktik që kjo shprehje përdoret për të thënë që je dakord me mendimin e asaj që po bashkëbisedon, por mund të përdoret edhe në mënyrë ironike, pra për të shprehur konfirmim, por ironikisht.

*“A ç’më ha... kohën e lirë”* - Kjo shprehje përdoret për të shprehur një shpërthim emocional pezhorativ, është siç mund ta cilësojmë ndryshe një shprehje banale. Individuale ose sociale qoftë, ajo çfarë nënkuptohet nga kjo shprehje, varet nga mënyra e shqiptimit, pra nga intonacioni që i jepet dhe në varësi të këtij elementi përcaktohet edhe kuptimi. Nëse do të merret në kuptimin e saj të drejtpërdrejtë do të thotë që dikush po të shpenzon kohën për gjëra të cilat kanë pak ose aspak vlerë për ti kushtuar kohë dhe rëndësi. Kuptimi i dytë i fshehur, pra kuptimi figurativ është ai i lartëpërmendur i një shprehjeje banale. Kjo shprehje nuk mund të cilësohet si një kod në komunikimin brenda grupit, sepse kuptimi i saj është lehtësisht i perceptueshëm nga kushdo.

*“Je duke ja fut me top më duket”* - një shprehje figurative kjo, e cila përmban figurën letrare të metaforës fsheh një kuptim ironik. Ajo që folësi kërkon të shprehë në momentin që e përdor këtë shprehje është tërheqje e vëmendjes së bashkëbiseduesit për ta bërë të kuptojë se ato që po thotë, nuk kanë kuptim, pra që po flet pa ndjekur një logjikë të saktë në mënyrën e të shprehurit apo të gjykuarit. Një shprehje e tillë domosdoshmërisht është e përdorshme brenda një grupi të caktuar shoqëror, sepse vetë kuptimi që mbart kërkon të jetë e vendosur në një kontekst të tillë. Kjo shprehje është e kuptueshme nga pothuaj të gjithë studentët, sepse ekziston edhe në forma të tjera sinonimike me të si p.sh: *po ja fut kot*, *po ja fut si pasnesër* etj.

*“Vëri kyçin”* - kjo shprehje që njëkohësisht është një metaforë nga ana gramatikore është e strukturuar prej foljes “vë” që në ligjërimin akademik do të zëvendësohej përkatësisht prej foljes *vendos* dhe emrit të rasës kallëzore *kyçin*. Nga ana leksikore kjo shprehje vjen me kuptimin “*mbylle gojën*”, “*mos fol më*” që mund të konceptohet në formën e një këshille ose urdhri. Kjo varet gjithnjë nga konteksti. Për ta ilustruar po rendisim këto shembuj: (1) *Unë të jap vetëm një këshillë: “Vëri kyçin”*. (2) *Vëri kyçin dhe e lëmë me kaq!* Pra, në të dyja rastet përdoret e njëjta shprehje por që në shembullin e parë vjen në formën e një këshille ndërsa në shembullin e dytë shpreh një urdhër.

*“Më kanë braktis neuronet”* - një shprehje figurative që përdoret në formë metaforike, kjo e cila në mënyrën e përdorimit të saj, përbën një shkelje të hapur të rregullave gramatikore gjuhësore për sa i përket formës së foljes “*kan braktis*”. Këtu vihet re jo vetëm eliminimi i ë-së fundore në foljen ndihmëse *kam* por edhe asimilimi i mbaresës “*ur*” pjesë kjo e pjesores së foljes *braktis*. Këto forma përdoren rëndom në

ligjërimin e shkujdesur për arsyen e thjeshtë të të shpenzuarit më pak kohë dhe energji, pra për më tepër frytshmëri në ligjërim. Për tu kthyer tek ana kuptimore duke qenë se neuronet janë qeliza nervore, kjo të bën të kuptosh se kuptimi i kësaj shprehjeje është: *më ka ikur mendja*.

*"Flet sikur i është djegur llampa"* - kjo është një shprehje figurative e ndërtuar mbi figurën letrare të krahasimit lehtësisht e dallueshme nga prania e pjesëzës krahasuese *sikur*. Nga ana gramatikore në këtë shprehje nuk ka ndonjë shkelje të rregullave të gjuhësisë. Ajo që vlen për t'u theksuar është ana leksikore, pra kuptimi që mbart kjo shprehje që sikundër u lartëpërmend është i fshehur në figurën letrare të krahasimit. Kështu që, kur një student përdor një shprehje të tillë, ajo që realisht ai kërkon të shprehë është nënvlerësim duke qenë se i referohet dikujt që nuk është i aftë mendërisht ose që flet përçart.

*"Bashkëjeton një herë në javë"* -shprehje ku përdoret figura e simbolit, një shprehje e cila vjen në formën e një këshillë, që do të thotë se personat takohen rrallë.

*"Alabak pa klasë"* - është një shprehje e cila nuk është shumë e përdorshme dhe që nënkupton një djalë që përpiqet të jetë në modë, por është i paedukatë dhe i paarsimuar.

*"Shidha - shidha"* si bën - është një shprehje dialektore, jo shumë e përdorshme, një shprehje ku vihet re një devijim ndaj rregullave gramatikore sepse fjala *"shidha"* duhet të shprehet me fjalën *"shiko"*, ku ka kuptimin për dikë që po bën sjellje jo të natyrës së vet.

*"Ala heshtje"* - një shprehje dialektore, ku vihet re devijimi ndaj rregullave gramatikore sepse fjala *"ala"* duhet të shprehet në formën *"akoma"*, një shprehje e cila ka kuptimin që po mbizoteron heshtja për një kohë të gjatë.

*"E papame"* - është një epitete, një shprehje shumë e përdorshme e cila ka kuptimin për dikë që është shumë e bukur ose fantastike.

*"Skorpions"* - është një fjalë shumë e përdorshme e cila ka kuptimin për dikë që është shumë modern, i kohës.

*"Na ka fik derën"* - është një shprehje shumë e përdorshme, e cila ka kuptimin së diçka na ka prishur punë.

*"Truri"*: Fjala *truri* është shprehur në mënyrë figurative dhe përdoret për t'u referuar dikujt që është shumë i zgjuar.

*"Dërrasë"*: Kjo fjalë përdoret në mënyrë figurative si epitet për studentët që nuk mësojnë.

*"E qava"*: shprehja *e qava* e ka prejardhjen nga fjala *qaj* që do të thotë *vajtoj ...*, fjala *qava* është shprehur në mënyrë figurative e nënkupton kryerjen e një pune apo provimi me saktësi dhe pa gabime.

“*Lepërushi*”: fjala *lepërushi* e ka prejardhjen nga lepuri. Në këtë rast, është përdorur në mënyrë përkëdhelëse, për një person që na pëlqen.

“*Ka shkarë fare*“: Përdorimi i kësaj foljeje është figurativ dhe nënkupton një person që nuk është mirë nga mendja, apo i ka shkarë mendja.

“*Qeveri me vete*“: fjala *qeveri* do të thotë organizmi më i lartë i administratës shtetërore që ushtron veprimtari ekzekutive. Fjala *qeveri* është përdorur në mënyrë figurative dhe nënkupton një person që mendon ndryshe nga të tjerët apo dikë që nuk do t’ia dijë së çfarë ndodh përreth tij.

“*Të ka ikur kosherja*“: Fjala *koshere* është përdorur në mënyrë figurative dhe ironike në të njëjtën kohë. Kuptimi i dyfishtë i saj është: dikush nuk është në rregull nga ana mendore.

“*Pasha, vëllah pasha*“: fjala *pasha* vjen nga turqishtja që do të thotë njeri i plotfuqishëm (gjeneral). Kjo shprehje është përdorur në mënyrë figurative dhe tregon një person që rri dhe nuk bën gjë.

“*Je thes i grisur*“: kjo shprehje ka përdorim të gjerë në Jug, dhe në mënyrë figurative nënkupton një person që nuk mban sekrete. Shprehje sinonimike është: *Të këndon dhe zverku*: fjala *zverk* përdoret në Jug dhe nënkupton gushën e njeriut. Edhe në këtë rast, kjo shprehje përdoret në mënyrë figurative dhe nënkupton që flet shumë.

“*Ti e ke të bluar*“: Mbiemri *i bluar* vjen nga folja *bluaj*. Kjo shprehje është përdorur në mënyrë figurative dhe nënkupton një person që çdo gjë e ka në rregull dhe se lodh mendjen.

“*Ti nuk ke cipë*“: fjala *cipë* do të thotë një prej shtresave të lëkurës dhe nënkupton që dikush nuk ka turp.

“*Ti je i karbonizuar fare*“: fjala *i karbonizuar* vjen *karbonizoj* dhe kjo nga fjala *karbon* (qymyr) që nënkupton një njeri që është tepër i lodhur.

“*Të kallka datën*“: fjala *kall* përdoret nga zona e mesme dhe do të thotë më trembe.

“*Çdo gjë që ndodhi qe bombë për mua*“: kjo shprehje përdoret në mënyrë figurative dhe do të thotë ajo që ndodhi ishte e papritur për mua, nuk e prisja që të ndodhte kështu.

“*U nxeh situata këtu*“: kjo shprehje e përdorur në mënyrë figurative brenda grupit shoqëror për të nënkuptuar që erdhi dikush i padëshiruar.

“*Humbjen e kam në xhep unë*“: kjo shprehje përdoret nga zona e Jugut dhe shpreh kuptimin se sado përpjekje të bëjë dikush, rezultati do të jetë jo në favor të tij.

“*Ai djalë është si veriu*“: krahasimi *si veriu* në këtë shprehje nënkupton shpejtësi, shkathtësi.

“*Halla di të bëj byrek, por nuk ka miell*“: figurshmëria e kësaj shprehjeje (fjale të urtë) nënkupton “di unë ta zgjidh situatën por nuk mundem, sepse nuk kam mundësi apo të holla që ta zgjidh”.

Pra, në të folurin bisedor dhe të lirë të studentëve vërehet përdorimi i shpeshtë i shprehjeve dhe njësisive frazeologjike. Funkzioni i përdorimit të këtyre ndërtimeve gjuhësore është përcjellja e mesazhit të koduar, shprehja e origjinalitetit e individualitetit, si dhe komoditeti që paraqet përdorimi i tyre në gjuhë. Konteksti i përdorimit të njësisive frazeologjike është i shumtë, sidomos në mjediset e jashtme universitare, në mjediset shoqërore, kafene, konvikt etj. Shformimet në nivele të ndryshme, theksimi i emotivitetit deri në zbrazje semantike, ngjyrimet e forta kuptimore, asosacionet e papritura dhe shpeshherë të pakuptueshme, copëzimi i thënieve etj., janë tiparet kryesore të leksikut të ligjërimit të shkujdesur<sup>310</sup>.

Në përfundim të kësaj nënçështjeje, mund të shprehemi se *ligjërimi i shkujdesur, i përdorur në ligjërimet joformale të studentëve të Universitetit të Vlorës, vuri në dukje disa tipare dhe shmangie nga norma letrare. Standardi shtrembërohet dhe fiton tipare të përgjithshme. Shkeljet të normës gjuhësore vihen re në ligjërimin individual, por edhe në ligjërimin e një grupi të ngushtë shoqëror, të cilin ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë tek njëri – tjetri. Në këto raste, shmangiet nga norma si sistem janë të shumta.*

Duke u bazuar në heterogjenitetin gjeografik, mund të shprehemi se format gjuhësore të ligjërimit të shkujdesur paraqiten si një përzierje e formave të ndryshme letrare e krahinore, të cilat paraqiten si forma të shtrembëruara, të krijuara dhe të kushtëzuara nga momenti i ligjërimit.

Karakteristikë e gramatikës së ligjërimit të shkujdesur është paqëndrueshmëria e elementeve morfologjike dhe sintaksore, shtrembërimi leksiko-gramatikor dhe copëzimi i togjeve në të folur.

Folësit e vënë re dukurinë e zhvendosjes së ligjërimit prej gjuhës letrare drejt një ligjërim më të thjeshtë, në të drejtpërdrejt, në të cilin mbizotëron ana subjektive e folësit dhe tiparet gramatikore shkelen në masë të madhe. Në dialog, për shkak të ngarkesës së madhe emocionale, vihet re përsëritja

### **c. Prurjet e reja leksikore**

Në vitet e fundit, në sistemin leksikor të shqipes kanë hyrë me qindra **prurje të reja leksikore**. Për këtë kanë kontribuar rrugët e zakonshme të pasurimit të fjalorit të një gjuhe, që janë formimi i fjalëve të reja me brumin e gjuhës, nëpërmjet prejardhjes dhe përbërjes, dhe sidomos huazimit leksikor<sup>311</sup>.

---

<sup>310</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 178.

<sup>311</sup> Omari, A., *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, Tiranë, 2011, f. 175.

Kristal (Crystal, 1992) i cilëson termat e huazuar si prurje fonologjike, morfologjike, leksikore dhe sitaksore nga një gjuhë ose varietet në një tjetër. Ndërsa Rodrigues (Rodrigues, 1996) e konsideron termin “huazim” si të papërshtatshëm dhe të paplotë semantikisht në përshkrimin për shkëmbimet gjuhësore. Janë të shumtë shembujt e shkëmbimeve leksikore nga anglishtja në gjuhën shqipe, në të cilat mungon ekuivalenca e plotë leksikore. Për këtë arsye, Rodrigues sugjeron termat “fjalë e huaj” ose “alienizëm”. Ndonëse, termi “huazim” zë vend më të gjerë në përdorim, gjuhëtarë të tjerë si Sampedro (2000) etj., sugjerojnë terma si “anglicizma”, “neologjizma”, “kalke” ose “barbarizma”. Lënda e mbledhur për këtë qëllim vërtetoi se në ligjërimin e folur dhe të shkruar, sidomos ai teknik, por edhe në ligjërimin e lirë që haset më së shumti në bisedat informale apo shënimet e studentëve, por edhe në komunikimet elektronike u vërejtën një sërë huazimesh sidomos nga gjuha angleze. Të shumtë janë shembujt si: *weekend* për fundjavë, *make-up* për grim, *trendy* për ...e kohës etj. Sikurse vihet re në shembujt e paraqitur gjenden fjalë të huaja të cilat kanë ekuivalentin e tyre në gjuhën shqipe dhe nuk paraqesin vështirësi për të hamendësuar kuptimin e tyre. Midis tyre janë edhe fjalë që tashmë konsiderohen si *ndërkombëtare*, të cilat i përkasin fushës së ekonomisë, sportit, elektronikës, mediave etj., për shembull: *background*, *Big Brother*, *X-Factor*, *The Voice*, *facebook*, *sms*, *trendy*, *look*, *Top Show*, *CV* etj.

Hyrja në gjuhë e fjalëve dhe ndërtimeve të reja, së pari, është si nevojë për t’u përgjigjur zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Pra, gjuha shqipe detyrohet të krijojë por edhe të marrë hua një numër të madh fjalësh nga gjuhët me të cilat ka marrëdhëniet më të dendura, siç janë anglishtja dhe italishtja. Shpesh herë duke e marrë fjalën e huaj gati, pa pritur krijimin e terminologjive të fushave përkatëse nga gjuhëtarët apo të shqipërimin të fjalëve të huaja.

Në studim, u evidentua se huazimet mund të jenë të *drejtpërdrejta*, (I) duke shprehur të njëjtin kuptim në të dyja gjuhët, si: *weekend* (fundjavë), *trendy* (e kohës), *make-up* (bëj tualet, grim), *shopping* (pazar), *pub* (lokal), etj; (II) paraqesin të njëjtën formë grafike dhe të njëjtin shqiptim edhe në gjuhën shqipe, p.sh.: *hobby*, *facebook*, *mouse*, *software*, etj; (III) i njëjti shqiptim, por nuk ekziston sinonimi i fjalëve në shqip, si: *hot dog*, *chips*. *Fast food*, *work shop*, *draft*, *pizza*, *sandwich*, *hamburger*, etj.

Prandaj, fjalori pëson një zgjerim të brendshëm, në kuptimet e fjalëve, në thëniet e ilustrimet, etj. Studimi bën përpjekje për të realizuar një vlerësim stilistik tërësor të leksikut të studentëve dhe nëpërmjet analizimit të tij zbërthehen të gjitha ato njësi që zbulojnë lidhjet dhe përdorimin e fjalëve në gjuhën e gjallë, në ligjërim. Në ligjërimin e lirë studentor u vu re një përdorim i huazimeve të panevojshme të përdorura me qëllim stilistikor, duke mbartur ngjyrime, si: *OK*, *like a boss*, *very meravigliose*, *qyteti stupida*, *amigo*, *aot* (out), *new entry*, *non stop*, *bye-bye*, *amore-n*, *çao* (ciao), *on air*, *tezoro*. Analizë më e hollisishme e huazimeve në gjuhën shqipe, përdorimi i të cilave, në disa raste, shoqërohet nga dykuptueshmëria, jepet më poshtë:

“*Oh sun don't you ever step shining*” - Kjo shprehje tipike për studentët anglishtfolës individuale ose jo, gramatikusht është e saktë dhe ndiqet rregulli i formimit të një fjalie thirrmore. Ajo që bën diferencën në këtë rast është ana leksikore. Për të qenë me konkrete, kjo fjali edhe pse i përngjan një thirrjeje, mbart kuptim figurativ, sepse ajo që do të shprehesh realisht nuk është ti lutesh diellit të vazhdojë të shkëlqejë, por do te thotë se dikush është kaq i lumtur në momentin që e përmend këtë frazë saqë do të donte të ishte gjithmonë kështu.

“*E seivova dokumentin*”- folja *seivova* është një fjalë e huazuar e cila vjen nga anglishtja: *save* (alb. < ruaj)<sup>312</sup>. Në këtë rast duke i shtuar mbaresën e kohës së pakryer -ova , pra *seiv* + *ova* është formuar fjala *ruajta*, korresponduese në gjuhën shqipe. Më tepër se sa një shprehje grupi e cila ka një kuptim të fshehur dhe jo të kuptueshëm nga kushdo kjo është një shprehje individuale e cila perdoret më tepër për të treguar se je njohës i një gjuhe të huaj dhe përdorues i teknologjisë.

“*Bëj copy-paste*” - këto dy folje *copy* dhe *paste*, që përkatesisht në gjuhën shqipe nënkuptojnë “kopjoj” dhe “ngjis”<sup>313</sup> përdoren masivisht nga studentët anglishtfolës dhe më gjerë. Ashtu sikundër u theksua në shembullin e sipër përmendur, përdorimi i fjalëve të tilla përben më tepër një trend. Pra duke qënë se jetojmë në një periudhë të cilesur si shekulli i teknologjisë përpos zhvillimeve të mëdha teknologjike, përdorimi i termave të tillë shihet si diçka tepër normale edhe pse këto fjalë zëvendesojnë dhe lënë mënjanë foljet e gjuhës shqipe. Pra, në një mënyrë a në një tjetër duke iu gjetur hapësirë në bisedat e përditshme, fjalë të tilla ndikojnë në mospërdorimin dhe si rrjedhim më tej asimilimin e fjalëve apo shprehjeve korresponduese në gjuhën shqipe.

“*New entry*”- shprehje e huaj angleze, shumë e përdorshme, e cila ka kuptimin për diçka që është e re<sup>314</sup>. Kuptimi i dytë i kësaj shprehjeje është: prania e një anëtarit të ri në grupin e ngushtë shoqëror.

“*Çdo gjë është OK*”- fjala *OK* është fjalë e huaj etimologjia e së cilës nuk është përcaktuar ende. Të shumta janë sugjerimet se ky akronim rrjedh nga gjuha angleze, frënge, gjermane, ruse, latine dhe nga greqishtja. Dy gërmat janë dy inicialet e para të fjalëve *oll korrekt* ose *oll korrekt*<sup>315</sup> (nga anglishtja), *O qu'oui*<sup>316</sup>, *ohne Korrektur*<sup>317</sup>, *Ochen Khorosho* (Очень Хорошо)<sup>318</sup>, *Omnis Korrekta*<sup>319</sup>, *ola kala* (Όλα Καλά)<sup>320</sup>, që

<sup>312</sup> Hysa, R., *Fjalor anglisht-shqip*, Tiranë, 1998, f. 672.

<sup>313</sup> Shih po aty, f 130, 509.

<sup>314</sup> Shih po aty, f 207, 466.

<sup>315</sup> *List of proposed etymologies of OK*. Wikipedia, the free encyclopedia. [http://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_proposed\\_etymologies\\_of\\_OK](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_proposed_etymologies_of_OK)

<sup>316</sup> Wikipedia, the free encyclopedia. <http://en.wikipedia.org/wiki/Okay>

<sup>317</sup> *How 'OK' took over the world*, London, 2011.

<sup>318</sup> Harper, D., *Online etymology dictionary*, 2001-2014.  
<http://www.etymonline.com/index.php?term=ok>

<sup>319</sup> Oxford., *Language matters*, London, 2014, f. 321.

<sup>320</sup> Wikipedia, the free encyclopedia. <http://en.wikipedia.org/wiki/Okay>

do të thotë *gjithçka në rregull*. Fjala OK shpreh aprovim të një veprimi apo bie dakort në opinionin e bashkëbiseduesit.

“*Fejsbuku*”- shprehja *fejsbuk* është fjalë e huaj, vjen nga gjuha angleze dhe i referohet rrjetit social në internet: Facebook. Fjala *fejsbuk* përveç kuptimit të drejtpërdrejt, në disa raste shpreh figurshmëri, duke nënkuptuar një djalë ose vajzë që ka gjetur të dashurën/rin në këtë rrjet social.

“*Ma hoqe passwordin*”- fjala *password* vjen nga gjuha angleze që do të thotë “*fjalëkalim*”<sup>321</sup>. Kjo shprehje përdoret në mënyrë figurative dhe nënkupton më lërë rehat se më çmende.

Ndonëse dukuria e huazimit të fjalëve dhe shprehjeve nga gjuhë të huaja është tepër e përhapur në gjuhën shqipe, transformimet dhe shkëmbimet leksikore midis gjuhëve të ndryshme nuk duhen konsideruar si aspekt negativ, nëse ato janë të pangulitura në gjuhë dhe arsyet e përdorimit të tyre janë thjesht subjektive, si për të rënë të sy, për t’u dukur modern etj. Gjuha shqipe është në një proces të vazhdueshëm e të pandërprerë pasurimi, jo vetëm nga marrëdhëniet e ngushta me dialektet, nëndialektet, e deri tek idiolektet por një pjesë të kontributit për pasurimin e saj luajnë edhe *huazimet*. Ato përcjellin kuptimet dhe termat e konceptet e realiteteve të reja që çdo ditë e më shumë pasurojnë jetën tonë.

## PËRFUNDIME

Qëllimi i përdorimit të kësaj analize është zbulimi i strukturave leksikore ‘për të shpjeguar një shoqëri’. Në bisedat e lira studentore, pavarësisht tematikës së bisedës, konteksti gjuhësor karakterizohet nga thyerje të shumta të normës letrare, si rrjedhojë vihet re kujdesi shumë i pakët, ndonjëherë pasivitet edhe shpërfillje e gjuhës standarde dhe shkelje të rënda të saj, sidomos në formën e folur të përdorimit.

Për sa i takon qëllimeve të komunikimit, këta jo vetëm janë bërë të shumëllojshëm në larminë e regjistrave, por synojnë gjithmonë e më tepër cilësinë, saktësinë, pasurinë dhe efektshmërinë e shprehjes<sup>322</sup>.

Në variantin e folur, jashtë auditorit, të gjuhës standarde në institucionin universitar të Vlorës, është e konsiderueshme prania a varianteve dialektore, e cila ndikohet nga faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, si e folmja e Vlorës, Fierit, Beratit, Tepelenës, Kukësit etj. Përdorimi i gabueshëm i gjuhës standarde reflektohet në nyjëtimin e tingujve, rrokjeve, e fjalëve në shpërpjesëtim me kriteret drejtshqiptimore të njësisive gjuhësore<sup>323</sup>.

---

<sup>321</sup> AudioEnglish.org <http://www.audioenglish.org/dictionary/password.htm>

<sup>322</sup> Po aty, shih f. 10.

<sup>323</sup> Mujaj, H., *Zbatimi i gjuhës standard në institucionet shtetërore*, Tiranë, 2011, f. 366.

Është e natyrshme që thyerjet e normës shqiptimore, veçanërisht shmangiet për arsye të bazës dialektore, sidomos në shqiptim, të mos kuptohen nga folësit<sup>324</sup>.

Shmangie e shkelje vërehen edhe në *rrafshin e fonetikës*: intonacioni, ngjyresat lokale të subjekteve folës, ngjyrosja e zanoreve, reduktimi i togjeve pastheksore, dallimi jo i mjaftueshëm i bashkëtingëlloreve, shqiptime të gabuara të disa fonemave, të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, përdorim i gabuar i theksit, shkurtimi ose zgjatja e disa zanoreve.

Këtu është rasti për të parashtruar disa vërejtje për ligjërimin e folur të studentëve:

I. Folësit dhe folëset shqiptojnë fjalët përgjithësisht sipas të folmes familjare. Pra, mbizotëron shqiptimi me *ë* i fjalëve si: *dëndur, gjëndje, qëndër, zëmërim etj.*, të cilat duhet të shkruhen dhe shqiptohen me *e*, si: *dendur, qendër, zemërim*.

II. Luhatje të theksuara ka në shqiptimin e zanores *ë* në fjalët: *drejtësi, frymëzim, qetësi, Shqipëri etj.*, disa studentë e shqiptojnë deri diku, disa nuk e shqiptojnë fare zanoren *ë* si: *drejtsi, frymzim, qetsi, Shqipri*.

III. Luhatje vërehen edhe në shqiptimin e bashkëtingëllores *rr*<sup>325</sup>: fjalët që shkruhen me *rr* herë shqiptohen drejt e herë me *r* të thjeshtë, p.sh. në vend të shqiptimit me *rr* në fjalët *rresht, rradhë, burrë* shpeshherë dëgjohen shqiptime të tilla si *radhë, resht, apo burë apo buri*.

IV. Një gabim i ngjashëm vërehet edhe në shqiptimin e fonemës /h/. Shumica e studentëve përdorim variante pa /h/ për fjalët *letë, ftotë, nxetë etj.*

Te shumica e studentëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore të familjes a të rrethit shoqëror në ligjërimin jashtë auditorit, por shumë pak prej tyre bëjnë përpjekje serioze për të njohur dhe përdorur rregullat e shqiptimit letrar<sup>326</sup>. Disa prej tyre korrigjojnë gabimet dukshme dhe trajtat joletrare në komunikimin në auditor. Duket sikur ata kanë krijuar bindjen se shqiptimi letrar është ashtu siç flasin ata, por prapëseprapë nuk janë në nivelet e duhura gjuhësore dhe ndihen luhatje të shumta të normës letrare.

Sikurse shprehet studiues Sh. Islamaj (2003:316) shmangiet në rrafshin e leksikut meritojnë vëmendje të veçantë. Zhvillimi i vullshëm i leksikut të rinisë studentore shqiptare jo gjithmonë është tregues i pasurimit të gjuhës. Në gjuhën shqipe po vërshojnë vullshëm tek përdoruesi prurje të “pafiltruara”, sidomos nga gjuhët e huaja, përdorimi i të cilave e tejkalon fushën e ligjërimin studentor, duke u shtrirë edhe në shtresa të tjera sociale apo media, etj., të cilat deri diku e shfytyrojnë shqipen në shkallë shqetësuese<sup>327</sup>.

<sup>324</sup> Shkurtaç, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 102.

<sup>325</sup> Lafe, E., *Gjuha e medias sot—probleme dhe detyra*, Tiranë, 2000, f. 14.

<sup>326</sup> Shih, po aty, f. 15.

<sup>327</sup> Çeliku, S., *Shmangie në fushë të gramatikës e drejtëshkrimit në...*, Tiranë, 2003, f. 178.

Prof. A. Marashi, thekson se shqipja po komunikon përherë e më dendur me gjuhët e tjera dhe me sisteme të tjera të ligjërimit, por asaj i duhet ta bëjë këtë brenda natyrës së vet.<sup>328</sup>

Sipas Profesor Shkurtaj (2003:77), dyndja e pashfrenueshme e fjalëve të huaja të panevojshme në gjuhën shqipe, sidomos nga anglishtja dhe italishtja, shtimi i termave të huaj në vend të temave shqip që përdreshin normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohen është “dallga” më e re e huazimeve në një gjuhë që tashmë ka mjaft turqizma në leksikun e saj.

Gjithashtu, përdoruesit e shqipes, sidomos brezi i ri, ndikon në leksikun e gjuhës shqipe duke shtuar në lëmin e saj një numër të konsiderueshëm fjalë e shprehje nga çdo aspekt të jetës e sidomos nga teknologjia. Në vitet e fundit, si rezultat, i zhvillimit të vullshëm teknologjik është rritur shumë përdorimi i termave të fushës së elektronikës në ligjërimin e folur, bisedor, por edhe në ligjërimin e shkruar.

Studiues Ardian Vehbiu shprehet se shqipes i mungojnë mekanizmat e duhur gjuhësorë për të komunikuar natyrshëm me këtë zhargon ose për të administruar trysinë leksikore të anglicizmave:

*“Na mungon teknologjia gjuhësore për të përballuar anglishten teknologjike. Kur dëgjon të rinjtë të thonë bëje save, bëje reboot, bëje doenload, bëje setup, bëje delete, gjuhëtarit nuk mund veç t’i kujtohen togje të tipit bëj derman, bëhu mukajet; në të dy rastet, sistemi reagon ndaj kësaj ofensive trulllosëse nëpërmjet u kreolizimit, meqë anglicizmat, si orientalizmat dikur, nuk integrohen dot vetvetiu dhe natyrshëm në sistemin morfologjik të shqipes”<sup>329</sup>.*

Pra, zhvillimi teknologjik, ndikimi i mediave të ndryshme elektronike, nevoja për koncepte të reja, dëshira për t’u dukur ndryshe nga të tjerët, etj janë disa nga arsyet e huzimeve leksikore në shqip. Gjithashtu, sipas studiues Lloshi, 30% apo më shumë e popullsisë shqiptare kanë njohuri të gjuhës angleze, italiane dhe greke, si gjuhë të dytë. Huazimi i fjalëve të tilla, sidomos i anglicizmave vijnë në shqipen në kuadrin e një *dygjuhësie të çalë*, d.m.th., nëpërmjet shqiptarëve që nuk e dinë mirë anglishten dhe nuk kanë as ndershmërinë dhe as përgjegjësinë më të vogël që para se të përdorin fjalët në anglisht, t’i shohin sesi përkthehen në fjalorët anglisht-shqip<sup>330</sup>.

Evidencat e huazimeve sistematike në gjuhën shqipe janë të dukshme, por mendohet se është ende herët për të nxjerrë përfundime për ndikimin pozitiv apo negativ të tyre, duke qënë se ato ende janë në periudhën fillestare të përdorimit të tyre dhe nuk janë të ngulitura në gjuhë<sup>331</sup>.

---

<sup>328</sup> Marashi, A., *Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve*, Tiranë, 2011, f. 10.

<sup>329</sup> Vehbiu, A., *Leksiki i shqipes së sotme - Sfida të pasurimit*, Tiranë, 2011, f. 444.

<sup>330</sup> Shkurtaj, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 79.

<sup>331</sup> Curzan, A., *The end of modern English?* Washington, 2008, f. 299-301

Problemet që dalin për normën leksikore në ligjërimin e folur studentor mund të përmbliken në këto pika:

-*prania e madhe e fjalëve të huaja dhe prirja e tyre që ato të vazhdojnë të përdoren me intesitet*, si këto: *departament, konsultim, mid-term, kolegium, ciao, love you, okay, etj.*

- *përdorimi i dy a tri emërtimeve për të njëjtin nocion a dukuri*. Sidomos në fushën e terminologjisë (në fushën kompjuterike, të biznesit, financës, juridikut, etj.), mbizotëron përdorimi i dy termave të dy gjuhëve, shqip e gjuhë e huaj, si *download* dhe *shkarkoj*, *software* dhe *program*, *mediator* dhe *ndërmjetës*, *konvertim* dhe *kthim*, etj. Depërtimi i fjalëve të huaja, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar, sidomos nga anglishtja dhe italishtja, shkel normën e shqipes standarde dhe gjen përdorim edhe tek “shtresat e ngritura”. Me të drejtë gjuhëtari J. Thomai e ka quajtur këtë dukuri “snobizëm gjuhësor”<sup>332</sup>.

-shkelje e vrazhdë e normës së theksimit i fjalëve sipas theksit të natyrës së gjuhëve të huaja. Të tilla janë: *kompjuter, kámara*,

-*përdorim i madh i leksikut nga bisedimi i përditshëm*, shpesh mjaft banal e i papërzgjedhur. Ndoshta për efekt humori e ngjyrimet stilistike apo për të qënë pjesë e grupit, studentët përdorin një të folme të veçantë, një zhargon, i mbushur me fjalë të huaja, fjalë nëndialektore të ndryshuara dhe një gjuhë rrugë, e cila me keqardhje mund të shprehemi se ka filluar të marrë status publik.

Përdorimi i figurave letrare, fjalëve të huaja, shkurtimeve në ligjërim ndodh kur folësit përzgjedhin të përdorin një gjuhë me ngjyrimet kuptimore të larmishme në vënd të përdorimit të kuptimit të drejtpërdrejt. Ky është një veprim i ndërsjelltë midis bashkëbiseduesve<sup>333</sup>. Qëllimi i përdorimit është krijimi i ngjyrimet stilistikor në bisedë, për të qënë pjesë e saj dhe për të realizuar komunikim më të thjeshtë, më të drejtpërdrejtë<sup>334</sup>.

---

<sup>332</sup> Thomai, J., *Lëvizje në leksikon e gjuhës shqipe në kushtet e reja historiko-sociale*, Shkup, nr. 6, 2000, f. 53.

<sup>333</sup> Drew, P., & Holt, E. *Figures of speech: “Figurative expressions and the management of topic, Translation in conversation*, Cambridge, 1998, f. 496.

<sup>334</sup> Shih po aty, f. 498.

## KAPITULLI I SHTATË

### KUNDRIME GRAMATIKORE TE LIGJËRIMI AKADEMIK STUDENTOR NË UNIVERSITETIN E VLORËS

---

**a. Kundrime të përgjithshme**

**7.a.1 Dukuri sintaksore**

**7.a.2 Tipare gjuhësore të ligjërimit akademik studentor**

**b. Tipare gjuhësore të ligjërimit bisedor**

**7.b.2 Gabimet drejtshqiptimore**

**c. Kundrime morfologjike**

**7.c.1 Elemente drejtshqiptimore**

**7.c.2. Tipare drejtshqiptimore**

**d. Proceset fjalëformuese në fjalët shqipe dhe fjalët e huazuara të përdorura në ligjërimit bisedor dhe atë të shkujdesur**

**7.d.1 Shmangiet drejtshqiptimore**

**7.d.2 Elemente drejtshkrimore**

**7.d.3 Tipare drejtshkrimore**

**7.d.4 Gabime drejtshkrimore**

**e. Çështje të normës sintaksore**

**f. Kundrime gramatikore të studentëve sipas ndryshorit**

*mjedis administrativ*

**7. f.1 Shkelje të normës gramatikore**

**g. Përfundime**

---

## **a. Kundrime të përgjithshme**

### **7.a.1 Tipare sintaksore**

Përpos, risive leksikore, në sistemin e gjuhës së folur mund të vërehen edhe **shumë dukuri sintaksore**: vërehen ndryshime në ndërtimin e fjalive, në lidhjet mes fjalive të thjeshta e të përbëra, në lidhjet mes fjalive pyetëse dhe çuditëse; vërehen tipa të rinj të rendit të fjalëve; vërehen ndryshime në raportet mes ligjërimin të drejtpërdrejtë dhe ligjërimin të ndërmjetuar; ndryshojnë kohët gramatikore të foljeve (brenda një thënieje); bëhen copëzime të dialogëve, ndarje të tekstit, vërehen lojë fjalësh që prishin struktura sintaksore normative dhe shumë dukuri të tjera.

Tiparet ligjërimore më të spikatura që **konkretizojnë bisedat** në mjedisin universitar vlonjat janë:

1. Ndërtimet sintaksore janë më pak të ndërlikuara, thëniet janë të thjeshta dhe më të shkurtra.

2. Sintaksa copëtohet, theksohet pjesa më e rëndësishme emocionalisht, gjymtyrëzimi aktual dhe theksi logjik shumë shpesh shoqërohen me mjete paralinguistike ose me ndryshime të theksuara të intonacionit (por kumti ngaherë del i plotë)<sup>335</sup>.

3. Përdoren shprehje përforcuese, të cilat shoqërohen nga ngarkesë emocionale e lartë.

4. Shprehjet nuk janë domosdoshmërisht tepër të sakta nga ana kuptimore.

5. Përdoren dendur sintagma me përcaktor, të barasvlershme me një fjali emërore (nominative):

(5. a) Emër + mbiemër: *Katunare lukzose / prestigjoze, gocë e lexume, dashnor i rregullt, new entry!, kuklla e vogël, parking i vjetër, mendje e ligë, palaço njeri etj*

(5. b) Emër + emër: *çun tavoline, zyra e gjendjes civile, zog nate, Hallat nga Amerika, pulë fushe, lepur dushku etj.*

6. Përdoren fjali emërore (nominative) me një gjymtyrë (zakonisht ndërtohen fjali me intonacion të theksuar): *hajdar, pallosh, popozitet, trendy, out, gjigand, rrangalle, e paparë, lekist/e, ballkon, bordellacion, pompa, miza, legen etj.*

7. Përdoren dendur fjali të ndërtuara me sintagma foljore gjysmë të ngurtësuar si dhe me shprehje frazeologjike: *ta çaj gojën, e vdes fare, më ka ik petlla, është bishë fare, i fus një tegel, është fibër, duam aheng, u fiksova fare, e ka kap ai/ajo, për ty bëj pesë vjet burg, ia fut për kënaqësi, i ka vdekur nëna atij muhabeti, do të shkrij*

<sup>335</sup>Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005, f. 326.

*komplet, e ka muhabetin me të futur, është grup fare, i ka fut ujë komerdarja, t'i ndërroj vajin, të shkund oxhakun etj.*

8. Sintagma të ngjeshura, të reduktuara në një gjymtyrë foljore: *tërheq, punon, halet, varja etj.*

### **7.a.2 Tipare gjuhësore të ligjërimit akademik studentor**

Gjuha e mësimdhënies dhe e të nxënit është tepër e rëndësishme në klasë, sepse ajo ndikon cilësinë e arsimit të studentëve dhe rezultatet e tyre. Pushteti që kanë pedagogët për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve në mësim apo për vlerësuar pozitivisht ose negativisht studentët gjatë orës së mësimit, është një prej metodave më të mira për t'i motivuar ata në procesin e të mësuarit. Nëse pedagogët dhe studentët duan të jenë të suksesshëm në komunikim mes tyre, atëherë të dyja palët duhet t'i përshtaten komunikimit të ndërsjellë dhe situatave të ndryshme që krijohen në leksione e seminare.

**Ligjërimit akademik** në ambiente të brendshme të universiteteve dhe veçanërisht në auditorë përgjithësisht synon të jetë në një nivel gjuhësor që u përkon standardeve të normës gjuhësore. Duke i dhënë rëndësi kësaj të fundit, norma gjuhësore në auditorë mundëson një ligjërimit akademik që duhet të respektojë nivelet gramatikore në ndërtimet e shprehjeve apo të strukturës së fjalive në tërësi dhe nuk mund të tolerojë shkelje. Nga vëzhgimet e bëra, konkludojmë se në Universitetin e Vlorës përgjithësisht zotërohet shqipja standarde, edhe pse sintaksa shfaq shpesh ngarkesa, tejzgjatje, përdorim të panevojshëm lidhëzash, përemra lidhorë (*sidomos që*) jo rrallë edhe paqartësi. Kjo bie në sy po të shohësh punët (provimet) me shkrim të studentëve të degëve të ndryshme.

Ligjërimit akademik i studentëve karakterizohet nga:

-- përdorimi i një numri të madh parafjalësh a lokucionesh parafjalore emërore, si: *përkrah, në krahasim me, nëpërmjet, në vend të, për shkak të, lidhur me etj.*

-- zhvillimi i strukturës së frazës nëpërmjet përdorimit të një numri të madh lidhëzash e lokucionesh lidhëzore nënrenditëse: *për arsye të, për arsye se, për shkak të, për shkak se, me qëllim që, me qëllim të etj.*

Këto elemente e ndihmojnë për të zhdërvjelltësuar strukturën sintaksore të fjalisë dhe frazës, duke krijuar mundësi më të mëdha përzgjedhjeje për qëllime funksionale e stilistike<sup>336</sup>.

Nëse do të bënim një krahasim midis gjuhës së përdorur prej pedagogëve dhe studentëve në auditor do të vërejmë ndryshimet në rrafshin gramatikor dhe semantik.

---

<sup>336</sup> Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë, 2003, f. 113.

Gjatë një ore mësimi, vërehet dukshëm prirja e pedagogëve për të folur me shprehjet e duhura dhe respektimi në mënyrën sa më të mirë të mundshme të normës gramatikore.

Për shembull: “...*ju ishit në dijeni për përgatitjen dhe analizën e temës...*”. Në këtë strukturë fjali të përdorur shpesh nga pedagogët është përdorur saktë koha e foljes (koha e pakryer e foljes jam) dhe qëllimi semantik është i qartë. Nga ndërtimi sintaksor do të kishim mëdyshje nëse vendosja e gjymtyrëve do të ishte në këtë mënyrë. Gjymtyrët kryesore në këtë shprehje, ”ju” si kryefjalë dhe kallëzuesi “ishit”, përcaktojnë gjymtyrët e dyta, kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, “për përgatitjen dhe analizën” dhe lidhen nga ana kuptimore dhe strukturore. Sipas *gjymtyrëzimit aktual* këtu tema është sintagma foljore (“...*ju ishit në dijeni*), kurse kundrinorët dalin si remë për përgatitjen dhe analizën e temës...”.

Kur po kjo fjali përdoret sikurse vijon: “...*për përgatitjen dhe analizën e temës, ju ishit në dijeni...*”, tendenca për të tërhequr vëmendje në auditor se pedagogu tashmë e ka përfunduar pjesën e vet të shpjegimit dhe pritshmëria e një përgatitjeje të auditorit duhet të ndodhë në atë moment të ligjëritimit, kjo bëhet vetëm në kombinim e këtyre gjymtyrëve të dyta të vendosura në krye të fjalisë dhe gjymtyrëve kryesore në fund të saj. Elementi semantik është realizuar i plotë, struktura gramatikore transmeton plotësisht mesazhin e synuar. Por këtu ndryshon informacioni, sepse tashmë tema është...*për përgatitjen dhe analizën e temës*, kurse rema *ju ishit në dijeni...*”

Ndërsa në ligjërimin studentor të përdorur në auditorë, mund të përmendim konstrukte të gatshme që lidhen edhe me regjistrin e komunikimit në ligjërimin shkencor. Ndërtimet “...*ju lutem profesor, doja të pyesja...*”, “...*a mundeni të më sqaronit ...*” etj., janë disa nga shprehjet që studentët përdorin shpesh për të filluar ligjërimin e tyre, por qëllimi i këtij ligjërimi nuk është i përfunduar. Përdorimi i shumësit në vetën e dytë përdoret me një funksion të caktuar kortezie: të shprehurit në mënyrë sa më të mirësjellshme. Të shumtë janë shembujt e gërshetimit të ligjëritimit akademik dhe me fjalë parazitare si: *pak, një çik, domëthënë, e thashë unë...* etj.

Në shembujt e tjerë të komunikimit *student - student*, është e dukshme përdorimi i gjerë i sintagmave *fjali*, të paplota, të shkurtuara, të rrudhura, si një tjetër tipar i ligjëritimit gjuhësor në auditorët e universitetit. P.sh. “*Sa të vështira po na i bën ..!*”, fjalia e plotë do të ishte: “*Sa të vështira po na i bën mësimet profesori / profesorja!*”.

Fjalitë shumë shpesh ndërtohen me kohët e foljeve në të shkuarën. Bie shumë në sy përdorimi i formave normative të foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*. Në shembullin: “*kam dashur ta kuptoja, por nuk e kam pasur të qartë që kur u shpjegua...*” është përdorur folja *kam* si folje ndihmëse dhe forma normative e pashtjelluar e kësaj foljeje.

Gjatë hulumtimit të shembujve kur studenti i drejtohet pedagogut, në orën e mësimit, hapësira e përdorimit të normës gjuhësore lejon realizimin e saj, por si u shprehëm më lart shpesh kemi thyerje të saj, që lidhet me faktorë të ndryshëm

qofshin edhe emocionalë. Duket sikur ligjërimi i studentëve është më afër ati të pedagogëve, por shpesh është edhe i kufizuar gati dhe i ngrirë.

Nëse do të kërkonim të njëjtin nivel standardi midis komunikimeve gjuhësore ndërmjet studentëve në një orë mësimi, kjo deri diku është arritur, por nuk është më e mira e mundshme.

Shumë shpesh vërehet përpjekja për t'u shprehur saktë, sidomos kur bëhet një pyetje nga studenti kundrejt pedagogut, si "*Do të donim të ishim më të qartë për këtë çështje. A mund të na e sqaronit ...?*". Përdorimi i kohës së ardhme të së shkuarës për të tërhequr vëmendjen e dikujt që ka një status më të lartë se vetë studenti në rastin tonë (pedagogu), ka për qëllim gjithashtu të përdoret mirësjellja në një raport të tillë.

Është e qartë se në shembullin e mësipërm flet një student si përfaqësues i studentëve të tjerë. Për këtë arsye, këtij studenti i lejohej të flasë me "*ne*", edhe pse në të vërtetë në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me një "*ne*", por me një "*unë*" që flet me "*ne*". Duket si e amplifikuar duke i shtuar "*unë*"-it një tërësi të personave të tjerë, për të dalluar në këtë mënyrë një formë dhe një tjetër tipar të sjelljes gjuhësore. Ndërkohë, përdorimi i përemrit "*ju*", shfaqet si element që shpalos përdorimin e mirësjelljes.

Po në momentet e vështira, sikurse janë provimet, pyetjet që i bëhen pedagogut: "*Çfarë do të kemi në provim?*" janë të thjeshta nga pikëpamja gramatikore dhe të sakta në përdorim, sepse ato lindin nga shqetësimi dhe stresi për provimet dhe semantikisht nuk duan ambiguitet. Pyetje të tilla nuk kërkojnë një strukturë sintaksore të ngatërruar apo të rënduar me pjesë të nënrenditura. Pra nga pyetja e përdorur kërkohet qartas një përgjigje për atë që e shqetëson më shumë studentin: për provimin.

Kuptohet që krejt natyrshëm në mjediset universitare do të ndeshesh orë e çast me fjali pyetëse, që kërkojnë dhe përgjigje të zakonshme, por edhe për informacionin shkencor. Në Univeristetin e Vlorës në një fjali pyetëse ndeshet shumë shpesh përemri pyetës "*ç*" i shoqëruar me fjalë të tjera ose përmëri "*çfarë*" në funksionin e një fjalie të vëçantë.

Përderisa ka tendenca ambiguteti në përdorime të tilla, në ambientet e brendshme (auditorë) por edhe në komunikimet jashtë orës së mësimi në të dyja kategoritë e komunikimit gjuhësorë: studentë –pedagogë apo studentë –studentë, kjo e bën **ambiguitetin** një tjetër tipar të ligjërit studentor. Në shembullin, "...*ka shans ta marr këtë provim?*", "*sa e pafat isha sot..!*" duket qartë se "*shansi*" apo mbiemri "*e pafat*", ka dy kuptime semantike.

Janë të shumta rastet e ligjëritit gojor studentor, të cilat paraqesin çrregullsi në renditje të gjymtyrëve në nivel sintaksor; përdorim në mënyrë të gabuar të ndajfoljeve si rrethanorë (nuk përdoren në rasën e duhur, por vetëm në atë emërore; përdoren trajta të shkurtra me tepri; fjalët nuk përdoren në vetën apo numrin e duhur, duke

sjellë shkelje në përshtatjen sintaksore të gjymtyrëve me njëra tjetrën. Të tilla janë: “...ku mendjen e kam tani, po ma thuaj një çik çka tha?” etj.

Fjala “*një çik*” është dukshëm shkelje e normës gjuhësore, sepse kuptimi i saj për të pasur informacionin në një sasi shumë apo pak nga studenti por tendenca që të arrijë qëllimin për të marrë informacionin pa e bezdisur shumë shokun e banalizon kërkesën duke përdorur figurën letrare të litotës dhe që në fakt shtrembëron kuptimin semantik të fjalës “*pak*” që përdoret për të treguar masën e diçkaje dhe që nuk ka të bëjë me kompetencën gjuhësore apo njohuritë shkencore që studenti ka në fushën e studimit. Ndërrimi i vendit të kallëzuesit dhe vendosja e kundrinorit të drejtë përpara, përcjell më së miri mesazhin subjektiv të folësit: padurimin dhe nervozizmin që të mbarojë ora e mësimi. Shkelje të normës, zakonisht, janë rezultat i mungesës së vëmendjes në zgjedhjen e formave dhe strukturave gramatikore.

Ndonëse ligjërimit student - pedagog duhet të jetë më afër gjuhës letrare dhe në të të mbizotërojnë fjalët kyçe të mirësjelljes, vihet re një nënvlerësim i këtyre fjalëve, p.sh. “*Fjalinë e fundit nuk e kuptova, mund ta përsërisni ju lutem*” - zëvendësohet me - “*Edhe një herë*”.

Pjesa më e madhe e ligjërimit akademik studentor realizohet në mjediset universitare. Kalimi nga një mjedis fizik, si auditori, në një mjedis fizik tjetër, në ambientet e jashtme të universitetit, karakterizohet nga ndryshime të dukshëm në gramatikën e diskursit.

Në të folurën e sotme, madje jo rrallë edhe në shkrime, gjejmë fjalë e shprehje që nuk kanë të bëjnë me leksikonin e gjuhës shqipe dhe nuk i përkasin standardit të gjuhës, por që janë nga të folmet vendore. Siç vërejmë, tiparet e sjelljes gjuhësore janë të lidhura me zotërimin e njohurive të të gjitha disiplinave gjuhësore (të njohurive fonetike, morfologjike, sintaksore etj.), për të arritur në një mënjanim të formave dialektore ose bisedore. Pra për të arritur një qartësi dhe standard të normës gjuhësore në auditorët e universitetit do të veçonim respektimin formave dhe kategorive gramatikore, qëndrimin të përdoruesve të këtyre normave në më të mirën e mundshme<sup>337</sup>.

Si konkluzion, mund të shprehemi se ligjërimit akademik është ai lloji ligjërimit i cili kërkohet të përdoret në ambientet universitare, është formal dhe serioz në ton, duhet të jetë sa më objektiv dhe ka si për qëllim të informojë, të interpretojë dhe të shpjegojë koncepte, ngjarje apo procese shkencore etj. Ka disa studentë të cilët janë shumë të aftë në përdorimin e ligjërimit akademik. Gjuha e përdorur prej këtyre studentëve i përshtatet komunikimit që realizohet me pedagogët dhe me studentë të tjerë në ambientet akademike. Ndonëse nuk mungojnë format e përziera të normës gjuhësore me tipare ligjërimore bisedore.

---

<sup>337</sup> Qerimi, R., *Disa veçori të së folurës që nuk janë të pranishme në gjuhën standarde*, Tiranë, 2009, f. 1.

Për të arritur seriozitetin në një orë mësimi kërkohet impenjim jo vetëm akademik, por dhe përqendrim i plotë për të arritur qëllimin e kërkuar duke folur sipas standardit gjuhësor.

### **b. Tipare gjuhësore të ligjërimit bisedor studentor**

Bashkëbisedimet e zhvilluara prej studentëve me njëri-tjetrin gjatë seminareve apo me pedagogët, kanë karakter formal. Por duke qenë se nivelet kulturore të bashkëbiseduesve janë të ndryshme, pasi ata kanë të njëjtën kulturë e edukatë dhe u përkasin zonave të ndryshme gjeografike, komunikimi verbal paraqet deri në një farë mase ndryshime në formësimin gramatikor, fonetik e leksikor. Në këto kushte, që biseda të bëhet më e kuptueshme dhe efektive për të dyja palët bashkëbiseduese, zbutet deri në një farë mase zbatimi i normës letrare duke përdorur *elemente të ligjërimit bisedor*. Numri i studentëve të përfshirë në këtë fazë studimi është 375 studentë.

Disa prej tipareve gramatikore të ligjërimit studentor të përdorura në auditorë janë:

- a) Përdorimi i pyetjeve pa folje (dukuri që lidhet me elemente të tekstit dialogues, sepse vendoset një bashkëbisedim ose marrëdhënie pedagog / student. Gjithashtu këtu zëvendësohen shumë gjymtyrë fjalië nga mjetet paralinguistike si dhe kushtëzohen nga konteksti: “*Kush, unë?*” (punimi i ushtrimit në dërrasë); *Ti? Ajo? Për në vjeshtë? Prapë? (të vijë prapë për të dhënë provimin?)* etj.
- b) Përdorimi i përgjigjeve pa folje (arsyet janë si më sipër, tek pika a): “*Edhe unë*”, “*As unë*”, “*Jo.*”, “*Po.*”, “*Ashtu.*”, “*Dakord*” etj.
- c) Prishje rendit të fjalëve, e kushtëzuar shpesh nga theksi logjik, i cili lëviz në fjali dhe shumë shpesh del në fillim të thënieve “*për x problem më pyete?*”;
- d) Përdorimi i fjalive me vetë të përcaktuar, d.m.th pa kryefjalë, sepse bashkëbisedimi nënkupton vetën e parë dhe të dytë (pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në bisedë përcakton në këto dy veta të foljes): “*Ku shkon?*”, “*Si dole?*”, “*E more provimin?*”, “*Do ikim?*” etj.
- e) Nuk mungojnë edhe përdorimet e frazave dhe fjalive të gjata: “*Dua të them, domethënë, disa pjesë të saj janë, tepër të çuditshme, apo jo?*”;
- f) Përdorimi i disa pyetjeve njëra pas tjetrës nga i njëti folës, të cilat karakterizohen nga rritja e intonacionit: “*Si the? Çfarë? Katër?*”; “*Si the? Si the? Bëtë sherr?*” etj.

g) Nuk mungojnë elementet pasthirrmore sidomos përsëritjet, në shqip por shpesh në gjuhë të huaja, anglisht, italisht, greqisht: “*Mirëdita! Çkemi! Si keni kaluar?*”, *Tung*; “*Ciao*”, “*Hi*”, *Jasu / jadas*” etj.

h) Përdorimi i fjalëve bisedore që shprehin afrimet, miqësi marrëdhënie shoqërore të mira etj., si përgjigje ndaj pyetjeve, p.sh.: “*Si jeni?*”:

*A: “Si ndihesh sot?”*

*B: Çka./ Jo keq./ Kam qënë edhe më keq./ Jo mirë./ Jo shumë mirë. etj”*

*C: Si po kalon?*

*D: Shumë mirë./ Fantastike!/ Mrekulli! etj”*

i) Përdorimi i varianteve joformale të përgjigjeve “*Po/Jo*”:

*A: “Jeni të lodhur?”*

*B: “Po/ Çka!/ Ja ashtu!”, etj.*

j) Mbizotërimi i fjalive të nënrenditura përcaktore (Ai / ajo që po ndalon te bankomati...), kushtore (*Nëse e bën atë veprim, do të mërzhitem shumë*), shkakore (nuk e mora se s’isha përgatitur...; Nuk i hodha shumë (lekë celularit), se nuk kisha lekë) etj.

### **7.b.2 Gabimet drejtshqiptimore**

Për sa i përket zbatimit të normës gjuhësore, problemet më të mëdha dalin në fushën e sintaksës. Më poshtë paraqiten disa prej ***tipareve gramatikore të ligjërit bisedor të studentëve jashtë auditorit*** gjatë bisedave me tematika të ndryshme,:

1. Lëkundje të trajtave morfologjike në kohën e foljeve, në rasat e emrave , në përshtatjen e sidomos në trajtat e shumësit të emrave; pjesët e ligjëratës dalin në pozicione të pazakonshme për to sipas normës, p.sh., “*Atë ditë isha pushim, [isha] në vend të [e kisha];*”

2. Fjalitë thjeshtohen, mbizotërojnë lidhjet bashkërenditëse, fjalitë e varura të shkallës së parë e deri të dytë. Sintagmat kanë pak gjymtyrë. Për shembull, emri nuk merr dy deri në tre përcaktorë si në gjuhën librore: *plasa mërzhie, u lodha shumë sot, plasa vapit këtu brenda, u çmenda duke studiuar, ta kam shpjeguar 100 herë, sa s’kupton dhe ti, mësimi është thënë dy herë etj. .*

3. Gjithashtu, shfaqen shumë shpesh ndërtime të paplota, eliptike, të papërfunduara, të cunguara: *qepe!, mbylle!* etj.

4. Mënjanohen cilësorët e rrethorët.

5. Kundrina nuk rrimmerret si kryefjalë në fjalinë pasuese të varur. Kundrina e drejtë edhe bie, p.sh., “*Po lexoja* (leksionet) etj.

6. Në shprehje mbizotëron afektiviteti, dhe shprehja synon të paraqesë një formë sintetike, jo të zbërthyer; si pasojë copëzohet thënia dhe leksikalizohen grupet e fjalëve.

7. Ndërtimi sintaksor është i segmentuar, për shembull: “*Ikë, ore, po ikë!*”

8. Mbizotërojnë ndërtime metonimike (jepet lënda për emrin e pedagogut): *Erdhi Semantika* (në vend të: *Erdhi pedagogu i Semantikës*), *Erdhi sintaksa*, *Erdhi italishtja* etj.

9. Intonacioni merr përparësi. Në strukturën *fjalë - tog fjalësh - fjali* luan rëndësi zhvendosja sintaksore. Fjalja paraqitet me renditje të ndryshme të gjymtyrëve, p.sh.: *Pas i kemi lënë shumë tema* (Shumë tema i kemi lënë pas.); *Ishte një verë super* (Vera ishte super).”

10. Zhvendosja shkakton rimarrjen me përemra ose ndajfolje: “*Ne thamë se na erdhi behari, “jo”, na u kthye dimri!*”

11. Zhvendosja e perspektivës logjike të shtjellimit të thënieve shoqërohet me aktualizues, me fjalë a fjali të ndërmjetme, të cilat bëhen edhe pikënisja e shmangies (pasi folësi i rikthehet logjikës së bisedës thotë: *ku e kisha fjalën?*)

Ndërtimi i fjalisë së thjeshtë tek të gjithë studentët e anketuar ruan renditjen e gjymtyrëve: kryefjalë + folje + gjymtyrë të tjerës, si kundrinor ose rrethanor (*Jeta është gjithçka e shtrenjtë për mua.*)

Zhvendosja e gjymtyrëve, nxjerrja në pah e një përbërësi të fjalisë gjatë të shkruarit e mbështetur në imagjinatë, duhet të ishte më e theksuar. Në fjalinë e thjeshtë dëftore zhvendoset rrethanori, shumë rrallë kundrinori me parafjalë (*Para nesh shfaqen ngjarje të mistershme të historisë. Me të gjithë sillem mirë.*)

Fjalitë e thjeshta janë kryesisht fjali dëftore, fjali pyetëse dhe fjalitë njëkryegjymtyrëshe, sidomos, fjalitë emërore.

Nuk duhet të anashkalojmë se jo rrallë mbizotëron fjalja e përbërë me shumë pjesë, sidomos në punët me shkrim: *Të luftosh për të mirën dhe dije se do të ndjekë e mira gjithë jetën tënde.*

12. Përdorimi i fjalive me një fjalë: *ika* (po iki); *e mora* (e mora librin); *flasim* (do të flasim prapë për këtë gjë ose do shihemi sërish);

13. Përdorimi i fjalisë me dy kryefjalë, në krye del gjymtyra me rëndësi vlerësuese: “*Ina, ajo më tha ta marr!*”;

14. Mungesa e foljes në fjali, p.sh.: “*(Ne)+(kemi)+Tre provime në një ditë; I vështirë +(ishte)+ provimi.*”

15. Përdorimi i trajtave të shkurtra, p.sh.: *“S’di si do dal në provim; Na i kishte ngrënë disa pikë.”*

16. Përdorime të paplota të trajtave foljore (sidomos i pjesores së foljes) si: *të thyej në mes; për ty kam bërë pesë orë rrugë; e ke myt komplet; më ka ik zari; e ka kap ai tjetër.*

17. Kondesimi sintaksor dhe semantik: *“I shkreti!”* (domethënë: më vjen keq për atë njeri që i ka ndodhur diçka.);

18. Ndeshen dendur fjalitë pyetëse, urdhërore, dhe habitore me intonacion përkatës të theksuar: *“Ajo? Po ti tregoj të gjitha ato? E di ç’bëhet, e di! S’merrke vesh ti!”*

19. Përdorimi i emrave të përveçëm, i pjesëzave, pasthirmave për të tërhequr vëmendjen e tjetrit. *“Na! Ore! Shiko! Dëgjo ti!”*

20. Fjalët e ndërmjetme shpesh shndërrohen në përsëritje parazite karakteristike për folësin: *Që thua ti. Domethënë! Kupton ti! O t’u mbylltë. E ku di unë. Ja kështu, ja. Sigurisht.* Një pjesë e tyre vijnë për të siguruar kontaktin gjatë bisedës (funksioni fatik), për shembull: *“dëgjo, shiko ti, more vesh, ti moj, dale.”*

21. Përdorimi i togjeve frazeologjike: *“Se ha unë atë. Mos më bëj budalla ti mua. Gjete kujt t’ia thuash!”*

22. Përdorim i mjeteve tërthore: *“Jo ore! Mos more! Ashtu, ë! Na, more, na!”*

23. Përdorimi i tingujve paragjuhësor: *“C-c-c! Hë-hë-hë!”*

24. Përdorimi i shprehjeve etnolinguistike (formulat e përshëndetjeve, mirësjelljes, të fillimit dhe ndërprerjes së bisedës.)

25. Një drejtim tjetër që vihet re në sintaksën e shqipes të studentëve në ligjërimin letrar, është ndryshimi i tranzitivitetit të foljeve. Vihet re një prirje për përdorimin kalimtar të foljeve që zakonisht në shqipë janë jokalimtare dhe kërkojnë një kundrinë të zhdrejtë. Të shumta janë shembujt që ilustrojnë këtë pikë, si: *telefonoj Gencin në vend të i telefonoj Gencit; konsideroj presorin.*

26. Përemri vetor *ti* përdoret në trajtë të gabuar: *E dëgjova nga ty. Më erdhi nga ty.*

Ndodh që në sintaksën e fjalisë, për të shprehur marrëdhënie përcaktore dhe rrethore, të përdoren sintagma joparafjalore *emër ose folje + emër* në rasën rrjedhore të tipit: *fjalë burri, u lodh së foluri*, (e bëre muhabetin) *çorape leshi, u mek ose vdiq së qeshuri* etj. Krahas tyre përdoret edhe sintagmat *emër + emër* në *gjinore: djalë i fjalës* (që e mban fjalën e dhënë) dhe *emër + mbiemër: vajzë mirë, etj.*

**Shmangie të tjera janë:**

(1) Përdorimi i sintagmave foljore, mungesë e rrethanorit të vendit / shkakut / i kohës / qëllimit:

(a) mungesa e rrethanorit të vendit:

**Hë mo, s'qenke fut këtë orë ti?**- *Ku?* Mungon rrethanori i vendit. (*S'qenke fu kete ore ti*)- sintagmë foljore, brenda kësaj sintagmë foljore ka një përcaktor me përshtatje (*këtë orë*); **Si e bëre treshin?**- *Ku?* Në këtë rast mungon rrethanori i vendit (*tek provimi*). Sintagmë foljore: *Si e bëre treshin?*; **Ika unë të dielën vij.** -*Ku?* Mungon rrethanori i vendit. (*Ika unë*)-sintagmë foljore (*të dielën vij*)-sintagmë foljore. Pra, fjalia paraqet këtë strukturë të brendshme: SF + SF.

**Kam dhe 2 orë të enjten pastaj nisem.** - *Ku?* Mungon rrethanori i vendit në pjesën e dytë të fjalisë. (*kam dhe 2 orë të enjten*)-sintagmë foljore. (*2 orë të enjten*-përcaktor me bashkim)- sintagmë emërore (*pastaj nisem*)- sintagmë foljore. Në këtë shembull, struktura paraqitet: SF {folje + SE} + SF.

**Do mundohem të dal sa më mirë po s'e di.** - *Ku?* Mungon rrethanori i vendit në pjesën e parë të fjalisë kurse në pjesën e dytë (*po s'e di*) *Çfarë s'di?* mungon kundrinori i drejtë. Të dyja pjesët e fjalisë janë sintagma foljore sepse gjymtyra kryesore në to është një folje dhe jo një emër. Struktura e fjalisë është: SF + SF.

**Nesër do ngrysemi këtu.** - *Ku?* Mungon rrethanori i vendit. Kjo është një fjali e thjeshtë e shprehur me një sintagmë foljore.

**Po shkoj të marr atë fotokopjen.** - *Ku?* Mungon rrethanori i vendit. Fjali e përbërë nga një sintagmë foljore.

**Mora ndonje pikë?** *Ku?* Mungon rrethanori i vendit. Fjali e thjeshtë e përbërë nga një sintagmë foljore.

**Humbe ndonjë pikë doje të thoje.** *Ku?* mungon rrethanori i vendit. Fjali e përbërë nga dy sintagma foljore.

**Si e bëre ushtrimin e fundit.** *Ku?* mungon rrethanori i vendit. Është fjali e thjeshtë me një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*ushtrimin e fundit*- përcaktor me drejtim): SF + SE {përcaktor me bashkim}.

**Ke mësuar ndonjë gjë ti moj?** *Ku?* Mungon rrethanori i vendit; Fjalia është e shprehur me një sintagmë foljore.

**Filloj beteja.** *Ku?* Mungon rrethanori i vendit; *Pse?* Mungon rrethanori i shkakut; Fjalia ka një sintagmë foljore.

(b) Mungesa e rrethanorit të shkakut / qëllimit:

**Po mendoja të filloja ndonjë punë, po nuk ia dal dot.** - *Pse?* Mungon rrethanori i shkakut. Të dyja pjesët e fjalisë janë sintagma emërore, kjo është fjali e përbërë me bashkërenditje kundërshtore. Struktura e fjalisë paraqitet: SE + SE.

**U kënaqëm!** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut; Kur? Mungon rrethanori i kohës; Ku? Mungon rrethanori i vendit. Kemi të bëjmë me një fjali të thjeshtë me një sintagmë foljore.

**Kjo e marta ka qënë historikisht dite ters.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Kjo është një fjali e thjeshtë, që përbëhet nga një sintagmë emërore (*kjo e marta*-përcaktor me përshtatje), nga një sintagmë tjetër emërore (*dite tersi*-përcaktor me bashkim) sintagmë e cila është pjesë e sintagmës foljore (*ka qënë historikisht dite ters*). Struktura e fjalisë paraqitet kështu: SE {përcaktor me përshtatje}+ SF {folje + përcaktor me bashkim}.

**Të martën ne jemi për të marrë bukë me vete.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Është fjali e thjeshtë, me një kallëzues emëror i formuar nga folja këpuje jam dhe një grup emëror.

**Uh unë jam katastrofë!** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjali e thjeshtë, përmban një sintagmë foljore.

**Do ulem sot të bëj ndonjë gjë.** -Ku? Mungon rrethanori i shkakut. Fjali e përbërë nga dy sintagma foljore.

**Ti je e çmendur përfundimisht.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjali e përbërë nga një sintagmë foljore e shprehur me një kallëzues emëror i formuar nga folja këpuje jam.

**Duhet studim çdo ditë.** -Me ç'qëllim? Mungon rrethanori i qëllimit. Fjalja përbëhet nga një sintagmë foljore (*duhet studim*) dhe nga sintagma emërore (*çdo ditë*-përcaktor me bashkim). Struktura e fjalisë është: SF + SE {përcaktor me bashkim}.

**Shumë ters kjo ditë sot.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut, mungon gjithashtu edhe folja. Kjo fjali është e përbërë nga sintagma emërore. *Shumë ters*-është përcaktor me bashkim; *kjo ditë*- përcaktor me përshtatje. SE {përcaktor me bashkim + përcaktor me përshtatje}.

**U çmenda!** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjali një krye gjymtyrëshe e shprehur me folje, pra ka një sintagmë foljore.

**Më iku petlla.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Është dërrasë.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore e shprehur me kallëzues emëror. SF {kallëzues emëror}.

**Për ty i them burgut hapu.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka 2 sintagma foljore.

**Të rëntë damllaja.** -Pse? mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Na shkruaj një sms.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut; kur? Mungon rrethanori i kohës. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Na kanë zënë dhimbjet e kokës.** - Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore; një sintagme emërore (*dhimbjet e kokës*-përcaktor me drejtim). Struktura e fjalisë paraqitet: SF + SE {përcaktor me drejtim}.

**Se qysh do i bëjmë ne nuk e di?** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut; me kë?

Mungon kundrinori i drejtë me parafjalë. Fjalja ka dy pjesë ku pjesa e dytë është pjesë e nënrenditur ftilluese. Në fjali ka dy sintagma foljore: SF +SF.

**Do na rrinë veshët rehat ca ditë.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. fjalja ka një sintagmë foljore, dy sintagma emërore (*veshët rehat*-përcaktor me bashkim; *ca ditë*-përcaktor me bashkim), SF + SE {përcaktor me bashkim} + SE {përcaktor me bashkim}.

**Tani jam në gjendje lufte unë.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore e shprehur me kallëzues emëror.

**Do na rrinë trupë rehat.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut; kur? Mungon rrethanori i kohës. Fjalja ka një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*trupë rehat*-përcaktor me bashkim): SF +SE {përcaktor me bashkim}.

**Më në fund free.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut; Kush? Mungon kryefjala, Mungon edhe folja. Fjalja është e shprehur me një sintagmë emërore.

**Më gjeni ndonjë mik.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore; një sintagmë emërore (*ndonjë mik*-përcaktor me bashkim): SF + SE {përcaktor me bashkim}.

**Do qetësoj bateritë.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Më në fund do rrimë rehat.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut; Kur? Mungon rrethanori i kohës. Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

**Do e kthejmë ndonjë?** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

**Një Zot i merr vesh.** Fjalja ka një sintagmë foljore dhe një sintagmë emërore (*një Zot*- përcaktor me bashkim)

**Ta vdesësh fare.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

**Dola dobët në provim.** Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Një punë na duhet.** -Pse? Mungon rrethanori i shkakut, Kur? Mungon rrethanori i kohës. Fjalja ka një sintagmë foljore dhe një sintagmë emërore (*një punë*- përcaktor me bashkim): SF + SE {përcaktor me bashkim}.

**Vendosi ca qëllime vetes.** -Me ç'qëllim? Mungon rrethanori i qëllimit. Fjalja ka një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*ca qëllime*-përcaktor me bashkim) : SF + SE {përcaktor me bashkim}.

**Fole me kushuririn ti?** -Kur? Mungon rrethanori i kohës. Fjali me një sintagmë foljore.

(2) Përdorimi i sintagmës foljore, mungesë e kundrinorit të drejtë.

**Ma merr mendja se i marr me forcat e mia.** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. (*ma merr mendja*)-sintagmë foljore; (*marr me forcat e mia*)- sintagmë foljore; (*forcat*

e mia-përcaktor me përshtatje)-sintagme emerore. Kështu, fjalia paraqet këtë strukturë: SF + SE.

***E tha dhe radioja mbrëmë.*** -Çfarë tha? Mungon kundrinori i drejtë. Kjo është një fjali e thjeshtë që përbëhet nga një sintagmë foljore.

***Mbaj mend kur kam qënë i ri.***- Çfarë? Mungon kundrinori i drejtë. Fjalia është e përbërë me nënrenditje kohore, fjalia ka dy sintagma foljore: SF +SF.

***Po ushtrimet në fund i kishim gjë për t'i zgjidhur?***-Në fund të kujt? Mungon kundrinori i zhdrejtë. Fjalia përbëhet nga një sintagmë emërore (*ushtrimet në fund*-përcaktor me bashkim) dhe pjesa tjetër e fjalisë është sintagmë foljore. Struktura e fjalisë është: SE {përcaktor me bashkim}+ SF.

***S'e bëra dot.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. Fjalia nuk ka sintagmë emërore.

***Se kuptova fare.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. Fjalia ka vetëm sintagmë foljore.

***Unë i bëra të gjitha por ajo nuk m'a dha.***- Çfarë? Mungon kundrinori i drejtë. Fjalia ka dy sintagma foljore: SF + SF.

***Shkojmë ta kthejm një herë.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalia ka një sintagmë foljore dhe një sintagmë emërore (*një herë*-përcaktor me bashkim): SF + SE P{përcaktor me bashkim}.

***Shkojmë të djegim.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalia nuk ka sintagmë emërore.

***Nuk i përballoj dot?***- Kë? Mungon kundrinori i drejtë; Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalia ka një sintagmë emërore

***Mos e diskuto më.***-Kë? Mungon kundrinori i drejtë; Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjali e shprehur me një sintagmë emërore.

***Hapi rrugën.*** -Kujt? Mungon kundrinori i zhdrejtë. Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalia ka një sintagme foljore.

***Do e marr për grua.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë, fjalia ka një sintagmë foljore.

***Ajo na orientoi që herën e kaluar.*** -Për çfarë? Mungon kundrinori i drejtë me parafjalë. Kjo fjali përbëhet nga një sintagmë foljore, dhe një sintagmë foljore (*herën e kaluar*-përcaktor me përshtatje).

***Nejse, faleminderit goca.*** -Për çfarë? Mungon kundrinor i drejtë me parafjalë. Është një fjali e thjeshtë ku mungon folja, pra fjalia është e shprehur me një sintagmë foljore.

***S'e kanë dëgjuar më duket.*** -Kë? Mungon kundrinori i drejtë. Kjo është një fjali e thjeshtë me një kallëzues. Kjo fjali është e shprehur me një sintagmë foljore.

***Po, vetëm 1, 2, 3 pjesën tjetër do e punojmë orën e seminarit.*** -Të kujt? Mungon kundrinori i zhdrejtë. Fjalia përbëhet nga: sintagma emërore (*po vetëm 1,2,3*) pjesa tjetër është sintagmë foljore, por brenda kësaj sintagme foljore ka dhe një tjetër sintagmë emërore (*orën e seminarit*-përcaktor me drejtim): SE + SF {folje + SE (përcaktor me drejtim)}.

**Po se deri në janar ne do i kemi harruar.** -*Kë?* Mungon kundrinori i drejtë. Fjalja është e përbërë nga një sintagmë foljore.

**Vetëm tre ushtrimet e para.** -*Ç' bëjnë?* Mungon folja; të kujt? Mungon kundrinori i zhdrejtë. Fjalja është e shprehur me sintagmë emërore.

(3) Përdorimi i fjalive pa kryefjalë, p.sh.: “(Unë) nuk isha në klasë dhe ngela mbrapa; (Leksionet) janë të vështira, të pakuptueshme”. Shembuj të tjerë janë:

**Janë të vështira? Cilat?** Mungon kryefjala. E gjithë fjalja është një sintagmë foljore.

**Fillojnë në faqen 30-45. Cilat?** Mungon kryefjala. Fjalja është e shprehur me sintagmë foljore.

**Ma hoqen trurin.** *Cilat?* Mungon kryefjala. Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

**Është me moshë.** *Kush?* Mungon kryefjala. Fjalja është e gjitha sintagmë foljore e shprehur me kallëzues emëror.

**Ishin bombë.** *Kush?* Mungon kryefjala. Fjalja është sintagmë emërore e shprehur me kallëzues emëror.

**Nga njeri vesh më hynë dhe nga tjetri më del.** *Kush?* Mungon kryefjala. Fjalja ka dy sintagma foljore.

**Ishte i thjeshtë.** *Kush?* Mungon kryefjala. Fjalja ka vetëm një sintagmë foljore të shprehur me një kallëzues emëror të formuar nga folja këpuje *jam*.

**Ishin shumë të renda.** *Cilat?* Mungon kryefjala Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja është sintagmë foljore e shprehur me kallëzues emërore.

**Nuk mësohen.** *Cilat??* Mungon kryefjala; Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja është e tëra një sintagmë foljore.

**Janë shumë të vështira? Cilat??** Mungon kryefjala. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Kot pa lidhje.** *Kush?* Mungon kryefjala; ç' bën? Mungon folja. Fjalja është e shprehur me një sintagmë emërore.

**Si Benz 240-tsh.** *Kush?* Mungon kryefjala; ç' ben? Mungon folja. Fjali e shprehur me sintagmë emërore.

**Me të meta mendore.** *Kush?* Mungon kryefjala; ç' bën? Mungon folja. Fjali e thjeshtë e shprehur me sintagmë emërore.

**I pavëmendshëm.** *Kush?* Mungon kryefjala; ç' bën? Mungon folja; Fjali me një gjymtyrë.

**Na i nxiu.** *Kush?* Mungon kryefjala; pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja ka një sintagmë foljore.

**Erdhën këto dreqet.** Fjalja ka një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*këto dreqet*-përcaktor me përshtatje): SFF + SE {përcaktor me përshtatje}.

**Ka marr fund.** *Kush?* Mungon kryefjala; Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja është sintagmë foljore.

**Është flakë fare.** *Kush?* Mungon kryefjala. Pse? Mungon rrethanori i shkakut. Fjalja është sintagmë foljore e shprehur me kallëzues emëror i formuar nga folja

këpuje jam.

(4) Ndërtime të ndryshme të fjalisë, me përbërje, SE + SF , SE pa folje, SF + SF, mungesë e sintagmës emërore etj.

***Mirë që s'i keni pasur të gjitha ushtrimet.*** Kjo është një fjali e thjeshtë, që përbëhet nga një sintagmë foljore dhe nga një sintagmë emërore (*të gjitha ushtrimet*-përcaktor me përshtatje).

***Shyqyr, jashtë që ketu.*** Fjalja ka sintagmë emërore dhe i mungon folja.

***Mbani qetësi se nuk po përqëndrohëm dot.*** Fjalja ka dy sintagma foljore.

***I kam qarë.*** Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

***I ka bërë ujë.*** Fjalja nuk ka sintagmë emërore.

***Ma merr mendja se i marr me forcat e mia.*** Fjalja ka dy sintagma foljore (*Ma merr mendja; i marr me forcat e mia* ); fjalja ka dhe një sintagmë emërore (*forcat e mia*-përcaktor me përshtatje): SF + SF + SE.

***Dini gjë kur e kemi provimin e fonologjisë?*** Fjalja ka dy sintagma foljore, dhe një sintagmë emërore (*provimin e fonologjisë*- përcaktor me drejtim): SF + SF + SE.

***Sa për qind ka ky provimi?*** Fjalja ka një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*ky provimi*-përcaktor me përshtatje)

***Të të bëj një pyetje.*** Fjalja ka një sintagmë foljore (*të të bëj*), dhe një sintagmë emërore (*një pyetje*-përcaktor me bashkim).

***Kemi ndonjë orë bosh?*** Fjalja ka një sintagmë foljore dhe një emërore (*ndonjë orë*-përcaktor me bashkim): SF + SE.

***Si duken lëndët këtë vit, janë ndonjë çik të vështira.*** Fjalja ka dy sintagma foljore (*Si duken lëndët; janë ndonjë çik të vështira*- kallëzues emëror), dhe një sintagmë emërore (*këtë vit*-përcaktor me përshtatje): SF + SE + SF.

***Do vish lart se kemi edhe një orë?*** Fjalja ka dy sintagma foljore.

***Provimi në fakt nuk ishte shumë i vështirë po ca gjera nuk kuptoheshin.*** Kjo fjali ka dy sintagma foljore, (*ishte shumë i vështirë*- kallëzues emëror; *nuk kuptoheshin*), fjalja ka gjithashtu edhe dy sintagma emërore (*shumë i vështirë*-përcaktor me bashkim; *ca gjera*-përcaktor me bashkim).

***Shkoni në ndonjë vend të bukur.*** Fjalja ka një sintagmë foljore që është gjithë fjalja, ka edhe një sintagmë emërore (*ndonjë vend të bukur*).

***Ku do ikim këtë verë.*** Fjalja ka një sintagmë foljore dhe një sintagmë emërore (*këtë verë*-përcaktor me përshtatje).

***Ti dukesh më bukur kur dëgjon sesa kur flet.*** (Kjo fjali ka dy sintagma foljore.) Njëra pjesë është kryesore (*ti dukesh më bukur*) dhe ka një pjesë të nënrenditur kohore (*kur dëgjon sesa kur flet*).

***Më mirë mos fol e lëri të tjerët të mendojnë se je budalla sesa të flasësh e t'ua heqësh dyshimin.*** Fjalja ka tre sintagma foljore që mund të qëndrojnë të vetme: SF + SF + SF.

***Më duket sikur do hedh provimet e jetës.*** Fjalja ka dy sintagma foljore dhe një sintagmë emërore (*provimet e jetës*- përcaktor me drejtim).

*Lënda që studioj më duket interesante.* Fjalja ka një sintagmë foljore.

*Sa të vështira po na i bën.* Fjalja ka një sintagmë foljore, dhe një sintagmë emërore (*sa të vështira*).

### c. Kundrime morfologjike

Kjo nënçështje përqendrohet në dy drejtime: (a) në tiparet drejtshqiptimore; (b) në tiparet drejtshkrimore të ligjërimit të studentëve në Universitetin e Vlorës.

#### 7.c.1 Elemente dhe shmangie drejtshqiptimore

**Tiparet drejtshqiptimore** që hasen më së shumti në ligjërimit formal dhe informal të studentëve paraqiten si më poshtë:

*Vlera morfologjike formëformuese e nyjes së përparme te mbiemrat e nyjshëm të emëruar:* në tërë paradigmen e mbiemrave të nyjshëm të emëruar vetëm trajta e shquar e gjinisë femërore njëjës del me tri trajta: *e mira ~ i së mirës ~ së mirës ~ të mirën ~ së mirës*<sup>338</sup>. Shpesh dhe me lehtësi në këtë paradigmë kalohet nga trajtat me një të përparme *së* të gjinore-dhanore-rrjedhore në trajtat e përgjithshme me *të* (*e mira ~ i të mirës ~ të mirës ~ të mirën ~ të mirën*). Ky njësim i mëtejshëm i nyjes së përparme në përdorimin gojor është i zakonshëm dhe i pandjeshëm; por është edhe në përputhje me prirjen e përgjithshme të thjeshtimit të strukturës eptimore të shqipes<sup>339</sup>.

E njëjta paradigmë vihet re edhe në paradigmen e lidhorit *i cili ~ e cila*, të përemrit *e saj* dhe të emrave të ditëve të javës *e hënë, e martë*, etj. Edhe në paradigmen e tyre format e gjinore-dhanore-rrjedhore me një të përparme *së* po zëvendësohen nga ato me *të*.

Profesor E. Likaj<sup>340</sup> (2011:140), gjithashtu, vë theksin se në gjuhën shqipe prej kohësh vihet re *prirja e rikthimit të temave foljore në trajtën e njësuar të mëparshme*, duke ndjekur modelin pak të njohur të shqipes, e cila prej kohësh tematizon forma të caktuara gramatikore të përgjithshme dhe cilësore për grupe të caktuara foljesh, që ndryshojnë temë gjatë paradigmes. Kështu, për foljet që në vetën e parë njëjës të zgjedhimit vepron të mënyrës dëftore dalin herë me *-s*, herë me *-t*, është zgjedhur forma me *-t*, duke ndjekur prirjen e përgjithshme për njësimin e temave (*mat* e jo *mas*, *rrit* e jo *rris*, etj).

<sup>338</sup> Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 170.

<sup>339</sup> Likaj, E., *Morfologjia e shqipes standard dhe zhvillime të reja*, Tiranë, 2011, f. 134.

<sup>340</sup> Shih po ai, po aty.

Por, nga hulumtimet e tanishme në ligjërimin e bashkësisë gjuhësore të studentëve e jo vetëm, vihet re se për vetën e tretë të së pakryerës njëjës dëftore është rikthyer tema me *-s*, e vetmja në tërë paradigmen e këtij grupi foljesh (*maste, rriste, priste, fliste*, etj).

Në ligjërimin e folur, vihet re gjithnjë e më shumë prirja për mospërdorimin e mjeteve gramatikore sintetike ose analitike, karakteristikë për ndërtimin e formave gramatikore të fjalëve të shqipes. Kjo dukuri vërehet më tepër te emrat e më rrallë te foljet, si pasojë e ndikimi të gjuhëve të huaja. Ndryshimet e shumta që ndodhin në rrafshin morfologjik, sintaksor, por edhe atë fonetik, bazohen në parimin me karakter universal, parimi i ekonomizimit gjuhësor. Ky parim vepron gati në mënyrë të heshtur, dhe vepron në çdo rrafsh dhe te shumë fjalë, por më shumë te fjalët më të përdorshme.

Një prirje tjetër është përdorimi i pjesshëm i treguesit analitik të së ardhmes. Shpesh në gjuhën e folur, por edhe në gjuhën e shkruar elementi formal *të* mënjanohet në përdorim, pa sjell asnjë problem në komunikim. Në vend të strukturës *do të punoj*, përdoret struktura *do punoj*; nuk tha se sa *do të vonohet*, zëvendësohet nga nuk tha se sa *do vonohet*; *do e marrësh* librin? Po, *do e marr*. Të njëjtën rrjedhë ndjekin edhe strukturat më të ndërlikuara, si: *do të të kisha thënë*, *do t'ju kisha marrë*, etj., në gjuhën e folur përdoren: *do thosha*, *do merrja*, etj.

Ndërkohë vihen re edhe gabime të tjera gramatikore, si:

- (1) Në vend të përemrave vetorë *ne, ju* rasa emërore e kallëzore, përdoren trajtat gjegjëse të dhanores *neve, juve*;
- (2) Përdorimi i gabuar i përemrit pyetës *kush*, i cili si rregull nuk duhet vihet përpara një emri (në funksion përcaktori), si p.sh. *Kush ushtrim ishte më i lehtë?* Por, “cila-cili”. Po kështu me këtë përemër shpesh pyetet për jofrymorë.
- (3) Përdorimi i përemrave pronorë të vetës së tretë me disa emri farefisi (hiperkarakterizim): *i vëllai i tij, e ëma e saj* etj.

Semantika, kuptimi i fjalës, ushtron ndikim mbi zgjedhjen e prapashtesave dhe kështu mbi produktivitetin e mjeteve të formimit të shumësit<sup>341</sup>. Te frymorët mashkullorë janë produktive prapashtesat *-ë, -a* dhe *-0 (zero)*. Te emrat femërorë që mbarojnë në *-ë, -a*-ja ka është normative, si p.sh.: *drekë/dreka, etj.* Ndërsa, në grupet e tjera të femërore, të cilat përfundojnë me zanore të tjera, *-a*-ja nuk lejohet më, si p.sh.: te emri *shtëpi*, tani nuk duhet thënë më: *shumë shtëpia*. Gjithashtu, Gramatika e Akademisë, f. 33 shkruan: “për qëllime të caktuara stilistike-shprehëse ose për të shprehur ngjyrimet e veçanta kuptimore, përdoren si trajta dytësore mbaresat *-(ë)ra, -ër...çudira* (Çfarë çudira po ndodhin!), *marrëzira, etj.*” Për prapashtesën *-ër* shkruhet në “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”, f. 27 se: “Disa emra frymorë, kur përdoren me

<sup>341</sup> Fiedler, W., *Tendenat e formimit të shumësit në shqipen e sotme*, Tiranë, 2011, f. 154.

kuptim të figurshëm, për qëllime stilistike-shprehëse, mund ta formojnë trajtën e shumësit me mbaresën –ër, p. sh.: *bufër, qenër, hajvanër*”.

Gjithashtu po përdoren gjithnjë e më të diferencuara e ardhmja e zakonshme e tipit *do të shkoj* dhe ajo me ngjyrim modale (siguri, etj.) e tipit *kam për të shkuar*, e ardhmja e tipit *do të shkoj, do të marrë, do të blej, do të lexoj* përdoren më tepër në variantin e shkurtuar *do shkoj, do marr, do blej, do mësoj*, etj. E njëjta dukuri vërehet edhe në format e kohës së shkuar, ku forma *kam shkuar, kam shkruar, kam lexuar* përdoren *shkova, shkrova* ose *shkruajta, mësova*; po përdoret shumë fjala *ca* në funksion të nyjës joshqyese të shumësit të emrave, ndërkaq *disa* po përdoret kryesisht si përemër (*ca ushtrime, ca vajza, kam ca orë mësimi sot, ca fytyra, ca sy, ca zëra, disa herë, disa minuta, etj.*).

Gjatë vëzhgimit të bisedave joformale të studentëve të Gjuhëve të Huaja, u vu re se studentët përdorin kohën e tashme për të shprehur veprime që do të ndodhin në të ardhmen. Të shumtë janë shembujt: *po vij nesër!* në vend të *do të vij nesër.*; *sonte do bëj detyrën me siguri* në vend të fjalisë *sonte do ta bëj detyrën me siguri.*; *provimi është nesër për provimi do të bëhet nesër.*; *ndoshta do jap leksionin e ri* përdoret për të shprehur *ndoshta do të na japi leksionin e ri.*

Rezultatet e vëzhgimit gjithashtu nxjerrin në pah përdorimin e kohës së shkuar për të shprehur veprime që realizohen në kohën e tashme si: *nuk kopjova për nuk po kopjoj; erdha në leksion në vend të fjalisë po vij në leksion* etj.

Në ligjërimin e folur studentor brenda dhe jashtë mjediseve akademike vërehen edhe disa trajta të parregullta të foljeve: *keni, jeni, deshi, pati*, si edhe *doli, nxorri* etj.; trajtat foljore me *s'prisnin, priste, flisni, pyesnin*; përdoren në formën *priste, fol, pyeti*; ndërsa në trajtën *kafé* me theks fundor vihet re vendosja e theksit në rrokjen e parë *káfe*, ndonëse për variacion ose ngjyrim stilistikor përdoret trajta *do ta pimë káfenë* (ose *káfen*).

Shmangie vërehen edhe në rastin e përdorimit të trajtës së mashkullore *tre* për femëroren *tri*: *tre vajzat, tre klasat, etj.* Mesa duket, prirja synon zhdukjen e dallimit gjinor edhe të numërorit *tre/tri* në të mirë të gjinisë mashkullore<sup>342</sup>.

Gjithashtu, shmangie vëzhgohen edhe me përdorim e ë-së së tepërt në fjalët si *femër – fëmër, qen – qën, vend – vënd*, të cilat janë gabime që lindin nga mosnjohja e mirë e rregullave standarde dhe ndikimi i madh i variantit krahinor të gjuhës.

#### **d. Proceset fjalëformuese në shqipe dhe fjalët e huazuara në ligjërimin bisedor dhe atë të shkujdesur**

Studiuesja A. Omari<sup>343</sup> (2011:176) shprehet se një shfaqje e zhvleftësimit dhe konsumimit të fjalëve është dhe nevoja për të krijuar fjalë të reja nëpërmjet

<sup>342</sup> Çeliku, S., *Shmangie në fushë të gramatikës e drejtëshkrimit në ...*, Tiranë, 2003, f. 178.

<sup>343</sup> Omari, A., *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, Tiranë, 2011, f. 183.

prejardhjes. Parashtesat dhe prapashtesat që i shtohen një fjale për krijuar një fjalë e re.

*Huazimet janë kryesisht leksikore*, por mund të jenë edhe **huazime gramatikore**. Ndërtime të tilla vërehen më së shumti në ligjërimin bisedor dhe ligjërimin e thjeshtë.

Le të shohim disa prej tyre: *Të shumta janë edhe ndërtimet e tipit fjalët nga gjuhët e huaja + mbaresat e eptimit në shqip (anglisht, italisht) që përdoren në shprehje ose fjali shqipe, të shoqëruara nga mbaresat të ndryshme të gjuhës shqipe*, si, mbaresat **-ove** (<shqip. -ove), **-shi** (<shqip. -shi), **-(l) ua** (<shqip. -ua).

*Fjalët që merren nga gjuhët e huaja i nënshtrohen sistemit fonetik e gramatikor të gjuhës marrëse, d.m.th. shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit të saj, eptohen sipas klasave gramatikore dhe sipas rregullave përkatëse, si p.sh.:*

(1.a) përdorimi i **mbaresës shqipe -ove** (<shqip. -ove), si p.sh.: *me fjalë angleze: e andërstove (e kuptove!); me fjalë të gjuhës italiane: e kapitove (e kuptove!);*

(1.b) përdorimi i **mbaresës shqipe -(l) ua** (<shqip. -ua), si: *me fjalë të gjuhës italiane: i ka ikur çervelua (truri).*

Shembuj të tjerë të përdorimit të fjalëve të huaja në fjali shqipe të cilave u bashkangjiten prapashtesa të ndryshme: *jam duke lërnur apo rajtur* (learn + ur; ërite + ur) – ang. < I am learning; I am writing (alb. < po mësoj; po shkruaj); *e finisha detyrën* (finish + a) – I finished the homeëork (ang. < finish, alb.< mbarova); *folat në telefon me bradhërin* (brother + in) – I phone my brother (ang. <brother, alb. < vëlla); *e delitova mesazhin* (delit + ova) – I delited the message ( ang. < delit, <shqip. fshiva); *jam duke çenxhur drejtim* (change +ur) – I am changing direction (anb. < change, alb. < ndryshoj) etj.

Gjithashtu, vihet re përdorimi i **formës si në gjuhën e origjinës** (<shqip. -shi), si p.sh.: *me fjalë të gjuhës italiane, si: kapishi (e kuptove!); me fjalë të gjuhës angleze, si: izi (easy “lehtë”); hi (ç’kemi).*

2. Gjatë analizimit të bisedave të zhvilluara me studentët, ra në sy prirja e theksuar e **të folurit shqip me theks anglofon, grek ose latin**. U vu re se gjatë bisedave informale me njëri-tjetrin për tematika të ndryshme, studentët u shtonin fjalëve prapashtesa të ndryshme, si p.sh:

(2.a) Përdorimi i **fjalëve shqip me prapashtesa të gjuhës angleze**: shtimi i prapashtesës **-ejshën** (<angl. -ation) në fjalë tipike shqipe ose të huazuara, si: provimejshën (*provim*); kafeishën (*kafe*); detyreishën <E kam për detyrejshëm!> (*detyrim*); fletoreishën (*fletore*); libreishën (*libër*); këpuceishën (*këpucë*); televizoreishën (televizor); luleishën (*lule*); makineishën (*makinë*); shkollëishën (*shkollë*); organizejshën (*organizim*); flemeish[n] (*fle gjum*); interesoreishën (*interesim*); kuptuejshën (*kuptova*); fillejshën (*fillimi*); mbarejshën (*mbarimi*); makineish[n] (*makin*); budalleish[n] (*budallall*); okeish[n] (*vjen nga <ang. OK., me*

kuptimin “dakort”); telefoneishën (*telefon*); sigureishën (*sigursht*); kuptueishën (*kupton*).

(2.b) Përdorimi *i fjalëve shqip me prapashtesa të gjuhës greke*: shtimi i prapashtesës **-qi** ose **-qis** (<gr. -qi) në fjalë tipike shqipe si: trenaqi (*trenë*); Lajbëraqi (*Labëri*); frigoriferaqi (*frigorifer*); oraqi (*orë*); ujaqi (*ujë*); sizaqi (*syze*); gabimaqi (*gabim*); vonesaqi (*vonesa*); tiganraqi (*tigan*); jam nga Vloraqi (*jam nga Vlora!*); stomaqi (stomaku); mamaqi (*mami*); babaqi (*babi*); libraqi (*libri*); psikomaqi; berberaqi; papataqis (*patate*); provimaqis (*provim*); kafaqis (*kafe*); oraqis mësimaqis (*orar mësimesh*); rrimë kotaqis (*rrimëkotë*); kazanaqi; pordhaluqi (*mendjemadh*); shkurtabiqis (*i shkurtër*); bluzaqis (*bluzë*); profesoraqis (*profesorë*); frutaqis (*fruta*);

(2.c) si dhe përdorimi *i fjalëve shqip me prapashtesa të gjuhës latine -os* (<lat. -os): Ku dos vamos (*Ku do të shkojmë*); Do hamos ndonjë gjë? (*Do hamë ndonjë gjë?*).

Duhet theksuar se kjo mënyrë e të folurit me përzierje gjuhësore shqip-gjuhë e huaj është më tepër e theksuar tek studentët e gjuhëve të huaja ndërsa kur përdoret nga studentët e degëve të tjera ka më tepër ngjyrimë ironizuese.

(3) Ndodh ndryshe me disa huazime të tjera si emra, mbiemra apo folje të prejardhura: prejardhja u nënshtrohet ose rregullave morfologjike të gjuhës burimore ose atyre të gjuhës shqipe<sup>344</sup>. Ndeshen të dy rastet.

(3.a) një varg emrash të prejardhur nga foljet që tregojnë veprim, të formuar me anën e prapashtesës **-im**; *destruktim, laikim* (like + im) *etj.*

(3.b) gjenden gjithashtu edhe emra të formuar me anë të prapashtesave të burimit të huaj, **-itet**: *shoqëritet* (me kuptimin *shoqëria jonë*).

4. Fjalë të prejardhura me ndajshitesa: mbizotërojnë fjalët e krijuara nga rrënjë + sufiks, si:

**Trashaman** => *i trashë* (mbiemër) + *man* (prapashtesa)

**Shtrigane** => *shtrigë* (emër) + *an* + *e* (prapashtesa)

**Gjumash** => *gjumë* (emër) + *ash* (prapashtesa)

**Çmenduri** => *çmendur i* (mbiemër) + *i* (prapashtesë)

**Lepurushe** => *lepur* (emër) + *ush* + *e* (prapashtesa)

**Fatkeqësi** => *fatkeq* (mbiemër) + *ësi* (prapashtesa)

**Shkëputje** => *shkëput* (folje) + *je* (prapashtesa)

**Rrugaç** => *rrugë* (emër) + *aç* (prapashtesë)

<sup>344</sup> Monteko, K., *Neologjizmat e fjalorit personal të bazetarëve shqiptarë*, Tiranë, 2009, f. 94.

Fjalë të krijuara nga paranyjëzimi i pjesoreve të foljeve

**Dehur** => *deh* (rrënja) + *dehur* - i dehur

**Rrjedhur** => *rrjedh* (folje) + *rrjedhur* + i rrjedhur

### 7.d.1 Shmangiet drejtshqiptimore

Ndërsa, **fjalori i ligjërimit të shkujdesur** transformohet nga procese fjalëformuese, që njihen dhe në shqipen mbarë, si derivacioni, përbërja, përngjitja apo shkurtimi.

Togje të krijuara nëpërmjet *përbërjes*:

(a) emër + emër: trupeshk, kokëqyp, kokëbosh, kokëderr, kokëgdhë, kokëqepë, kokëçibuk, gojëçorape, barkderr, fytyrë patate, veshllapush, kokë mushkë; trugomar.

(b) emër + mbiemër prejpjesor: bukëshkelur, kokërrjepur, xhepbushur, trushkukur, mendjendritur, trutharë.

(c) mbiemër + emër ose emër + mbiemër: idiotthing, surratshëmtut, mendjemadh, fatkeq, dënglamadh.

Në ligjërimin e shkujdesur haset dendur dukuria e formimit të fjalëve të reja me **prejardhje pa ndajshitesa** ose me konversion. Ndryshimi i pjesës së ligjëratës zakonisht nga një mbiemër në emër, si p.sh: *E bardha, servili, i mefshti, mangut, i trashë, e paparë, mendjemprehti, i madhi, i zgjuari, i mënçuri, i dalluari, inteligjenti, modeli, tru-peshku, tru-thari, mendjemadhi, i papërgjegjshmi, karagjozi, e madhe, gjigande, i leshti, debili, i pakuptueshmi, i varur, njeshi, përtaci, i lodhuri, o lumadhe, të ftohtët, mendjendrituri*.

Shkurtime, akronimet dhe përzierjet janë disa procese të tjera fjalëformuese të cilave u nënshtrohen leksiku i ligjërimit të thjeshtë. Qëllimi i përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve në këtë mënyrë është ekonomizimi i në gjuhë. Shembuj ilustrues janë: *sms, paçim, gjes, tdsh, nsr* etj.

Përdorimi i fjalëve të parme shoqëruar nga konotacionet kontekstuale përbën tipar tjetër të ligjërimit të shkujdesur. Shembuj të tillë janë: *gjeniu* (etiketim që shpreh kuptimin e kundërt), *shef* (kur dikush ka sjelle të shefit), *legen, dërrasë* apo *tullë* (për dikë që nuk kupton), *bombë* (vajzë fizikisht e bukur), *gjigand* ose *flori* (person që ka sjelle shumë të mirë apo është tepër i shoqërueshëm), *zombi* (dikush nuk është i përqendruar në bisedë por është i përhumbur në mendimet e tij/saj), *truri* (etiketimi që përdoret për studentët që mësojnë shumë) etj. Në proceset fjalëformuese, sidomos në ligjërimin e shkujdesur, vërehen dy lloj neologjizma<sup>345</sup>: (a) *neologjizma semantike*, (b) *neologjizma stilistikore*.

<sup>345</sup> Me termin *neologjizma semantike* do të nënkuptojmë të gjithë ato fjalë e shprehje ekzistuese të cilat fitojnë kuptime të reja. Ndërsa, me termin *neologjizma stilistikore* do të nënkuptojmë të gjitha ato

### **7.d.2 Dukuritë më të shpeshta drejtshkrimore në ligjërimin e studentëve**

Dukuri morfologjike rreth drejtshkrimit të studentëve:

Në rreth 21% të shkrimeve të studentëve, më së shumti në shkrimet shkollore të studentëve të vitit të fundit të gjuhës shqipe, u vërejtën përdorime të rrjedhës pa parafjalë në funksion të përcaktorëve dhe të rrethanorëve, sidomos me përemra, por edhe me emra, si një përpjekje për të bërë efekte stilistike, si p.sh. *jetë njerëzish, shprehje vlerësimi, shenjë besimi, burim fitimesh* etj.

Një përdorim më të gjerë, rreth 42%, kanë një varg ndërtimeve të tilla si lokucione parafjalore ose lidhëzore, p.sh.: *në këmbim të, në emër të, nga puna se, vërtet që, mirë që* etj.

Shqipja ka dy lidhëza sinonime: *se* dhe *që*, të cilat kanë përdorim të gjerë në fjalitë e nënrenditura përcaktore, kryefjalore, kundrinore dhe kallëzuesore. Ato alternohen shpesh në përdorim, por edhe në përbërje të shprehjeve lidhëzore kushtore, shkakore, lejore etj. Shembuj të tillë që u vunë re në shkrimet e studentëve janë: *në qoftë se (që), nga se (që), po qe se (që), meqënëse (që), ndonëse (që), megjithëse (që)* etj. Ato hyjnë në përbërjen e shumë lokucioneve lidhëzore që përdoren në frazat me fjali të nënrenditura rrethanore, duke dyfishuar kështu numrin e mjeteve lidhëse në mënyrë sistemore dhe ekonomike<sup>346</sup>.

### **7.d.3 Kundrime të përgjithshme të gabimeve drejtshkrimore më të shpeshta të studentëve:**

Vërehen njohje e pamjaftueshme e rregullave drejtshkrimore. Gabimet rrjedhin ngaqë nuk njihen rregullat dhe fjala shkruhet sipas shqiptimit vetjak. Ja disa nga luhatjet tipike drejtshkrimore.

#### ***Zanoret***

Përdorimi i ë-së së patheksuar në shkrim përbën një nga problemet kyçe edhe në rastin e përcaktimit të normave drejtshkrimore edhe në procesin e zotërimit të normës<sup>347</sup>. Zanorja ë përdoret gabimisht në shumë raste:

Ë-ja fundore e emrave të gjinisë femërore, e numërorëve dhe e emrave të gjinisë mashkullore që lakohen si emrat e gjinisë femërore, shkruhen gabimisht në 25% të rasteve, si fjalët e tipit: *fjalë, shtatë, djalë*, shkruhen pa ë-në fundore.

---

raste gjuhësore kur fjalët që konsiderohen se i përkasin standardit gjuhësor, përdoren edhe në situata të tjera joformale.

<sup>346</sup> Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë, 2003, f.114.

<sup>347</sup> Bajçinsa, I., *Çështje të shqipes së stome letrare vështruar në aspektin teorik e të zbatimit në praktikë*, Tiranë, 1992, f.103.

Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me zanore *i* të theksuar shkruhen gabimisht, pa –ë, në gjinore, në dhanore, në kallëzore dhe në rrjedhore. Shkalla e përdorimit të gabuar të këtyre emrave është 25% te studentët e përfshirë në studim për këtë çështje (p.sh. *bukuris-ë, vajzëris-ë*).

Shkrimi i një *ë*-je të tepërt para prapashtesës –*shëm* te forma femërore e mbiemrave, si: *e ardhëshme, të përditëshme, të mundëshme*, etj. dhe te disa fjalë të veçanta, si: *arësye, tepëron, vjetërohet* etj.

Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore që e formojnë shumësin me zanoren –*ë*, shkruhen pa këtë zanore në 18% të rasteve, si: *punëtor-ë, qytetar-ë* etj.

Ndërkohë, që në shkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj që kanë grupe zanoresh si *ia* dhe *io* bëhen gabime drejtshkrimore duke vendosur në mes të tyre një *e* kthyer *i* në *j*, p.sh.: *materjal, mobilje* etj. për *material, mobilie* etj.

### ***Bashkëtingëlloret.***

Gabimet në shkrimin e bashkëtingëlloreve janë të shumta, por më të pakta në numër. Bien në sy:

1. Ngatërrimi i shkonjës *r* me shkronjën *rr* është i shpeshtë, sikurse paraqitet në shembujt në vijim: *burë* për *burrë, bira* për *birra*, etj. gjithashtu, shkruhen gabimisht me *r*: *rallë, resht, konkurues*; përkundrazi me *rr*: *rradhë, rregjistroj* etj. Gabimet e evidentuara në esetë, detyrat e klasës dhe shënimet e studentëve paraqesin një situatë aspak të favorshme për gjuhën letrare dhe nivelin gjuhësor të studentëve. Shtrohet detyra se gjuha shqipe duhet të jetë lëndë e detyruar edhe në ciklin universitar dhe duhet punuar më shumë me studentët dhe nga studentët për të eliminuar ose zvogëluar gabimet drejtshkrimore të studentëve dhe për të ngritur kulturën e tyre gjuhësore.

2. Mungesa e shkronjës *j* te fjalë si: *ndërgjegja, përgjigja, idea*.

3. Shkrimi me *j* në vend të *i*-së te format e zgjedhimit të foljes *ndjej*, si: *ndjejnë, ndjehem, ndjehet* etj.

4. Në disa raste u vërejtën gabime në shkrimin e bashkëtingëlloreve *ç/-sh/-zh-*nistore: *çfaqje, shmalle* etj.

### ***Apostrofi***

1. Shkelje e rëndë e rregullave gramatikore është edhe ndarja me apostrof e pjesëzës *të* të lidhore dhe e gerundit, e cila së bashku me trajtën e shkurtër ka kaluar në *ta*, si dhe veçimi pa asnjë arsye i bashkëtingëllores *ç* në përemrat e pazbërthyesëm *ç'farë, ç'do* (*çfarë, çdo*, etj). Në këtë rast kemi shkelje të rregullave pikësimore. Megjithëse, u vu re një rënie e përdorimit gabim të këtij tipari, duhet theksuar se ky gabim fillestar është ende i pranishëm në shkrimet e disa studentëve në vite të ndryshme studimi.

2. Trajta e shkurtra të bashkuara të përemrave, në raste të shpeshta shkruhen gabimisht pa apostrof, si p.sh. *mi dha, ti dha, (m'i dha, t'i dha)* etj. Trajta e shkurtër e vetës së dytë të shumësit e përemrit *ju* ngatërrohet me trajtën e shkurtër të vetës së tretë të shumësit *u*, si në rastet: *....ju erdhi keq....(....u erdhi keq....)*. Trajta e shkurtër e bashkuar e përemrit vetor, veta e tretë njëjës e dhanores *ia* shkruhet gabimisht me *j (ja)*, si: *...ja dhashë librat shokut të dhomës*, në vend të *...ia dhashë librat shokut të dhomës*. Pra, në 19% të rasteve në esetë e studentëve paraqiten gabime të kësaj natyre.

3. Gjithashtu, duke shkelur rregullat më elementare të gramatikës së drejtshkrimit shpërbëhen disa fjalë të prejardhura me parashtesat: *jo, pa, mos, sapo, ç*, duke shkruar veç e veç përbërësit e disa fjalëve të përbëra a të përngjitura: *ç'interesim, të pa korruptuar, të pa shoqëruara, kurse një vjeçare, dy ditore* etj. Lulatje u vërejtën edhe në shkrimin e shprehjeve ndajfoljore e lidhëzore, që priren nga trajta shkrimore e përngjitur (*sëbashku, nëqoftëse*, etj).

### ***Shkrimi njësh dhe ndaras***

Gabime vërehen edhe në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me ose pa vizë lidhëse. Shkruhen gabimisht ndaras: *shpesh herë, pa dyshim me njëherë, deri sa, një farë, mos vazhdim etj.*; dhe njësh: *përshembull, përqind, , përsa*.

Gjithashtu, gabime të shumta bëhen edhe në përdorimin e nyjave para gjymtyrëve homogjene. Shpeshherë nuk shkruhet nyja *të*. I njëjti gabim vërehet edhe në mospërdorimin e parafjalëve para gjymtyrëve homogjene si: “Pedagogu foli për rëndësinë e zhvillimit të ekonomisë shqiptare, (për) uljen e borxhit dhe (për) ndryshimet në sistemin ekonomik. (kështu shkruan një student i degës së Ekonomisë.) Përdorimi i gabuar i nyjave dhe parafjalëve kap një përqindje prej 21% të rasteve në ese.

### ***Pikësimi***

Gabimet që vërehen më shumë i takojnë përdorimit të prejses. 45% e studenteve nuk e vendosin presjen para përemrave lidhorë *i cili, e cila*, para lidhëzës kundërshtore *por* dhe para lidhëzës shkakore *sepse*. Ndërkohë që në 22% të rasteve të studiuara u vu re përdorimi i presjes para *etj.*; mungon dendur (rreth 64 %) presja para përemrave lidhorë *i cili, e cila*, para lidhëzës kundërshtore *por* dhe para lidhëzës shkakore *sepse*.

## **e. Çështje të normës morfologjike**

Mangësitë që bien në sy më shumë në këtë fushë janë:

1. Në 32% të rasteve përdoret gabimisht lidhorja. Kështu, e tashmja e vetës së parë njëjës e lidhore ngatërrohet me të tashmen e vetës së tretë njëjës e anasjelltas, si: *të punoj unë, të punoj ai*.

2. Një numër i konsiderueshëm studentësh nga Shqipëria e Veriut, përdorin paskajoren dhe shpeshherë kjo formë ndërtohet me mbaresën –uar, p.sh. *me punuar*.

3. Gabimet më të shumta drejtshkrimore u vërejtën në shkrimin e kompozitave, në shkrimin e fjalëve me parashtesa si p.sh. *i pa ditur* (i paditur), *i pa matur* (i pamatur), *jo amtare* (joamtare). Edhe në shkrimin e lidhëzave, të pjesëzave e të pasthirmave, përmerave të pacaktuar të përngjitur bëhen shumë gabime drejtshkrimore si: *meqënë se* (meqënëse), *kush e di* (kushedi), *thuj se* (thujse), etj. Në 31% të rasteve në esetë e studentëve u evidentuan këto gabime.

4. Të shpeshta janë edhe *ndërtimet sintaksore* të gabuara, të vërejtura më së shumti në shkrimet e studentëve të vitit të parë: përdoret një ndërtim në vend të tjetrit, vendosen gjymtyrët në rend të gabuar, përdoret një strukturë e cunguar, përdoren konstrukte të huaja, përdoren gabim shenjat e pikësimit. Këto shembuj dëshmojnë për mosnjohuri të theksuar në shprehjen e në njohjen e përciptë të shqipes.

5. Përdorimi i gabuar i përemrit *që* si: *Ky është shoku që të fol!* në vend të: *Ky është shoku për të cilin të fol!*; *Ta thashë që në klasë!* Në vend të: *Ta thashë kur ishim në klasë!*

6. Së fundi, u has edhe një grup tjetër shmangiesh që shprehin një prirje të re në gjuhë. Këto shmangie vërehen në disa rrafshë: fonetike, drejtshkrimore ose gramatikore. Të tilla janë: përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës *i* për shumësin *u*; mospërdorimi i “nyjave të përparme” ; përdorimi i numërorit *tre* edhe për femëroren *tri*; përdorimi i ndërtimit *lidhore + kallëzore* në vend të *lidhore + emërore*; përdorimi i parafjalës *pavarësisht + dhanore* në vend të lokucionit parafjalor *pavarësisht nga + emërore*, etj.

Me gjithë gabimet e lartpërmendura, pjesa më e madhe e studentëve i kanë përvetësuar njohuritë gjuhësore. Ata shkruajnë në mënyrë të kënaqshme në gjuhën letrare. Duhet theksuar se studentët bëjnë më tepër gabime gramatikore në të folur sesa në të shkruar. Kjo mund të shpjegohet nëpërmjet faktorëve që kushtëzojnë ligjërimin verbal dhe ndikimi i të folmes vendore. Pra, dukuri e përgjithshme është se studentët përpiqen t’i zotërojnë dhe t’i zbatojnë njohuritë për normën drejtshkrimore.

#### **f. Kundrime gramatikore të studentëve sipas variablit *mjedis administrativ***

Me gjithë përpjekjet e suksesshme për përdorimin e standardit vihen re edhe dukuri dialektore. Kjo tregon se te një pjesë e studentëve të anketuar njohuritë nuk janë ngulitur, nuk janë bërë shprehi të qëndrueshme. Duhet theksuar se kjo gjuhë e normuar sipas rregullave dialektore i shërben një komuniteti të caktuar. Prurjet e shumta të studentëve në qendrat universitare i kanë sjellë një përthyerje të ndjeshme normës letrare, sikurse në qendrat rurale duket një përforcim i dialekteve.

Kështu, shumëllojshmëria e mjeteve të shprehjes, e gjuhëve të shumta të lëvruara brenda një komuniteti, e përdoruesve të tyre kanë rënë në një shkujdesje dhe deformim të standardit.

Këto ndryshime rrënjësore të rrafshit leksikor, fonetik, morfologjik, sintaksor e pasurojnë gjuhën me prurje produktive, por njëkohësisht shumë elemente të këtyre ndryshimeve e dëmtojnë atë.

Po të shtrohet pyetja: *në ç' nivel është kultura gjuhësore e studentëve tanë?* Mendojmë se mund të përgjigjemi se ajo është larg nivelit të dëshiruar.

### **7. f.1 Shpeshherë hetohen edhe shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore), si p.sh.:**

(1) Përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore te emrat e gjinisë femërore. Gabojnë te shumësi i emrave gati 42 % e studentëve.

(2) Gabime në përdorimin e nyjës;

(3) Përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën *të*;

(4) Përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me *-e* dhe *-ra*;

(5) E pakryera veprorë e foljeve ndonjëherë dëgjohet e shkruhet në formë sigmatike (punojsha) në vend të formës josigmatike (punoja);

(6) Dëgjohen edhe pjesoret e foljeve pa mbaresa: (kam) *lexu.*, *shku.*, *shkru:etj*;

(7) Mjaft shpesh gabohet në përdorimin e formës standarde të lidhore, sepse ose në vend të /ë/-së përdoret /e/-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës së tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh.: (thuhet) *të shkojë* ose *të shkon*, *të punojë* ose *të punon*, *të mësojë* ose *të mëson* (<duhet të shkojë, të punojë, të mësojë) etj.

(8) Përdorimi i gabuar i kallëzuesit të përbërë foljor me strukturën folje gjysmëndihmëse *duhet+pjesore*, ndjekur nga një emër a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë, pra ndërtimi përsor foljor merr një kundrinë të drejtë. P.sh.: *do ta kërkosh brenda apo do të dalësh jashtë*.

Tipare dhe gabime të tjera gramatikore do të ishin: ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku përshtjellohet mendimi deri në moskuptim.

Ndikime nga gjuhët e huaja shihen edhe në rendin e fjalëve. Rendi i zakonshëm i shqipes në fjalinë kryesore është kryefjalë-kallëzues, në fjalitë e varura rendi i zakonshëm është kallëzues-kryefjalë<sup>348</sup>. Ndërkaq, në ditët e sotme nën ndikimin e gjuhëve të huaja rendi i fjalëve kryefjalë-kallëzues po merr përparësi edhe në fjalitë e

---

<sup>348</sup> Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 235.

varura, kryesisht filluese. Në ligjërimin bisedor, por edhe në atë të lirë, gjithmonë e më shpesh dëgjohen ndërtime si: *siç shokët kanë kërkuar, se sa Miri kishte folur...nuk e dinim, etj*, prirje që shkon deri në një renditje të panatyrshme të fjalëve, si p.sh.: *kur Genta, si të gjithë i thoshim ne*, në vend të rendit të zakonshëm: *si i thoshnim ne të gjithë*.

Nuk mungojnë rastet kur struktura gramatikore të italishtes dhe anglishtes huazohen në shqip sikurse janë në gjuhën e origjinës, si: *Good for you!* në shqip përdoret sipas përkthimit fjalë për fjalë *Mirë për ty!*, ndërkohë që varianti më i përshtatësh në shqip do të ishte ekuivalentja *Kjo të bën mirë!*

Gjithashtu, vihet re një rend i përmbysur i fjalëve në togfjalësha, nën ndikimin e anglishtes, ku përcaktori vendoset para emrit të përcaktuar, si *Tini figura*.

Fjalitë dhe frazat e gjymtuara nga ana kuptimore, fillimi i shprehjes së mendimit me fjali të varura pa fjalinë drejtuese për të përmyllur mendimin si rrjedhojë e mosnjohjes së sintaksës.

Sikundër është përmendur më lartë, ndërtimet morfo-sintaksore nuk ndikojnë vetëm strukturën e brendshme të shprehjes apo fjalisë, por në shumë raste ato kushtëzojnë kuptimin e tyre duke krijuar efekte konotative. Të tilla janë:

*“Ditë me diell”* - kjo është një shprehje emërore e përbërë nga emri *ditë* në rasën emërore në trajtën e pashquar dhe emri i rasës kallëzore *me diell*. Kjo shprehje përdoret në kuptim figurativ sepse cilëson një situatë argëtuese, qesharake, humoristike.

*“Do lëshohemi një xhiro”* - kjo shprehje është tipike e ligjërimin të shkujdesur. Kjo gjë dëshmohet prej përdorimit të foljes *lëshohemi* në vend të foljes *dalim*. Edhe pse vihet re tendenca e krijimit të fjalëve të reja apo zëvendësimit të disa fjalëve me disa të tjera, ajo çka ndikohet nga e gjithë kjo veprimtari gramatikore është kuptimi që kjo shprehje mbart dhe përcjell që i përngjan një ofertë ose një sugjerimi duke qënë se kuptimi i saj i drejtpërdrejtë është do dalim një xhiro? Kjo shprehje mund të konsiderohet si individuale po aq sa edhe sociale, pra përdoret dhe kuptohet lehtësisht prej grupit shoqëror të cilit një student i përket.

*“Hajt se folim”* -një shprehje tipike e ligjërimin të shkujdesur, ku vihet re një devijim ndaj rregullave gramatikore sepse folja *folim* duhet të shprehet në formën *flasim*; përse i përket anës leksikore kjo shprehje përdoret për të shmangur bisedën për të anashkaluar bashkëbiseduesin.

*“Tip delikat”* -një shprehje e përbërë nga dy fjalë emër + mbiemër, të cilat përdoren me ironi për një person që ka pretendime.

*“Çun me botë”* - shprehje shumë e përdorshme e përbërë nga emër + parafjalë + emër, e cila vjen në formën e një komplimenti për dikë që është i zgjuar.

“*Jashtë orbite*“ - shprehja përbëhet nga dy fjalë: ndajfolje + emër; e cila ka kuptimin për dikë që është jashtë bisedës.

“*Dashnor i /e rregullt*“ - është një shprehje e cila përbëhet nga emër + mbiemër dhe vjen në formën e ironisë, e cila ka kuptimin për dikë që ka dy lidhje njëkohësisht.

“*Angazhohu në jetë*“ - është një shprehje e përbërë nga emër + folje, e cila vjen në formën e një këshille, me kuptimin që të marrin iniciativën dhe të jenë më të organizuar.

“*Të shqej*” – nga ana gramatikore si fjalë është e saktë, hyn tek grupi i foljeve. Nga ana kuptimore është fjalë lehtësisht e kuptueshme nga çdo grup shoqëror dhe përdoret për të shprehur kërcënim.

“*Të thyej në mes*” - nga ana gramatikore si fjalë është e saktë, hyn tek shprehjet foljore. Nga ana kuptimore është fjalë që kuptohet lehtësisht nga çdo individ. Përdoret për të treguar fortësin.

“*Më iku truri*” - nga ana gramatikore si fjalë është e saktë hyn tek metaforat. Nga ana kuptimore si fjalë është e kuptueshme nga çdo individ. Është një mënyrë për të treguar sa i shqetësuar je.

“*Është mos ta kesh as në qytet*” – është e saktë nga ana gramatikore. Nga ana kuptimore nuk është lehtësisht e kuptueshme nga çdo individ, përdoret më tepër si kod në mes një grupi shoqëror.

Gjithsesi, situata e sotme gjuhësore sillet mjaft problematike në lidhje me fushën e zbatimit të kulturës gjuhësore. Jo në çdo aspekt të përdorimit të vet gjuha njeh saktësinë dhe normativitetin standard.

## **Përfundime**

Gjithsesi, situata e sotme gjuhësore sillet mjaft problematike në lidhje me fushën e zbatimit të kulturës gjuhësore. Jo në çdo aspekt të përdorimit të vet gjuha njeh saktësinë dhe normativitetin standard.

Struktura sintaksore e gjuhës letrare nuk ka dallime të rëndësishme as nga struktura sintaksore e varianteve letrare dialektore, as nga sturuktura e të folmeve të veçanta. Ndryshimi i vetëm i rëndësishëm me dialektin e Veriut është mungesa e ndërtimeve me paskajore të tipit “me punue” në gjuhën letrare<sup>349</sup>.

Sipas, S. Mansaku (2003:109), kufiri midis normës dhe jonormës në sintaksë dhe në leksik nuk është aq i përcaktuar sa në drejtshkrim dhe në morfologji. Lëvizjet nga

---

<sup>349</sup> Totoni, M., *Struktura sintaksore e gjuhës letrare shqipe dhe probleme të normës së saj*, Tiranë, 1992, f. 106.

Jonorma te norma janë më të zakonshme në sintakse dhe në leksik. Gjithashtu, edhe rregullat që përcaktojnë normën sintaksore nuk mund të jenë aq të prera sa në morfologji dhe në drejtshkrim. Ndërkohë, këto rregulla sado të plota të jenë, është e vështirë të mbulojnë gamën e gjerë të përdorimeve sintaksore dhe të lëvizjeve semantike që kushtëzohen nga faktorë të shumtë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Gjithashtu, janë të shpeshta ndërtimet sintaksore të gabuara: përdoren një ndërtim në vend të një tjetri, vendosen gjymtyrët në rend të gabuar, përdoret një strukturë e cunguar, përdoren konstrukte të huaja, përdoren gabim shenjat e pikësimit. Këto raste e të tjera si këto dëshmojnë për një varfëri në shprehje e njohje të mirë të normës gjuhësore.

Një grup tjetër shmangiesh nga norma, të cilat u kundërvihen kodeve ekzistuese duke shprehur një prirje të re në gjuhë (nuk i përkasin vetëm bashkësisë gjuhësore të studentëve, por të rinjve shqiptarë në përgjithësi) janë shmangiet gramatikore në të folur e në të shkruar, të cilat nga ndonjëherë kushtëzohen nga prurjet e reja në gjuhë, nga huazimet e ndryshme, sidomos nga anglishtja e italishtja, etj., por së shumti nga moszotërimi i njohurive shkencore dhe normative. Të tilla janë: përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës *i* për shumësin *u*; mospërdorimi i të ashtuquajturave “nyja të përparme”; përdorimi i numërorit *tre* edhe për femëroren *tri*; etj. Nga këto si shkelje të papranueshme e që duhen së paku ndryshuar janë përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës për shumësin, mospërdorimi “i nyjave të përparme” etj.

Shmangiet kanë origjinë të ndryshme, disa kanë prejardhje dialektore e këto janë tipike e me shtrirje të gjerë dhe më të qëndrueshme<sup>350</sup>, disa janë rezultat i prurjeve nga fusha e teknologjisë, etj., shumica e tyre janë thjesht gabime gjuhësore dhe përdoren si pasojë e mosnjohjes së kodeve dhe e mos zbatimit të tyre nga padituria. Shmangiet në gjuhë mënjanoohen kryesisht nëpërmjet zotërimit të standardit dhe kodeve të tij.

Gjithashtu, në fushën e sintaksës vepron edhe dukuria e sinonimisë: kuptime të njëjta sintaksore ose afërsisht të njëjta shprehen me ndërtime të tipave të ndryshëm, si gjymtyrë fjalie, me gjymtyrë të veçuara, me fjali të tipave të ndryshëm (asidentike me bashkërenditje ose me nënrenditje).

Krahas sinonimisë, në sintaksë vepron edhe dukuria e homonimisë. Një strukturë mund të japë dy interpretime: fjalitë përcaktore me përemrin lidhor *që* mund të shprehin edhe marrëdhënie përcaktore dalluese-kufizuese, edhe marrëdhënie përcaktore shtjelluese-shtesore. Nëse gjatë realizimit të kësaj strukture kuptimi është lehtësisht i kapshëm, kjo është e mundur në sajtë të të dhënave që na jep konteksti ose situata dhe të pranisë a të mungesës së pauzës para përemrit lidhor<sup>351</sup>.

Mund të thuhet se varianti i folur i gjuhës së studentëve del plot me ndryshore, të cilët janë shumë të theksuar, dhe duke u bazuar në tiparet e tyre mund të kuptohet

---

<sup>350</sup> Çeliku, S., *Shmangie në fushë të gramatikës e drejtëshkrimit në ...*, Tiranë, 2003, f. 182.

<sup>351</sup> Totoni, M., *Struktura sintaksore e gjuhës letrare shqipe dhe probleme të normës së saj*, Tiranë, 1992, f. 109.

përkatësia rajonale e folësve. Norma standarde (drejtshkrimore e drejtshqiptimore) asnjëherë nuk ushtrohet dot automatikisht mbi gjithçka që shkruhet, dhe aq më pak mbi të folurit<sup>352</sup>.

Zhargoni studentor, tashmë shfaqet si një “gjuhë” që pritet të anashkalojë gjuhën standarde. Ai përcakton në një masë të madhe normën gjuhësore, pasi pasqyron edhe prirjet e kulturës së sotme gjuhësore shqiptare<sup>353</sup>. Shmangiet e shkeljet në rrafshin gramatikor, sidomos sintaksor, përkeqësojnë pamjen gjuhësore të studentëve. Në ligjërimin bisedor të studentëve stilemat janë të qëndrueshme, por duke u bashkuar shprehja emocionale dhe vlerësimi subjektiv ndodh një thyerje karakteristike e rregullave të sintaksës. Në rrjedhën e përditshme të ligjërimin të folur dhe të shkruar sintagma të caktuara me përbërje semantike dhe në kushte morfo-sintaksore të veçanta, shndërrohen në mjete të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore<sup>354</sup>.

Përcaktimi i karakteristikave gramatikore u bazua në pesë drejtime kryesore: (1) te gjatësia dhe lloji i fjalisë, (2) te ndërtimet aktive e pasive, (3) te shprehjet emërore / foljore, (4) te përcaktorët, (5) te rastet kur kuptimet e fjalive ndikohen nga ndërtimi gramatikor.

Lloji i fjalive: shpeshtia dhe kompleksiteti i ndërtimit të thënies.

(i) Llojet e fjalive.

|                            |      |
|----------------------------|------|
| a. Fjali të thjeshta       | 38 % |
| b. Fjali të përbëra        | 42 % |
| b. 1 dy pjesë përbërëse    | 33 % |
| b. 2 tre pjesë përbërëse   | 19 % |
| b. 3 katër pjesë përbërëse | 6 %  |
| b. 4 pesë pjesë përbërëse  | 4 %  |

(i) Numri i fjalëve

|                           |      |
|---------------------------|------|
| 1. Fjali me 8 fjalë       | 27 % |
| 2. Fjali me 9 - 16 fjalë  | 28 % |
| 3. Fjali me 17 - 24 fjalë | 17 % |
| 4. Fjali me 25 -32 fjalë  | 11%  |
| 5. Fjali me 33 – 40 fjalë | 8 %  |
| 6. Fjali me 40 – fjalë    | 5 %  |

<sup>352</sup> Lloshi, Xh., *Variacioni dhe norma drejtshkrimore*, Tiranë, 1992, f. 249.

<sup>353</sup> Stavri, J. D., *Shqipja standard në epokën dixhitale, prirje, mjete dhe teknologji te reja gjuhësore* (2), Tiranë, 2012, f. 5.

<sup>354</sup> Sulejmani, F., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë, 2003, f. 113.

- (ii) Fjalë që pozicionohen në fillim të fjalisë.
- |                         |      |
|-------------------------|------|
| 1. Kryefjalë            | 15 % |
| 2. Shprehje parafjalore | 11 % |
| 3. Ndajfolje            | 9 %  |
| 4. Fjalët theksuese     | 10 % |
| 5. Folje                | 55 % |
- (iii) Llojet dhe shpeshia e përdorimit të shprehjeve emërore / kallzuesore
- |  |      |
|--|------|
| a. përemrat lidhorë <i>që</i> dhe përemrat pyetës <i>kush, çfarë, sa</i> , që funksionojnë si përemra lidhorë. | 37 % |
| b. paskajorja  | 45 % |
| c. pjesët e nënrenditura   | 34 % |
- 2 Trajtat aktive dhe pasive.
- (i) Trajtat aktive 85 %
- |                        |      |
|------------------------|------|
| a. Lloji i fjalive     |      |
| a.1 folje kalimtare    | 73 % |
| a. 2 folje jokalimtare | 27 % |
- (ii) Ndërtimet aktive me folje ndihmëse
- c. Shpeshia e përdorimit të foljeve ndihmëse:
- |  |      |
|--|------|
| a.1 kam  |      |
| a. 1.1 mën. dëftore, e tashme dhe e pakryer.       | 56 % |
| a. 1. 2 mën. lidhore, e tashme dhe e pakryer, etj. | 46 % |
| a. 2 jam   |      |
| a. 2. 1 mën. dëftore, e tashme dhe e pakryer.      | 63 % |
| a. 2. 2 mën. lidhore, e tashme dhe e pakryer, etj. | 37 % |
- (iii) Shpeshia e përdorimit të kohëve të foljeve
- |                         |      |
|-------------------------|------|
| a. E tashmja e thjeshtë | 48 % |
| b. E shkuara            | 37 % |
| c. E kryera             | 8 %  |
| d. Më se e kryera       | 3 %  |
| e. E ardhmja            | 42 % |
- 3 Përdorimi i përcaktorëve, para dhe pas emrit
- |   |      |
|---|------|
| (i) Mbiemrat që qëndrojnë para emrit                  | 47 % |
| (ii) mbiemri në rasën emërore të pashquar ka përdorim |      |

---

|   |      |
|---|------|
| të gjerë në ligjërimin bisedor                                | 39 % |
| (iii) përcaktori si pjesë gjymtyre:                           |      |
| a. Pjesorja e tashme  | 52 % |
| b. Pjesorja e shkuar  | 48 % |
| 4 Ndërtimi sintaksor dhe ndikimi i tij në kuptimin e fjalisë. |      |
| (i) ndërtime të paqarta                                       | 60 % |
| (ii) interpretime të paqarta të foljeve ndihmëse              | 21 % |
| (iii) përdorimi i lidhore                                     | 34 % |
| (iv) Shprehjet që shprehin dëshirë                            | 58 % |
| (v) Përdorimi i ligjëratës së drejtë.                         | 46 % |
| (vi) Fjalitë kushtore.  | 34 % |

Analizimi i tipareve të lartpërmendura nxjerr në pah këto elemente interesante  
a. mbizotërojnë ndërtimet aktive dhe lidhore,

b. shumica e shembujve paraqiten si shprehje foljore të shoqëruar nga kundrinorë e përcaktore.

Në përmbyllje, vlejné fjalët e studiuesit Xh. Lloshit se “Njësia e gjuhës shqipe sipas një norme standarde është e domosdoshme, që ajo të luajë rolin shoqëror e kulturor. Variacioni është i pranishëm dhe i domosdoshëm për ekzistencën e gjuhës. Një shoqëri e përparuar ka një shumësi mënyrash përdorimi të gjuhës. Asnjë bashkësi folësish dhe asnjë njeri nuk e kufizon repertorin e vet me një mënyrë të vetme gjuhësore, që nuk do t’i lejonte të shprehte me gjallërinë e thellësinë njerëzore gjendjen e qëndrimit, interesat e parapëlqimet, veçantinë e prirjet krijuese. Bashkëpunimi dhe ndeshja e njësisë dhe ndryshueshmërisë, është forcë lëvize e zhvillimit të e lëvrimin të gjuhës.”<sup>355</sup>

Në këtë këndvështrim shihet edhe ligjërimi studentor në Universitetin e Vlorës.

---

<sup>355</sup> Lloshi, Xh., *Variacioni dhe norma drejtshkrimore*, Tiranë, 1992, f. 248-249.

## **Përfundime**

---

1. Gjuha shqipe në ditët e sotme funksionon përmes varianteve topike (dialekteve dhe të folmeve krahinore) e stratike (të folmeve shoqërore). Një nga këtë variante është dhe shqipja standarde. Ajo shfaqet si *sistem* (që nënkupton qëndrueshmërinë), por edhe si *proces* (që nënkupton zhvillimin). Ky variant ka një prestigj të ndryshëm nga të tjerët dhe priret që të shtrihet e të zotërohet sa më shumë si horizontalisht (në gjithë hapësirën shqipfolëse, por edhe në hapësirat ku jetojnë shqiptarët për arsye emigrimi etj.) ashtu dhe vertikalisht (në të gjitha shtresat e shoqërisë). Në të njëjtën kohë ai bashkëvepron me të gjitha variantet e tjera, qofshin gjeografike qofshin shoqërore, ushtron trysni ndaj tyre e njëkohësisht merr në vazhdimësi prej tyre njësi të të gjitha rrafshëve. Ai pasurohet në mënyrë të jashtëzakonshme me njësi të reja, sidomos me fjalë nga letërsia artistike, nga sistemet terminologjike, nga procesi i fjalëformimit për të shënuar nocione e konceptet të reja, por edhe për të përballuar e zëvendësuar fjalët e huaja të panevojshme. Gjithashtu, me të drejtë pohohet se standardi është dhe duhet të jetë më i hapur ndaj dialekteve, të pranojë prej tyre çdo gjë që nuk bie ndesh me sistemin e saj, çdo gjë që integrohet në mënyrë të natyrshme dhe e pasuron atë. Asnjëri nga dialektet nuk i ka shteruar mundësitë e tij shprehëse, nuk ka vënë në qarkullim të gjithë pasurinë leksikore, frazeologjike dhe ndërtimet sintaksore, përdorimi i dialekteve në sfera dhe funksione të caktuara do ta pasuronte gjuhën standarde.

2. Shqipja standarde ka problemet e gjuhëve të tjera standard, si:

**Qëndrimi** ndaj fjalëve të huaja, veçanërisht ndaj termave tekniko-shkencorë e të tjerë, masa e të cilave është shumë e madhe dhe trysnia shumë e fortë. Gjuhët e huaja fliten në masë, sidomos prej rinisë. Zotërimi i këtyre gjuhëve, pa njohur mirë strukturën dhe vlerat e shqipes, ka pasoja sepse shpesh e vë në pozitë të vështirë, duke i kërcënuar së pari funksionin emërtuese e shprehës. Kjo trysni duket te vërshimi i të fjalëve të huaja, të cilat mund të kenë hyrë sidomos nga anglishtja ose italishtja, etj, duke ia zënë frymën shqipes. Shumë studiues shqiptarë i cilësojnë një pjesë të madhe të këtyre fjalëve si të panevojshme të cilat duhen zëvendësuar me fjalët shqipe ekzistuese.

**Nevoja** për një zgjerim të vazhdueshëm të fjalësit dhe pasurimin e gjithanshëm të gjuhës jo vetëm me elemente gjuhësore, po edhe me zgjerimin e të ashtuquajturave

çerdhe fjalësh dhe me dallimin e qartë të regjistrave të fjalëve; për emërtime të reja; për fjalë, shprehje a mënyra të thëni që shprehin botën shpirtërore të njeriut.

**Një kërkesë** e vazhdueshme që qëndron para shqipes së sotme është zgjerimi i hapësirave në fushë të fjalëformimit, po edhe në fushë të krijimit të modeleve të togfjalëshave e të ndërtimit të marrëdhënieve sintaksore për të shprehur një botë gjithnjë më të pasur e më të ndërlikuar, në stile të ndryshme.

Pasurimi i gjuhës shqipe është një proces ligjësor objektiv, në të cilin marrin pjesë të gjitha shtresat sociale.

3. Procesi i funksionimit dhe i nxënies së standardit shoqërohet me dukuri të shumta gjuhësore të përcaktuara nga faktorë socialë, gjeografikë, gjinorë, ekonomikë, politikë, fetarë, profesionalë etj. Mjedise të ndryshme bëhen tregues të këtyre zhvillimeve. Një mjedis i tillë është edhe Universiteti i Vlorës në të cilin punimi ynë është ndalur për të parë dukuri, zhvillime por edhe prirje gjuhësore të vëzhguara nga ana sociolinguistike, etnolinguistike, psikolinguistike, dialektologjike. Gjithçka u pa në marrëdhënie me standardin si variant i shqipe që mundëson edhe identifikimin por edhe homogjenizimin tonë e kompaktësimin e shqiptarëve si komb.

Gj. Shkurtaç pohon se *në çdo komb a gjuhë kombëtare të caktuar, ka aq variante e idiolekte sa janë realisht folësit e një gjuhë të marrë në studim*, shumëzuar për aq lloje e nënloje variantesh sa janë rastet e ligjërimeve që ndjekin parimin tashmë të njohur të sociologut Joshua Fishman: kush flet, me kë, kur, ku për çfarë.

4. Kultura rinore është nën një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe gjuha siguron të gjitha mjetet e duhura linguistike dhe stilistikore për të pasqyruar këto ndryshime.

Gjuha është në lëvizje e pasurim të pandërprerë. Ne e përdorim dhe përshtatim atë sipas qëllimeve tona, përpunojmë material, theksojmë, krijojmë gjëra të reja. Anëtarët e komuniteteve gjuhësore sjellin risi në drejtime të ndryshme: bëjnë gjëra të reja dhe krijojnë mënyra të reja të folurit për këto risi. Fati, pra jetëgjatësia, e prurjeve të reja varet nga statusi i krijuesit të tyre në shoqëri.

Si rezultat, stilet dhe situatat ligjërimore ndryshojnë vazhdimisht. Gjuha merr forma dhe përdorime të reja, duke qenë se përdoruesit më krijues e entuziastë janë të rinjtë, ka të ngjarë që identitetet kulturore të kenë lidhje me këtë grupmoshë. Ndonëse, ligjërimi akademik është një ndër tiparet kryesore në institucionet universitare, gjuha e studentëve jashtë auditorit nuk mund t'i shmanget aspektit bisedor dhe deri diku të shkujdesur, aspekt ky i cili po shtrihet gjerësisht në ambientet jashtë auditorëve.

5. Në një mjedis universitar, si ai Vlorës mund t'i vëresh **diferencat gjuhësore sipas ndryshoreve të ndryshëm sociolinguistikë:**

**Gjinia** duke qenë një nga ndryshoret më të dallueshëm në komunikim, është një faktor që ndikon shumë në ligjërim studentor, pavarësisht nëse studimi bazohet në sjelljet verbale, shoqërore, mendore, emocionale apo fizike të folësve.

Duke u bazuar në materialin e mbledhur për këtë çështje dhe në analizimin e tij, u pa se marrëdhënia gjuhë-gjini shpërfaq dukuri interesante në drejtimet:

- ✓ Përkatësia në stilet e ligjërimit bisedor-ndërgjinor.
- ✓ Përkatësia gjinore e folësit.
- ✓ Lënda e sjellë tregon se si gjuha zbulon, mishëron dhe mbështet sjellje gjuhësore dhe qëndrime të kushtëzuara nga përkatësia gjinore.
- ✓ Përdoruesit e gjuhës flasin në mënyra të ndryshme dhe të veçanta që pasqyrojnë përkatësinë gjinore të tyre.

Vëzhgimet, anketimet etj si dhe studimi i tyre tregojnë se:

- Studentet vajza flasin më shumë se meshkujt, janë më të sjellshme, të pavendosura / në mëdyshje, ankohen më shumë, bëjnë shumë pyetje, dhe janë më bashkëpunuese;
- Student djem betohen më shumë, nuk flasin për ndjenjat, flasin më shumë për sportin, për vajzat dhe makinat në të njëjtën mënyrë, fyejnë shpesh njëri-tjetrin, janë konkurrues në bisedë, dominojnë bisedën, flasin me më shumë autoritet, japin më shumë komanda, ndërpresin më shumë në bisedë.
- Disa prej këtyre konkluzioneve janë përshkrime objektive, disa prej tyre të pabazuara edhe jo-gjuhësore.

6. Rezultatet e studimit me studentët (meshkuj dhe femra), në Universitetin e Vlorës nxorën në pah katër dukuri në kontrast me njëra-tjetrën. Ato janë:

- Pavarësi *përkundrejt* Intimitet
- Informacion *përkundrejt* Ndjenja
- Urdhëra *përkundrejt* Propozime
- Konflikt *përkundrejt* Kompromis

7. Ligjërimi i vajzave karakterizohet më tepër nga:

Përdorimi i frazave shpjeguese dhe modifikuese, duke përdorur fjalë si: *domethënë, kështu pra, ashtu, duket siku*, etj.

Përdorimi i tepruar i mbiemrave zbukurues: *fantastike, i bukur, i madh fare*.

Përdorimi i deklaratave të drejtpërdrejta. Meshkujt i perifrazojnë mendimet në mënyrë më të tërthortë.

Përdorimi i leksikut të veçantë: femrat përdorin më shumë fjalë për gjëra të tilla, si emocionet, ndërsa djemtë përdorin më shumë fjalë për sportet e ndryshme.

Përdorimi i shprehjeve tepër të zbukuruara, por edhe i fjalive ku shprehet mosbesim.

Kërkojnë më shumë të falur: (për shembull, "Më vjen keq, por mendoj se...")

Përdorimi i ndërtimeve modale: (të tilla si, mund të, do, duhet, duhet- "A duhet të dalim tani?")

Përdorimi i përforcuesve më veçanërisht kështu dhe shumë (për shembull, "Jam shumë / aq e kënaqur që erdhët!")

Psherëtitjnë e mallkojnë më shumë se djemtë: *të hëngërt mortja!; u kanceri..!*

Përdorin më shumë shprehje zbuluese e përkëdhelëse se djemtë.

8. Në bisedat midis studentëve të së njëjtës gjini, por edhe në bisedat ndërgjinore, vihet re përdorimi i shpeshtë i fjalëve dhe shprehjeve të huaja, sidomos nga gjuha angleze dhe italiane. Disa nga arsyet e përdorimit të këtij leksiku janë sidomos prirja (tendenca) e kohës dhe ndikimi nga shoqëria.

Në lidhje me tematikat e bisedave, vërehet se djemtë flasin dhe përdorin më shumë terma *për para ose punë, për femrat, makinat, futbollin, për thashetheme të ndryshme, për cigaret, televizionin, çështjet aktuale, shtëpinë* etj.; ndërsa vajzat flasin më shumë *për dhe rreth rrobave, paraqitjes së jashtme, për meshkujt, për thashetheme të ndryshme, për shtëpinë, televizionin, për punën, çështjet aktuale, futbollin.*

Ligjërimi femëror thekson gjendjet psikologjike e sociale. Ligjërimi mashkullor thekson çështjet e përditshme që i shqetësojnë ata.

9. Ndryshimet në të folurin gjinor rrjedhin nga koncepti që vajzat dhe djemtë kanë për komunikimit. Djemtë e konsiderojnë komunikimin si një mjet që shërben për të shkëmbyer informacion, domethënë, ata flasin kur kanë diçka për të thënë, kur duan të arrijnë një qëllim të caktuar, i kushtojnë më pak rëndësi anës afektive të të folurit dhe nuk japin shumë hollësira rreth çështjes. Vajzat përdorin komunikimin për të krijuar lidhje me të tjerët, për të diskutuar rreth një çështjeje në të cilën mbizotëron aspekti emocionues dhe të treguarit e hollësishëm të çështjes.

10. Tiparet e ligjërimin të vajzave kushtëzohen apo diktohen nga mjedisi social-kulturor ku ato jetojnë dhe arsimimi i tyre, prandaj është e nevojshme njohja e zakoneve, e traditave dhe botëkuptimit, sepse vetëm kështu do të nxirren në pah tiparet ligjërimore, eufemizmat, tabutë etj, të ligjërimin femëror.

Duke iu referuar *Diferencave sipas ndryshorit mjedis familjar dhe klasë ekonomike*, studentët e Universitetit "Ismail Qemali", pohuan se në familjet e tyre përdoren fjalë dhe shprehje që janë tipike të rrethit të ngushtë familjar, por këto fjalë dhe shprehje nuk mund të cilësohen si neologjizma. Janë shumë të pakta krijimet leksikore brenda familjes. Gjuha familjare, më shumti, përbëhet nga fjalë, shprehje, apo proverba që janë të njohura edhe për të tjerët, sikurse janë krahina apo qyteti në të cilin ata jetojnë.

Porse, në ligjërimin familjar shqiptar neologjizmat janë të pakta, komunikimi realizohet nëpërmjet fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese. Ndonëse, nuk mungojnë edhe rastet kur “gjuha” familjare u bashkëngjitet kuptime të tjera fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese. Pra, *gjuha e përdorur në familje fiton deri diku tiparin e fshehtësisë*.

Në anketën e zhvilluar me studentët e Universitetit të Vlorës, u arritën këto përfundime:

Në familje në të shumtën e rasteve flitet në dialekt për arsye se vendet prej ku vijnë ata i përkasin një shtrirjeje gjeografike ku i gjithë rrethi flet në dialekt.

Edhe pse preferojnë të flasin në dialekt, studentët janë kundër mësimit apo favorizimit të dialektit në universitet.

Zakonisht shumica e studentëve preferojnë që në familje ta ruajnë kulturën tradicionale duke përdorur në çdo situatë gjuhën e rrethit (dialektin).

Një pakicë e vogël e “studentëve e shohin gjuhën standarde si një mjet të domosdoshëm për t’u paraqitur sa më denjësisht në shoqëri”.

11. Në më të shumtën e rasteve familja dhe farefisi i një studenti flasin në dialekt. Vërehet se edhe studentët preferojnë që në familje të ruajnë traditën gjuhësore – kulturore. Po kështu, edhe në komunikimet joformale me njëri – tjetrin studentët preferojnë të flasin në dialekt. Për pasojë, dallimet individuale të përdorimit të gjuhës ndikohen nga mjedisi familjar dhe më pas ai shoqëror. Dallimi më i madh social është ai midis gjuhës së individit në varësi të klasës apo shtresës sociale të familjes.

Variacioni në gjuhë shfaqet më tepër në fushën e fonetikës, të leksikut (në përzgjedhjen e fjalëve), por edhe në ndërtimet gramatikore të veçanta, sidomos ato nën ndikimin e gjuhëve të huaja.

Lebovi, në studimet sociolinguistike, ka vënë re se sa më cilësor të jetë arsimi i një vendi, aq më i vogël do të jetë dallimi midis variantit të gjuhës standarde dhe variantit të folur joformal. Nga ky konstatim del roli i edukimit gjuhësor që në ciklet e fillores dhe kultivimi i tij në të gjitha stadet e studimit.

12. Duke iu referuar *diferencave gjuhësore sipas ndryshorit mjedis administrativ*, studentët e Universitetit të Vlorës, në ligjërimin bisedor por edhe në atë akademik, shfaqin ngjyrimet e të folmeve tradicionale. Këto dallime nuk janë leksikore e kuptimore për fjalët gjegjëse të gjuhës standarde, por dalin si dallime fonetike dialektore.

Fjalët dhe shprehjet e vendlindjes përdoren në një shkallë të madhe brenda grupit të ngushtë shoqëror ose me studentë që vijnë nga i njëjti mjedis administrativ. Porse, leksiku vendor përdoret më pak kur komunikohet me studentët që u përkasin vendeve dhe kulturave të tjera. Elementet fonetike dhe forma sinonimike për të njëjtin objekt apo dukuri etj., hasen më tepër në bisedat ndërkulturore. Ky tipar vërehet më tepër në ligjërimin e studentëve të vitit të parë, pasi gjatë viteve të studimit, studentët i

përshtaten mjaftueshëm ligjërimin standard, duke shmangur edhe keqkuptimet që vijnë si rezultat i dallimeve ligjërimore.

Ndryshimet fonetike shfaqen edhe në artikullimin e fjalëve të reja, të cilat janë krijuar si rezultat i këtyre zhvillimeve dëgjohen rëndom fjalë në variantet dialektore, si: *softuar* (software), *antori i grupit* (për: anëtari i grupit), *daunlotu* (download) etj. Ndërkohë, zotërimi i mirë i varietetit standard zhvillon aftësitë komunikuese për qëllime të ndryshme dhe jep mundësi të gjithanshme për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të studentëve, si dhe për vetë formimin e personalitetit të tyre.

13. Shumë interesante në mjedisin universitar vlonjat dalin edhe *Taktikat e ligjërimin studentor*. Së pari veçohen përdorimi i Zbunimeve dhe i përkëdhelie. Disa nga motivet e përdorimit të këtyre dukurive, sidomos të zbunimit janë:

Shmangia e emrave të gjatë apo të vështirë për t'u shqiptuar në të folurin e shpejtë.

Mënjanimi i dy emrave vetjakë të njëjtë brenda grupit shoqëror. Zbukurimi apo riemërimi i emrave që bazohen në besëtytni të ndryshme.

Riemërimi në rastet e përdorimit të emrave të vjetër ose bazuar në besëtytni të ndryshme prej të cilave burojnë një sërë emrash përcmues e keqësues për vajzat, por edhe për djemtë.

Mashkullorizim i emrave për përkëdheli (duke u bazuar thjesht në shkurtim apo cilësi e personit). Gjatë procesit të zbunimit të emrave përdoren dendur edhe nofkat apo sharjet dashamirëse.

Emrat vetjak mund të kenë më shumë se trajtën zyrtare ose dhe ndodh që trajtat e dyta kthehen në trajtën kryesore të identifikimit të personit. Ky zëvendësim i trajtës së parë me trajtën e dytë ndodh vetëm në situatat joformale dhe ambientet tepër familjare.

Mund të ndodh që trajtat e dyta të emrave vetjakë të mos kenë asnjë lidhje me trajtat e para: krijohen me prapashtesa trajta të dyta të emrave vetjakë, krijohen trajta të dyta që vijnë nga shkurtimi i trajtave të para pa ndonjë ndërrim tjetër tingullor.

14. Hetimet dhe hulumtimet e kryera në bashkësinë shoqërore të studentëve, dhe përkatësisht në grupet e ngushta shoqërore nxorën në pah shembuj të shumtë të dukurisë së zbunimit dhe taktikave të tjera ligjërimore, të cilat përdoren si shprehje e qëndrimit subjektiv të folësit ndaj një shoku / shoqeje të afërt. Larmia dhe varieteti gjuhësor i studentëve si entitet gjuhësor tashmë i afirmuar paraqet katër elemente lidhur me raportin e gjuhës shqipe dhe bashkësisë shoqërore që e përdor atë:

Grupe të ndryshme studentore përdorin lloje ose variante të ndryshme gjuhe.

Në situata të ndryshme, të njëjtët individë përdorin lloje a varietete të ndryshme të gjuhës shqipe.

Gjuha pasqyron njeriun që e përdor, pasqyron gjurmët e përvojës dhe të përjetimeve të tij.

Gjuha e formon shoqërinë në të cilën është përdorur.

15. Ligjërimi studentor kushtëzohet nga disa ndryshore sociolinguistik, si *gjinia, mjedisi familjar e administrativ, mosha*, të cilët të çojnë te larmia e të folurit me plot kodëzime (“*peer groups*”, “*baby talk*”), te shndërrimet semantike të fjalëve nga motive jashtëgjuhësore, te zbunimet apo format përkëdhelëse të emrave të përveçëm, te eufemizmat, të folmet e fshehta, zhargonet në lidhje me çështje të ndryshme, gjithashtu, te antonimet e sharjet lënduese dhe shumë elemente të tjerë leksiko-semantikë dhe morfo-sintaksorë.

Gjatë përdorimi të gjuhës, ashtu si vëren studiuesi Lloshi, folësit kanë një shkallë të caktuar të lirisë, domethënë u nënshtrohen shtrëngesave kufizuese të konteksteve përkatëse të fjalëve. Prandaj ndryshon përdorimi i gjuhës kur studentët bëjnë një bisedë me njëri-tjetrin nga biseda me pedagogët.

Konvencionet shoqërore sundojnë përdorimin e përshtatshëm të gjuhës, madje duke përfshirë edhe atë, që mund të dukej jo korrekte nga ana gramatikore e vijueshmëria kuptimore. Në zhargonin studentor, gjithashtu, gjenden mjaft shprehje parafrazuese me ngarkesa stilistike, si: *Mbylle derën nga jashtë! Po na bën vapë këtu! Tani e gjete të vish! Rri pse nuk ikën!, etj.* Të gjitha këto akte të foluri kanë vlerë kur përdoren në kontekstet e tyre përkatëse.

16. Interesant është edhe aspekti ligjërimor që lidhet me **Zhargonin studentor vlonjat**. Studentët përdorin terma të shumtë e të larmishëm në të folurin e përditshëm, gjatë orëve të mësimi, por edhe jashtë auditorit. Vëzhgimet tregojnë se ka veçanti në mënyrën e të komunikuarit gjatë orës së mësimi e jashtë saj në mënyrat e të treguarit të eksperiencave përditshme etj. dhe studentët synojnë të krijojnë një “kod” të posaçëm shprehjeje midis anëtarëve të rrethit shoqëror, kryesisht (apo vetëm) studentor.

17. “Kodi ligjërimor” nuk mund të veprojë kudo dhe me këdo. Të gjitha shprehjet të këtij ligjërimi duhet të jenë gjithmonë të përlijtura nga disa rrethana jashtëgjuhësore, si: rrethana miqësore, shoqërore, familjare, intime, dhe jo në rrethana zyrtare e formale. Termat e këtij “kodi” të posaçëm shprehjeje midis anëtarëve të rrethit shoqëror, kryesisht studentor, harrohen pas disa vitesh, pasi pas përfundimit të studimeve të larta përdoruesit e tyre i shkëpusin lidhjet me njëri-tjetrin,

Të gjitha shprehjet individuale ose të grupit shoqëror, zbunimet dhe sharjet dashamirëse ndaj anëtarëve të grupit social përdoren për të shprehur afrimitet, dashuri, apo për humor, etj. Pra, lidhja midis realitetit dhe identitetit, rebelimi ose llojet e konsumimit, ndjenja e zhgënjimit dhe kërkimi i një statusi vetjak senëdërtojnë subkulturën e të rinjve, duke shpjeguar edhe shmangiet e tyre në rrafshin e zgjedhjeve gjuhësore.

Marrëdhëniet sociale midis studentëve kushtëzohen më tepër nga vendi i realizimit të bisedës sesa nga elemente të tjera, si tematika e bisedës. Pra, mënyra e të folurit është kushtëzuar nga konteksti psiko-social dhe sjellja gjuhësore pasqyron sjelljen sociale. Të rinjtë, gjithmonë, kanë gjeneruar terma të ligjërimit të bisedor, si rezultat, kultura rinore, qëndrueshmëria relative dhe ndryshimi në krijimin e leksikut të të rinjve, është vendi i duhur për të studiuar këtë dukuri gjuhësore.

18. Zhargoni studentor karakterizohet nga të folme të thjeshta që shquhen për ngjyrë humoristike, si dhe nga një karakter fshehtësie jo të thellë”. Fjalët e ligjërimit bisedor në më të shumtën e rasteve janë sinonime me fjalët asnjëse. Gjithashtu, shumë fjalë e shprehje të ligjërimit bisedor lidhen me jetën shkollore dhe jetën e përditshme. Përdorimi i tyre vihet re sidomos në të folur. Frazologjia gjuhësore e pasthirrmat janë karakteristike për këtë ligjërim. Vërehen në përdorim shprehje ironizuese dhe etiketime për degën e studimeve, për notat e provimet; vërehen shtrembërimet forëms fonetike dhe të formës morfologjike të fjalëve; vërehen terma ofendues për studentët e vitit të parë të studimeve e paraqitjen e jashtme; vërehen figura letrare të çuditshme; shkurtime të fjalëve e shprehjeve. Si rezultat, zhargoni studentor pëson një zgjerim të brendshëm, në kuptimet e fjalëve, në thëniet e ilustrimet etj.

19. Interesante janë edhe dukuritë që lidhen me **marrëdhëniet Ligjërim i “Peer groups” dhe individi folës**. Grupmoshat e reja kanë "gjuhën" e tyre, i njohur me përkufizimin lingistik: *Variacion i ligjëratis i përdorur nga një grup i caktuar*. Bashkësia shoqërore studentore dhe nëngrupet që e përbëjnë atë, kanë krijuar gjuhën e tyre, sociolektin, i cili njëkohësisht formëson dhe përforcon lidhjet shoqërore të grupit. Sociolekti shënjon veçantinë e një grup shoqëror nga të tjerët. Ai pasqyron marrëdhëniet e brendshme të grupit si dhe eksperiencën dhe përjetimet e individëve si anëtar të grupit.

Në mjedisin universitar vlonjate vërehen tre tipare kryesore të dialektit social të grupit: *fshehtësia; veçantia, aftësia shprehëse* (sidomos figurshmëria leksikore).

Gjithashtu, në punim u dalluan tre shtresa të leksikut të grupit:

- Fjalor i gjuhës bisedore
- Fjalori i përgjithshëm i ligjërimit të shkujdesur
- Fjalori i veçantë brenda grupit.

Përdorimi i leksikut të veçantë ndodh vetëm në praninë e anëtarëve të grupit dhe sa më shumë shprehje apo fjalë me përdorim të kufizuar të ketë në gjuhën e tyre, aq më emocionues është komunikimi.

20. *Gjuha e grupit* paraqitet edhe si një shumësi idiolektesh të udhëhequra nga disa tipare tipizuese të përbashkëta. Folësi shfaq në gjuhë individualitetin, pra shpreh diçka vetjake që e dallon nga të tjerët. Strukturat e repertorit individual përfshijnë karakteristika si: timbri i zërit, karakteri vetjak, individual i të folurit njerëzor,

përzgjedhja e fjalëve, ngjyrimet leksikore dhe strukturat gramatikore. Ato bëjnë që një folës të dallohet nga një tjetër në “tregun gjuhësor” sikurse e cilëson Prof. Shkurtaj. Aty përfshihen të gjitha mënyrat e formulimit të mesazhit. Kjo vlen më së shumti, në rastet e fjalëve përkëdhelëse, sharjet dashamirëse apo nofkat e gjuhën e fshehtë etj. Gjithashtu, të folurit individual paraqet edhe një informacion plotësues për folësin, p.sh. nga cili qytet / krahinë është.

Gjatë bashkëveprimit gjuhësor në mjedisin universitar bashkëbiseduesit veprojnë si individë dhe si anëtarë të grupit, ku bie në sy, kur, si dhe pse një student përdor gjuhën dhe ligjërimin të lidhur me qëllimin, situatën, tematikën dhe kontekstin social të realizimit të bisedës. Ndaj studimi i gjuhës së grupit shoqëror fillon nga gjuha e individit. Kompetenca gjuhësore e individit është e ndryshme, ndërsa e studiuar si pjesë e grupit, ligjërimi i individëve shfaq ngjashmëri me të folurin e pjesës tjetër të grupit.

21. Ligjërimi i shkujdesur është një fushë ku përsëri ndeshen dukuri gjuhësore vëmendjetërheqëse. Ky lloj ligjërimi markohet shumë nga zhargonet. Gj. Shkurtaj shprehet se çdo varietet i gjuhës duhet të shihet në lidhje të ngushtë me faktorët jashtë gjuhësor që e shoqërojnë atë. Kundrimi gjuhësor duhet bërë në lidhje të ngushtë me anën shoqërore, të kulturës shpirtërore dhe të asaj materiale, duke i parë ato si anë të ndryshme, por të lidhura ngushtë në kuadrin e një bashkësie gjuhësore të dhënë. Termat sleng janë tipare karakterizuese të kulturës rinore dhe përdorimi i tyre ligjërimor është shprehje e identitetit të kulturës sociale të të rinjve. Nëngrupet sociale të ndryshme reflektojnë strukturën sociale të komunitetit social studentor në të cilin bëjnë pjesë. Nëngrupet shoqërore, në vetvete, janë produkt i qëndrimeve, vlerave dhe besimeve të grupmohës së tyre, të prindërve, të komunitetit shoqëror të vendlindjes etj.

22. Hulumtimi shkencor mbi lëndën gjuhësore të mbledhur, ndihmoi në arritjen e disa përfundimeve për ligjërimin e shkujdesur:

Përdorimi i ligjërimin të shkujdesur vlen më së shumti për të etiketuar grupet sociale, dhe përshkruar stereotipitë e njëri-tjetrit.

Ligjërimi i shkujdesur është burim për formimin e fjalëve dhe lindjen e kuptimeve të reja. Neologjizmat, risitë, figurshmëria dhe shumëllojshmëria kuptimore, shoqëruar nga tipare sociologjike, si: vulgariteti, tallja, ofendimi, karakterizojnë këtë ligjërim.

Regjistri gjuhësor i këtij ligjërimi dallohet nga një sërë tipare gjuhësore që pasqyrojnë stilin e jetës së përdoruesve të tij dhe tregojnë përkatësinë e individit kundrejt bashkësisë shoqërore që bën pjesë.

Originaliteti, shkalla e lartë e informalitetit, shprehësia emotive karakterizojnë ligjërimin e thjeshtë studentor. Shumë prej termave dhe frazave të ligjërimin të shkujdesur kanë funksion tallës, ofendues, vulgar. Karakteristikë tjetër e këtij

ligjërimi është leksiku jostandard, fjalët dhe shprehjet, kuptimet e të cilave karakterizohen nga ngjyrimet ekstreme pozitive dhe pezhorative.

Në ligjërimin bisedor dhe të lirë të studentëve, rëndësi të veçantë në kuptimin e fjalëve luan edhe konteksti, i cili del në rolin e *aktualizuesit semantik*.

23. Analiza psikolinguistike e diskursit të të rinjve nxjerr përfundimin se gjuha ndikohet së tepërmi nga sjellja sociale. Vërehet se, kur të rinjtë përdorin termat sinonimikë në kontekste informale, ato shënjojnë të njëjtin referent, por reflektojnë konotacione të ndryshme, pozitive apo negative

Ligjërimi i shkujdesur karakterizohet nga *tipare gjuhësore* të ndryshme të të gjitha nënsistemet (gramatikë, semantikë, fonetikë) etj., nga *tipare sociologjike*, të cilat krijohen si rrjedhojë e funksioneve të shumta të këtij ligjërimi.

24. Në studim u dalluan dy lloje të leksikut të ligjërimin të shkujdesur: leksik i përgjithshëm, leksik me përdorim të kufizuar. Sikurse, në zhargonin studentor, edhe në ligjërimin e thjeshtë të përdorur prej tyre, gjuha e fshehtë dhe kuptimet e dyfishta të fjalëve ose shprehjeve janë karakteristikë dalluese në këtë ligjërim. Sipas studiuesit Xh. Lloshit nëpërmjet përftesash të ndryshme mund të ndërtohen thënie, që të nënkuptojnë diçka tjetër dhe duke e ditur këtë, bashkëbiseduesi mundohet të zbulojë një informacion mbirreshtor.

25. Shpeshherë gabohet kur pohohet se gjuha e të rinjve si krijon një stil të veçantë Ky përgjithësim nuk është aspak i vërtetë. Gjuha e të rinjve paraqet disa tipare të përbashkëta, por jo kjo nuk do të thotë se krijimi e një stili të mëvetësishëm. Bashkëbiseduesit kanë aftësinë që nga thëniet të nxjerrin faktet që janë ngërthyer në to: të nxirren fakte për marrëdhëniet në hapësirë, në kohë dhe nga ana shoqërore ndërmjet ligjëruesve, qëllimet e besimet e tyre përse e bëjnë shkëmbimin fjalësor.

26. Në variantin e folur, jashtë auditorit në mjedisin universitar të Vlorës, është e konsiderueshme prania a varianteve dialektore, e cila ndikohet nga faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, si elemente nga e folmja e Vlorës, Fierit, Beratit, Tepelenës, Kukësit etj. Përdorimi i gabueshëm i gjuhës standarde reflektohet në nyjëtimin e tingujve, rrokjeve, e fjalëve në shpërpjesëtim me kriteret drejtshqiptimore të njërive gjuhësore. Është e natyrshme që thyerjet e normës shqiptimore, veçanërisht shmangiet për arsye të bazës dialektore, sidomos në shqiptim, të mos kuptohen nga folësit.

Shmangie e shkelje vërehen edhe në *rrafshin e fonetikës*: intonacioni, ngjyresat lokale të subjekteve folës, ngjyrosja e zanoreve, reduktimi i togjeve pastheksore, dallimi jo i mjaftueshëm i bashkëtingëlloreve, shqiptime të gabuara të disa fonemave, të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, përdorim i gabuar i theksit, shkurtimi ose zgjatja e disa zanoreve.

Te shumica e studentëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore të familjes a të rrethit shoqëror në ligjërimin jashtë auditorit, por shumë pak prej tyre bëjnë përpjekje serioze për të njohur dhe përdorur rregullat e shqiptimit letrar. Disa prej tyre

korrigjojnë gabimet dukshme dhe trajtat joletrare në komunikimin në auditor. Duket sikur ata kanë krijuar bindjen se shqiptimi letrar është ashtu siç flasin ata, por prapëseprapë nuk janë në nivelet e duhura gjuhësore dhe ndihen luhatje të shumta të normës letrare.

27. Dyndja e pashfrenueshme e fjalëve të huaja të panevojshme në gjuhën shqipe, sidomos nga anglishtja dhe italishtja, shtimi i termave të huaj në vend të temave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohej, është “dallga” më e re e huazimeve që shfaqen edhe në ligjërimin studentor..

28. Problemet që dalin për normën leksikore në ligjërimin e folur studentor mund të përmbliken në këto pika:

- *prania e madhe e fjalëve të huaja dhe prirja e tyre që ato të vazhdojnë të përdoren me intesitet*, si këto: *departament, konsultim, mid-term, kolegium, ciao, love you, okay, etj.*

- *përdorimi i dy a tri emërtimeve për të njëjtin nocion a dukuri*. Në vitet e fundit, si rezultat, i zhvillimit të vullshëm është rritur shumë përdorimi i termave në fushën kompjuterike, të biznesit, financës, juridikut, etj.), mbizotëron përdorimi i dy termave të dy gjuhëve, shqip e gjuhë e huaj, si *doënlod* dhe *shkarkoj*, *softëare* dhe *program*, *mediator* dhe *ndërmjetës*, *konvertim* dhe *kthim*, etj.

- *shkelje e vrazhdë e normës shqiptimore që lidhet me theksin e fjalëve, duke ruajtur theksin e gjuhëve të huaja*. Të tilla janë: *kompjuter, kamerë etj.*

- *përdorim i madh i leksikut nga ligjërimi i thjeshtë (i përditshëm)*, shpesh mjaft banal e i papërzgjedhur.

- *Krijimi i ngjyrimit stilistikor në bisedë, për të qenë pjesë e saj dhe për të realizuar komunikim më të thjeshtë, më të drejtpërdrejtë.*

29. Në ligjërimin studentor vlonjate, lëvizjet nga norma te jonorma janë të zakonshme në sintaksë, morfologji dhe në leksik. Të shpeshta janë *ndërtimet sintaksore të gabuara*: përdoren një ndërtim në vend të një tjetri, vendosen gjymtyrët në rend të gabuar, përdoret një strukturë e cunguar, përdoren konstrukte të huaja, përdoren gabim shenjat e pikësimit. Këto raste e të tjera si këto dëshmojnë për një varfëri në shprehje e njohje jo të mirë të normës gjuhësore.

Ndeshen shmangie morfologjike në të folur e në të shkruar, si përdorimi i trajtës së shkurtër njëjës *i* për shumësin *u*; mospërdorimi i të ashtuquajturave “nyja të përparme”; përdorimi i numërorit *tre* edhe për femëroren *tri*; etj

30. Shmangiet kanë origjinë të ndryshme, disa kanë prejardhje dialektore e këto janë tipike e me shtrirje të gjerë dhe më të qëndrueshme, disa janë rezultat i prurjeve nga fusha e teknologjisë, etj., shumica e tyre janë thjesht gabime gjuhësore dhe përdoren si pasojë e mosnjohjes së kodeve dhe e moszbatimit të tyre nga padituria.

## KAPITULLI I NËNTË

### Diagrama, grafikë, modele anketimesh

---

- I. Tabela**
  - II. Figura**
  - III. Anketa**
- 

#### I. Tabela

- Tabela 1. 1** Faktorët që ndikojnë në ligjërimin individual
- Tabela 2. 1** Interpretime personale të studentëve për fjalë ose shprehje të përdorura në marrëdhëniet informale me njëri-tjetrin, në mjedisin universitar (jashtë auditorit)
- Tabela. 3.1** Deklaratat në lidhje me përgjithësimet socio–kulturore
- Tabelë. 3. 2** Përcaktimi i tipareve sociale sipas gjinisë
- Tabelë. 3. 3** Tematikat e bisedave sipas gjinisë
- Tabelë 3. 4** Shembuj të ndryshëm nga ligjërimi familjar sipas qyteteve.
- Tabela 3. 5** Fjalët dhe shprehjet që studentë nga qytete të ndryshme përdorin në situata të caktuara, deri diku me humor, dhe më shoqërinë e tyre të ngushtë
- Tabela 3. 6** Fjalët dhe shprehjet që studentë nga qytete të ndryshme nuk i përdorin në mjediset e brendshme universitare apo me studentë të tjerë që nuk janë në shoqërinë e tyre të ngushtë
- Tabela 4. 1** Sharjet dashamirëse që përdoren brenda mjediseve universitare (jashtë auditorit)
- Tabela 4. 2** Sharjet dashamirëse që përdoren jashtë mjediseve universitare
- Tabela 4. 3** Etiketimet që studentët i bëjnë njëri-tjetrit në bazë të degës së studimit

- Tabela 4.4** Sharjet dashamirëse të përdorura nga studentët brenda dhe jashtë mjedisve universitare (jashtë auditorit)
- Tabela 5.1** Përdorimi i përsëritjeve në gjuhë të huaja në vend të fjalëve dhe shprehjeve shqip, në biseda joformale
- Tabela 5.2** Përdorimi i fjalëve të huaja nga vajzat dhe djemtë në biseda joformale
- Tabela 5.3** Përqindja e subjekteve që përdorin termat e ligjërimit të shkujdesur
- Tabelë 5.4** Përqindja e njohjes ose jo të kuptimit të termave të ligjërimit të shkujdesur (djem: 140, vajza: 160)
- Tabela 5.5** Leksiku i ligjërimit të shkujdesur që njihet më tepër nga djemtë dhe vajzat
- Tabelë 5.6** Përqindjet në njohjen e leksikut të ligjërimit të shkujdesur sipas ndarjes: Jug / Veri
- Tabelë 5.7** Tiparet sociologjike të evidentuara në ligjërimin e shkujdesur
- Tabela 6.1** Elementet që përcaktojnë tiparet e ligjërimit bisedor
- Tabelë 6.2** Përdorimi i fjalëve standarde në të folmen vendore

## **II. Figura**

---

- Figurë 1. 1** Përqindja e njohurive për normën standarde
- Figurë 1. 2** Përqindja e njohurive për normën gjuhësore
- Figurë 1. 3** Përqindja e mbizotërimit të gjuhës së thjeshtë dhe standardit në bisedat e lira
- Figurë 1. 4** Njohuritë e studentëve për normën gjuhësore të paraqitura në përqindje
- Figurë 1. 5** Përqindja për kontekstin e përdorimit të normës gjuhësore
- Figurë 1. 6** Përqindja e përzgjedhjes së alternativave për shqiptimin e fjalës *Standard*
- Figurë 3. 1** Keqkuptimi ndërkulturor midis gjinive
- Figurë 3. 2** Përqindja e rezultateve të deklaratave përgjithësuese për gjininë
- Figurë 3. 3** Përqindja e tolerancës së studentëve ndaj vajzave dhe djemve që paraqesin tipare ligjërimore të gjinisë së kundërt
- Figurë 3. 4** Përqindja e përdorimit të fjalëve të huaja në komunikimin e përditshëm ndërgjinor
- Figurë 3. 5** Arsyet e përdorimit të leksikut të gjuhëve të huaja në ligjërim e përditshëm dhe virtual të studentëve të universitetit “Ismail Qemali”
- Figurë 3. 6** Tematika e bisedave të djemve studentë
- Figurë 3. 7** Tematika e bisedave të vajzave studente
- Figurë 3. 8** Përqindja e përdorimit të të folmes dialektore të studentëve sipas pedagogëve
- Figurë 3. 9** Motivet e ndikimit të të folmes dialektore
- Figurë 3. 10** Pasqyrimi i formës dialektore në punët me shkrim
- Figurë 3. 11** Përqindja e korigjimit të të folmes dialektore në orën akademike
- Figurë 3. 12** Përqindja e origjinës së studentëve të anketuar
- Figurë 3. 13** Përqindja e ndryshimit të të folmes në shtëpi me atë në universitet, të studentëve të anketuar
- Figurë 4.1** Përdorimi i fjalëve përkëdhelëse në bazë gjinie
- Figurë 4. 2** Përqindja e përdorimit të fjalëve përkëdhelëse dhe elementeve të tjerë zbulues sipas gjinisë

**Figurë 4. 3** Përqindja e keqkuptimeve të nofkave apo fjalëve përkëdhelëse të përdorura në publik

**Figurë 5.1** Përqindja e përdorimi të gjuhës së fshehtë brenda grupit shoqëror

**Figurë 5.2** Përqindja e përdorimi të regjistrit të veçantë por jo të fshehtë brenda grupit shoqëror

**Figurë 5. 3** Termat më shumë dhe më pak të përdorur për etiketimin e njerëzve

**Figurë 5. 4** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 5** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 6** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 7** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 8** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 9** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 10** Shprehjet më shumë apo më pak të përdorura

**Figurë 5. 11** Etiketimet në bazë të degës së studimit

**Figurë 5. 12** Etiketime të ligjërimit të shkujdesur për njerëzit

**Figurë 5. 13** Etiketimet e ligjërimit të shkujdesur për studentët sipas performancës akademike

**Figurë 5. 14** Etiketime për aktivitete shkollore

**Figurë 5. 15** Etiketime të ligjërimit të shkujdesur në bazë të aktiviteteve jashtë shkollore

**Figurë 5. 16** Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

**Figurë 5. 17** Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

**Figurë 5. 18** Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore

**Figurë 5. 19** Fjalët më të përdorshme të ligjërimit të shkujdesur për aktivitetet jashtë shkollore: bisedat telefonike brenda dhe jashtë gjinisë

---

### III. ANKETA

---

#### **ANKETE 1: Marrëdhëniet e gjuhës standarde me dialektet**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25..... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes\_Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_
5. Etnia: Shqiptare \_\_\_\_ Greke \_\_\_\_ Arumune \_\_\_\_ Çame \_\_\_\_, etj, \_\_\_\_\_
6. Mjedi familjar: \_\_\_\_\_

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25..... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes\_Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_
5. Etnia: Shqiptare \_\_\_\_ Greke \_\_\_\_ Arumune \_\_\_\_ Came \_\_\_\_, etj, \_\_\_\_\_
6. Mjedi familjar: \_\_\_\_\_

#### a. Për studentët

- (1) Nga jeni me origjinë?  
Qytet \_\_\_\_\_ Fshat \_\_\_\_\_
- (2) A ndryshon e folmja juaj në shtëpi me atë në universitet?  
Shumë\_\_ Pak\_\_\_\_ Aspak \_\_\_\_\_
- 3) Në cilin prej dialekteve (geg / tosk) bazohet gjuha standarde?
- 4) Gjuha standarde përdoret në:
  - (i) Mjediset publike
  - (ii) Në shkolla
  - (iii) Në gazeta e televizione
  - (iv) Në dokumentat zyrtare

(v) Të gjitha alternativat.

5) Varianti i saktë është:

- (a) standard
- (b) standarti
- (c) standart
- (d) standardizimi

6) Çfarë stili ligjërimit përdorni gjatë komunikimit me pedagogët?

7) Si flisni janë auditorit ose universitetit? Jepni shembuj.

8) Sa e përdorni gjuhën shqipe standard dhe rregullat gramatikore të të folurit?

9) Çfarë gjuhe (regjistri gjuhësor) përdorni në klasë dhe në diskutimet për çështjet mësimore? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

10) Si flisni në auditor? Jepni shembuj.

11) Sipas jush, mendoni se keni njohuri të mjaftueshme për gjuhën letrare?

12) Në bisedat me miqtë dhe shokët/shoqet e klasës, flisni më tepër në gjuhën standard apo në atë bisedore ose të lirë?

c. Për pedagogë

1. A evidentohet e folmja dialektore në universitet?

Po \_\_\_ Jo \_\_\_ Ndonjëherë \_\_\_

2. Motivet kryesore të këtij ndikimi janë:

- 1. Studentë që vijnë nga zonat rurale
- 2. Studentë që vijnë nga rrethet e tjera
- 3. Tek të gjithë studentët

3. A pasqyrohet forma dialektore në punët me shkrim të studentëve?

Po \_\_\_ Jo \_\_\_

4. A ndërhyhet nga ana juaj tek këto studentë apo jehohet të flasin lirshëm?

Po \_\_\_ Jo \_\_\_

**ANKETE 2: Mjedisi administrativ**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25.... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes \_Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_
5. Etnia: Shqiptare \_\_\_\_\_ Greke \_\_\_\_\_ Arumune \_\_\_\_\_ Çame \_\_\_\_\_, etj, \_\_\_\_\_
6. Mjedisi familjar: \_\_\_\_\_

1. Cilat janë disa nga fjalët që ju përdorni më shumë nga krahina juaj ?
2. A vazhdoni ti përdorni këto fjalë në mjediset universitare? Me cilët i përdorni?
3. Jeni ndjerë në vështirësi kur të tjerët rreth jush korrigjojnë mënyrën e të folurit?
4. Jeni etiketuar nga shoqëria për gjuhën tuaj të të folurit?
6. A e ka kupton shoqëria juaj dialektin tuaj në në biseda?
7. Cilat janë disa nga shprehjet e vendlindjes dhe të familjes tuaj që vazhdoni t'i përdorni edhe në mjedisin e jashtëm të Universitetit?
8. Ndikojnë miqtë në të folurin tuaj? Jepni shembuj të fjalëve e shprehjeve që përdorni me miqtë tuaj.
9. Kur jeni me miqtë tuaj përdorni shqipen standarde në mjediset universitare? Si i flet një shoqe/shoku për një mësim të gjatë e të vështirë?
10. Listoni disa nga fjalët ose shprehjet tipike të vendlindjes ose kulturës tuaj familjare:

1.

2.

3.

4.

5.

Etj.

11. Listoni disa nga fjalët ose shprehjet e vendlindjes që nuk mund t'i përdorni në mjedisin universitar:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- Etj.

12. Përshkruani nëse ka ndonjë ndryshim fonetik (mënyra e shqiptimit) midis të folurës tuaj të përditshme nga e folura akademike.

13. Listoni disa fjalë ose shprehje që ju përkasin vetëm juve si individë:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.
- Etj.

14. Ndikojnë miqtë në të folurin tuaj? Jepni shembuj të fjalëve e shprehjeve që përdorni me miqtë tuaj.

15. Kur jeni me miqtë tuaj përdorni shqipen standarde në mjediset universitare?

16. Përdorni fjalë të huaja (angleze, italiane, greke, etj.) në mjediset universitare? Jepni shembuj.

**ANKETE 3: Ligjërimi gjinor**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25..... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes\_ Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_

**(1) Keqkuptimi ndërkulturor ndodh kur dy ose më shumë njerëz të kulturave të ndryshme nuk e kuptojnë plotësisht njëri-tjetrin për shkak të ndryshimeve kulturore.** Kjo teori mund të përdoret edhe në komunikimin midis meshkujve dhe femrave. Jepni vlerësimin tuaj sipas listës numërore 1-5 (1-aspak dakord 5-shumë dakord) për thënien:

“Femrat dhe meshkujt nuk përfaqësojnë dy kultura të ndryshme në lidhje me komunikimin!”

|              |            |         |        |              |
|--------------|------------|---------|--------|--------------|
| 1            | 2          | 3       | 4      | 5            |
| Aspak dakort | pak dakort | neutral | dakort | shumë dakort |

Shpjegoni me fjalë përgjigjen tuaj:

**(2) Në tabelën e mëposhtme jepen pesë deklaratë rreth gjuhës dhe gjinisë.**

Vendosni në krahasim të secilës deklaratë numrin 1-5 sipas mendimit tuaj.

|   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| Femrat bëjnë më shumë thashetheme se meshkujt.  |   |   |   |   |   |
| Gjatë bisedave mes meshkujve dhe femrave, meshkujt ndërpresin më shumë bisedat.   |   |   |   |   |   |
| Femrat përdorin më tepër stil bindës apo shpjgues, shoqëruar nga termat e mirësjelljes sesa meshkujt (p.sh., ‘do të ishte e mundur sikur...’, ‘të vjen keq sikur...’) |   |   |   |   |   |
| Meshkujt kundërshtojnë ose ndërpresin më tepër njëri-tjetrin në bisedë.   |   |   |   |   |   |
| Femrat kanë tendencën të vazhdojnë bisedën rreth të njëjtës tematikë (p.sh të flasim për të njëjtën temë që   |   |   |   |   |   |

mund të kenë folur më parë)

- (3) Sugjerimi se femrat dhe meshkujt mund të përdorin tipare ligjërimore të gjinisë tjetër, nënkupton se një mashkull që përdor stil të foluri femëror mund të konsiderohet si “i butë, delikat” dhe “femëror”, dhe një femër që përdor stil të foluri mashkullor mund të konsiderohet si “agresive” dhe “mashkullore”.

*Sipas mendimit tuaj cilat janë karakteristikat e ligjërimin (të folurit) femëror, që e bëjnë një mashkull të duket si “i butë”?*

*Sipas mendimit tuaj cilat janë karakteristikat e ligjërimin (të folurit) mashkullor, që e bëjnë një femër të duket “agresive”?*

- (4) Pretendohet se meshkujt që përdorin tipare të ligjërimin bisedor femëror paragjykojnë më tepër se femrat që paraqesin tipare të ligjërimin mashkullor në të folur. Përcaktoni me numër mendimin tuaj rreth deklaratës së mësipërme:

|              |            |         |        |              |
|--------------|------------|---------|--------|--------------|
| 1            | 2          | 3       | 4      | 5            |
| Aspak dakord | pak dakord | neutral | dakord | shume dakord |

Shpjegoni me fjalë përgjigjen tuaj.

- (5) Në tabelën e mëposhtme përcaktoni nëse tiparet e mëposhtme janë femërore, mashkullore apo i përkasin të dyja gjinive.

|  | Meshkuj | Femra | Të dyja gjinitë |
|--|---------|-------|-----------------|
| Konkurues  |         |       |                 |
| Bashkëpunues   |         |       |                 |
| Agresiv  |         |       |                 |
| Përpiqen shumë   |         |       |                 |
| Llafazanë  |         |       |                 |
| Të ndjeshëm (emocionalë)   |         |       |                 |
| Praktikë   |         |       |                 |
| Përdorin shumë pyetje konfirmuese (Kaluan shumë mirë në ditëlindje, apo jo?) |         |       |                 |

- (6) Më poshtë gjendet një list me tema të ndryshme bisedash që mund të diskutohen në ambiente të ndryshme si lokal apo mjedis në shkollë, jashtë auditorit. Vendosini numra nga 1-9 sipas rëndësisë ( 1-sh. e rëndësishme, 9-aspak e rëndësishme) në kolonën e djathtë.

| <b>Tematikat</b>  | <b>Renditja sipas rëndësisë (1-9)</b> |                         |
|---|---------------------------------------|-------------------------|
|   | <b>Lokal</b>                          | <b>Jashtë auditorit</b> |
| Makinat   |                                       |                         |
| Veshjet   |                                       |                         |
| Çështjet aktuale /Politike zë një pjesë shumë të madhe të kohës së njerëzve |                                       |                         |
| Futbolli  |                                       |                         |
| Shtëpia   |                                       |                         |
| Thashetheme të ndryshme   |                                       |                         |
| Seksi   |                                       |                         |
| TV  |                                       |                         |
| Puna  |                                       |                         |

**ANKETE 4: Idiolekti dhe “Peer groups”**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25.... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_

(1) Si do të bisedoni për tema të caktuara, si mësimet / provimet / pushimet / me shokun ose shoqen tuaj:

| Rastet e përdorimit                                | Statusi                            | Tema     |  |
|--|------------------------------------|----------|--|
| Orë mësimi   | Studentët në klasë<br><br>Pedagogë | Mësimet  |  |
|  |                                    | Provimet |  |
|  |                                    | Pushimet |  |
| Në ambientet e universitetit, por jashtë auditorit | Shoqëri                            | Mësimet  |  |
|  |                                    | Provimet |  |
|  |                                    | Pushimet |  |

---

---

|        |         |          |  |
|--------|---------|----------|--|
|        |         |          |  |
| Shtëpi | Familja | Mësimet  |  |
|        |         | Provimet |  |
|        |         | Pushimet |  |

- (2) Si reagoni kur shikoni diçka të bukur?
- (3) Si reagoni kur dëgjon një lajm të keq?
- (4) Keni një fjalë ose shprehje që e përdorni gjithmonë?
- (5) Çfarë e bën të veçantë stilin tuaj të të folurit?
- (6) Listoni disa nga shprehjet karakteristike që përdorni me shokët ose shoqet tuaja në mjediset universitare:
- 1.
  - 2.
  - 3.
  - 4.
  - 5.
- Etj.
- (7) Listoni disa nga fjalët dhe shprehjet me kuptim të dyfishtë që përdorini me grupin tuaj shoqëror.
- (8) Sa ndikon komunikimi on-line në të folurin tuaj të përditshëm: Brenda dhe jashtë universitetit? Jepni shembuj.

**ANKETE 5: Zhargoni studentor vlonjat; Zbunimet dhe përkëdhelitë**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25.... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes\_ Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_
5. Etnia: Shqiptare \_\_\_\_ Greke \_\_\_\_ Arumune \_\_\_\_ Çame \_\_\_\_, etj, \_\_\_\_\_
6. Mjedi familjar: \_\_\_\_\_

**(1) Çfarë epiteti do t'i vini studentëve që studiojnë për:**

- Gjuhë të huaj
- Pedagogji
- Gjuhë-letërsi
- Infiermieri
- Biznes (Manaxhim  
biznesi/ Financë)
- Matematikë
- Fizikë
- Inxhinieri Navale/Mekanike
- Informatikë
- Drejtësi
- Biologji
- Shkenca Nautike
- Inxhinieri Elektrike

**(2) Përshkruani disa nga “Sharjet dashamirëse” që përdorni më tepër me shoqërinë tuaj kur ndodheni në mjedisin universitar dhe jashtë tij:**

| Mjedi universitar |                   | Jashtë univeritetit (p.sh kafene) |                   |
|-------------------|-------------------|-----------------------------------|-------------------|
| <u>Për vajzat</u> | <u>për djemtë</u> | <u>Për vajzat</u>                 | <u>për djemtë</u> |
| 1.                |                   |                                   |                   |
| 2.                |                   |                                   |                   |
| 3.                |                   |                                   |                   |
| 4.                |                   |                                   |                   |

5.

Etj.

- (3) Përshkruani disa nga “**Përkëdhelitë**” (fjalët përkëdhelëse) që përdorni më tepër me shoqërinë tuaj kur ndodheni në mjedisin universitar dhe jashtë tij:

| Mjedis universitar |                   | Jashtë univeritetit (p.sh kafene) |                   |
|--------------------|-------------------|-----------------------------------|-------------------|
| <u>Për vajzat</u>  | <u>për djemtë</u> | <u>Për vajzat</u>                 | <u>për djemtë</u> |
| 1.                 |                   |                                   |                   |
| 2.                 |                   |                                   |                   |
| 3.                 |                   |                                   |                   |
| 4.                 |                   |                                   |                   |
| 5.                 |                   |                                   |                   |
| Etj.               |                   |                                   |                   |

- (4) Cilat terma ose fjalë specifike të degës tuaj të studimit përdorni me shoqërinë tuaj jashtë orës së mësimi?
- (5) Çfarë etiketimesh përdorini për pedagogët tuaj në lidhje me lëndët mësimore, paraqitjen e tyre, moshën, natyrën e pedagoguëve dhe karakterin?
- (6) Si i emërtoni lëndët e ndryshme që zhvillohen në universitet?
- (7) Si shpreheni për notën kaluese, ngelëse?
- (8) Si shpreheni për mësimet apo sezonin e provimeve?
- (9) Çfarë epitetesh përdorni për studentët e vitit të parë?
- (10) Cilat janë disa nga emërtimet apo “ofendimet” që keni dëgjuar për konviktorët/et?

| <u>Djem</u> | <u>Vajza</u> |
|-------------|--------------|
|             |              |

- (11) Si shpreheni për vajzat dhe djemtë e shëndoshë / të shkurtër/ tipare të tjera fizike?
- (12) Si veproni kur doni të thoni diçka pa e kuptuar të tjerët?
- (13) Cilat shprehje përdorni me kuptim të dyfishtë?
- (14) Përdorni fjalë të huaja me shoqërinë tuaj? Shkruani disa prej tyre.
- (15) Si i flisni me përkëdheli një shoqe / shoku?

Ma. Dorianë Klosi

---

- (16) Çfarë etiketime apo nofka përdorni me shoqërinë tuaj të ngushtë?
- (17) Si i flisni shkurt në emër shoqes / shokut tuaj?
- (18) Ju ka ndodhur të flisni si fëmijë i vogël me grupin tuaj shoqëror?
- (19) Pse përdorni forma të tilla komunikimi?
- (20) Sa ndikon marrëdhënia shoqërore (shok / shoqe e ngushtë ose jo) në përdorimin e fjalëve përkëdhelëse?
- (21) Ju ka ndodhur të jeni keqkuptuar në ndonjë rast që keni përdorur fjalë përkëdhelëse?
- (22) Sa i përdorni nofkat në familje?
- (23) Listoni disa nga sharjet dashamirëse që i përdorni:

Brenda mjediseve universitare (jashtë auditorit)

Jashtë mjediseve universitare

---

- (24) Kush i përdor më tepër nofkat dhe zbulimet: vajzat apo djemtë?
- (25) Çfarë përshtypje krijoni për një djalë që përdor shumë fjalë përkëdhelëse?

**ANKETE 6: Ligjërimi i shkujdesur**

1. Gjinia: Mashkull..... Femër.....
2. Cilës grupmoshë i përkisni? 18–25.... 26–33..... 34–41..... 40+.....
3. Dega e studimit: \_\_\_\_\_, Fakulteti: \_\_\_\_\_, Viti: \_\_\_\_\_
4. Vendi i lindjes\_Qyteti \_\_\_\_\_ Fshati \_\_\_\_\_
5. Etnia: Shqiptare \_\_\_\_ Greke \_\_\_\_ Arumune \_\_\_\_ Came \_\_\_\_, etj, \_\_\_\_\_
6. Mjediisi familjar: \_\_\_\_\_

**Seksioni I**

**(1) Etiketime për njerëzit**

- Rektorin
- Pedagogët
- Rojen e institucionit
- Sanitaret

**(2) Etiketime për studentët sipas performancës akademike**

- student shumë i zgjuar dhe studion shumë
- studentë që ndjek rregullisht leksionet por nuk mëson
- studentë dembel:

**(3) Aktivitetet shkollore**

- të ngelësh në provim:
- të kalosh në provim:
- të mungosh në mësim:
- të mësoh:
- tema e diplomës:
- pushimet, festat:

**(4) Aktivitetet jashtë shkollore**

- situata qesharake:
- situata tepër argëtuese:
- situata të këqija
- Fjalët e shkujdesura për celularin:

- internet:
- konsumimi i pijeve alkoolike:
- të dehesh
- substancat narkotike:
- mbrëmjet festive dhe argëtuese:
- të dashurin / të dashurën dhe përfundimin e lidhjeve dashurore:
- marrëdhëniet seksuale:
- vajza dhe / ose djem të paraqitshëm:
- vajza që bëjnë tualet të rëndë
- homoseksualitetin:
- për njerëzit jo të zgjuar apo të ngathët në mendime ose veprime
- të shprehurit në telefon
- Kur përgjigjet në telefon një femër (kur e telefonon shoku/ i dashuri):
- Shprehje të ndryshme ofenduese:

## **Seksioni II**

Në tabelën e mëposhtme shënoni me + ose x nëse e njihni ose jo termin apo shprehjen. Gjithashtu, shkruani fjalë dhe shprehje të tjera sinonimike nëse dini apo keni dëgjuar:

|   |
|---|
| E tërheq (merr substanca narkotike)   |
| Katunare luksoze (që do të bëhet moderne me doemos)   |
| Zar (servil)  |
| Ta çaj gojën (kërcënim)   |
| Të thy në mes (lloj sharjeje)   |
| Të tërheq zvarrë (mënyrë për të treguar fortësinë)  |
| E vdes fare (kur bën diçka shpesh ose kur është specialist në një fushë) p.sh (xhirim i rrotave të makinës) |
| E myt komplet (disa kuptime, e ka nderuar veten, ose është degraduar)                                       |
| Rozgo (e rëndomtë)  |
| Hajdar (shprehje për t'i thënë tjetrit që je i paaftë)  |
| Pallosh (sharje për të thënë sa i trashë që je)   |
| Punon (merret me punë të pista)   |
| Më ka ik petlla/zari (jam shumë i shqetësuar)   |
| Si 200 ( bëhet fjalë për makinën, benzi, që ka dal nga moda dhe nuk është avangard.                         |

Në këtë rast është krahasues për mashkullin. Rri si 200)  
Palltek (lloj sharjeje që përdorin adoleshentët mes tyre)  
Karallo (nuk është i zgjuar, është budalla)  
Mos më çaj tallamandrën (mos më mërzit shumë)  
Katunare prestigjioze (një vajzë e cila përpiqet të jetë në modë)  
Është gabriela (një rrobë e blerë me çmim të lirë, por që pretendohet të jetë firmë e  
njohur)  
Me haspi (gjasme)  
Haspi karalloi (pusho mos fol)  
Është bishë fare (femër seksi)  
Goc ose çun për shpi (goc ose çun i mirë)  
Ta boft zoti mar (nuk e vret mendjen)  
I fus një tegel (pirje drogash)  
Çun tavoline (që ka diapazon dhe di të bisedojë)  
Dredhje beli (e anashkalon bisedën)  
Është fibër (ka fizik të mirë)  
Vari teneqen (mos i jep rëndësi)  
Duam harem, hallakatje, aheng (festë)  
Na zuri treni ose autobusi (na mërziti me atë lloj bisede)  
Dhe produkte të tjera ushqimore (përdoret si shprehje për t'i dhënë fund një bisede të  
bezdisshme ose një diskutimi të gjatë)  
Më fal se të fika llullën (më fal se të bezdisa e thënë me ironi)  
U fiksova fare (e humba toruan)  
Është për t'i fut çorapen në gojë (është për ta rrahur)  
E ka kap ai/ajo (është e dashura e atij/asaj)  
Ka në mend me e mor (do të fejohet, martohet, do ta marrë për grua)  
Për ty boj pesë vjet burg (mënyrë për të ngacmuar femrat)  
Qafsha për zotin (lloj betimi)  
Është i bomë (është nën efektin e lëndëve narkotike)  
Pompozitet (i jep rëndësi, e fryn më tepër sesa duhet, ose një person që hyn me  
krenari)  
Kardinal (djalë, vajzë me pretendime)  
Llosh (është budalla, nuk është i mençur)  
Dari (shkurtimi i sharjes handar, i paaftë) Mashtrues me patentë ndërkombëtare  
(shkalla sipërore e të thënurit, gënjeshtar I madh)  
Haet (është i/e mirë, vajzë/ose djalë simpatik)  
Trendy (është me kohën)  
Tip delikat (ironi për një person që ka pretendime)  
Çun me botë (djalë me mend)  
Goc e lexume (vajzë që lexon libra ose e aftë)  
Alabak pa klas (djalë që përpiqet të jetë në modë, por është i paedukatë dhe i  
paarsimuar)

Rural komplet (katundar)  
Alpin (malok, në kuptimin i trashë)  
Aut (nuk është i përfshirë)  
Jashtë orbite (është jashtë bisedës, ose jashtë rrjedhës)  
Guci dhe Armani, Versace, D&G, (kur një i ri ose e re vishet me rroba firmë)  
Është çun me etapa (djalë që i di rregullat)  
Dashnor i/e rregullt (që ka dy lidhje njëkohësisht, ose kur partneri është i sjellshëm)  
Bashkëjeton një herë në javë (takohen rrallë)  
Angazhohu në jetë (merr iniciativa i pari)  
Të honkshin qentë (mallkim)  
Të rraftë ngordhja (mallkim)  
Gjigand (Djalë i mirë, i respektueshëm)  
Neë entry (është e re)  
Kafshatë që s'kapërdihet (për diçka që nuk të pëlqen, ose nuk mund të vazhdojë më)  
Ia fut për kënaqësi (flet përçart)  
Sllon, 4 fenersh, avangard, kuklla vogël, goca ime (makinë e tipit të fundit ose makinë e bukur, e madhe)  
Rrangalle (makinë e vjetër me të cilën është turp të të shikojnë)  
Është njish (është djalë i mirë dhe mbi të gjitha shakatar)  
E papame (fantastike)  
Për shkepje (për qejf, për argëtim)  
Të mushme e ke (Që nuk të ndihmoj dot)  
E ke hap krahun (po devijon)  
Ai është: hyr, mirë ardhsh, mirë të gjetsha (që nuk merr vesh, s'ka asnjë lidhje me ambientin, nuk kupton)  
Hajt se folim (mënyrë për të shmangur bisedën, për ta anashkaluar bashkëbiseduesin)  
Na ka fik derën (na prishi punë)  
Ai është 8 pa 10 (s'merr vesh, nuk e vret mendjen)  
I ka vdek nona atij muhabeti (ka përfunduar si punë)  
Skorpions (modern)  
Çun katalogu, djalë pasarelash (djalë në modë, që vishet bukur)  
Vajzë kopertonash (vajzë simpatike, që vishet bukur)  
Lekist/lekiste (shkon pas parasë)  
E bën vizën sa tavolina (është përdorues i vjetër i lëndëve narkotike)  
Do të shkrij komplet (lloj kërcënimi)  
Pantallona deri te zemra ose deri te goja (pantallona demode që janë me bel të lartë)  
Qeka çmim i leverdishëm (kodi për të thënë se çmimi është tepër i shtrenjtë)  
Zog nate (të rinj që frekuentojnë shpesh diskotekat, pub-et)  
E ka muhabetin me të futme (që nuk tregohet i singertë)  
Drazhlla (trashje)  
Na u llash trapa (u mërzitëm duke pritur, duke ndenjmur kot)  
Kjo po kjo, Brinty Spears, (këngëtarja), (e mban veten për vajzë të bukur)

Ma. Dorian Klossi

Futja vrapit (shumë kuptime, ik se na mërzhite, ai është i bezdisshëm)  
Genci, kallo, e kuqe, çokollatë, miell, kërp) emra më të cilat identifikojnë lëndët  
narkotike)  
Toç kuklle (idiot)  
Ka mërdhif (ka mbaruar komplet)  
E pi cigaren me llullë, e ha cigaren fare (pi shumë cigare)  
Është grup fare (është djalë, vajzë e mirë)  
Goc, çun nobël (vajzë, djalë i mirë)  
Anej këndeje gjithandeje (kur sorollatesh)  
Paske dalë kabriolet (kur një femër është me rroba që e tregojnë gjysmë të zhveshur)  
Lavazhier (person i rëndomtë)  
Zdroms/e (ordiner/e)

"Berthame e thyer" - Femër e kaluar në moshë  
"I ka fut uje komardarja" - Jo e virgjër  
"Ballkon" - Për gjoksin e një vajzë në përmasa të medha  
"T'i nderroj vajin" - Marrëdhënie seksuale  
"Te shkund oxhakun" - Marrëdhënie seksuale  
"Pashuk" ose "Lici" - Policit të shkolles  
"Baloja", "Qylaxhiu" - Per rojen civile të shkolles  
"Zyra e gjendjes civile" - Per baret ku njihen vajza  
"E zeze", "Cigare e dredhur" - Hashashi  
"Qumesht pa ngjyrë", "Uji me erë" - Alkooli  
"Parkingu i vjetër" "Ish-e dashura  
"Bordellacion" - shkolla  
"Kucedra" - mësuesja  
"Karafil" - meshkuj që shkojnë me femra më të mëdha se vetja  
"Zjarrmi", "Burimi" - të dashurave  
"Doganë me shumë kalime" - femrat që kanë më shumë se një partner  
"Frajer" - gocat i thonë të dashurit  
"Gore" - i fëlliqur  
"Tutore", "Babysiter" - prindërve  
"Fashkull" - homoseksual  
"TDF" - të dua fort  
"Bunder" - femër e përdalë  
"Harabel" - mashkull i lehtë nga mendja  
"Hallat nga Amerika" - periodat  
"Kthesa e Kamzes" - vajze me kembe të shtrembra  
"Pompa" - zemra

**termat për të dashurin apo të dashurën.**

"Burimi", "zjarrmi" apo "bebushi i vogël". (Kjo e fundit, thuhet vetëm në rastet kur "ja vlen", d.m.th., kur të ka hyrë pak në zemër...

Nga femrat dëgjohet shpesh "çuni", "zemra" dhe tendencë e kohëve të fundit, është dhe fjala e huazuar nga Kosova, "frajer

**kanë lidhje me më shumë se një partner.** Edhe atyre ua kanë ngjitur pullën: "Doganë më shumë kalime" dhe një tjetër "dyqani me listë". Për femrat që ata konsiderojnë si të përdala, përdoren fjalë si: "Kuti votimi"... Për djemtë me shumë partnere thuhet "bariu" BRIGADIERI, SHEFI I RROBAQEPESISE, "tren me shumë tunele" dhe "çezme me shumë burime...".

## BIBLIOGRAFIA

- Adams, M., *Slang: the people's poetry*, United States, 2004, f. 6.
- Agnihotri, R. K., *Labov's Concept of the Vernacular Speech: The Site of Language Structure, Acquisition and Change*. United States, 2013, f. 101.
- Amsberry, D., *Talking the Talk: Library Classroom Communication and International Students*
- AudioEnglish.org <http://www.audioenglish.org/dictionary/password.htm>
- Badallaj, M., *Sa dhe si realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet*. Tiranë, 2011, f. 556.
- Bajçinsa, I., *Çështje të shqipes së stome letrare vështruar në aspektin teorik e të zbatimit në praktikë*, Tiranë, 1992, f.103.
- Balla , M., *Marrëdhëniet e sotme gjuhë standard-dialekt në shkolla*. Tiranë, 2011, f. 268-271.
- Beci, B., *Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore*. Tiranë, 1995, f. 53.
- Bently, H., *Slang today and yesterday; dictionary of American slang; Slang, phrases and idiom in colloquial english and their use*. United States 1935, 63.
- Bernstein, B., *Language and Social Class*. England, 1960, f. 271-276
- Berryman, C. L., dhe Eman, V. A., *Language and Gender Communication, Language and Sex*. United States, 1983, f.30-35.
- Bhasin, K., *Të kuptosh përkatësinë gjinore*. Tiranë, 2006, f. 14-15.
- Bishop, L., *Investigating idiolect and youth sociolect*,
- Bodine, A., *Review of: Male/Female Language* . Cambridge , 1977 , f. 104-110
- Bosanquet, H. D., *The family*. Chicago, 1907, f. 399
- Briscoe, R. E., *Individualism, Externalism and Idiolectical Meaning*. United States , 2006 , f. 98.
- Brown, R., *Complexity and order in teenagers 'speech in Psycholinguistics*, New York, 1970, f. 85.
- Bucholts, M., *Globalization: language and youth culture*. North Carolina, 2000, f. 281.
- Çabej, E. *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1975, f. 213.
- Cameron, D., *Gender and Language Ideologies' In Holmes and Meyerhoff 'Handbook of Language and Gender*. Oxford, 2003, f. 159.
- Cardona, G. R., *Introduzione al' etnolinguistica*, Milano, 1976, f. 92.
- Caton, S. C., *Review of: Contributions of Roman Jakobson*. United States, 1987, f. 223-260

- Çeliku, M.; Karapinjalli M., & Stringa R., *Gramatika praktike e gjuhë shqipe*. Tiranë, 1998, f. 125.
- Çerkezi, E., & Billa, E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*. Korçë, 2013, f. 310.
- Curzan, A., *The end of modern English?* Washington, 2008, f. 299-301
- D. Chrystal-D., *Davy, Investigating English Style*, London, 1969, f. 64.
- Department of Linguistic., *Language Files*, Ohio, 2007, f. 407.
- Dickson, P., *Family words: a dictionary for people who don't know a frone frone from a brinkle*. Washington, 1998, f. 3.
- Dod, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 28
- Dorian, N. C., *Varieties of variation in a very small place: social homogeneity, prestige norms and linguistic variation*, United States, 1994, f. 634.
- Drass, K. A., *The Effect of Gender Identity on Conversation Author*. United States, 1986, f.296.
- Drew, P., & Holt E. *Figures of speech: "Figurative expressions and the management of topic. Translation in conversation*, Cambridge, 1998, f. 496.
- Ducrot, O.; Porter, C.; Rabbitt, K., & Waugh, L., *Charles Bally and Pragmatics*, United States, 1991, f. 2-19.
- Dumas, B. K., & Lighter, J., *Is slang a word for linguists?* United States, 1978, f. 12.13.
- Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territoriale që ndikojnë në variantet e shqipes standarde si dukuri sociolinguistike*. Korçë, 2013, f. 381.
- Eckert, P., *Adolescent language*. New York, 2003 f. 52003.
- Ferguson, N., *Simultaneous Speech, Interruptions and Dominance*, England, 1977, f. 295-302.
- Fiedler, W., *Tendencat e formimit të shumësit në shqipen e sotme*, Tiranë, 2011, fq: 154.
- Fishman, J., *Who speaks what language to whom and when?* Paris, 1965, f. 49.
- Fjalori i sotëm i gjuhës shqip*. Tiranë, 1980, f. 98.
- Frazer, T. C., *Review of: America Women Talk by Jennifer Coates*. United States, 1998, f. 416.
- Friedrich, P., *The language parallax: Linguistic relativism and poetic indeterminacy*, Texas, 1980 f. 86.
- Gazeta PANORAMA, *Të ndihesh "inorant" përballë një adoleshenti*, 2012, f. 1.
- Giglioli, P., *Language and Social Context*. United States, 1972, f. 267.
- Gjinari, J., *Rotacizmi në dialekte dhe në gjuhën letrare në "Gjuha jonë"*, Tiranë, 1978 f. 46-47. Cituar në: Çerkezi E., & Billa E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare*. Korçë, 2013, f. 311.
- Gjinari, J. *Përqsja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik*. Tiranë, 1984, f. 2.
- Gjinari, J., *Marrëdhëniet e sotme të dialektikave me gjuhën letrare*, Tiranë, 2011, f. 456.
- Gjinari, J., & Shkurtaj, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë. 2003 f. 178.

- Goetting, A., *Review of: You Just Don't Understand: Women and Men in Conversation by Deborah Tannen Journal*. United States, f. 99.
- Gordon, E., *Sex, Speech, and Stereotypes: Why Women Use Prestige Speech Forms More than Men*. Cambridge, 1997, f. 50.
- Grabias, S., *Jezyk wzachowaniach spolenczynch*, Lublin, 1994 f. 239.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 170.
- Gumpers, J. S., *Linguistic and social interaction in two communities*, United States, 1964 f. 137.
- Harper, D., *Online etymology dictionary*, 2001-2014.  
<http://www.etymonline.com/index.php?term=ok>
- Hendrix, E. H., *Genderly Speaking*. Georgia, USA. 2001. f. 2.
- Holmes, J., *Review of: AmericaLanguage and Gender by Penelope Eckert*, United States, 2004, f. 846-849  
<http://en.wikipedia.org/wiki/Internet>  
<http://en.wiktionary.org/wiki/gay>
- Hudson, R. A., *Sociolinguistics*, Cambridge, 1996 f. 241.
- Hudson, R., *Sociolinguistika*, Tiranë. 2002, f. 25
- Humbolt, W., *Linguistic variability and intellectual development*, Miami, 1971 f. 682.
- Hymes, D., *In vain I tried to tell you: Essays in native American ethnopoetics*, Philadelphia, 1981 f. 74.
- Hysa, R., *Fjalor anglisht-shqip*, Tiranë, 1998, f. 672.
- Ibrahimi, M., *Shtresimet që ndikojnë në variantet e gjuhës standard si dukuri sociolinguistike*. Tiranë, 2011, f. 512.
- Johnson, S. & Meinhof, U. H., *Language and masculinity*. Oxford, 1999, f. 312
- Johnson, G., *Style and Stylistic*. London, 1992, f. 134.
- Johnstone, B., *The individual voice in language*, United States, 2000 f. 405.
- Joseph, J. E., *Ferdinand de Saussure*, United States, 1987, f. 228,
- Juachoerin, *The grammar of Slan*, California, 2004, f. 2.
- Keranen, N., & Bayyurt, Y., *Bridging the Gap Between Teaching Styles and Learning Styles: A Cross-Cultural Perspective*. United States. 2006, f. 1.
- Kollock, P, Blumstein, & Schwartz, P., *Sex and Power in Interaction*. United States, 1985 f. 67.
- Kotrri, P., & Topalli, T., *Gjuha dhe ligjërimi në shkollë në kuadrin e shqipes standard*. Tiranë 2003, f. 407.
- Kramarae, C., *The Voices and Words of Women and Men*. United States, 1983, f. 195.
- Kramsch, C., *Language and culture*. Oxford. 1998, f. 3.
- Krasniqi, V., *“Hi, flm, sps...” - gjuha “moderne” e të rinjve*, Tiranë, 2013, f. 1.
- Kratz, H., *What Is College Slang?* United States, 1964, f. 189.
- Kryeziu, B., *Shqipja mes globalizimit dhe variantizimit*. Tiranë, 2011, f. 94.
- Labov, T., *Language barriers among adolescents*, United States, 1992, f. 346 .

- Labov, T., *Social and language boundaries among adolescents*. United States. 1992, f. 340.
- Labov, W., *Sociolinguistic Patterns*, Philadelphia, 1972, f. 277.
- Labov, T., *American Speech*, Vol. 67, No. 4 339-366, 1992, f. 65.
- Lafe, E., *Gjuha e medias sot—probleme dhe detyra*, Tiranë, 2000, f. 14.
- Lakoff, R., *Language and Woman's Place*. Cambridge, 1973, f. 63
- Lewandowski, M., *Sociolect and registers -A contrastive analysis of two kinds of linguistic variation*, Poloni, 2010, f. 62.
- Likaj, E., *Morfologjia e shqipes standard dhe zhvillime të reja*, Tiranë, 2011, f. 134.
- List of proposed etymologies of OK*. Wikipedia, the free encyclopedia.  
[http://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_proposed\\_etymologies\\_of\\_OK](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_proposed_etymologies_of_OK)
- Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 16-163.
- Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2001, f. 150
- Lloshi, Xh., *Variacioni dhe norma drejtshkrimore*, Tiranë, 1992, f. 249.
- Long, D., *Quasi—standard as a linguistic concept*. United States. 1996, f. 118.
- Louwerse, M., *Semantic variation in idiolect and sociolect: Corpus linguistics. Evidence from literary texts*, Memphis, 2004 f. 207-208.
- Louwrence, M., *Investigating the relation between idiolect and sociolect*. Netherlands, 2004, f. 6.
- Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë. 2003, f. 110.
- Mansaku, S., *Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standard-dallime terminologjike dhe përmbajtësore*. Tiranë, 2011, f. 60-61.
- Mansaku, S., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*. Tiranë, 2003, f. 114.
- Manual për të rinjtë dhe mësuesit: *Adoleshentët dhe çështjet gjinore*. Tiranë, 2005, f. 5.
- Marashi, A., *Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve*, Tiranë, 2011, f. 10.
- Maxwell-Atkinson, J., & Heritage, J., *Structures of Social Action: Studies in Conversation Analysis*, Cambridge, 1984, f. 148.
- Mencken, H. L., *The American language*, New York, 1948, f. 644.
- Monteko, K., *Neologjizmat e fjalorit personal të bazetarëve shqiptarë*, Tiranë, 2009, f. 94.
- Morau, M., “*Sociolinguistique*”, Paris, 1997, f. 163.
- Mujaj, H., *Edukimi gjuhësor dhe indeksikaliteti në gjuhën standarde*. Korçë, 2013, f. 46.
- Mujaj, H., *Zbatimi i gjuhës standard në institucionet shtetërore*, Tiranë, 2011, f. 366.
- Nordquist, R., *What is Family Slang?* United States, 2012, f. 1.
- Ochs, E., *Transcription as Theory*. United States, 1999, f. 68.
- Omari, A., *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, Tiranë, 2011, f. 183.
- Oxford., *Language matters*, London, 2014.

- Paçarizi, Rr., *Rruga e zhvillimit të shqipes standard në raport me nevojat e komunikimit*, Tiranë, 2011, f. 6.
- Pavli, Q., *Fjalori shqip – anglisht*, Tiranë, 1999, f. 921.
- Piluri A., & Dardha D., *Ndikimii mjedisit social në gjuhën e fëmijëve*, Korçë, 2013, f. 140.
- Pragmatics, The Language in Class*, Ohio, 2007, f. 237.
- Qerimi, R., *Disa veçori të së folurës që nuk janë të pranishme në gjuhën standardem*, Tiranë, 2009, f. 1.
- Qosja, R., *Kongresi i drejtshkrimit—tridhjetë vjet pas*, Tiranë, 2003, f. 36.
- Rentel, V. M. & DeStefano, J. S., *Language variation: perspectives for teachers*. Ohio, 2003, f. 329.
- Reves, H. F., *What Is Slang?: A Survey of Opinion*, United States, 1926, f. 218.
- Roberts, J., *Review of: Style and Sociolinguistic Variation by Penelope Eckert; John R. Rickford*, United States, 2003, f. 856.
- Rosen, L., *An Interview with William Labov*. United States, 1979, f. 16-19.
- Rudolf, P., *Review of: Language and Sexuality by Deborah Cameron; Don Kulick*. Cambridge, 2005, f. 277-282.
- Sager, H., *Language, Culture and Communication*, Standford, 1971, f. 58.
- Samara, M., *Roli i dialekteve të shqipes për zhvillimin e normës letrare në fushën e leksikut*. Tiranë, 1992, f. 333.
- Sapir, E., *Selected writings of Edward Sapir in language, culture and personality*, California, 1949 f. 590.
- Scott, A., *Review of: Language and Woman's Place by Robin Lakoff*. United States, 1976, f. 74-75 .
- Shkurtaj, Gj., *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, f. 326.
- Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë 2000 f. 77.
- Shkurtaj, Gj., *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2005, f. 212-213.
- Shkurtaj, Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 33-34.
- Shkurtaj, Gj., *Pesha e fjalës shqipe*. Tiranë, 2009, f. 65.
- Simkins, B. J., and Wildman B., *An Investigation into the Relationships between Gender and Language' Sex Roles*, United Staes, 1991 f. 361.
- Stavri, J. D., *Shqipja standard në epokën dixhitale, prirje, mjete dhe teknologji te reja gjuhësore (2)*, Tiranë, 2012, f. 5.
- Sulejmani, F., *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma*, Tiranë, 2003, f. 113.
- Swaminathan, N., & Gender, J., *Do Women Talk More than Men?* United States, 2007, f. 68.
- Tablot, M., *Language and Gender - An introduction*. . USA, 2010, f. 115.
- Thomai, J., *Lëvizje në leksikun e gjuhës shqipe në kushtet e reja historiko-sociale*, Shkup, nr. 6, 2000, f. 53.
- Thorne, B., *Review of: Language and Woman's Place by Robin Lakoff*. Chicago, 1976, f. 744-746.

- Totoni, M., *Struktura sintaksore e gjuhës letrare shqipe dhe probleme të normës së saj*, Tiranë, 1992, f. 106.
- Trudgill, P., *A glossary of Sociolinguistics*, Oxford, 2002, f. 122.
- Vehbiu, A., *Leksiki i shqipes së sotme - Sfida të pasurimit*. Tiranë, 2011, f. 444.
- Voorhoeve, P., *In memoriam o. L. Helfrich: (1860—1958)*. London, 1958, f. 249-253
- Vossler, K. *Positivismus und idealismus inder sprachwissenschaft*, United States, 1904, f. 278.
- Weiher, C., *Sexism in Language and Sex Differences in Language Usage: Which Is More Important?* United States, 1976, f. 242.
- Wes,t C., *Sexist Language: A Modern Philosophical Analysis*. United States, 1983, f.329 .
- Wikipedia, the free encyclopedia. <http://en.wikipedia.org/wiki/Okay>
- Wikipedia, the free encyclopedia. <http://en.wikipedia.org/wiki/Okay>
- Winson, D. A., *Review of: Talking Power: The Politics of Language by Robin Lakoff*. United States, 1991, f. 99-101.
- Lloshi, Xh., *Stilistika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2001. f.150.
- Khafa, D., *Language and society in context of globalism*, Korçë, 2013, f. 165.
- Zhang, Li-F., *Do age and gender make a difference in the relationship between intellectual styles and abilities?* China , 2010, f. 96.